

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË**  
**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Nr. 134 Akti  
Dt. 01.12.2023

Nr. 134 Vendimi  
Dt. 07.12.2023

**VENDIM**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë prej:

**GJYQTARE - IRENA GJOKA**

asistuar nga sekretare gjyqësore **Bora Totolaku**, sot me datë 07.12.2023, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, kërkesën penale me nr. 134 Akti që i përket:

**KËRKUES:** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar në paraqitjen e kërkesës nga prokurori **Dritan Prençi**.

**OBJEKTI:** LCaktimin e masave të sigurimit personal shtrëngues “*Arresti në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale

**NDAJ PERSONAVE NËN HETIM:**

**1. Lefter Koka**, i biri i Haki-ut dhe i Lumturie-s, i datëlindjes 04.08.1964, lindur dhe banues në Durrës, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

**2. Alqi Bilako**, i biri i Edmond-it dhe i Kostanca-s, i datëlindjes 10.05.1987, lindur në Ersekë banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, dy herë, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.

**3. Pëllumb Abeshi**, i biri i Hamdi-ut dhe i Fatime-s, i datëlindjes 06.05.1958, lindur në Elbasan, banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

**4. Erjon Murataj**, i biri i Selman-it dhe i Ervehe-së, i datëlindjes 02.08.1982, lindur në Sarandë, banues në Tiranë me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare

**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

5. **Taulant Tusha**, i biri i Ndue-s dhe i Drita-s, i datëlindjes 24.06.1977, lindur në Laç, banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare  
**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

6. **Namik Simixhiu**, i biri i Ajet-it dhe i Nezver, i datëlindjes 02.12.1957, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.  
**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

7. **Bledar Karoli**, i biri i Romeo-s dhe i Ferjale-s, i datëlindjes 31.12.1978, lindur në Elbasan, banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.  
**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

8. **Etleva Kondi**, e bija e Goxho-s dhe e Vitori-së, e datëlindjes 29.03.1972, lindur në Vlorë, banues në Tiranë, me gjendje civile beqare, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.  
**E DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

9. **Jetmir Llapaj**, i biri i Edmond-it dhe i Anila-s, i datëlindjes 01.12.1994, lindur në Fier, banues në Tiranë, me gjendje civile beqar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare  
**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

10. **Klodian Zoto**, i biri i Agim-it dhe i Valentina, i datëlindjes 24.04.1976, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare  
**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprave penale “*Mashtrimi*” me pasoja të rënda, në bashkëpunim, “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 143/3, 25, 245 të Kodit Penal, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287, gërmat “a” dhe “b” të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal.

11. **Mirel Mërtiri**, i biri i Trifon-it dhe i Andoniqi-t, i datëlindjes 08.08.1978, lindur në Fier, banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.  
**I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprave penale “*Mashtrimi*” me pasoja të rënda, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 143/3, 25 i Kodit Penal, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287, gërmat “a” dhe “b” të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal.

**II. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “Arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj personave nën hetim:**

12. **Valbona Ballgjini**, e bija e Shyqyri-ut dhe i Diana-s, e datëlindjes 07.07.1985, lindur në Durrës, banues në Tiranë, me gjendje civile e martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.  
**E DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

13. **Alba Thoma**, e bija e Viktor dhe e Irena, e datëlindjes 06.09.1982, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me gjendje civile e martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.  
**E DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

14. **Sidita Kopliku**, e bija e Avenir dhe e Avidane, e datëlindjes 23.10.1988, lindur në Shkodër, banues në Tiranë, me gjendje civile e martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.  
**E DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

15. **Silena Tola**, e bija e Vangjo dhe e Nexhmije, e datëlindjes 02.08.1989, lindur në Poliçan, banues në Tiranë, me gjendje civile beqare, me kombësi dhe shtetësi shqiptare.  
**E DYSHUAR:** Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 228, 229, 230,237,238, 244/1 të K.Pr.Penale.

Gjykata, në dhomë këshillimi pasi shqyrtoi kërkesën, mori provat dhe aktet e paraqitura nga prokurori, si dhe pasi vlerësoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N

Pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në datë 01.12.2023, është paraqitur për gjykim kërkesa e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me objekt caktimin e masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues “*arrest në burg*” dhe “*arrest në shtëpi*”, parashikuar nga nenet 238 dhe 237 të Kodit të Procedurës Penale, për shtetasit nën hetim përmendur në pjesën hyrëse të këtij vendimi, të dyshuar për veprat penale përkatëse.

Gjykimi i kërkesës, bazuar në nenin 278 të Kodit të Procedurës Penale (në lidhje me nenin 13 pika 2 gërma “a” të po këtij Kodi) si dhe në nenin 75/a të Kodi të Procedurës Penale, i ndryshuar me ligjin 35/2017, hyn në kompetencën e kësaj gjykate, pasi ndodhemi para një kërkesë që i përket fazës së hetimeve paraprake dhe që lidhet me procedimin penal, gjykimi i së cilit është në kompetencën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

### **Rrethanat e faktit dhe analiza e provave**

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga ana e Partisë Demokratike të Shqipërisë me datë 22.10.2020 ka regjistruar procedimin penal nr.255 për veprat penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, “*Shpërdorimi i detyrës*”, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale*”, të parashikuara nga nenet 258, 248 dhe 287 të Kodit Penal, procedim penal ky i bashkuar me procedimet penale nr.53 të vitit 2021, nr.45 të vitit 2022, nr.49 të vitit 2022, nr.50 të vitit 2022, nr.54 të vitit 2022, nr.143 të vitit 2022, me objekt hetimi për të njëjtin fakt penal.

Nga aktet e administruara ka rezultuar se në lidhje me kontratën e koncesionit me objekt “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë”, lidhur me datë 31.08.2017, ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë “Integrated Energy

BV S.P.V” sh.p.k, është ndjekur korrespondenca dhe koordinimi mes institucioneve të ndryshme si vijon.

1. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 22239 prot. datë 23.12.2015, ka njoftuar Ministrinë e Mjedisit se Bashkia Tiranë së bashku me Koorporatën Ndërkombëtare Financiare /International Financial Cooperation (IFC), kanë përfunduar studimin për përmirësimin e shërbimit dhe trajtimit të mbetjeve në qytetin e Tiranës dhe për mundësinë e përfshirjes së sektorit privat nëpërmjet Partneritetit Publik Privat. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj shkrese Bashkia Tiranë ka informuar se opsioni i zgjerimit të Landfillit të Sharrës është vlerësuar dhe nga ekspertët e Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Japan International Cooperation Agency (JICA), në kuadër të Masterplanit të Menaxhimit të Mbetjeve për qytetin e Tiranës, si dhe i ka kërkuar Ministrisë së Mjedisit mbështetje për këtë nismë.

2. Me shkresën kthim-përgjigje të Ministrisë së Mjedisit, nr. 1469 prot., datë 03.03.2016, konfirmohet se midis stafeve teknike të dy institucioneve është arritur në përfundimin që kjo procedurë të vazhdohet nga Ministria e Mjedisit duke propozuar ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës.

Në lidhje me përgjigjen me shkresën e mësipërme, që do të jepte Ministria e Mjedisit në drejtim të Bashkisë Tiranë, për përmbajtjen e saj është vënë në dijeni një ditë më parë administratori dhe aksioneri i shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, shtetasi Klodian Zoto, në datën 02.03.2016. Kjo e dokumentuar nga këqyrja dhe marrja e të dhënave nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik nr.93, datë 21.04.2022, në lidhje me ekspertimin e të dhënave të kompjuterit të sekuestruar tek banesa e shtetasit Klodian Zoto, me datë 14.12.2021.

Nga të dhënat e administruara tek kompjuteri i sekuestruar, i shtetasit Klodian Zoto, rezulton se nga adresa elektronike e ish-Këshilltarit të jashtëm të Ministrit të Mjedisit, Lifter Koka, shtetasit Vladimir Bezhani, nga adresa elektronike e tij, “Vladimir.Bezhani@moe.gov.al”, me datë 02.03.2016, është dërguar përmbajtja e shkresës kthim-përgjigje e Ministrisë së Mjedisit, nr.1469 prot., datë 03.03.2016, në drejtim të adresës elektronike të shtetasit Klodian Zoto. “k.zoto@its.al”.

Po ashtu, rezulton se më herët, në datën 19.02.2016, në drejtim të adresës elektronike të shtetasit Klodian Zoto, “k.zoto@its.al”, është dërguar email nga adresa elektronike e shtetasit Vladimir Bezhani, “Vladimir.Bezhani@moe.gov.al”, me këtë përmbajtje:

*“Pershendetje Klodi,*

*Po te dergoj Master Planin per Menaxhimin e Mbetjeve te Ngurta Urbane te Tiranes, hartuar nga JICA ( Japonezet ). Eshte nje material teper i plote, qe do te na sherbej edhe per studimin e fizibilitetit perfundimtar, pavaresisht opsionit qe do te perzgjidhet.*

*Kalofsh nje fund jave te kendshme me familjen.*

*Ladi.”*

Po në këtë datë, më 19.02.2016, ky email, së bashku me dokumentin e titulluar “FR\_Kap\_5\_Masterplani\_i\_MMN.docx”, i cili ka qenë bashkëlidhur email-it, është transferuar nga njëra adresa elektronike e shtetasit Klodian Zoto, “k.zoto@its.al”, në drejtim të adresës elektronike tjetër të tij, “klodiazoto@yahoo.com”.

Me shkresën nr. 6257 prot, datë 03.05.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i është kërkuar informacion Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit në lidhje me marrëdhënien e punësimit të shtetasit Vladimir Bezhani.

Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 6257/1 prot, datë 12.05.2023, të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, rezulton se shtetasi Vladimir Bezhani ka qenë ish punonjës i Ministrisë së Mjedisit i emëruar në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Mbetjeve dhe Aksidenteve Industriale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Mjedisit, këtë pozicion e ka mbajtur deri në datë 07.11.2014, pasi marrëdhëniet e punës për shtetasin Vladimir Bezhani kanë përfunduar me urdhrin e lirit, nr. 1978, datë 07.11.2014.

Me shkresën nr. nr. 7189 prot., 22.05.2023, i është kërkuar informacion Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit në lidhje me punonjësin e këtij institucioni që ka përdorur adresën e postës elektronike "Vladimir.Bezhani@moe.gov.al" pas datës 07.11.2014.

Me shkresën kthim-përgjigje nr.3316/1 prot. datë 31.05.2023, të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, është konfirmuar se në arkivin e saj nuk gjendet dokumentacion mbi hapjen dhe mbylljen e postës elektronike të shtetasit Vladimir Bezhani.

I pyetur për këtë fakt shtetasi **Vladimir Bezhani**, ka deklaruar se në vitin 2014 ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Mjedisit, me pozicionin "Përgjegjës Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve", me detyrë kryesisht në hartimin e politikave të menaxhimit të mbetjeve, si strategjia kombëtare e mjedisit, hartimin e legjislacionit në fushën e mbetjeve, dhe ndjekjen e projekteve në fushën e mbetjeve të financuara si nga buxheti i shtetit, ashtu edhe organizatat e huaja. Këtë detyrë e ka ushtruar deri në datën 07.11.2014, kohë, në të cilën ka dalë në pension. Pas kësaj date, ai deklaroi se ka punuar në sektorin privat, konkretisht, specialist në shoqërinë "Integrated Technology Services" sh.p.k, me pronar shtetasin Klodian Zoto, me rrogë fikse neto, 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë, që kishte si detyrë për të zgjidhur problemet teknologjike. Pranë kësaj shoqërie ka punuar deri nga fundi i vitit 2021. Ai deklaroi se nuk ka pasur ndonjë zyrë tek kjo shoqëri, pasi për punën që bënte, përfaqësuesit e shoqërisë ia dërgonin nëpërmjet email-it detyrat dhe projektet që duhet të punonte dhe pasi ai i përfundonte detyrat që i ishin ngarkuar, i dërgonte po nëpërmjet email-it, si edhe në raste të nevojshme ka shkuar vetë në zyrat e shoqërisë që ishin pranë "Sky Toëer". Shtetasi Vladimir Bezhani deklaroi se pranë shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, është marrë me këshillimin e publikut për të sqaruar mbi ndikimin në mjedis që do të kishte teknologjia e përdorur nga kjo shoqëri në mjedis. Ai deklaroi se tek Inceneratori i Tiranës ka dhënë informacion në lidhje me sasinë e mbetjeve të qarkut, strukturën e mbetjeve të qarkut që do të trajtohej në këto impiante, si edhe për projektin e landfillit, të cilin e krahasonte me standartet që ishin vendosur nga Këshilli i Ministrave dhe standartet Europiane. Ai deklaroi se këto informacione i kishte nga studime të mëparshme si JICA, studime nga Banka Botërore, studime nga KFË Gjermane, informacione të cilat i ka aksesuar, nëpërmjet internetit, si dhe nga puna e mëparshme në Ministrinë e Mjedisit, ku kishte pasur si detyrë ndjekjen e këtyre projekteve. Ai deklaroi se teknologjia për incenerimin e mbetjeve në Inceneratorin e Tiranës, referuar projektit, ishte shumë e avancuar, por që nuk është realizuar deri më sot. Po ashtu, ai deklaroi se në projektin e Inceneratorit të Tiranës ka pasur një linjë riciklimi automatike që kushtonte rreth 3,000,000 (tre milion) Euro, e cila nuk është vendosur, por në vend të kësaj linje është vendosur një linjë seleksionimi e zakonshme, që kushtonte më pak dhe që kërkonte seleksionim manual, linjë, e cila herë vendosej në punë dhe herë nuk vendosej. Ai deklaroi se ka qenë Këshilltar i jashtëm i ish Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, për përiudhën nga momenti që ka dalë në pension, në vitin 2014 deri në momentin që shtetasi Lefter Koka është larguar si Ministër i Mjedisit. Ai deklaroi se duke qenë se për shkak të formimit të tij, ishte e nevojshme konsulenca për Ministrinë e Mjedisit, ish-Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, shtetasi Alqi Billako, i ka sugjeruar që të ishte Këshilltar i jashtëm i Ministrit të Mjedisit, por duke qenë se nuk do të paguhej nga Ministria e Mjedisit, shtetasi Alqi Billako i ka thënë që

për të marrë pagën, do ta punësonte atë tek shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, ku dhe është punësuar. Ai deklaroi se gjatë periudhës kohore nga viti 2014 deri në vitin 2021 ka punuar tek shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k. nga viti 2014 deri në vitin 2017 nuk ka patur kontratë punë, ndërsa më vonë, pasi kishte përfunduar procedura e dhënies së Inceneratorit, ai ka lidhur kontratë formale pune me shoqërinë e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k. Ai deklaroi se gjatë kohës që ka punuar si Këshilltar i jashtëm i Ministrisë të Mjedisit Lefter Koka dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit Alqi Bllako ka patur në përdorim edhe adresën e email-it zyrtar të Ministrisë së Mjedisit. "[Vladimir.Bezhani@moe.gov.al](mailto:Vladimir.Bezhani@moe.gov.al)", adresë, të cilin e ka patur në përdorim që nga viti 2011 deri në vitin 2017, kohë që ka punuar në Ministrinë e Mjedisit. Ai deklaroi se tek kjo adresë emaili ka patur akses vetëm ky shtetas dhe askush tjetër. I pyetur në lidhje me komunikimet elektronike që ka patur me shtetasin Klodian Zoto, duke i siguruar atij dokumente dhe informacione, të cilat kanë shërbyer si të dhëna që janë përdorur për hartimin e studimit të fizibilitetit nga shoqëria propozuese e shtetasit Klodian Zoto, ai deklaroi se këto dokumente i ka siguruar nga puna e tij në Ministrinë e Mjedisit dhe ia ka vendosur në dispozicion shtetasit Klodian Zoto, pasi gjatë kohës që punonte si Këshilltar i jashtëm i Ministrisë, pa pagesë, ai ka qenë i punësuar edhe tek shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k.

I pyetur në lidhje me komunikimin elektronik me shtetasin Klodian Zoto, të datës 28.06.2016, shtetasi Vladimir Bezhani deklaroi se email-in dhe shkresën që ka të bëjë me kthimin e përgjigjes pozitive, në drejtim të shtetasit Klodian Zoto, përse i përket propozimit të pakërkuar të ardhur në Ministrinë e Mjedisit nga shoqëria propozuese, e ka konceptuar ai, pasi ka vënë në dijeni Ministrin Lefter Koka dhe Sekretarin e Përgjithshëm Alqi Bllako, se duhej t'i kthenin përgjigje pozitive shoqërisë propozuese të shtetasit Klodian Zoto. Ai deklaroi se e ka konceptuar këtë shkresë, por duke qenë se nuk kishte të drejtë nënshkrimi, kjo shkresë është nënshkruar nga ish vartësja e tij, shtetasja Ledjana Karalliu, dhe më pas është nënshkruar sipas hierarkisë së shkresave, deri tek Sekretari i Përgjithshëm Alqi Bllako dhe Ministri i Mjedisit, Lefter Koka. Ai deklaroi se kjo shkresë është konceptuar, pasi ai është udhëzuar nga Ministri i Mjedisit, Lefter Koka dhe Sekretari i Përgjithshëm Alqi Bllako. I pyetur për komunikimet që kanë rezultuar me shtetasin Klodian Zoto në lidhje me sasitë e mbetjeve të depozituara në landfillin e Sharrës gjatë vitit 2015, ai deklaroi se ia ka nisur këto të dhëna shtetasit Klodian Zoto, pasi i duheshin atij për të hartuar një studim fizibiliteti dhe sqaron se shtetasi Klodian Zoto nuk kishte asnjë mundësi të hartonte një studim fizibiliteti të tillë, por studimin e fizibilitetit të shtetasit Klodian Zoto e ka hartuar një kompani tjetër italiane, por që nuk ia kujton emrin, si dhe studimin e fizibilitetit, shtetasi Klodian Zoto e ka dorëzuar në një moment tjetër në Ministrinë e Mjedisit dhe jo në momentin kur ka dorëzuar letrën e interesit për propozimin e pakërkuar. Ai ka deklaruar se pasi shoqëria "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k, ishte shpallur fituese e koncesionit të Inceneratorit të Tiranës, shtetasi Mirel Mërtiri i ka paraqitur të gjithë projektin e skicuar në letër, ndër të tjera ishte edhe impianti i riciklimit të mbetjeve, një teknologji shumë e përparuar. Ai deklaroi se në dijeninë e tij shtetasi Klodian Zoto ishte pronari i shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV S.P.V." sh.p.k.

Në rrethana të mësipërme rezultoi se nga ana e Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit, ka një komunikim më të hershëm mes saj dhe shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, përpara se të bëhej propozimi i pakërkuar nga kjo shoqëri.

3. Me shkresën nr.16/044, datë 23.06.2016, shoqëritë “Energy Recuperator S.P.A”, “Paul Ēurth Italia S.P.A” “Integrated Technology Services” sh.p.k, kanë dërguar shkresën pranë Ministrisë së Mjedisit, me lëndë “Letër interesi”. Nga dokumentacioni i marrë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sipas procesverbalit të këqyrje dhe marrjes, datë 01.02.2023, rezulton se kjo shkresë nuk ndodhet e administruar pranë Autoritetit Kontraktor, në Ministrinë e Mjedisit apo në Ministrinë së Infrastrukturës dhe Energjistikës, por që përmbajtja e kësaj shkrese është e administruar tek dokumentet e kompjuterit të sekuestruar, të shtetasit Klodian Zoto.

Nga të dhënat e administruar tek kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimi teknik kompjuterik nr.93, datë 21.04.2022, rezulton se shkresa e mësipërme “Letër interesi”, dërguar nga shoqëritë e mësipërme në Ministrinë e Mjedisit me datë 23.06.2016, është hartuar fillimisht nga Këshilltari i jashtëm i Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, shtetasi Vladimir Bezhani, i cili në datën 15.06.2016, ia ka dërguar këtë shkresë me email shtetasit Klodian Zoto, në adresat e email-it të tij, të përshkruara më sipër. Më pas, në datën 20.06.2016 kjo shkresë është përpunuar nga punonjësja e shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, shtetasja Sevi Zani, e cila tek adresa e email-it të saj, “sevizani@gmail.com”, ia ka dërguar këtë shkresë për aprovim shtetasve Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, tek adresat elektronike respektive “mirelmertiri@gmail.com” dhe “klodianzoto@yahoo.com”. Në datën 21.06.2016, kjo shkresë është nisur nga punonjësja e shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, shtetasja Sevi Zani, tek adresat elektronike të përfaqësuesve të shoqërive të huaja, “Paul Ēurth Italia SPA”, “Energy Recuperator SPA”, “De Mare Sri”, “Arcadis”.

I pyetur për këtë fakt, shtetasi Vladimir Bezhani deklaroi se ai e ka hartuar letrën e interesit, që shoqëria propozuese ka dërguar në Ministrinë e Mjedisit, si propozim i pakërkuar. Ai deklaroi se gjatë kësaj kohe ai ka qenë në pozicionin e Këshilltarit të jashtëm të Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, njëkohësisht ka qenë i punësuar tek shoqëria e shtetasit “Integrated Technology Services” sh.p.k. Kjo shkresë është konceptuar nga ai, pasi ia kishte kërkuar shtetasi Klodian Zoto.

4. Me shkresën kthim-përgjigje të Ministrisë së Mjedisit, nr. 4101/1 prot., datë 28.06.2016, konfirmohet në drejtim të shoqërive “Energy Recuperator S.P.A”, “Paul Ēurth Italia S.P.A” “Integrated Technology Services” sh.p.k, dhe për dijeni Bashkisë Tiranë, duke e konsideruar shkresën me propozimin e shoqërive, si “propozim të pakërkuar” në mbështetje të nenit 25, të ligjit 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” dhe në vlerësimin e këtij propozimi, Ministria e Mjedisit shprehet se propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm dhe paraqet interes publik, si dhe i ka kërkuar dokumentacion shtesë. Kjo shkresë kthim-përgjigje është konceptuar nga shtetasja Lediane Karalliu, miratuar nga shtetasi Athanas Karaja, konfirmuar nga shtetasi Pëllumb Abeshi dhe nënshkruar nga shtetasi Lefter Koka.

E pyetur për këtë fakt shtetasja Ledjana Bojaxhi (Karalliu), me funksionin Përgjegjëse për mjedisin në Ministrinë e Mjedisit, e cila pasi është njohur me shkresën e mësipërme, ajo ka deklaruar se nënshkrimi që gjendet pranë emrit të saj është e saj, por nuk i kujtohet nëse shkresa është konceptuar nga ajo. Ajo deklaroi se ky model shkrese mund të ketë qenë gati edhe për dy koncesionet e tjera, atë të Elbasanit dhe të Fierit dhe e ka marrë modelin gati, dhe thjesht e ka riformuluar, ose shkresa mund të jetë konceptuar nga ndonjë punonjës i Ministrisë së Mjedisit dhe asaj i ka shkruar thjesht për ta firmosur, dhe pasi e ka parë atë i është dukur në rregull përse i përket Ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe në përputhje me VKM nr. 175, datë 19.01.2011, lidhur me

strategjinë dhe planin kombëtar për menaxhimin e mbetjeve. Ajo shprehet se në këndvështrimin e saj kjo përgjigje nuk duhej të kishte dalë nga Sektori i Mbetjeve, por duhet ta kishte trajtuar Drejtoria Juridike, ose në bashkëpunim nga të dy Drejtoritë. pasi Sektori i Mbetjeve mund të shprehej vetëm për ligjin e mbetjeve dhe strategjinë dhe planin kombëtar për menaxhimin e mbetjeve. Ajo deklaron se nuk i kujtohet që ajo të këtë kthyer këtë përgjigje, dhe as nuk i kujtohet nëse e ka orientuar dikush për të kthyer këtë përgjigje. Ajo ka deklaruar se e njeh shtetasin Vladimir Bezhani, pasi ai ka punuar Përgjegjës i Sektorit të Mbetjeve deri rreth vitit 2014, kur ai ka dalë në pension. Ajo deklaron se pas daljes në pension, shtetasi Vladimir Bezhani ka vazhduar Këshilltar në Ministrinë e Mjedisit. Shtetasi Vladimir Bezhani gjatë kohës që ka qenë Këshilltar, i ka kërkuar asaj t'i drejtohet me shkresa institucioneve dhe bashkive të ndryshme, për të marrë informacione në fushën e mbetjeve. Po ashtu, shtetasi Vladimir Bezhani e ka ndihmuar atë edhe në shkresat kthim-përgjigjet që ajo ka bërë në emër të Ministrisë së Mjedisit. Ajo deklaron se gjatë kohës që ka qenë Këshilltar, shtetasi Vladimir Bezhani ka patur në përdorim adresën e email-it zyrtar të Ministrisë së Mjedisit, "[Vladimir.Bezhani@moe.gov.al](mailto:Vladimir.Bezhani@moe.gov.al)".

Nga këqyrja e të dhënave të aktit të ekspertimit teknik kompjuterik, nr. 93, datë 21.04.2022, kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, rezulton se në datën 23.06.2016, kur është dërguar "Letër Interesi" në Ministrinë e Mjedisit, shoqëritë "Energy Recuperator S.P.A", "Paul Ēurth Italia S.P.A" "Integrated Technology Services" sh.p.k, ende nuk e kishin hartuar studimin e fizibilitetit, pasi nga analizimi i të dhënave të këtij akt ekspertimi rezulton se ka komunikime ndërmjet punonjësve të shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, ku rezulton se studimi i fizibilitetit nuk ishte përfunduar akoma.

Me shkresën nr. 5474 prot., datë 24.08.2016, Ministria e Mjedisit ju është drejtuar Bashkisë Tiranë, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), për caktimin e anëtarëve të komisionit të dhënies së koncesionit me objektin "Për dhënien me koncesion/ppp, ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese, Tiranë".

Në kohën kur Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit ka kërkuar caktimin e anëtarëve të Komisionit të dhënies së koncesionit, nuk ka patur ende një projekt konkret të dorëzuar nga shoqëritë "Energy Recuperator S.P.A", "Paul Ēurth Italia S.P.A" "Integrated Technology Services". Në lidhje me veprimet e Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit, për caktimin e anëtarëve të komisionit të koncesionit/PPP, rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e nenit 3 pika 3, të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar.

5. Me datë 31.08.2016 shoqëria holandeze "Integrated Energy B.V", e formuar nga bashkimi i tre shoqërive "Energy Recuperator S.P.A", "Paul Ēurth Italia S.P.A", "Integrated Technology Services" sh.p.k, i ka dërguar shkresë Ministrisë së Mjedisit dhe për dijeni Bashkisë Tiranë, ku vetëm liston dokumentet e kërkuara nga Ministria e Mjedisit me shkresën e datës 28.06.2016, pa dokumentacion shoqërues të kësaj shkrese. Shkresa e nisur nga operatori ekonomik "Integrated Energy B.V" ka në fund të saj një vulë, por mungon nënshkrimi i përfaqësuesit të shoqërisë.

Nga këqyrja dhe marrja e dokumentacionit pranë Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, me datë 01.02.2023, si dhe nga korrespondenca shkresore me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, rezulton se nuk ka dokumentacion bashkëlidhur shkresës së mësipërme. Shkresa e nisur nga shoqëria "Integrated Energy B.V", ka në fund të saj një vulë, por mungon nënshkrimi i përfaqësuesit të shoqërisë.

Me shkresën nr.7770 prot, datë 31.05.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i është kërkuar Ministrisë së Mjedisit një kopje e njësuar me origjinalin, e dokumentacionit në lidhje me shkresën e dërguar nga shoqëria 'Integrated Energy BV', së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur kësaj shkrese, shkresë e cila është protokolluar në Ministrinë e Mjedisit me nr.4101/2 prot., datë 01.09.2016.

Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 3535/1 prot, datë 06.06.2023, të Ministrisë së Mjedisit, është dërguar një kopje me origjinalin e të gjithë dokumentacionit që gjendet në arkivin e këtij institucioni, përsa i përket procedurës koncesionare me objekt: "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzituese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, rezulton se nuk gjendet asnjë nga dokumentet, të cilat citoohen të listuar nga shoqëria propozuese "Integrated Energy B.V" me shkresën e datës 31.08.2016, shkresë e cila është protokolluar me nr.4101/2 prot., datë 01.09.2016, në Ministrinë e Mjedisit.

7.Me shkresën kthim-përgjigje nr.25796/1 prot., datë 01.09.2016, të Bashkisë Tiranë, protokolluar në Ministrinë e Mjedisit me nr.5474/3 prot., datë 05.09.2016, është konfirmuar për anëtarët pjesëmarrës në Komisionin e dhënies së koncesionit, ku Bashkia Tiranë ka caktuar si anëtar shtetasit Taulant Tusha, me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Publike dhe Namik Simixhiu, me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pastrimit të Mbetjeve Urbane.

8.Me shkresën kthim-përgjigje të Agjencisë së Trajtitit të Koncesioneve (ATRAKO), nr.243/1 prot., datë 01.09.2016, protokolluar në Ministrinë e Mjedisit me nr.5474/2 prot., datë 02.09.2016, është konfirmuar në lidhje me anëtarët pjesëmarrës në Komisionin e dhënies së koncesionit, ku ATRAKO ka caktuar si anëtar specialistët shtetasit Erjon Murataj dhe Sidita Temali.

9.Me shkresën kthim-përgjigje të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, nr.5349/1 prot., datë 01.09.2016, protokolluar në Ministrinë e Mjedisit me nr.5474/1 prot., datë 01.09.2016, është konfirmuar për anëtarët pjesëmarrës në Komisionin e dhënies së koncesionit, ku Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka caktuar si anëtar shtetasen Etleva Kondi, me Detyrë Drejtoreshë e Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit.

Po ashtu, nga të dhënat e administruara tek kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik, nr.93, datë 21.04.2022, rezulton se me datë 02.09.2016 nga adresa e postës elektronike të shtetasit Klodian Zoto "klodianzoto@yahoo.com", është dërguar dokumentacion nëpërmjet aplikacionit "ëtransfer", në drejtim të adresave elektronike të shtetasve Valbona Ballgjini, me detyrë Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mjedisit dhe Alba Thoma, me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Mjedisit, në adresat respektive "vballgjini@hotmail.com" dhe "albathoma82@gmail.com", me këtë përmbajtje: Files (165MB total) "Bussines plan Tirana.pdf" "EIA Tirane anglisht.pdf" "Studim fizibiliteti Tirane anglisht.pdf".

Në rrethanat e mësipërme, rezulton se nga shoqëria holandeze "Integrated Energy BV" nuk është nisur në rrugë zyrtare dokumentacioni i kërkuar nga Ministria e Mjedisit sipas shkresës së datës 28.06.2016. Ky dokumentacion është nisur nga shtetasi Klodian Zoto nëpërmjet adresave të email-it privat tek shtetaset Valbona Ballgjini dhe Alba Thoma. Rezulton se në datën kur është dërguar email-i, datë 02.09.2016, shtetasja Valbona Ballgjini ende nuk ishte

emëruar nga Autoriteti Kontraktor në Komisionin e dhënies së koncesionit. Pra, shtetasi Klodian Zoto ka qenë në dijeni të përbërjes së komisionit të dhënies së koncesionit, ende pa u shpallur zyrtarisht komisioni nga Autoriteti Kontraktor.

Sipas procesverbalit të deklarimit të shtetases **Alba Thoma**, Ish Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Mjedisit, për faktin se nga adresa e email-it të shtetasis Klodian Zoto, "klodiazoto@yahoo.com" me datë 02.09.2016, para se të ngrihej komisioni i dhënies së koncesionit, në adresën e emailit personal të saj, "albathoma82@gmail.com", është dërguar dokumentacion në lidhje me procedurën e dhënies koncesionit të Inceneratorit të Tiranës, ajo ka deklaruar se nuk di se kush ia ka vënë në dispozicion apo se kush i ka thënë shtetasis Klodian Zoto që t'i niste asaj dokumentet e mësipërme. Ajo deklaron se dokumentacioni fizik është përcjellë në Ministrinë e Mjedisit zyrtarisht në "hard copy". përpara se të nisej me email tek adresa e saj personale "albathoma82@gmail.com". Ajo deklaron se atë e ka orientuar Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, shtetasi Alqi Bllako, që të komunikojë herë pas here me përfaqësuesin e shoqërisë propozuese, shtetasin Klodian Zoto, që t'i siguronte informacionet e nevojshme që nevojiteshin për të konceptuar shkresat përkatëse dhe më pas për t'ja përcjellë Ministrisë së Financave apo insitucioneve të tjera të përfshira në këtë procedurë, kur ishte nevoja. Po ashtu, ajo deklaron se me shtetasin Klodian Zoto e ka prezantuar shtetasi Alqi Bllako që në procedurën koncesionare të Inceneratorit të Elbasanit. Po ashtu, deklaron se adresën e email-it dhe numrin e celularit të shtetasis Klodian Zoto ia ka dhënë shtetasi Alqi Bllako. Ajo deklaron se ka qenë e përfshirë në këtë procedurë, pasi në pikën e fundit të Urdhrit të Ministrit të Mjedisit, ka qenë Drejtorja Juridike e caktuar në rolin e Sekretariatit Teknik.

Sipas procesverbalit të deklarimit të shtetases **Valbona Ballgjini**, Ish Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mjedisit, për faktin se si i është vendosur në dispozicion Komisionit të dhënies së Koncesionit dokumentacioni i shoqërisë propozuese, ajo ka deklaruar se nuk i kujtohen rrethanat e disponimit të këtij dokumentacioni. E pyetur për faktin se nga adresa e email-it të shtetasis Klodian Zoto, "klodiazoto@yahoo.com", me datë 02.09.2016, para se të ngrihej komisioni i dhënies së koncesionit, në adresën e emailit personal të saj "vballgjini@hotmail.com", është dërguar dokumentacion në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit të Inceneratorit të Tiranës, ajo deklaron se ka komunikuar me shtetasin Klodian Zoto, pasi i ka thënë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, shtetasi Alqi Bllako që do t'i sillte disa dokumente një përfaqësues i shoqërisë propozuese, dokumente të cilat ia ka dorëzuar më pas shtetasis Alqi Bllako.

10. Me urdhrin nr.169, datë 05.09.2016, të Ministri i Mjedisit, **Lefter Koka**, është ngritur **komisioni për dhënie me koncesion/ppp**, me objekt: "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese, Tiranë", përbërë nga shtatë persona, me kryetare shtetasen **Valbona Ballgjini** dhe anëtar shtetasit **Pëllumb Abeshi**, **Erjon Murataj**, **Sidita Temali**, **Etleva Kondi**, **Taulant Tusha**, **Namik Simixhiu**.

Me anë të këtij urdhri, anëtarët e komisionit janë ngarkuar për kryerjen e veprimeve, si më poshtë:

- a) Hartimin e studimit të fizibilitetit për koncesionin/ppp;
- b) Për përcaktimin e procedurës të zbatueshme për dhënie me koncesion/ppp dhe hartimin e dokumentacionit të tenderit;
- c) Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të pranuar dhe/ose, kërkësat për pjesëmarrje që janë dorëzuar;

- d) Formulimin dhe propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit, si dhe një shpjegim të tyre;
- e) Kryen të gjitha aktivitetet e tjera që ngarkohen për zbatimin e procedurës së koncesionit/ppp, në përputhje me rregulloret në fuqi;
- f) Komisioni i dhënies së koncesionit/ppp mban procesverbale për pasqyrimin e punës së tij, të cilat nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Për zbatimin e këtij urdhri janë ngarkuar Komisioni i dhënies së koncesionit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mjedisit dhe Jetësisimit të Prioriteteve dhe Sektori i Prokurimeve dhe Trajtimit të Koncesioneve.

11.Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së të dhënave tek kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik, nr.93, datë 21.04.2022, rezulton se me datë 09.09.2016, në orën 11:15, nga adresa elektronike private e anëtares së komisionit Etleva Kondi, "etlevakondi@yahoo.it", është dërguar dokumentacioni i emërtuar "Procedural Mapping-Ministria e Mjedisit.xlsx", në drejtim të adresës elektronike të shtetasit Klodian Zoto "klodianszoto@yahoo.com". Ky dokumentacion përmban hapat që do të ndiqeshin për dhënien e një koncesioni të projektit, duke i nisur për analogji "hapat proceduriale-dhenia me koncesion e ndertimit e administrimit te impjantit te trajtimit te mbetjeve urbane te qarkut Fier dhe prodhim energjie".

Po në datën 09.09.2016, në orën 12:09, shtetasi Klodian Zoto, nga adresa elektronike e tij, "klodianszoto@yahoo.com", ka nisur në drejtim të adresës elektronike private të kryetares së komisionit të dhënies së koncesionit, Valbona Ballgjini, "vballgjini@hotmail.com", dokumentin me të njëjtën përmbajtje të hapave proceduriale, siç i ishte nisur nga shtetasja Etleva Kondi, duke ndryshuar vetëm emërtimin e titullit të tabelës "hapat proceduriale-dhenia me koncesion e ndertimit e administrimit te impjantit te trajtimit te mbetjeve urbane te qarkut TIRANE dhe prodhim energjie".

Në rrethana të mësipërme, rezulton se shtetaset Etleva Kondi dhe Valbona Ballgjini kanë patur komunikime me shtetasin Klodian Zoto, pronari i shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, të cilit i është dhënë konsulencë juridike për hapat e ndjekjes procedurës së dhënies së koncesionit.

12.Me datë 09.09.2016, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr.1, të cilët kanë shqyrtuar propozimin e pakërkuar të shoqërive "Paul Eürth Italia SPA" "Energy Recuperator SPA", "Integrated Technology Services" sh.p.k. Në këtë takim, Komisioni është njohur me dokumentacionin që kanë dorëzuar shoqëritë e mësipërme, si plani i biznesit, studimi i fizibilitetit, raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe studimi teknik. Komisioni ka vendosur që të thërrasë në mbledhjen e radhës përfaqësues të shoqërisë, me qëllim prezantimin e projektit dhe shterimin e pikëpyetjeve të Komisionit.

13.Me datë 20.09.2016, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes, nr .2, ku kanë qenë prezent edhe përfaqësues të shoqërisë propozuese, të cilët kanë bërë një prezantim të studimit të fizibilitetit, të dorëzuar nga kjo shoqëri pranë Ministrisë së Mjedisit. Në këtë mbledhje, nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë është ngritur problematika e mungesës së të ardhurave të Bashkisë Tiranë për të përballuar kostot e implementimit të projektit. Sipas tyre, tarifa e pastrimit që mblidhet nga ky institucion nuk mjaftonte për të përballuar as shpenzimet që kishte në atë moment Bashkia Tiranë. Përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë kanë kërkuar mundësinë e financimit në masën 100% të kostove të depozitimit të mbetjeve në implant, jo vetëm për ta, por edhe për bashkitë e tjera

të Qarkut Tiranë, së paku për 4 vitet e para të projektit, pasi mendonin që me ndarjen e re territoriale do të ishin në gjendje të përballonin një pjesë të kostove të menaxhimit të mbetjeve urbane të Qarkut Tiranë.

14.Me datë 23.09.2016, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr .3, të cilët kanë diskutuar në lidhje me studimin e fizibilitetit, si dhe në lidhje me mungesën e të ardhurave të Bashkisë Tiranë, për të përballuar kostot e implementimit të projektit. Po ashtu, në këtë mbledhje është diskutuar në lidhje me zonën ku do të implementohej projekti, pasi një pjesë e saj ishte në pronësi private. Komisioni në këtë mbledhje ka vendosur që t'i kërkohet ZVRPP-së Tiranë, për statusin juridik të pronës, si dhe, meqenëse kërkohet mbështetje financiare për depozitimin e mbetjeve në impiant nga ana e bashkive, të cilat do të ishin pjesë e procesit, projekti t'i dërgohej për miratim paraprak Ministrisë së Financave.

15.Me shkresën nr. 5474/4 prot, datë 27.09.2016, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Alqi Billako, i është dërguar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, kërkesa për informacion për zonën kadastrale 3321. në lidhje me statusin juridik të sipërfaqes prej 120 ha në këtë zonë kadastrale.

16.Me shkresën nr. 5474/5 prot. datë 28.09.2016, të Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, i është dërguar Ministrisë së Financave kërkesa për miratim paraprak të studimit ekonomik financiar, për procedurën koncesionare “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese, Tiranë”. Në këtë shkresë, ndër të tjera, përkruhet se për 8 vitet e para, Bashkitë e Qarkut Tiranë, konkretisht Bashkia Tiranë, Vorë, Kamëz dhe Kavajë nuk disponojnë të ardhura të mjaftueshme për depozitimin e mbetjeve në impiant dhe propozohet që për këto 8 vite, këto institucione të mbështeten financiarisht nga qeveria qëndrore.

17.Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 13118/1 prot., datë 17.10.2016, Ministria e Financave ka njoftuar Ministrinë e Mjedisit se nuk mund të shprehet për këtë projekt koncesionar/ppp, për sa kohë që nuk janë plotësuar kushtet, kriteret dhe dokumentacioni përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Gjithashtu, Ministria e Financave i sjell në vëmendje Ministrisë së Mjedisit që përpara dërgimit për miratim në Ministrinë e Financave, të kishte parasysh që kostot përkatëse të projektit të jenë të planifikuara të përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuara nga Kuvendi dhe nga Këshilli i Ministrave, si një detyrim i parashikuar në nenin 22 të VKM-së nr.575/2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion,partneritet publik privat”, të ndryshuar.

18.Me datë 01.11.2016, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr.4, ku është diskutuar mbi studimin e thelluar financiar të paraqitur nga shoqëria, si dhe mbi tërësinë e studimit të fizibilitetit, ku është vendosur që do t'i kërkohen shoqërisë propozuese disa të dhëna shtesë për pjesën ekonomike dhe do t'i dërgohen komisionit me email. Gjithashtu, në këtë takim është diskutuar në lidhje me bonusin që propozohet të fitonte shoqëria. Në këtë takim, komisioni ka vendosur që do të vazhdonte punën për përfundimin e studimit të fizibilitetit dhe hartimin e draft-kontratës.

19.Me datë 04.11.2016, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin nr.5, ku në këtë takim ka vendosur se studimi ekonomik i paraqitur nga shoqëria, i plotësonte elementet ligjorë që kërkon një studim ekonomik dhe social. Në këtë takim, komisioni ka vendosur që t'i propozojë Ministrisë së Mjedisit hartimin dhe fillimin e procedurave për dhënien e bonusit prej 8% të pikëve shoqërisë propozuese. Komisioni do të vazhdonte

punën për përfundimin e studimit të lizibilitetit dhe hartimin e draft-kontratës deri në akordimin e bonusit shoqërisë prej 8 pikësh. nga Këshilli i Ministrave.

20.Me shkresën nr. 5474/8 prot, datë 07.11.2016, Ministri i Mjedisit, Lefter Koka, ka dërguar projektvendimin për miratim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, nëpërmjet të cilit, ka kërkuar që shoqërisë "Integrated Energy BV" t'i jepej bonus prej 8% të pikëve, në rast se ai merr pjesë në garë. Projektvendimi është shoqëruar me relacionin përkatës, konceptuar nga shtetasja Alba Thoma, nën cilësinë e Drejtoreshës Juridike të Ministrisë së Mjedisit dhe miratuar nga shtetasi Alqi Bllako, nën cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, nënshkruar nga Ministri i Mjedisit, Lefter Koka. Në këtë relacion përshkruhet se projekt idea është me interes publik dhe paraqitet si propozim i pa kërkuar nga shoqëria "Integrated Energy BV" sh.p.k. Gjithashtu, përshkruhet se kjo shoqëri është e regjistruar konform ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në pikën 9 të këtij relacioni, "Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzime buxhetore", përshkruhet se kjo procedurë koncesionare, nëse përfundon me sukses, nuk do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit, pasi kemi të bëjmë tërësisht me një investim privat.

Nga aktet e administruara rezulton se shoqëria "Integrated Energy BV", nuk ka qenë ndonjëherë e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, por rezulton se me datën 31.08.2017, në Qendrën Kombëtare të Biznesit është regjistruar shoqëria "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k, datë që përkon me datën e lidhjes së kontratës ndërmjet shoqërisë fituese të koncesionit, "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k dhe Autoritetit Kontraktor, Ministrisë së Mjedisit.

Sa më sipër, në lidhje me dokumentacionin shoqëruar të projektvendimit për dhënien e bonusit shoqërisë holandeze propozuese, "Integrated Energy BV", rezulton se relacioni i dërguar Këshillit të Ministrave nga ana e Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit, në pikën 9 të relacionit, për bonusin, ku përshkruhet se *"se kjo procedurë koncesionare nëse përfundon me sukses nuk do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit pasi kemi të bëjmë tërësisht me një investim privat"*, bie ndesh me shkresën me nr. 5474/5 prot., datë 28.09.2016, ku Ministria e Mjedisit ka informuar Ministrinë e Financave *"që për 8 vitet e para Bashkitë e Qarkut Tiranë dhe konkretisht bashkia Tiranë, Vorë, Kamëz dhe Kavajë nuk disponojnë të ardhura të mjaftueshme për depozitimin e mbetjeve në impiant dhe propozohet që për këto 8 vite këto institucione të mbështeten financiarisht nga qeveria qendrore"*.

21.Me shkresën nr. 5474/9, datë 09.11.2016, Ministria e Mjedisit i ka dërguar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, ri-kërkesën për statusin juridik të pronës ku do të implemetohej projekti.

22.Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 6490/1 prot., datë 15.11.2016, Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin, ka dërguar pranë Ministrisë së Mjedisit, dhënien e mendimit duke u shprehur se nuk konstatohet që shoqëria "Integrated Energy BV" sh.p.k, të jetë e regjistruar në QKB, të citohen aspektet pozitive dhe negative të impaktit që do të ketë projekti, si dhe nëse ky projekt mbivendoset me projektin (grant) e Bankës së Japonisë, për ndërtimin e terminalit të përpunimit të ujrave të ndotura për qytetin e Tiranës.

23.Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 7358/1 prot., datë 15.11.2016, Ministri i Drejtësisë i ka kthyer përgjigjen Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, në lidhje me projektvendimin për dhënien e bonusit shoqërisë, duke u shprehur se propozonte rivlerësimin e kësaj nisme.

24.Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 6695/1 prot., datë 17.11.2016. Ministria e Energjisë dhe Industrisë i ka kthyer përgjigjen Ministrisë së Mjedisit, në lidhje me projektvendimin për dhënien e bonusit shoqërisë, duke u shprehur parimisht dakord.

25.Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 8916/1 prot., datë 21.11.2016. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes i ka kthyer përgjigjen Ministrisë së Mjedisit, në lidhje me projektvendimin për dhënien e bonusit shoqërisë, duke u shprehur parimisht dakord.

26.Me datë 23.11.2016. Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr. 6, ku ka vendosur t'i kërkohej subjektit që ka bërë propozimin e pa kërkuar një sqarim i hollësishëm i të gjithë komponentëve, që përbëjnë llogaritjen e koston së depozitimit të një ton mbetje në impiantin e propozuar, si dhe një përlllogaritje e vlerës së tarifës së pastrimit që duhet të paguajë një familje në Qarkun e Tiranës dhe bizneset mbi bazë të kapacitetit të tyre, me qëllim që kosto e përballimit të depozitimit të mbetjeve në impiant të përballohet nga tarifa e pastrimit.

27.Me shkresën nr. 5474/14 prot, datë 25.11.2016, Ministria e Mjedisit ka ridërguar projektvendimin pranë Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, në lidhje me projektvendimin për dhënien e bonusit shoqërisë, me sqarimet përkatëse.

28.Me shkresën nr. 5474/14 prot, datë 25.11.2016, Ministria e Mjedisit ka ridërguar projektvendimin pranë Ministrisë së Drejtësisë, në lidhje me projektvendimin për dhënien e bonusit shoqërisë, me sqarimet përkatëse.

29.Me shkresën nr. 5474/15 prot, datë 05.12.2016, Ministria e Mjedisit ka dërguar për shqyrtim e miratim projektvendimin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, në lidhje me projektvendimin për dhënien e bonusit shoqërisë, me sqarimet përkatëse. Ky projektvendim është konceptuar nga Drejtoresha Juridike e Ministrisë së Mjedisit, Alba Thoma, miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Alqi Billako dhe nënshkruar nga Ministri i Mjedisit, Lefter Koka.

30.Me shkresën nr.7590 prot, datë 29.05.2023, të Prokuroirsë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i është kërkuar informacion dhe dokumentacion Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit, në lidhje me propozimin që ka bërë Komisioni i Dhënies së Koncesionit, për dhënien e bonusit prej 8 pikësh, shoqërisë propozuese "Integrated Energy BV".

Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 3535/1 prot., datë 06.06.2023, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, është administruar një kopje e njëzuar me origjinalin të të gjithë dokumentacionit të hartuar për dhënien e procedurës koncesionare. Nga dokumentacioni i dërguar nga Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, konstatohet se **nuk është mbajtur raporti përmbledhës i propozimit** që duhet të bënte Komisioni i Dhënies së Koncesionit, për dhënien e bonusit prej 8 pikësh, shoqërisë propozuese "Integrated Energy BV", në kundërshtim me VKM-në nr. 575, datë 10.7.2013. "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar, neni 3 "Identifikimi i projekteve të mundshme të koncesionit/PPP", pika 4 dhe 5.

31.Me shkresën nr. 5474/20 prot., datë 27.11.2016, Ministria e Mjedisit ka ridërguar pranë Ministrisë së Financave kërkesën për miratim, së bashku me studimin e fizibilitetit dhe draft-kontratën.

32.Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 15402/1 prot., datë 30.11.2016, Ministria e Financave shprehet se nga ana e Ministrisë së Mjedisit nuk është shprehur qartë nëse bashkitë e Qarkut e kanë parashikuar mbulimin e tarifës së depozitimit mbi bazë të sasisë së mbetjeve në buxhetin e tyre afatmesëm pasi: *“në relacionin e projektvendimit për bonusin përcaktohet se ky projekt nuk do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit pasi kemi të bëjme me investim teresisht privat, ndërsa po në këtë relacion thuhet se bashkitë e Qarkut do të paguajnë tarifën e depozitimit mbi bazë të sasisë së mbetjeve që do të depozitohen”*.

33.Me shkresën kthim-përgjigje nr.7358/3 prot., datë 02.12.2016, Ministria e Drejtësisë shprehet se në lidhje me bonusin që ishte propozuar që t'i jepej shoqërisë që kishte paraqitur propozimin e pakërkuar, ky projekt duhej që në relacionin e tij të shoqërohej me dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit dhe vetëm atëherë mund të kalonte për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.

35.Me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.855, datë 07.12.2016, “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim të vend depozitimeve ekzistuese, Tiranë”, i është akorduar bonusi prej 8% të pikëve shoqërisë “Integrated Energy BV”, për rezultatin teknik dhe financiar.

35.Me datë 27.12.2016, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr. 7, ku ka vendosur t'i dërgohet Ministrisë së Financave, kërkesa për miratim, shoqëruar me draft-kontratën dhe studimin e fizibilitetit.

Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së të dhënave të administruara tek kompjuteri i sekuestruar, i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik, nr.93, datë 21.04.2022, rezulton se me datë 19.01.2017, ora 11:49, nga adresa elektronike e shtetasës Alda Klosi, me funksionin Drejtoreshë e Drejtorisë së Koncesioneve në Ministrinë e Financave, është dërguar email në drejtim të shtetasës Alba Thoma me emertimin “përgjigje për bonusin M Mjedisit inc tirana”, me përmbajtje: *“Te lutem shikoje me vemendje këtë shkresë pasi në relacionin e bonusit keni thënë që nuk do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit. Në këndvështrimin tonë ka një mosperputhje të cilën duhet ta qartësosh. Do të të nis edhe komentet e bera nga Drejtorja e Analizës Buxhetore FLM, Alda”*. Këtij emaili i është përgjigjur shtetasja Alba Thoma, me email-in e datës 19.01.2017, ora 12:14, dërguar shtetasës Alda Klosi, me përmbajtje: *“Alda, Nuk kemi të bëjme me efekte shtesë në kuptimin e mirefillte të tyre pasi nuk do të akordohen leke MM-së por Bashkise Tirane si pjese e grantit që ato marrin nga qeveria Qendrore për realizimin e detyrimeve të saj. Kjo është arsyeja që nuk e kemi të parashikuar në tavanet tona buxhetore. Gjithsesi prandaj juaj kemi përcjelle për miratim procedurën pasi Qeveria Qendrore do t'i akordoj Bashkise fondet për depozitimin e mbetjeve në impjant si dhe për të mbuluar kostot e shpronësimit. Nga ana tjetër të kujtoj se VKM bonusit është miratuar tashme dhe për vazhdimin e procedurave koncesionare mbete vetëm miratimi juaj. Flm. Alba”*.

Po me datë 19.01.2017, ora 12:17 shtetasja Alda Klosi i kthen përgjigje shtetasës Alba Thoma, nepërmjet email-it, me përmbajtje: *“Flm, Alba. Te lutem jam në pritje të dërgimit të planit të biznesit i cili mungon në praktikën e përcjelle. Ka folur edhe me Bledin por akoma nuk ka ardhur materiali. FLM, Alda.”*

Po me datë 19.01.2017, ora 12:37, shtetasja Alba Thoma i ka kthyer përgjigje shtetasës Alda Klosi, me përmbajtje: *“Pershendetje Alda, Bashkelidhur janë dok e perpunuar mbi baze të bisedave. Nderhyrjet janë me të kuqe. Gjithashtu, bashkelidhru është edhe plani i biznesit. Nese janë ok për ju me thuaj. Flm. Alba”*.

Nga aktet e adminitruara rezulton se të gjitha korrespondencat e mësipërme që ka mbajtur shtetasja Alba Thoma, nën cilësinë e Drejtoreshës së Drejtorisë Juridike në Ministrinë së Mjedisit, me shtetasesn Alda Klosi, Drejtoreshë në Ministrinë e Financave, ajo ia ka dërguar nga adresa zyrtare "Alba.Thoma@moe.gov.al", vetes së saj në adresën personale "albathoma82@gmail.com", dhe më pas ajo ka informuar shtetsin Klodian Zoto nëpërmjet adresës së email-it privat të saj.

Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së të dhënave të administruara tek kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik, nr.93, datë 21.04.2022, rezulton se me datë 17.02.2017, ora 10:13, nga adresa elektronike e shtetasës Alma Shehu me funksionin specilaste në Sektorin e Procedurave Koncesionare në Ministrinë e Financave, "Alma.Shehu@financa.gov.al", është dërguar email në drejtim të shtetasës Alba Thoma nën cilësinë e Drejtoreshës së Drejtorisë Juridike në Ministrinë së Mjedisit, me emërtimin "Plotesime per inceneratorin Tirane", me përmbajtje: "*Përshëndetje Alba, Bashkëlidhur gjen materialin me pikat që duhet të plotësohen nga ana juaj, të cilat janë me ngjyrë të kuqe. Faleminderit!*". Këtë email që ka marrë shtetasja Alba Thoma tek adresa zyrtare e saj, më pas shtetasja Alba Thoma ia ka nisur vetes këtë email tek adresa private e saj, duke e nisur nga adresa zyrtare "Alba.Thoma@moe.gov.al", tek adresa private "albathoma82@gmail.com", dhe nga adresa private e saj ia ka dërguar email-in shtetasit Klodian Zoto, me përmbajtje: "*Sic ke komunikuar me Alqin, te lutem nje pergjigje per emailin me poshte*".

Rezulton se shtetasja Alba Thoma, nën cilësinë e Drejtoreshës së Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Mjedisit bashkërendonte punën me shtetasin Klodian Zoto, përse i përket kthimit të përgjigjeve të Ministrisë së Mjedisit në lidhje me kërkesat për plotësimin e kërkesave të duhura në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit.

36.Me shkresën nr. 13188/3 prot., datë 23.01.2017, Ministria e Financave i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit duke kërkuar sqarime shtesë në lidhje me: efektin shtesë në buxetin e shtetit që do të kishte ky projekt; analizën krahasuese të sektorit publik ndaj atij privat; shpronësimin që do të bëhej dhe përballimin e kostove të tij, si dhe me vlerën aktuale neto (NPV) dhe normën e brendshme të kthimit të investimit (IRR).

37.Me shkresën nr. 30753/3 prot., datë 26.01.2017, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë i ka kthyer përgjigjen Ministrisë së Mjedisit në lidhje me zonën kadastrale nr.3321, duke sqaruar se nuk mund të identifikonte pasuritë, pasi nuk ishin të azhomuara zonat urbane.

38.Me shkresën nr. 5474/23 prot., datë 01.02.2017, Ministria e Mjedisit ka ridërguar pranë Ministrisë së Financave, kërkesën për miratim.

39.Me shkresën nr. 13118/5 prot., datë 14.02.2017, Ministria e Financave i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit, duke i bërë me dije se duhej të reflekttoheshin rekomandimet e bëra nga ana e saj, me shkresën nr.13118/3 prot., datë 23.01.2017, përpara se të shpallej procedura.

40.Me shkresën nr. 5474/25 prot., datë 21.02.2017, Ministri i Mjedisit ka ridërguar kërkesën për miratim pranë Ministrisë së Financave, duke sqaruar efektin shtesë në buxhetin e shtetit që do të kishte ky projekt; analizën krahasuese të sektorit publik ndaj atij privat; shpronësimin që do të bëhej dhe përballimin e kostove të tij, si dhe me vlerën aktuale neto (NPV) dhe normën e brendshme të kthimit të investimit (IRR).

Në përmbajtje të kësaj shkrese, Ministria e Mjedisit, është shprehur se:

- Në lidhje me identifikimin e projektit, Ministria e Mjedisit dhe Bashkia Tiranë nuk mund të bënin identifikimin e projektit më të saktë dhe më të plotë sesa e ka bërë subjekti propozues, pasi nuk posedonin staf të specializuar për këtë qëllim dhe nuk mund të kontraktinin shoqëri të specializuar, pasi nga studimi i tregut, kontraktimi i kompanive të tilla shkon në vlerën rreth **3,000,000 Euro**.

- Në lidhje me projektimin dhe dizenjimin, Ministria e Mjedisit është shprehur se kushton 500,000 Euro, evidentimi i zgjidhjes më të mirë kushton 300,000 Euro, Knoë-Hoë i shoqërisë kushton 1,000,000 Euro.

Nga aktet e administruara, rezulton se Ministria e Mjedisit është informuar nga Bashkia Tiranë përpara se të depozitohet propozimi i pakërkuar nga shoqëria, që Bashkia Tiranë së bashku me IFC-në kanë identifikuar një projekt me interes në lidhje me përmirësimin e shërbimit dhe trajtimit të mbetjeve në qytetin e Tiranës dhe për mundësinë e përfshirjes së sektorit privat nëpërmjet Partneritetit Publik Privat. Gjithashtu, nuk rezulton se Ministria e Mjedisit të ketë kryer ndonjë studim tregu mbi koston e kontraktimit të një shoqërie për të kryer identifikimin e projektit, dhe aq më tepër që vlera të shkonte rreth 3,000,000 Euro.

Me shkresën nr.7770 prot., datë 31.05.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, i është kërkuar Ministrisë së Mjedisit një kopje të njëzuar me origjinalin, të dokumentacionit në lidhje me shkresën e Ministrisë së Mjedisit nr. 5474/25 prot., datë 21.02.2017. drejtuar Ministrisë së Financave.

Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 3535/1 prot., datë 06.06.2023, të Ministrisë së Mjedisit, janë administruar një kopje me origjinalin të të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurën koncesionare me objekt: “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzituese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike”.

Nga dokumentacioni i administruar pranë Ministrisë së Mjedisit, si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, rezulton se nuk gjendet asnjë dokumentacion, mbi të cilin të jenë bazuar, konceptuesit dhe miratuesit e shkresës së mësipërme, nr.5474/25 prot., datë 21.02.2017, për nxjerrjen e të dhënave të përdorura në studimin e fizibilitetit në lidhje me: efektin shtesë në buxetin e shtetit që do të kishte ky projekt; analizën krahasuese të sektorit publik ndaj atij privat; shpronësimin që do të bëhej dhe përballimin e kostove të tij, si dhe me vlerën aktuale neto (NPV) dhe normën e brendshme të kthimit të investimit (IRR). Pavarësisht konstatimeve të Ministrisë së Financave, e cila ka kërkuar që para se të shpallej procedura koncesionare, të ishin bërë rregullimet dhe sqarimet përkatëse nga ana e Ministrisë së Mjedisit, rezulton se është vijuar me studimin e fizibilitetit të njejtë me atë që ka dorëzuar shoqëria propozuese.

41.Me shkresën nr. 5474/26 prot, datë 28.02.2017, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Alqi Bllako, i është drejtuar me kërkesë Bashkisë Tiranë, për miratimin e vazhdimit të procedurës koncesionare.

Nga aktet e administruara rezulton se Bashkitë Vorë, Kamëz, Rrogozhinë nuk disponojnë dokumentacion apo korrespondenca të mbajtura në lidhje me procedurën koncesionare me objekt: “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzituese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike”, sipas konfirmimeve të dhëna organit procedues, me shkresën kthim përgjigje me nr. 1026/1 prot., datë 01.03.2023, të Bashkisë Vorë, me shkresën kthim-përgjigje, nr.704/1 prot., datë 03.03.2023, të Bashkisë Rrogozhinë, me shkresën kthim-përgjigje, nr. 1913/1 prot., datë 01.03.2023, të Bashkisë Kamëz.

Me shkresën nr.2613 prot.,datë 20.02.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, i është kërkuar Bashkisë Kavajë një kopje të njësuar me origjinalin të të gjithë dokumentacionit, si dhe korrespondencave që ka mbajtur Bashkia Kavajë në lidhje me procedurën koncesionare me objekt: "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzituese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike".

Me shkresën kthim-përgjigje nr. 747/1 prot., datë 17.03.2023, të Bashkisë Kavajë, është administruar një kopje e njësuar me origjinalin, të të gjithë dokumentacionit që ky institucion disponon në lidhje me procedurën koncesionare me objekt: "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzituese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike". Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se korrespondenca më e hershme e Bashkisë Kavajë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, fillon me datë 21.12.2017, disa muaj më vonë pasi ishte lidhur kontrata koncesionare me shoqërinë propozuese.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga bashkitë e Qarkut Tiranë, rezulton se nga ana e Ministrisë së Mjedisit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, Alqi Bilako, është dërguar kërkesa për marrjen e miratimit për vazhdimin e procedurës koncesionare vetëm tek Bashkia Tiranë, dhe jo tek bashkitë e tjera të Qarkut Tiranë, ndryshe nga sa ishte kërkuar nga Ministria e Financave, nëpërmjet shkresës së saj, me nr. 13118/7 prot.,datë 02.03.2017, pasi projekti në fjalë do të prekte të gjithë Qarkun e Tiranës.

42.Me shkresën nr. 13118/7 prot.,datë 02.03.2017, Ministria e Financave i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit, duke i kërkuar që të marrë miratimin nga Qarku Tiranë, pasi ai projekt do të prekte gjithë Qarkun e Tiranës.

43.Me shkresën nr.8275/1 prot., datë 27.03.2017, Kryetari i Bashkisë Tiranë i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit duke u shprehur dakord me studimin e fizibilitetit të paraqitur nga Ministria e Mjedisit.

44.Me shkresën nr. 5474/29 prot, datë 28.03.2017, Ministri i Mjedisit i ka ridërguar kërkesën Ministrisë së Financave, për të marrë miratimin përfundimtar për vazhdimin e procedurës koncesionare.

45.Me shkresën nr. 5474/31 prot, datë 28.03.2017, Ministri i Mjedisit i ka dërguar kërkesën Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për të marrë miratimin në lidhje me përbalimin e riskut nga çmimi i energjisë elektrike, në mënyrë që të vazhdonte procedurën koncesionare.

46.Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 13118/9 prot.,datë 06.04.2017, Ministri i Financave ka dhënë miratimin pa komente, duke e sqaruar Ministrinë e Mjedisit se financuesi dhe përfituesi kryesor i projektit do të ishte Bashkia Tiranë. Gjithashtu, ai ka kërkuar marrjen e miratimit nga njësitë e qeverisjes vendore të përfshira në këtë projekt. lidhur me përbalimin prej tyre të riskut të mosplotësimit të sasisë së mbetjeve për t'u trajtuar nga koncesionari.

Nga aktet e administruara rezulton se në studimin e fizibilitetit, që është hartuar nga Komisioni i dhënies së koncesionit dhe që është ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit, është pasqyruar mënyra e llogaritjes së tarifës prej 29 Euro/ton, që duhet të paguajnë Njësitë e Qeverisjes Vendore për depozitim e mbetjeve në vlerën, por pasqyrimi i mënyrës së llogaritjes së tarifës mungon në studimin e fizibilitetit, që i është bashkëlidhur kontratës së lidhur midis Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit, dhe shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV".

Në studimin e fizibilitetit që është hartuar nga Komisioni i dhënies së koncesionit, i cili sqaron mënyrën e llogaritjes së tarifës, vërehen pasaktësi, si dhe kostot dhe të ardhurat e llogaritura nuk pasqyrojnë realitetin, të konstatuara si më poshtë:

- Vlera e mjeteve të transportit në momentin që është përdorur për të llogaritur koston e ndërtimit është shënuar në vlerën prej 750,000 Euro, ndërsa kur është llogaritur tarifa, vlera e mjeteve të transportit është vendosur 3,750,000 Euro. Kjo ka mbivlerësuar koston e ndërtimit në vlerën prej 3,000,000 Euro dhe ky mbivlerësim ka ndikuar në rritjen e tarifës që është përcaktuar për t'u paguar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

- Studimi i fizibilitetit i hartuar nga Komisioni i dhënies së koncesionit ka vendosur kostot për ndërtimin e objekteve, të cilat nuk i sqaron sesi i ka vlerësuar, pra nuk shpjegon në mënyrë të detajuar zërat e punimeve që do të kryhen, sasisht e punimeve për çdo zë, matjet e kryera për të përcaktuar sasisht e punimeve për secilin zë, si edhe çmimet e përdorura për çdo zë të punimeve, pajisjet, komponentët përbërës të pajisjeve me çmimet përkatëse, si edhe ku janë marrë referencat e çmimeve për çdo komponentë.

Kostot e ndërtimit të objektit janë si më poshtë:

- Mbyllja e venddepozitimit ekzistues në vlerën 12,928,700 Euro;
- Termovalorizatorët në vlerën 76,000,000 Euro;
- Vend depozitimi i Mbetjeve Urbane në vlerën 11,292,500 Euro;
- Vend depozitimi i inerteve në vlerën 5,668,500 Euro;;
- Vend depozitimi i hireve në vlerën 11,292,500 Euro;
- Impianti i pastrimit të ujrave në vlerën 1,990,250 Euro;
- Impianti i diferencimit në vlerën 1,650,000 Euro;
- Nenstacioni elektrik në vlerën 1,225,000 Euro;
- Sheshe, rruge aksesit etj në vlerën 5,450,000 Euro;
- Mjete Transporti në vlerën 750,000 Euro.

Nga të dhënat e administruara tek kompjuteri i sekuestruar shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik, nr.93, datë 21.04.2022, në lidhje me kostot të ndërtimit të objektit të kontratës koncesionare, rezulton se në datën 07.07.2016, shtetasi Ilirjan Priftaj, inxhinier i shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, ju ka dërguar shtetasve Mirel Mërtiri, Klodian Zoto, Sevi Zani, Denisa Tollkuci, Helada Papa, një dokument të emërtuar "Tirane, mbyllja e ekzistuesit.xls", ku gjendet preventivi i objektit "Kapsulimi i venddepozitimit ekzistues, Sharrë, Tiranë" në vlerën prej 12,093,700 Euro. Po në datë 07.07.2016, shtetasi Ilirjan Priftaj ju dërgon një email tjetër, me tekst "**Preventivi sipas sugjerimeve të Mirelit**", ku bashkëlidhur gjendet përsëri dokumenti i emërtuar "Tirane, mbyllja e ekzistuesit.xls", në të cilin konstatohet se preventivi i objektit "Kapsulimi i venddepozitimit ekzistues, Sharrë, Tiranë" ka ndryshuar dhe ka vlerën 12,928,700 Euro. Ky ndryshim vjen si rezultat i ndryshimit të çmimit sipas preventivit të sugjeruar nga shtetasi Mirel Mërtiri, për zërat:

-Nr. 8 "Sistemime dhe zhvendosje mbetje ekzistuese", ku çmimi nga 2.5 Euro ka shkuar në 3 Euro, duke sjellë ndryshimin e vlerës për këtë zë nga 1,250,000 Euro në 1,500,000 Euro;

-Nr. 9 "Rehabilitimi i barrierave artificiale sipas shtresave: Gjeotekstil me fibra polipropileni", ku çmimi nga 9.5 Euro ka shkuar në 10.5 Euro, duke sjellë ndryshimin e vlerës për këtë zë nga 1,852,500 Euro në 2,047,500 Euro;

Nr. 11 "Realizimi i barrierave artificiale sipas shtesave: Gjeomembrane HDPE me spesor 1.50mm", ku çmimi nga 17.5 Euro ka shkuar në 19.5 Euro, duke sjellë ndryshimin e vlerës për këtë zë nga 3,412,500 Euro në 3,802,500 Euro.

Rezulton se shtetasi Mirel Mërtiri ju është përgjigjur me email shtetasve Klodian Zoto, Ilirjan Priftaj, Sevi Zani, Helada Papa, Denisa Tollkuci dhe Rajmond Braja. duke ju thënë "Jam dakort...".

Më datë 26.08.2016, shtetasi Klodian Zoto ka dërguar email nga adresa e postës elektronike të tij, "klodianzoto@yahoo.com", në drejtim të adresave elektronike të shoqërisë "Paul Eurth", "fabio.fabiola@paulEurth.com" dhe "thomas.hansmann@paulEurth.com" me tekst: "Gentili Signori, In allegato il piano business reale non quello dello stato. Saluti Klodian Zoto / Të nderuar Zotërinj, Bashkëlidhur është plani real i biznesit dhe jo ai shtetëror. Me respekt Klodian Zoto", ku bashkëlidhur email-it gjendet edhe dokumenti i emërtuar "plan biznesi per IEBV". Në këtë dokument gjenden parashikimet për planin e biznesit, ku kosto totale e investimit vlerësohet rreth 102.5 milion Euro, e prezantuar në mënyrë analitike si më poshtë:

Objekti	Kosto në Euro
Mbyllja e landfillit ekzistues	4,000,000
Termovalorizatorin	56,000,000
Pune civile për Termovalorizatorin	7,000,000
Venddepozitimi i Mbetjeve urbane	12,000,000
Venddepozitimi i inerteve	2,000,000
Venddepozitimi i hireve	12,000,000
Impianti i pastrimit të ujrave	1,990,250
Impianti i diferencimit	1,650,000
Nënstacioni elektrik	1,225,000
Sheshe, rrugë aksesit etj	2,800,000
Mjete Transporti	1,800,000
<b>Totali</b>	<b>102,465,250</b>

Në rethanat e mësipërme rezulton se kostot e ndërtimit të vendosura në studimin e fizibilitetit 128,248,330 Euro, janë fryrë në vlerën 25,783,080 Euro. Nga krahasimi i zërave midis të dhënave të koston së ndërtimit sipas studimit të fizibilitetit dhe të dhënave të koston së ndërtimit të administruara nga komunikimet me email të personave të mësipërm, rezultojnë të dhënat si më poshtë :

Objekti	Kosto e studimit të fizibilitetit në Euro	Kosto sipas planit të biznesit në email në Euro	Diferenca midis koston në studimin e fizibilitetit me koston në email
Mbyllja e landfillit ekzistues	12,928,700	4,000,000	8,928,700
Termovalorizatorin + Punë civile për Termovalorizatorin	76,000,880	63,000,000	13,000,880
Venddepozitimi i Mbetjeve urbane	11,292,500	12,000,000	(707,500)
Venddepozitimi i inerteve	5,668,500	2,000,000	3,668,500

Venddepozitimi i hireve	11,292,500	12,000,000	(707,500)
Impianti i pastrimit të ujrave	1,990,250	1,990,250	0
Impianti i diferencimit	1,650,000	1,650,000	0
Nënstacioni elektrik	1,225,000	1,225,000	0
Sheshe, rrugë aksesi etj	5,450,000	2,800,000	2,650,000.00
Mjete Transporti	750,000	1,800,000	(1,050,000)
<b>Totali</b>	<b>128,248,330</b>	<b>102,465,250</b>	<b>25,783,080</b>

Rezulton se në kontratën koncesionare, të datës 31.08.2017, lidhur midis shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k, dhe Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit, i është dhënë e drejta shoqërisë koncesionare që të kërkojë ndërtimin e veprave plotësuese, të cilat nuk janë pjesë e projektit aktual, por që në pikën 10.5.2 të kontratës është përcaktuar se vlera e investimit në varësi të optimizimit të projektit, koncesionari mund të përfshijë brenda të njëjtës vlerë investimi edhe kostot në lidhje me veprat plotësuese. Sipas prokurorisë, është e fryrë vlera e objekteve të përcaktuara në projekt, përderisa këto vlera do t'i lejojnë mundësinë shoqërisë koncesionare që përveç ndërtimit të objekteve të përcaktuara në projekt, të ndërtohen edhe objekte të tjera (vepra plotësuese).

-Komisioni nuk ka argumentuar sesi i ka gjetur vlerat referuese për të përcaktuar kostot e operimit dhe mirëmbajtjes për funksionimin e impiantit (kostot e operimit të landfillit). Gjithashtu, rezulton se janë dhënë vlerësime në lidhje me shpenzimet për operimin dhe mirëmbajtjen për funksionimin e impiantit, ndërsa në tabelën e të dhënave të përgjithshme të landfillit, janë shtuar zëra të tjerë të kostove, duke ndikuar në rritjen e tarifës që është përcaktuar për t'u paguar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Këto kosto janë vlerësuar si më poshtë:

-Shpenzimet e pagave për rreth 27 të punësuar në vlerën 408,000 Euro në vitin e dytë, dhe rritje graduale deri në vitin e shtatë me 130 të punësuar me kosto totale 846,000 Euro. Për këtë zë kostoje është kontradiktor fakti që për 27 punonjës është vlerësuar që shpërblimi duhet të jetë në masën 408,000 euro, ndërsa kur numri i punonjësve rritet me 4.81 herë shpërblimi rritet me 2.07 herë. Gjithashtu, gjatë vitit të dytë të punës, bazuar në grafikun e punimeve dhe në studimin e fizibilitetit, do të jetë mbyllur landfilli ekzistues, do të jetë ndërtuar landfilli i ri, do të jetë ndërtuar impianti i riciklimit dhe stabilizimit, do të jetë ndërtuar linja e parë e termovalorizatorit, pra pothuajse që të gjitha aktivitetet që do të kryhen gjatë 30 viteve të koncesionit do të fillojnë që gjatë vitit të dytë, pra fuqia punëtore që i duhet koncesionarit gjatë vitit të dytë nuk do të duhet të ndryshonte shumë me fuqinë punëtore që do t'i duhej koncesionarit gjatë vitit të shtatë e në vazhdim, kjo sepse ndërtimi i linjave të mbetura të termovalorizatorëve nuk do të kërkojë 103 punonjës shtesë, pasi mbetjet që do të dërgohen në këto linja e kanë përfunduar procesin e selektimit dhe vetëm do të transportohen me kamion në pikën e grumbullit të termovalorizatorëve dhe nga aty nëpërmjet një vinçi do të furnizohet furra e termovalorizatorëve;

-Shpenzime për materiale të konsumit, të cilat përbëhen nga substancat kimike që përdoren në impiant dhe materiale ndihmëse, me kosto 360,000 Euro për secilin linjë të termovalorizatorëve. Komisioni nuk ka shpjeguar konkretisht se çfarë janë këto materiale, sasia e tyre që duhet të përdoren për çdo ton mbetje që të digjet në termovalorizator, si edhe çmimi për sasi i këtyre materialeve;

-Kosto mirëmbajtje impiantesh (termovalorizatorësh) në vlerën 320,000 euro në vit për impiant. Komisioni nuk shpjegon se cili nga komponentët e impiantit do të ndërtohet, shpeshtësinë e ndërrimit të tyre, si edhe mënyrën sesi ka konkluduar që vlera e këtyre është 320,000 Euro;

-Kosto e operimit të venddepozitimeve në vlerën 12.5 euro për ton. Komisioni nuk ka shpjeguar se çfarë përfshihet në këtë zë kostoje. Përfshirja e këtij zëri duket sikur dublon kostot, pasi kosto e operimit të landfillit përbëhen nga kosto e punonjësvë, kosto e mirëmbajtjes impiantesh(termovalorizatorësh), kosto mirëmbajtje dhe operimi mjetesh kosto këto të llogaritur në mënyrë të veçantë;

-Kosto e mirëmbajtjes dhe operimit të flotës operative në vlerën 900,000 Euro në vitin e parë dhe 1.300,000 Euro në kapacitet të plotë. Komisioni nuk ka treguar komponentët e mjeteve që kanë nevojë për mirëmbajtje dhe kostot përkatëse të tyre (kontradiktor është fakti që vlera e mjeteve të transportit është 750,000 Euro), gjithashtu nuk ka treguar se çfarë përfshihet në kostot e operimit të flotës dhe mënyrën sesi e ka vlerësuar këtë kosto.

-Komisioni i dhënies së koncesionit kur ka llogaritur tarifën për depozitim e mbetjeve, përveç kostove të operimit të mësipërme, ka shtuar vlera shpenzimesh, për të cilat nuk është shprehur më herët në studimin e fizibilitetit (këto në tabelën e llogaritjes së tarifës janë në rubrikën e kostove të operimit të landfillit, por në faqet 93-94 të studimit të fizibilitetit ku janë listuar kostot e operimit të landfillit, këto shpenzime nuk janë përfshirë). Shpenzimet që janë shtuar në momentin e llogaritjes së tarifës janë në vlerën 61,179,232 Euro dhe janë të përbëra nga shpenzimet për konsulencë në vlerën 2,115,000 Euro, shpenzime telekomunikacioni, në vlerën 507,600 Euro dhe shpenzime të tjera administrative, në vlerën 58,556,632 Euro.

-Përfitimi i shoqërisë për ton mbetje të depozituar është shënuar në vlerën 2.9 Euro/ton, e përlllogaritur kjo vlerë për sasinë e parashikuar për 30 vite, prej 8,364,340 ton mbetje, që sipas këtyre të dhënave do të konsistonte në vlerën  $2.9 * 8,364,340 = 24,256,586$  Euro. Këto të dhëna bien ndesh me të dhënat ku në të njëjtën tabelë përfitimi i shoqërisë koncesionare është shënuar 120,948.356 Euro.

Për këtë fakt, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer Raport Auditimin e përputhshmërisë tek 'Drejtoria e Koncesioneve-Ministria e Financave dhe Ekonomisë', në vitin 2019, përcjellë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me shkresën nr.1017/1 prot, datë 21.11.2023, në të cilin janë konstatuar shkeljet, si më poshtë:

**Kostot e investimit të projektit janë të detajuara në analizën ekonomike të projektit duke përfshirë pjesën e analizës së investimeve dhe projektimin e tyre për qëllime të përcaktimit të tarifës së operimit për njësi. Nga auditimi është konstatuar se kostot e investimit të parashikuar për t'u realizuar, janë të paraqitura në vlera të ndryshme, në pjesë të ndryshme të analizës ekonomike të studimit të fizibilitetit. Diferencat janë të paraqitura, sipas tabelës së mëposhtme:**

	<i>Në euro</i>	
<b>Fluks dalës nga investimi flukseve</b>	<b>Sipas propozimit</b>	<b>Sipas tabelës së</b>
<b>Totali</b>	<b>128,248,330</b>	<b>131,248,330</b>
<b>Mbyllja e venddepozitimit ekzistues</b>	<b>12,928,700</b>	<b>12,928,700</b>

Termovalorizatorët	76,000.880	76,000.880
Venddepozitimi I Mbetjeve urbane	11,292.500	11,292,500
Venddepozitimi I inerteve	5,668,500	5,668,500
Venddepozitimi I hireve	11,292,500	11,292,500
Impianti I pastrimit të ujrave	1,990,250	1,990,250
Impianti I diferencimit	1,650,000	1,650,000
Nenstacioni elektrik	1,225,000	1,225,000
Sheshe, rruge aksesi	5,450,000	5,450,000
<b>Mjete Transporti</b>	<b>750,000</b>	<b>3,750,000</b>

Diferencat janë të paraqitura në investimet e propozuara për mjetet e transportit, ku në një rast është propozuar shumë më 750,000 euro, ndërkohë që në një rast është paraqitur në shumë më 3,750,000 euro. Këto diferenca kanë efekt të drejtpërdrejtë në përcaktimin e kostos për njësi të shërbimit të ofruar dhe rrjedhimisht në pagesat e projektuara nga autoritetet publike në funksion të zbatimit të projektit koncesionar. Në të njëjtën kohë ato vendosin në dyshim vlerat reale që do investohen nga koncesionari gjatë procesit të zbatimit të projektit koncesionar/PPP.

**Kostot e operimit të projektit përgjatë të gjithë periudhës janë të llogaritura sipas tabelës së mëposhtme:**

	<i>Në euro</i>
<b>Fluks dalës nga mirëmbajtja</b>	
<b>299,399,063</b>	
Pagat	
24,141,379	
Materialet e konsumueshme	
38,052,000	
Kosto Mirembajtje	
34,240,000	
Kostot e trajtimit të Landfillit	
104,596,563	
Shpenzime për automjetet	
37,189,889	
Shpenzime konsulence	
2,115,000	
Telekomunikacion	
507,600	
Shpenzime të tjera administrative	
58,556,632	

Nga analiza e të dhënave të tabelës së mësipërme sipas argumentimit të bërë në studimin e fizibilitetit konstatohet se:

-Shpenzimet e pagave për rreth 27 të punësuar në vitin e dytë të funksionimit në një kosto prej 408 mijë euro dhe rritja gradualisht në përputhje me rritjen e numrit të të punësuarve dhe të ndërtimit të centraleve të reja që rezultojnë nga viti i shtatë tutje me 130 të punësuar efektive dhe kosto totale prej 846 mijë euro.

-Shpenzimet e materialeve të konsumit të cilat përbëhen nga substancat kimike që përdoren në impiant dhe materiale ndihmëse. Këto kanë një kosto prej 360 mijë euro në vit, kur një linjë e vetme do të jetë në veprim, 714 mijë euro kur dy linja do të jenë në veprim, 1,068

mijë euro gjatë periudhës kur tre linja do të jenë në veprim dhe 1.4 milionë euro gjatë operacionit të katër linjave.

-Shpenzimet e mirëmbajtjes së impianteve janë parashikuar të jenë rreth 320 mijë euro në vit, kur një linjë e vetme do të jetë në veprim, 640 mijë euro kur dy linja do të jenë në veprim, 960 mijë euro kur tre linja do të jenë në veprim dhe 1.3 milion euro gjatë funksionimit të katër linjave.

-Kostot e operimit të venddepozitimeve vlerësohen në 12.5 euro për ton dhe të përmbledhura në 993 mijë euro në vitin e parë në rritje deri në 3.65 milionë, në vitin e shtatë e në vazhdim, kur ky projekt është me kapacitet të plotë.

-Kostot e mirëmbajtjes dhe operimin të flotës operative (të vincave, kamjonve, kompaktatorve, ngarkuesve, ekskavatorëve, boteve etj) do të ketë një kosto vjetore prej 0.9 milionë euro në vitin e parë dhe 1.3 milion euro në kapacitet të plotë, duke përfshirë përdorimin e tyre.

Nga auditimi kostatohet se nuk ka argumentim në studimin e fizibilitetit në lidhje me kostot e konsulencës (2,115,000 euro), telekomunikacionit (507,600 euro) dhe mbi të gjitha të shpenzimeve të tjera administrative, të cilat janë paraqitur në vlerën (58,556,632 euro). Përfshirja e kostove administrative në masën 20% të vlerës totale të kostove të operimit të paargumentuara dhe të pambështetura paraqet dyshime në lidhje me fluksin dalës të projektuar për to me ndikim të drejtpërdrejtë në vërtetësinë e llogaritjeve të kryera për përcaktimin e tarifës së ofrimit të shërbimit. Mbi bazën e fluksit të investimeve të kërkuara, fluksit të shpenzimeve operative të kërkuara dhe flukseve të tjera hyrëse është kryer analiza për përcaktimin e tarifës për njësi të ofrimit të shërbimit që përfshin ky projekt. Sipas studimit të fizibilitetit, parashikimi bazuar në kapacitetin e disponueshëm është kryer bazuar në të dhënat e paraqitura si në vijim:

		<i>Në euro</i>
<b>Tonazhi I disponueshëm</b>		<b>8,364,340</b>
<b>Emertimi</b>	<b>Euro</b>	<b>Eur/njesi S.F</b>
<b>Eur/njesi Klsh</b>		
Kostot e ndërtimit 15.69	131,248,330	15.69
Kostot e operimit 35.79	299,399,063	35.79
Totali I kostove 51.49	430,647,393	51.49
Përfitimi nga shitja e energjisë (15.97)	(133,546,693)	(15.90)
Përfitimi nga shitja e skrapit (9.37)	(78,345,377)	(9.37)
Përfitimi I shoqërisë 14.46	120,948,356	2.90
Totali kosto 40.61	339,703,679	29.00
<b>Kostoja njesi per 1 ton mbeturina</b>		<b>29.05</b>

Nga auditimi konstatohet se treguesit e përdorur për përcaktimin e kostos për njësi janë llogaritur duke mos marrë parasysh vlerën në kohë të parasë, duke qenë se flukset dalëse nga investimet dhe flukset dalëse nga operimi i përkasin në vlera të ndryshme viteve të ndryshme. Nga ana tjetër, edhe për flukset hyrëse në lidhje me shitjen e energjisë si pasojë e energjisë së prodhuar nga impianti apo nga shitja e skrapit, nuk ka një projektion në lidhje

me realizueshmërinë e tyre në çdo vit. Nxjerrja e tarifës për njësi të shërbimit mbi bazën e këtyre supozimeve të munguara vendos në dyshim nevojën reale për mbështetjen e projektit në atë vlerë të projektuar nga njësitë e vetqeverisjes vendore. Përtej problemeve metodologjike me impakt direkt në tarifën e ofrimit të shërbimit, pasaktësi konstatohen edhe në llogaritjen e kostos për njësi dhe përfitimit për njësi të shoqërisë. Këto vlera janë transformuar dhe nuk i përgjigjen llogaritjeve matematikore, ku përfitimi i shoqërisë nga projekti llogaritet në masën 2.9 euro/njësi, ndërkohë që realisht ai rezulton në shumën 14.46 euro/njësi.

Po ashtu, nga të dhënat e administruara tek kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit aktit të ekspertimit teknik kompjuterik, nr.93, datë 21.04.2022, në lidhje me tarifën e mbetjeve për ton, rezulton se:

Shtetasi Erton Kaleshi, punonjës i shoqërisë “Studio e Konsulencës dhe Ekspertizës Profesionale” sh.p.k, me datën 14.12.2016, nga adresa e postës elektronike të tij, “erton.kaleshi@skep.com.al”, ka nisur email në drejtim të adresave elektronike të shtetasve Mirel Mërtiri, Klodian Zoto dhe Sevi Zani, kjo e fundit punonjëse e shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, tek adresat respektive të tyre, “mirelmertiri@gmail.com”, “klodianzoto@yahoo.com” dhe “sevizani@gmail.com”, dokumentin e emërtuar “Kosto dhe tarifa.xlsx”, me përmbajtje emaili:

*“Pershendetje,*

*bashkangjitur po ju nis tabelen e llogaritjes se tarifes prej 29 euro/ton.*

*Nqs do zbatojme te dhenat sipas planit te biznesit qe kemi bere, atehere kemi situaten si me poshte:*

*1-kostoja e investimit dhe operimit te landfielddit eshte rreth 51,13 Euro/ton;*

*2-Kompesim i koston nga shitja e energjise eshte rreth 22,81 Euro/ton;*

*3-Kompesim i koston nga shitja e skrapit eshte rreth 13,77 Euro/ton;*

*pra kosto e paster pas kompesimit nga te ardhurat e energjise dhe skrapit eshte 14,54 Euro/ton (51,13-22,81-13,77) dhe si rezultat per te arritur ne tarifen 29 euro/ton, e ardhura per shoqerine koncesionare do te jete 14,46 Euro/ton.*

*Mendoj qe te ulim te ardhuren e shitjes se skrapit ne menyre qe marzhi i fuimit te shoqerise koncesionare te ulet ne evidentimin e tarifes.*

*Best Regards,*

*Erton Kaleshi*

*Managing Director*

*SKEP SHPK*

*Rr. Qemal Stafa*

*P. Ri perballe Prokurorise*

*Mob: +355 (0) 6620 64794*

*T/F: +355 (0) 4 22419912*

*E-mail: erton.kaleshi@skep.com.al”.*

Në datë 15.12.2016, nga adresa e postës elektronike “erton.kaleshi@skep.com.al” është nisur në drejtim të adresave “sevizani@gmail.com”, “mirelmertiri@gmail.com” dhe “klodianzoto@yahoo.com”, email-i me lëndë “kosto varianti i ri me 10% marzh”, i cili ka bashkëlidhur dokumentin e emërtuar “kosto dhe tarifa.xlsx”.

Pasi ka marrë këtë email, po në datën 15.12.2016, nga adresa e postës elektronike "klodianzoto@yahoo.com" është nisur në adresën e postës elektronike të shtetases Alba Thoma, Ish Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Mjedisit, "albathoma82@gmail.com", email-i me lëndë "kosto varianti i ri me 10% marzh", i cili ka bashkëlidhur dokumentin e emërtuar "kosto dhe tarifa.xlsx".

Komisioni i dhënies së koncesionit i ka marrë kostot nga studimi i fizibilitetit të shoqërisë propozuese "Integrated Energy BV" pa kryer asnjë verifikim në lidhje me vërtetësinë e tyre, si dhe rezultojnë të dhëna se vlerat e vendosura kanë rritur fiktivisht tarifën e depozitimit të mbetjeve nga Njësitë e Qeverisjeve Vendore. Anëtarët e komisionit të dhënies koncesionit kanë vepruar në kundërshtim me VKM nr. 575, datë 10.07.2013. "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar, neni 13, pika pika 3. "Detajimi i studimit të fizibilitetit" të VKM nr. 575, datë 10.07.2013.

Në studimin e fizibilitetit të përgatitur nga Komisioni i dhënies së koncesionit, nuk janë marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat reale që do të përfitonte shoqëria koncesionare. Këto të ardhura, të cilat nuk janë përfshirë, ndikojnë negativisht në buxhetin e shtetit, pasi nëse do të ishin llogaritur, atëherë vlera e tarifës që do të duhej të paguanin Njësitë e Qeverisjes Vendore do të ishte më e ulët. Pra, Komisioni i dhënies së Koncesionit ka vepruar në kundërshtim me nenin 19 të ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", "Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat", si dhe në kundërshtim me nenet 7 dhe 13 të VKM-së nr.575/2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat" i ndryshuar.

50. Llogaritja e tarifës është nxjerrë nga Komisioni si rezultat i diferencës së shumës së kostove të llogaritura, fitimit të synuar të shoqërisë koncesionare me të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë edhe të ardhurave të realizuara nga shitja e skrapit. Diferenca është pjesëtuar me sasinë e mbetjeve të parashikuara që do të depozitohen për periudhën 30 vjecare nga Njësitë e Qeverisjeve Vendore. Nga kjo analizë komisioni ka konkluduar që tarifa është në vlerën prej 29.05 Euro/ton. Nga aktet e administruara rezulton se vlera e tarifës është përcaktuar përpara se të ndërtohej plan buxheti. Pra vlera prej 29 Euro/ton është e synuar nga shoqëria koncesionare, dhe kostot e vendosura në studimin e fizibilitetit nga shoqëria koncesionare, nuk janë reale, por janë përshtatur për të arritur në këtë vlerë. Komisioni i dhënies së koncesionit nga ana e tij ka përfshirë të dhëna të kostos në studimin e fizibilitetit, vërtetësinë e të cilave nuk e ka verifikuar, si edhe vlerat që ka marrë për llogaritjen e tarifës, kanë dukshëm mospërputhje.

Komisioni i dhënies së koncesionit ka anashkaluar përfshirjen e të ardhurave që do të përfitojë shoqëria koncesionare nga palët e treta për depozitimin e mbetjeve inerte, duke i shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë buxhetit të shtetit. Nga pëllogaritet e kryera për periudhën nga krijimi i shoqërisë koncesionare deri në datën 28.02.2021, rezulton se shoqëria koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k ka realizuar të ardhura nga shitjet në vlerën 6,063,327,392 lekë, ku kjo vlerë përbëhet nga shitjet që i ka faturuar Bashkisë Tiranë në vlerën 3,667,778,422 lekë, dhe shitjet që i ka faturuar palëve të treta, në vlerën 2,395,548,970 lekë. Nëse do të ishin përllogaritur të ardhurat që shoqëria koncesionare do të përfitonte nga palët e treta, si zë të ardhurash në studimin e fizibilitetit, atëherë do të ishte ulur pjesa e mbulimit që do të kryhej nga shteti.

Nga aktet e administruar rezulton se në studimin e fizibilitetit, Komisioni i dhënies së koncesionit ka patur mundësitë që të parashikonte si zë të ardhurash, të ardhurat që do të përfitonte shoqëria koncesionare nga depozitimi i mbetjeve inerte nga personat e tretë, pasi në studimin e fizibilitetit është parashikuar që koncesionari do të ndërtojë landfill për mbetjet

inerte (LOT G dhe LOT H), si dhe Komisioni e ka përfshirë si bazë ligjore VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, e cila synon në fushën e ndërtimit, duke përcaktuar rregullat dhe kërkesat konkrete për subjektet që operojnë në këtë fushë, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion,partneritet publik privat”. neni 19 pika 2 dhe 3 si dhe VKM nr. 575/2013 “Për të ndryshuar, neni 4 “Studimi i fizibilitetit”.

51.Me datë 12.04.2017, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr .8. në të cilën është diskutuar mbi procesin e marrjes së dakortësisë së Bashkisë Tiranë për vazhdimin e procedurave të projektit në fjalë, referuar studimit të fizibilitetit, si dhe miratimin përkatës nga Ministria e Financave. Në këtë mbledhje është finalizuar studimi i fizibilitetit, i cili është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Po ashtu, në këtë mbledhje është diskutuar në lidhje me hartimin e **Dokumentave Standarte të Koncesionit. Komisioni ka lënë si mbledhje të radhës, parimisht datën 14.04.2017, si dhe deri atëherë, do të procedonte me përfundimin e punës për hartimin e Dokumenteve Standarte të Koncesionit me miratimin përkatës.**

Nga të dhënat e administruara tek kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik. nr.93, datë 21.04.2022, rezulton se:

-Në datën 10.04.2017, në orën 14:46:10, shtetasi Klodian Zoto, nëpërmjet adresës elektronike të tij, “klodiazoto@yahoo.com”, ka dërguar email tek adresa elektronike e shtetasës Alba Thoma,Ish Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Mjedisit, “albathoma82@gmail.com”, me tekst: “Kam lene disa komente sepse duhet te plotesohen nga ju. Skane te bejne me kriteret.”, në të cilën është bashkëlidhur dokumenti i emërtuar “REV 2 TIRANA 3.docx”.

-Në datën 13.04.2017, në orën 10:00:53, shtetasi Bledar Karoli, me funksionin Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve në Ministrinë e Mjedisit. nëpërmjet adresës elektronike të tij, “bledarkaroli@gmail.com”, ka dërguar email tek adresat elektronike të shtetasve Klodian Zoto dhe Denisa Tollkuçi, respektivisht “klodiazoto@yahoo.com” dhe “dtollkuci@gmail.com”, me tekst: “hidhi nje sy dhe me thuaj”, në të cilën është bashkëlidhur dokumenti i emërtuar “DSKT Tirana dt 11 04 2017 erjon me komente.docx”.

-Po në datën 13.04.2017, në orën 11:56:55, nga adresa elektronike “dtollkuci@gmail.com” është dërguar email në drejtim të adresës elektronike “bledarkaroli@gmail.com” dhe në “CC” ka qenë adresa elektronike “klodiazoto@yahoo.com”,me tekst “Ne menyre perfundimtare komentet me te kuqe”. Bashkëlidhur këtij emaili ndodhet edhe dokumenti i emërtuar “DSKT Tirana dt 12 04 2017 erjon me komente replikim.docx”. Nga verifikimi i këtij dokumenti, rezulton se është i njëjtë me Dokumentet Standarte të procedurës përzgjedhëse konkurruese “Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i vend depozitimeve ekzistuese Tiranë”.

Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së të dhënave nga sistemi i prokurimit elektronik, datë 24.04.2023, rezulton se dokumentet e procedurës me emërtimin “Dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe reabilitimi i vend depozitimeve ekzistues Tiranë”, ku përfshihen edhe Dokumentet Standarte të procedurës përzgjedhëse konkurruese “Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i vend depozitimeve ekzistuese Tiranë”, janë ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik në datën 19.04.2017 nga përdoruesi “valbona ballgjini”. Gjithashtu, rezulton se në këto dokumente kanë lënë gjurmë kompjuterat që mbajnë emrin “Denisa Tollkuci” dhe “bledar.karoli”. Në këto rrethana rezulton se Dokumentet Standarte të procedurës së koncesionit janë hartuar nga punonjësit e shtetasit

Klodian Zoto, i cili jua ka dërguar më pas punonjësve të Ministrisë së Mjedisit, shtetasve Alba Thoma dhe Bledar Karoli. Në këtë kohë këto dy shtetas kanë shërbyer si “urë lidhëse” ndërmjet Komisionit të dhënies së koncesionit, Autoritetit Kontraktor, Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto. Më pas shtetasi Bledar Karoli këto dokumente i ka nisur në drejtim të përfaqësuesve të shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, pjesëmarrëse në këtë procedurë koncesioni si aksioner i shoqërisë holandeze “Integrated Energy BV”. Pasi janë bërë komentet nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, mbi Dokumentet Standarte të procedurës, është bërë ngarkimi i dokumenteve në sistemin e prokurimit elektronik nga shtetasja Valbona Ballgjini, Kryetare e Komisionit të dhënies së koncesionit, njëkohësisht me detyrë Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mjedisit.

Gjatë hetimit është pyetur me cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shtetasi **Bledar Karoli**, i cili ka deklaruar ndër të tjera lidhur me komunikimin me shtetasit Klodian Zoto dhe Denisa Tollkuçi se nepërmjet këtij email-i i ka dërguar Dokumentat Standarte të procedurës koncesionare shtetasit Klodian Zoto dhe pasi shtetasi Klodian Zoto ka dhënë komentet e tij, shtetasi Bledar Karoli ia ka vënë në dispozicion Komisionit të dhënies së koncesionit. Ai deklaron se ky komunikim ka ardhur si pasojë e porosive të dhëna nga eprorët e tij, për dërgimin e dokumentave standarte të procedurës koncesionare më parë tek Klodian Zoto, para se ato të ngarkoheshin në sistemin elektronik të APP-së. Ai deklaron se nuk e mban mend se cili nga eprorët e tij i ka thënë që t’ia nisë dokumentat standarte të procedurës koncesionare shtetasit Klodian Zoto, por duhet të kenë qenë një ndër nga eprorët e tij, Alba Thoma, Valbona Ballgjini ose shtetasi Alqi Bllako. Po ashtu, ai deklaron se në lidhje me dokumentet standarte të procedurës koncesionare, versioni final i tyre i ngarkuar në sistemin elektronik të APP-së, janë dokumentet të dërguara nepërmjet email-it nga shtetasja Denisa Tollkuçi (përfaqësuesja e shtetasit Klodian Zoto). Shtetasi Bledar Karoli, pasi i ka printuar, ia ka vënë në dispozicion Komisionit të dhënies së koncesionit, të cilët pasi i kanë miratuar ato, i kanë nënshkruar dhe më pas në një datë të mëvonshme ato janë ngarkuar në sistemin elektronik të APP-së.

Nga aktet e administruara rezulton se në kohën që janë ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Dokumentet Standarte të Koncesionit, nuk rezultojnë të jenë hartuar dhe miratuar nga anëtarët e komisionit, pasi rezulton se nga ana e komisionit nuk është mbajtur mbledhje për hartimin e Dokumentave Standarte të Koncesionit, si dhe nuk është mbajtur procesverbal për hartimin e Dokumenteve Standarte të Koncesionit, por rezulton se procesverbali i mbledhjes së radhës ka qenë për hapjen e ofertave.

Sipas prokurorisë, në rrethanat e mësipërme, rezulton se anëtarët e Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasit Valbona Ballgjini, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Sidita Temali, Etleva Kondi, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, kanë vepruar në kundërshtim me pikën 5/a të nenit 18 të Ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, si edhe pikës 2 të nenit 24 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion,partneritet publik privat”, i ndryshuar.

Ndërsa shtetasit Alba Thoma dhe Bledar Karoli, njëkohësisht pjesë e Sekretariatit Teknik, sipas Urdhrit të Ministrit të Mjedisit, rezultojnë se gjatë fazës së ndjekjes së procedurës së dhënies së koncesionit, kanë mbajtur lidhje me përfaqësueset të shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, shtetasit Klodian Zoto dhe Denisa Tollkuci, duke ju siguruar informacionin e duhur këtyre shtetasve, si dhe duke marrë sugjerime nga ato në lidhje me specifikimet teknike dhe Setin e Dokumenteve Standarte të Koncesionit, kanë shërbyer si persona ndërlidhës mes anëtarëve të Komisionit të dhënies së koncesionit dhe shtetasve

Klodian Zoto dhe Denisa Tollkuci, në lidhje me përcaktimin e Dokumenteve Standarte të Tenderit nga ana e Komisionit.

52.Me dokumentin "Memo" të datës 18.04.2017, drejtuar Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, nënshkruar nga Kryetarja e Komisionit të dhënies së koncesionit, Valbona Ballgjini, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Alqi Bllako, Ministri i Mjedisit Lefter Koka informohet se Komisioni ka hartuar Dokumentet Standarte të Procedurës Konkurese (DSPK), të cilat janë bashkëlidhur dhe pritët miratimi i tij. Ministri i Mjedisit, Lefter Koka, tek kjo shkresë krahas emrit të tij, ka sigluar "ok. Të vazhdojnë procedurën" dhe ka nënshkruar. ndërkohë, që rezulton se nuk ka dokumentacion bashkëlidhur kësaj shkrese.

53.Me datë 24.04.2017 Ministria e Mjedisit ka publikuar njoftimin e kontratës në Buletin nr.16 të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), ndërsa me datë 27.05.2017, Ministria e Mjedisit ka publikuar në Gazetën Europiane "The Economist", procedurën e tenderimit. Ministri i Mjedisit, Lefter Koka, me shkresën nr. 4526 prot., datë 05.06.2017, ka nxjerrë urdhrin nr.200, për pagesën e botimit të njoftimit në gazetën "The Economist". Nga aktet rezulton se gazeta "The Economist" me datë 27.05.2017 ka lëshuar faturën tatimore (invoice) ndaj Ministrisë së Mjedisit.

54.Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 2221/1 prot., datë 26.05.2017, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, i ka kthyer përgjigjen Ministrisë së Mjedisit, duke e sqaruar se në lidhje me përballimin e riskut nga çmimi i energjisë elektrike duhej t'i drejtohej Entit Rregullator të Energjisë.

55.Me datë 12.06.2017, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr. 9, për hapjen e ofertave të procedurës koncesionare, nga ku ka rezultuar se ka qenë vetëm 1 operator ekonomik, shoqëria "Integrated Energy BV".

Nga të dhënat e administruara tek kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik, nr.65, datë 03.03.2022, rezulton se:

-Në datën 03.07.2017, në orën 13:25:06, anëtarja e Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasja Etleva Kondi, nëpërmjet adresës elektronike të saj, "etlevakondi@yahoo.it", ka dërguar email tek adresa elektronike e shtetasit Klodian Zoto, në të cilën janë bashkëlidhur dokumentat e emërtuar "Procesv Verbal Shqyrtim dhe Vlerësimi.docx" dhe "Vendim KVO\_Good – Ministri.doc". Këtë komunikim me email dhe dokumentat bashkëlidhur, shtetasi Klodian Zoto ia ka dërguar shtetasës Alba Thoma, po me datë 03.07.2017, në orën 13:26:07.

Nga dokumentacioni i dërguar me email, konstatohet se këto dokumente kanë të bëjnë me vlerësimin që do të kryente Komisioni i dhënies së Koncesionit përsa i përket ofertës së paraqitur nga shoqëria holandeze "Integrated Energy BV", me përfaqësues shtetasin Klodian Zoto. Ndërsa vlen të theksohet se Komisioni i dhënies së koncesionit e ka kryer po këtë "vlerësim", me datë 17.08.2017.

56.Me datë 05.07.2017, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin nr. 10, ku ka vendosur që të procedohej me përfundimin e punës për vlerësimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria koncesionare, si dhe t'i kërkohej sqarime shtesë operatorit ekonomik që ka paraqitur ofertën ekonomike, në lidhje me regjistrimin e tij fiskal.

57.Me shkresën nr. 5506 prot., datë 05.07.2017, Ministria e Mjedisit i ka kërkuar sqarime shoqërisë "Integrated Energy BV", në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ana e saj.

58.Me shkresën nr.20/1 prot., datë 10.07.2017, shoqëria propozuese "Integrated Energy BV" i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit, duke e sqaruar se për çdo pyetje apo paqartësi që mund të kishin në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ana e tyre, ato ishin të gatshëm të vinin në dispozicion ekspertët e tyre. Kjo shkresë është nënshkruar nga shtetasi Klodian Zoto.

59.Komisioni i dhënies së koncesionit me datë 17.08.2017 ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes, ku është shënuar se u diskutua në lidhje me vazhdimin apo jo të procedurës koncesionare, në lidhje me VKM nr.482, datë 05.07.2017 "Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit publik". Komisioni ka vendosur, se meqenëse kishin të bënin me një procedurë koncesionare dhe jo prokurimi publik, t'i paraqiste Ministrit të Mjedisit vlerësimin përfundimtar të procedurës koncesionare. Po ashtu, në këtë datë, Komisioni ka mbajtur procesverbalin tjetër të mbledhjes, nr 11/1, në të cilin Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar ofertën e paraqitur nga shoqëria holandeze "Integrated Energy BV". Në këtë mbledhje Komisioni ka vendosur që shoqëria i plotëson kërkesat teknike duke u kualifikuar për në fazat e mëtejshme.

60.Me shkresën më nr.6392 prot., datë 17.08.2017, Komisioni i dhënies së Koncesionit i ka i dërguar shoqërisë propozuese "Integrated Energy B.V", njoftimin për ofertuesin e kualifikuar.

Nga të dhënat e administruara tek kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik, nr.65, datë 03.03.2022, rezulton se:

-Në datën 22.08.2017, në orën 15:35, shtetasi Floran Pustina, përfaqësues i studios ligjore "Tashko Pustina", nëpërmjet adresës elektronike të tij, "Floran.Pustina@tashkopustina.com". ka dërguar email tek adresa elektronike e shtetasit Klodian Zoto, me përmbajtje: "*Klodi, Bashkelidhur draft -pergjigja per Ministrine e Mjedisit sic folem ne telefon. Te lutem shikoje dhe me thuaj por besoj este OK persa biseduam. flori*".

-Po me këtë datë , 22.08.2017, shtetasi Klodian Zoto këtë komunikim të bërë me shtetasin Floran Pustina, ia ka nisur anëtares së Komisionit të dhënies së koncesionit, Etleva Kondi, me emertimin e dokumentit: "pergjigje Ministrise".

-Me datë 23.08.2017, ora 06:59:07, shtetasja Etleva Kondi, nëpërmjet email-it të saj "etlevakondi@yahoo.it", i ka dërguar email shtetasit Klodian Zoto, me përmbajtje: "*Vazhdo.... Qe ne kuptim te percaktimit ligjor per Bashkimin e perkohshem te shoqerive nenkupton plotesimin ose permbushjen e ketij kriteri sipas dokumentave standarte te peocedures konkurruese. Nese do te analizojme me kujdes edhe dokumentacionin e paraqitur nga ana jone ne permbushje te kriterëve te pergjithshme konstatojme se ato paraqitur nga cdo shoqeri (ortake e shqerise XX) ne raport me perqindjen e pjesmarrjes ne te. Ky fenomen vihet re edhe ne plotesimin e kriterëve te vecanta. Gjithashtu sjellim ne vemendjen tuaj qe te gjitha shoqerite ortake/anetare te ketij bashkimi/spv-je jane shprehur me vendime te vecanta te asambleve te ortakeve ne permbushje te kerkesave te dpsk lidhur me permbushjen e kriterëve te vecanta financiare dhe teknike. Ju sigurojme qe ortaket /anetaret e shoqerise xx si dhe vet ky bashkim i ka te gjitha mundesite/mjetet financiare dhe ato teknike per permbushjen e objektit te peocedures konkurruese per .....*".

-Me datë 23.08.2017, ora 09:37, shtetasi Klodian Zoto, këtë komunikim të bërë me shtetasen Etleva Kondi, ia ka dërguar shtetasit Floran Pustina, me përmbajtje: "*Shikoje pak kete te etleves per pergjigjen qe duhet ti cojme ministrise*".

- Po me këtë datë, 23.08.2017 shtetasi Floran Pustina nëpërmjet email-it të tij, "[Floran.Pustina@tashkopustina.com](mailto:Floran.Pustina@tashkopustina.com)" i dërgon email shtetasit Klodian Zoto, me përmbajtje: "*Ok Klodi – se bashked me komentet e Etlevës. Nuk dua te shkruaj bashkim operators / konsortium, sepse mund te na sjelli ndonje problem ligjor. Ky nuk eshte bashkim operatoren i mirfillte. Floran Pustina*"

Në rrethanat e mësipërme, konstatohet se këto dokumente kanë të bëjnë me formën juridike që do të kishte shoqëria fituese e koncesionit. Për këtë gjë, shtetasi Klodian Zoto merr konsulencë juridike nga anëtarja e Komisionit të dhënies së Koncesionit, shtetasja Etleva Kondi dhe nga studioja ligjore e shtetasit Floran Pustina, të cilët e këshillojnë që fituesi i koncesionit të mos paraqitet si "Bashkim operatorësh", pasi mund të sillte probleme ligjore në të ardhmen.

61.Me shkresën me nr.6488 prot, datë 24.08.2017, Ministria e Mjedisit ka dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), "Formularin e njoftimit të fituesit".

62.Me shkresën nr.25 prot., datë 25.08.2017, shoqëria propozuese "Integrated Energy BV" ka dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Dokumentacionin Standart të procedurës koncesionare për Inceneratorin e Tiranës, shkresë kjo, e protokolluar në Ministrinë e Mjedisit me datë 28.08.2017.

63.Me datë 25.08.2017, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr .12, në të cilën është diskutuar në lidhje me fillimin e hartimit të draft-kontratës. Në këtë mbledhje shoqëria fituese ka kërkuar një miratim me shkrim nga ana e bashkive të Qarkut, pjesë e procesit të koncesionit. Në këtë procesverbal përshkruhet se nga ana e Komisionit dhe nga ana e shoqërisë, është menduar si diçka me vend miratimin nga bashkitë e Qarkut Tiranë. Në këtë takim shoqëria ka kërkuar që të përcaktohet data e hyrjes në fuqi të kontratës, si dhe uljen e garancisë së kontratës në 5%, gjë të cilën Komisioni nuk e ka pranuar.

64.Me datë 28.08.2017, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr.13, në të cilën është diskutuar në lidhje me negociimin e draft kontratës, si dhe Komisioni ka vendosur që ta dërgonte draft-kontrarën për mendim pranë Avokaturës së Shtetit.

65.Me shkresën nr. 6550 prot., datë 28.08.2017, Ministria e Mjedisit i ka dërguar kërkesën për dhënie mendimi Avokaturës së Shtetit, në lidhje me draft-kontratatën e negociuar me shoqërinë koncesionare.

66.Me datë 30.08.2017, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin nr. 14, ku ka diskutuar në lidhje me negociimin e kontratës.

67.Me datë 31.08.2017, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr .15, në të cilën është diskutuar në lidhje me draftin final të kontratës. Në këtë takim ka patur debat në lidhje me diskutimin e ngritur nga Kryetarja e Komisionit, por edhe nga 2 anëtarë të tjerë, përfaqësues të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, përsa i përket futjes në kontratë të detyrimit që kontrata të miratohej me vendim të Këshillit Bashkiak, përpara hyrjes në fuqi të saj. Kjo kërkesë nuk është mbështetur nga ana e shoqërisë, por as nga përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë dhe nuk është bërë pjesë integrale e kontratës. Në këtë takim Komisioni ka vendosur përfundimin e hartimit të kontratës dhe përcjelljen e saj për miratim tek Ministri i Mjedisit për nënshkrim.

68. Me datë 31.8.2017 është lidhur kontrata ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë propozuese "Integrated Energy B.V", me nr 6597 prot. si dhe është bërë formulari i sigurimit të kontratës tek shoqëritë e sigurimit nga shoqëria koncesionare.

Projekti sipas kësaj kontrate nënkuptonte:

1) Ndërtimi/rehabilitimi i të gjitha veprave dhe veprave plotësuese, ashtu siç përcaktohet në mënyrë të detajuar në aneksin e kontratës dhe sipas grafikut të punimeve dhe konkretisht, veprat e mëposhtme:

- Kapsulimin e vendepozitimit ekzistues;
- Impianti i përpunimit të ujrave të ndotura;
- Impianti i diferencimit të mbetjeve;
- Vendepozitimi i mbetjeve të ngurta urbane;
- Impianti i përpunimit të mbetjeve;
- Nënstacioni elektrik;
- Vendepozitimi i hireve;
- Vendepozitimi i mbetjeve inerte.

2) Operimi ekskluziv nga shoqëria koncesionare e të gjitha veprave përgjatë periudhës së koncesionit, përfshirë, por pa u kufizuar në menaxhimin, depozitimin e mbetjeve, prodhimin e energjisë elektrike, importimin e lëndëve djegëse ndihmëse të procesit të funksionimit të impianteve, me qëllim rritjen e efikasitetit të tyre apo aktivitete të tjera në kuadër të operimit dhe shfrytëzimit të veprave dhe veprave plotësuese;

3) Transferimi tek Autoriteti Kontraktor në përfundim të periudhës koncesionare.

Veprat plotësuese: Në këtë Kontratë Ministria e Mjedisit dhe shoqëria koncesionare kanë rënë dakord se përtej veprave të parashikuara në Projekt, me qëllim rritjen dhe shfrytëzimin e efikasitetit të impianteve dhe energjive të prodhuara, shoqëria koncesionare mund të kërkonte nga Ministria e Mjedisit lejin për ndërtimin e veprave plotësuese, që synojnë përmirësimin e efikasitetit në energji, duke sjellë diversifikimin e produkteve të Projektit, të tilla si: a) sera me avull; b) veprimtari në agro-biznes; c) çdo veprimtari tjetër ekonomike në kuadër të diversifikimit të produkteve, kërkesa të cilat nuk mund të refuzoheshin në mënyrë të paarsyeshme nga Autoriteti Kontraktor, duke kërkuar modifikimin e Projektit apo duke aplikuar për lejet përkatëse përfshirë modifikimin e Lejes Zhvillimore apo çdo Autorizimi apo Leje/License për shoqërinë koncesionare.

Me qëllim rritjen e rentabilitetit/maksimalizimit të investimeve të koncesionarit, ky i fundit, ka të drejtë të marrë dhe të furnizohet me mbetje nga njësi vendore të qarqeve të tjera ose persona të tretë privatë ose publikë për aq kohë sa kjo nuk çënon përmbushjen e detyrimeve dhe sasisë së mbetjeve urbane që koncesionari ka sipas kësaj kontrate.

Në kontratën e hartuar ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, periudha e koncesionit është parashikuar për një periudhë 30 vjeçare.

Në nenin 5.10 të kësaj kontratë "Angazhimi i njësive vendore të Qarkut Tiranë" parashikohet se me nënshkrimin e kësaj kontratë, njësitet vendore të Qarkut Tiranë do të miratojnë konform ligjit dhe do të nënshkruajnë njëkohësisht Aneksin IX "Forma e angazhimit mbi detyrimet e njësive vendore të Qarkut Tiranë", duke marrë të gjitha dhe çdo vendim në lidhje me këtë nënshkrim, ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi nga ku këto njësi (Bashki) marrin përsipër të gjitha dhe çdo detyrim, angazhim nën këtë Kontratë. Ndërsa tek

përkufizimet e kontratës vihet re se me “Njësitë vendore të Qarkut Tiranë” kuptohej Bashkia Tiranë, Bashkia Kavajë, Bashkia Kamëz, Bashkia Rrogozhinë dhe Bashkia Vorë.

Në këtë kontratë është parashikuar se çmimi për ton për mbetje urbane që do të paguhej në favor të shoqërisë koncesionare ishte 29 Euro/Ton.

Në nënin 7.3 të Kontratës “Detyrimi për sasi minimale mbetjesh urbane” përcaktohej: Përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate Autoriteti Kontraktor nepërmjet Njësive Vendore të Qarkut Tiranë, garanton Koncesionarin në lidhje me furnizimin e tij me Sasinë Minimale të Garantuar të Mbetjeve Urbane. Në rast se sasia e mbetjeve urbane të dorëzuara Koncesionarit është më pak se Sasia Minimale e Garantuar e Mbetjeve Urbane, atëherë Bashkia Tiranë do t’i paguajë Koncesionarit diferencën mes vlerës totale të çmimit për ton mbetje urbane për sasinë e mbetjeve urbane dorëzuar koncesionarit si më sipër dhe vlerës totale të sasisë minimale të garantuar të mbetjeve urbane shumëzuar me çmimin për ton mbetje urbane të përcaktuar dhe përlllogaritur sipas këtij neni. (Pagesa për Arritjen e Sasisë Minimale të Garantuar të Mbetjeve Urbane). Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura brenda ligjit për të garantuar këtë detyrim të Bashkisë Tiranë dhe detyruar këtë të fundit të përmbushë këtë detyrim ndaj Koncesionarit.

Referuar plan biznesit të paraqitur nga shoqëria propozuese rezulton se “Sasia minimale e garantuar e mbetjeve për ton” është përcaktuar të jetë: për vitin e parë dhe të dytë do të ishte 550 ton mbetje në ditë, për vitin e tretë, të katërt dhe të pestë do të ishte 650 ton mbetje në ditë, për vitin e gjashtë do të ishte 740 ton mbetje në ditë, ndërsa nga viti i shtatë e në vazhdim do të ishte 800 ton mbetje në ditë.

Në dokumentacionin “Formulari i ofertës ekonomike” që shoqëria “Integrated Energy BV” ka paraqitur me datë 12.06.2017, pranë Autoritetit Kontraktor, Ministrisë së Mjedisit, gjatë fazës së dhënies së koncesionit, dokumentacion mbi të cilin ajo është shpallur fituese e procedurës koncesionare, shoqëria “Integrated Energy BV” shprehet se vlera e investimit që do të kryhet nga ana e saj, është në vlerën monetare prej 128,248,330 Euro (njëqind e njëzet e tetë milion e dyqind e dyzetë e tetë mijë, e treqind e tridhjetë), pa TVSH.

69.Me shkresën nr.6597/1 prot., datë 11.09.2017, Ministria e Mjedisit ka dërguar kontratën pranë Bashkisë Tiranë, për ekzekutimin për pjesën e saj, ndërsa me shkresën nr.6597/2 prot, me datë 12.09.2017, ka dërguar “Njoftimin e kontratës së nënshkruar” pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP).

70.Me shkresën nr.11918/1 prot.,datë 14.9.2017, të Agjencisë së Prokurimit Publik drejtuar Ministrisë së Mjedisit, sqarohet se Ministria e Mjedisit nuk e ka dërguar dokumentacionin “Njoftimin e kontratës së nënshkruar” në formatin elektronik dhe për këtë shkak nuk mund ta publikojë.

71.Me shkresën nr. 6597/4 prot., datë 19.09.2017, Ministria e Mjedisit ka ridërguar “Njoftimin e kontratës së nënshkruar” pranë APP-së, në formatin elektronik (CD).

72.Me shkresën nr.12161/1 prot., datë 25.09.2017, Agjencia e Prokurimit Publik i ka kërkuar Ministrisë së Mjedisit njoftimin e kontratës së nënshkruar edhe në rrugë shkresore dhe jo vetëm elektronike.

73.Me shkresën nr. 1295/1 prot., datë 14.11.2017, Ministria e Mjedisit ka dërguar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë një kopje të dokumentacionit në lidhje me procedurën koncesionare me objekt: “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese, Tiranë”, pas ndryshimit të fushës së përgjegjësisë shtetërore, pasi tashmë ishte Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Kontraktor.

74.Me shkresën nr. 409/3 prot., datë 06.12.2017, Ministria e Infstrukturës dhe Energjisë i ka kërkuar Ministrisë së Mjedisit caktimin e anëtarit në Njësinë e Zbatimit të Projektit.

75.Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 1777/1 prot., datë 12.12.2017, Ministria e Mjedisit ka dërguar shkresën pranë Ministrisë së Infstrukturës dhe Energjisë duke zgjedhur përfaqësuesin e saj si anëtar në Njësinë e Zbatimit të Projektit.

76.Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë pasi është bërë Autoriteti Kontraktor për kontratën koncesionare, ka nxjerrë urdhrin nr. 178, datë 06.11.2017, për ngritjen e Njësisë së Zbatimit të Projektit (NJZP).

- Nga deklarimi i shtetasës **Valbona Ballgjini**, me funksionin Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mjedisit, njëkohësisht nën cilësinë e Kryetares së Komisionit të dhënies së koncesionit të Inceneratorit të Tiranës në lidhje me mënyrën se si ka komunikuar Komisioni i dhënies së koncesionit me shoqërinë propozuese "Integrated Energy BV". Shtetasja Valbona Ballgjini ka deklaruar se me shoqërinë propozuese "Integrated Energy BV" është komunikuar gjithmonë me shkresa nëpërmjet protokollit të Ministrisë së Mjedisit, në rrugë zyrtare. Kur Komisioni ka patur kërkesa që kanë dalë nga mbledhjet e zhvilluar, këto kërkesa janë adresuar pranë Sektorit të Prokurimit të Ministrisë së Mjedisit, e cila më pas ka hartuar dhe përcjellë shkresat për tek institucionet e tjera. E pyetur në lidhje me email-in që ka përdorur kjo shtetase, ajo deklaron se email-i i saj personal është vballgjini@htomail.com, tek ky email ka akses vetëm ajo. E pyetur në lidhje me komunikimet e saj me shtetasin Klodian Zoto para se ajo të caktohej anëtare e Komisionit, ku rezulton se shtetasi Klodian Zoto i ka nisur në email-in e saj personal vballgjini@htomail.com. dokumentacionin që më pas është përdorur nga Komisioni i dhënies së koncesionit për procedurën koncesionare, shtetasja Valbona Ballgjini deklaron se ka komunikuar me email me shtetasin Klodian Zoto, pasi i kishte thënë ish Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Alqi Bllako, që shoqëria propozuese do t'i sillte disa dokumente me email, dokumenta të cilat ia ka dorëzuar më pas shtetasit Alqi Bllako. E pyetur në lidhje me hartimin e studimit të fizibilitetit që ka bërë Komisioni i dhënies së koncesionit, ajo deklaron se nuk e di se si janë llogaritur dhe nxjerrë të dhënat që përmban studimi i fizibilitetit. E pyetur në lidhje me faktin se pse në studimin e fizibilitetit Komisioni i dhënies së koncesionit, nuk ka llogaritur përfitimin që do të kishte shoqëria koncesionare nga të tretët duke mos llogaritur zërin "inerte", ndërkohë që tek baza ligjore që ka përmendur për hartimin e studimit të fizibilitetit është përmendur VKM nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", dhe po ashtu edhe në ndërtimin e veprës nga shoqëria koncesionare parashikohej ndërtimi i landfillit për inertet, ajo deklaron se nuk e di pse është bërë kjo gjë.

- Nga deklarimi i anëtares së Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasja **Etleva Kondi**, në lidhje me mënyrën se si i ishte vendosur në dispozicion dokumentacioni që ka dorëzuar shoqëria propozuese "Integrated Energy BV", si propozim i pakërkuar, në Ministrinë e Mjedisit, ajo deklaron se është njohur me dokumentacionin nga punonjësit e Ministrisë së Mjedisit, por nuk e di se cili person ia ka vendosur këtë dokumentacion në dispozicion. Po ashtu, ajo deklaron se nuk e di se si është komunikuar gjatë procedurës me shoqërinë propozuese "Integrated Energy BV", në lidhje me kërkesat e ndryshme që ka patur Komisioni i dhënies së koncesionit, por siç ishte parashikuar edhe në urdhrin për ngritjen e Komisionit të dhënies së koncesionit, kanë qenë dy drejtori apo sektorë nga Ministria e Mjedisit, të cilët kanë qenë në cilësinë e "urës lidhëse" ndërmjet Komisionit të dhënies së koncesionit dhe Autoritetit Kontraktor, Ministrisë së Mjedisit. Këto dy sektorë kanë qenë Sektori i Prokurimeve dhe Sektori për Politikat e Mjedisit, konkretisht kanë qenë shtetasit Bledar Karoli me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve të Ministrisë së Mjedisit dhe

shtetasja Alba Thoma me detyrë Drejtoreshë Juridike e Ministrisë së Mjedisit. E pyetur në lidhje me email-in që ka përdorur kjo shtetase, ajo deklaroi se email-i i saj personal ka qenë dhe është etlevakondi@yahoo.it dhe se tek ky email ka akses vetëm kjo shtetase. E pyetur në lidhje me komunikimet e saj me email me shtetasin Klodian Zoto gjatë kohës që kjo shtetase ka qenë anëtare e Komisionit të dhënies së koncesionit, kjo shtetase deklaroi se nuk i kujtohet arsyeja pse ka komunikuar me shtetasin Klodian Zoto, por nuk ka patur asnjë konflikt interesi në dhënien e informacioneve këtij shtetasi, pasi kanë qenë informacione publike. E pyetur në lidhje me hartimin e studimit të fizibilitetit që ka bërë Komisioni dhe se si janë nxjerrë të dhënat që ai përmban, kjo shtetase ka deklaruar se nuk e di se si janë llogaritur dhe nxjerrë të dhënat që ky studim fizibiliteti përmban dhe se ky studim fizibiliteti është dorëzuar nga shoqëria propozuese tek Autoriteti Kontraktor, Ministria e Mjedisit, ndërsa Komisioni i dhënies së koncesionit thjesht ka miratuar studimin e fizibilitetit që kishte dorëzuar shoqëria propozuese tek Autoriteti Kontraktor, Ministria e Mjedisit, pa bërë ndryshime në të. E pyetur në lidhje me faktin se pse në studimin e fizibilitetit Komisioni i dhënies së koncesionit, nuk ka llogaritur përfitimin që do të kishte shoqëria koncesionare nga të tretët duke mos llogaritur zërin "inerte" ndërkohë që tek baza ligjore që ka përmendur për hartimin e studimit të fizibilitetit është përmendur VKM-ja nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", dhe po ashtu edhe në ndërtimin e veprës nga shoqëria koncesionare parashikohej ndërtimi i landfillit për inertet ajo deklaroi se analiza financiare është hartuar nga shoqëria propozuese, nuk i ka nxjerrë Komisioni këto të dhëna financiare por ai thjesht ka bërë një shqyrtim të përgjithshëm. E pyetur në lidhje me faktin se a ndryshon studimi i fizibilitetit që Komisioni ka miratuar krahasuar me studimin e fizibilitetit që ka paraqitur shoqëria propozuese, ajo deklaroi se nuk ka nryshime por Komisioni thjesht ka miratuar atë që ka paraqitur shoqëria propozuese.

- Është pyetur anëtar i Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasi **Pëllumb Abeshi**, në lidhje me mënyrën se si i ishte vendosur në dispozicion dokumentacioni që ka dorëzuar shoqëria propozuese "Integrated Energy BV", si propozim i pakërkuar në Ministrinë e Mjedisit, ai deklaroi se nuk i kujtohet se si është njohur me këtë dokumentacion. I pyetur në lidhje me mënyrën se si ka komunikuar Komisioni i dhënies së koncesionit me shoqërinë propozuese "Integrated Energy BV", në lidhje me kërkesat e ndryshme që ka pasur Komisioni gjatë procedurës, ai deklaroi se Komisioni është asistuar nga Sektori i Prokurimeve i Ministrisë së Mjedisit në rolin e Sekretarisë Teknike, nga shtetasit Bledar Karoli dhe Alba Thoma. I pyetur në lidhje me hartimin e studimit të fizibilitetit që ka bërë Komisioni dhe se si janë nxjerrë të dhënat që ai përmban, ky shtetas ka deklaruar se Komisioni nuk ka hartuar studim fizibiliteti të ri dhe Komisioni nuk ka bërë ndryshime në studimin e fizibilitetit që ka dorëzuar shoqëria propozuese, por ka përdorur dokumentin e studimit të fizibilitetit që shoqëria propozuese kishte përcjellë pranë Ministrisë së Mjedisit dhe që ju ishte vënë më pas në dispozicion Komisionit të dhënies së koncesionit. Po ashtu, ai deklaroi se Komisioni nuk ka bërë ndryshime në studimin e fizibilitetit që ka dorëzuar shoqëria propozuese tek Ministria e Mjedisit. I pyetur në lidhje me faktin se pse në studimin e fizibilitetit, Komisioni i dhënies së koncesionit nuk ka llogaritur përfitimin që do të kishte shoqëria koncesionare nga të tretët, duke mos llogaritur zërin "inerte", ndërkohë që tek baza ligjore që ka përmendur për hartimin e studimit të fizibilitetit është përmendur VKM nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", po ashtu edhe në ndërtimin e veprës nga shoqëria koncesionare parashikohej ndërtimi i landfillit për inertet, ai deklaroi se nuk e di këtë gjë, pasi Komisioni i dhënies së koncesionit nuk ka hartuar studim fizibiliteti, por ai ka përdorur studimin e fizibilitetit që ka dorëzuar shoqëria propozuese, pa bërë ndryshime.

- Është pyetur anëtarja e Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasja **Sidita Temali** në lidhje me mënyrën se si i ishte vendosur në dispozicion dokumentacioni që ka dorëzuar shoqëria propozuese "Integrated Energy BV" si propozim i pakërkuar në Ministrinë e Mjedisit, e cila deklaron se ky ishte një propozim i pakërkuar, dokumentacioni që kishte dorëzuar shoqëria propozuese ka shkuar në Ministrinë e Mjedisit, si Autoritet Kontraktor dhe Komisionit i është vënë në dispozicion dorazi nepërmjet CD-së. për shkak të volumit të madh të dokumentacionit, nga punonjësit e Ministrisë së Mjedisit, që sipas saj duhet të jenë një ndër shtetasit Valbona Ballgjini ose Bledar Karoli, por që nuk e kujton me saktësi se nga cili prej tyre. Po ashtu ajo deklaron se edhe Dokumentet Standarte të procedurës së koncesionit ia kanë nisur me email njëri nga këto shtetas, Valbona Ballgjini ose Bledar Karoli, por që nuk e kujton me saktësi se cili prej tyre. Ajo deklaron se ka qenë kundër përsa i përket dhënies së bonusit, që projekti të vlerësohej me pikët maksimale, pasi nuk ishte llogaritur vlera e shpronësimit dhe ka propozuar që për analizën financiare të mos i jepeshin pikët maksimale. Gjithashtu, ajo deklaron se në takimet e Komisionit, e ka shprehur vazhdimisht mendimin e saj se duhej që projekti t'i shkonte me shkresë zyrtare Bashkisë Tiranë dhe që projekti të kalonte me Vendimin e Këshillit Bashkiak, pasi projekti kishte të bënte me një garanci që do jepte Bashkia Tiranë për sasinë e mbetjeve për ton, që do të shkonin tek koncesionari dhe në qoftë se nuk do arrihej kjo vlerë minimale, Bashkia Tiranë detyrohej të paguante diferencën e sasisë së mbetjeve të garantuara. E pyetur në lidhje me mënyrën se si ka komunikuar Komisioni i dhënies së koncesionit me shoqërinë propozuese "Integrated Energy BV", në lidhje me kërkesat e ndryshme që ka pasur Komisioni gjatë procedurës, ajo deklaron se komunikimin me shoqërinë propozuese e ka pasur Kryetarja e Komisionit dhe punonjësit e Sektorit të Prokurimeve që kanë asistuar Komisionin e dhënies së koncesionit në punën e tij, konkretisht shtetasja Valbona Ballgjini, shtetasja Alba Thoma dhe shtetasi Bledar Karoli. E pyetur në lidhje me faktin nëse nga Komisioni është hartuar ndonjë raport përmbledhës për dhënies e bonusit prej 8 % të pikëve shoqërisë propozuese, ajo deklaron se nuk ka dijeni të ketë nënshkruar ndonjë raport përmbledhës në lidhje me dhënien e bonusit prej 8% të pikëve. Po ashtu, ajo deklaron se gjatë procedurës së dhënies së koncesionit ka kërkuar një sqarim të hollësishëm të gjithë komponentëve që përbënin llogaritjen e kostos së depozitimit të një ton mbetje në impiantin e propozuar, por pavarësisht se shoqëria propozuese nuk ka sjellë sqarimet përkatëse, ka qenë e detyruar, pasi shumicën e kohës ose pothuajse gjithmonë ka qenë në minorancë dhe nuk kishte fuqinë e duhur që të ndalonte Komisionin për të vijuar punën më tej. Po ashtu, ajo deklaron se gjatë procedurës ka mbajtur qëndrim me vërejtje, observacion. Ajo deklaron se Dokumentet Standarte të koncesionit ia ka përcjellë shtetasi Bledar Karoli, në rrugë elektronike nepërmjet email-it, ndërsa përsa i përket procesverbalit të vlerësimit të datës 17.08.2017, ku thuhet se "nga ana e Komisionit është vlerësuar me 100 pikë ofertuesi i vetëm dhe është vendosur kualifikimi i tij si fitues, shoqëria propozuese "Integrated Energy BV", ajo deklaron se ky procesverbal vlerësimi i ka ardhur i gatshëm nga shtetasja Etleva Kondi dhe Komisioni vetëm e ka nënshkruar atë. Po ashtu, ajo deklaron se shtetasja Etleva Kondi ka qenë shumë e angazhuar në disa faza specifike të dhënies së koncesionit, konkretisht: në momentin e dhënies së bonusit, pasi ajo ka dashur që shoqëria të vlerësohej me pikët maksimale, ndërsa anëtarja Sidita Temali e ka kundërshtuar tek pjesa e vlerësimit të ofertës. Këtë procesverbal, të cilin e kishte përgatitur të gatshëm shtetasja Etleva Kondi ia ka paraqitur Komisionit që ta nënshkruanin. Ajo deklaron se shtetasja Etleva Kondi ka qenë e interesuar edhe për momentin e lidhjes së kontratës, shtetasja Etleva Kondi kishte lidhje me përfaqësuesit e shoqërisë propozuese. E pyetur në lidhje me faktin nëse janë reflektuar në kontratë nga ana e Komisionit konstatimet e bëra nga ana e Avokaturës së Shtetit, ajo deklaron se nuk janë reflektuar të gjitha mendimet që ka shprehur Avokatura e Shtetit, por vetëm disa prej tyre, pasi në të njëjtën ditë që ka kthyer përgjigjen Avokatura e Shtetit, është lidhur edhe kontrata

me shoqërinë koncesionare. Ajo deklaroi se anëtarët e Komisionit, Valbona Bullgjini, Etleva Kondi, si dhe shtetasit Bledar Karoli dhe Alba Thoma, i kanë thënë që duhej bërë po atë ditë lidhja e kontratës, në të njëjtën ditë që ka kthyer përgjigje Avokatura e Shtetit. Ajo deklaroi se kontratën koncesionare jua ka sjellë Komisionit shtetasi Bledar Karoli dhe ju është lënë vetëm 30 minuta kohë për të konkluduar për lidhjen e saj. Ajo deklaroi se nuk i është lënë as koha e nevojshme për ta lexuar dhe shtetasit e mësipërm i kanë thënë që duhej të kryhej sa më shpejt. Ajo deklaroi se kontrata është nënshkruar jashtë orarit zyrtar, si dhe i është thënë që ishte porosi e Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, që kontrata duhej finalizuar sa më shpejt dhe pa kundërshtime. E pyetur në lidhje me hartimin e studimit të fizibilitetit që ka bërë Komisioni dhe se si janë nxjerrë të dhënat që ai përmban, kjo shtetas ka deklaruar se studimin e fizibilitetit e ka dorëzuar shoqëria propozuese pranë Autoritetit Kontraktor, Ministrisë së Mjedisit, ndërsa Komisioni thjesht ka formalizuar studimin e dorëzuar nga shoqëria propozuese dhe nuk ka bërë bërë verifikim të tij. E pyetur në lidhje me faktin se pse në studimin e fizibilitetit Komisioni i dhënies së koncesionit, nuk ka llogaritur përfitimin që do të kishte shoqëria koncesionare nga të tretët, duke mos llogaritur zërin “inerte”, ndërkohë që tek baza ligjore që ka përmendur për hartimin e studimit të fizibilitetit është përmendur VKM-ja nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, ndërkohë që edhe për ndërtimin e veprës nga shoqëria koncesionare parashikohej ndërtimi i landfillit për inertet, ajo deklaroi se nuk di ta thotë pse nuk është llogaritur përfitimi që do të kishte shoqëria koncesionare nga të tretët, në lidhje me zërin “inerte”, por kujton që shtetasi Klodian Zoto ka qenë shumë i interesuar që të përfshihej “zëri i inerteve”. në kontratë.

- Është pyetur anëtari i Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasi **Namik Simixhiu**, në lidhje me mënyrën se si i ishte vendosur në dispozicion dokumentacioni që ka dorëzuar shoqëria propozuese “Integrated Energy BV”, si propozim i pakërkuar në Ministrinë e Mjedisit, ai deklaroi se Autoriteti Kontraktor ka qenë Ministria e Mjedisit, e cila ka administruar dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria propozuese. Si rrjedhojë, dokumentacioni i është vënë në dispozicion nga Ministria e Mjedisit, si dhe Komisioni i dhënies së Koncesionit asistohet nga Sektori i Prokurimit pranë Ministrisë së Mjedisit. Sektori i Prokurimit të Ministrisë së Mjedisit i ka dhënë Komisionit dokumentacionin e dorëzuar nga shoqëria propozuese. I pyetur në lidhje me mënyrën se si ka komunikuar me shoqërinë propozuese “Integrated Energy BV”, në lidhje me kërkesat e ndryshme që ka pasur Komisioni i dhënies së koncesionit gjatë procedurës, ai deklaroi se Kryetarja e Komisionit ka përcjellë kërkesa që ka pasur Komisioni pranë Sektorit të Prokurimit në Ministrinë e Mjedisit, i cili më pas ka konkretizuar kërkesat e Komisionit në shkresa konkrete. I pyetur në lidhje me hartimin e studimit të fizibilitetit që ka bërë Komisioni dhe se si janë nxjerrë të dhënat që ai përmban, ky shtetas ka deklaruar se nuk i kujtohet se si mund të jenë llogaritur dhe nxjerrë ato vlera nga Komisioni i dhënies së koncesionit. I pyetur në lidhje me faktin se pse në studimin e fizibilitetit Komisioni i dhënies së koncesionit, nuk ka llogaritur përfitimin që do të kishte shoqëria koncesionare nga të tretët, duke mos llogaritur zërin “inerte” ndërkohë që tek baza ligjore që ka përmendur për hartimin e studimit të fizibilitetit është përmendur VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, si dhe ndërkohë që edhe për ndërtimin e veprës nga shoqëria koncesionare, parashikohej ndërtimi i landfillit për inertet, ai deklaroi se nuk di ta thotë arsyen psc.

- Është pyetur anëtari i Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasi **Taulant Tusha** në lidhje me mënyrën se si i ishte vendosur në dispozicion dokumentacioni që ka dorëzuar shoqëria propozuese “Integrated Energy BV” si propozim i pakërkuar në Ministrinë e Mjedisit, ai deklaroi se dokumentacionin që shoqëria propozuese ka dorëzuar si propozim i

pakërkuar në Ministrinë e Mjedisit, ia kanë vënë në dispozicion anëtarët e Komisionit që kanë qenë në cilësinë e përfaqësuesve të Ministrisë së Mjedisit. I pyetur në lidhje me mënyrën se si ka komunikuar me shoqërinë propozuese "Integrated Energy BV" në lidhje me kërkesat e ndryshme që ka pasur Komisioni i dhënies së koncesionit gjatë procedurës, ai deklaron se çdo kërkesë e Komisionit është përcjellë pranë Kryetares së Komisionit dhe se komunikimi me shoqërinë propozuese është mbajtur nga punonjësit e Ministrisë së Mjedisit. I pyetur në lidhje me hartimin e studimit të fizibilitetit që ka bërë Komisioni i dhënies së koncesionit dhe se si janë nxjerrë të dhënat që ai përmban, ai deklaron se nuk e mban mend se si kanë dalë këto të dhëna që janë në studimin e fizibilitetit.

Sipas prokurorisë, në rrethanat e mësipërme, në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit me objekt: "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzituese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike", rezulton se shoqëria propozuese "Integrated Energy BV", në përbërje të së cilës është aksionere edhe shoqëria e shtetasit Klodian Zoto "Integrated Technology Services" sh.p.k, ka qenë e paracaktuar që të shpallej fituese e procedurës koncesionare, pasi kjo shoqëri ka qenë në dijeni të rrethanave konkurruese para se të shpallej procedura. Kjo ka ndodhur në sajë të ndihmës së vetë funksionarëve të Ministrisë së Mjedisit, shtetasi Lefter Koka, ish Ministri i Mjedisit, shtetasi Alqi Bllako, Sekretari i Përgjithshëm, shtetasja Alba Thoma, Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike, shtetasi Bledar Karoli, Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, si dhe nga anëtarët e Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasit Valbona Ballgjini, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Sidita Temali, Etleva Kondi, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, është pajisur me dokumentacionin e nevojshëm që duhej të dorëzonte në Ministrinë e Mjedisit para dhe gjatë procedurës koncesionare, me qëllim shpalljen fitues të kësaj shoqërie.

Shtetasit Lefter Koka, Alba Thoma, Bledar Karoli, Valbona Ballgjini, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Sidita Temali, Etleva Kondi, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, me veprimet dhe mosveprimet e kundraligjshme të kryera para dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës koncesionare, dyshohet se kanë kryer veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 të Kodit Penal.

Nga të dhënat e rezultuara të administruara tek kompjuteri i shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik nr.93, datë 21.04.2022, rezulton se shtetasi Alqi Bllako, Ish -Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, me datë 15.11.2016, në orën 15:48, ka bërë komunikime nëpërmjet adresës elektronike të tij "alqibllako@hotmail.com" me përfaqësuesin e shoqërisë italiane "IC Filling Systems", shtetasin Marco Solferini, në adresën e mail-it "marco@icfsgroup.com". Nëpërmjet këtij email-i, shoqëria italiane "IC Filling Systems", i ka dërguar shtetasit Alqi Bllako, dokumentin e titulluar "IC Filling Systems/Artemis Farm-Heads of Agreement", e cila është marrëveshje për një linjë teknologjike për mbushjen e shisheve të birrës, bërë ndërmjet shoqërisë italiane "IC Filling Systems" dhe shoqërisë shqiptare "Artemis Farm" sh.p.k (aktualisht me emrin "Artcon" sh.p.k), si dhe i ka dërguar edhe dokumentacionin shoqëruar, fatura e blerjes "Pro-Forma Invoice", e datës 07.11.2016, në vlerën totale 121.630 Euro.

Pas marrjes së këtij emaili, shtetasi Alqi Bllako, me datë 15.11.2016, në orën 16:02, nëpërmjet adresës së email-it të tij "alqibllako@hotmail.com", i ka dërguar të gjithë dokumentacionin shtetasit Mirel Mërtiri në adresën e email-it, "mirelmertiri@gmail.com".

Të nesërmen, me datë 16.11.2016, në orën 09:12, këtë dokumentacion të siguruar nga shtetasi Alqi Bllako, shtetasi Mirel Mërtiri, nëpërmjet email-it të tij "mirelmertiri@gmail.com" ia ka dërguar shtetasit Klodian Zoto, tek adresa e email-it

“klodiano@yaho.com”. Ky i fundit, po në këtë datë, në orën 09:15, dokumentacionin për blerjen e pajisjes, ia ka nisur juristes së shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services” sh.p.k, shtetases Denisa Tollkuçi, tek adresa e emal-it të saj, “dtollkuci@gmail.com”.

Nga verifikimi i llogarisë bankare të shoqërisë “Artcon” sh.p.k (ish “Artemis Farm”) në Bankën Credins, me nr. 00000783321, rezulton se kjo shoqëri ka kryer dy pagesa me vlerë totale 119,755 Euro kundrejt shoqërisë së huaj “IC Filling Systems SRL”, konkretisht: Në datën 22.11.2016, në vlerën 36,489 Euro, me përshkrimin “Pagesë 30% fatura, data 07.11.2016”; Në datën 11.07.2017, në vlerën 83,266 Euro, me përshkrimin “Payment Invoice 2017-205”.

Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së deklaratave doganore të import-eksport të shoqërisë “Artcon sh.p.k” (ish “Artemis Farm”), datë 25.05.2023, ka rezultuar se në datën 26.07.2017, shoqëria “Artcon” sh.p.k. ka importuar nga shoqëria italiane “IC Filling Systems” pajisjen “Makineri për mbushjen, mbylljen, vulosjen apo etiketimin e shisheve, makineri për gazimin e pijeve”, me vlerë 119,755 Euro.

Nga procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga faqja e Qendrës Kombëtare të Biznesit, datës 18.06.2023, rezulton se shoqëria “Artcon” sh.p.k, në periudhën që ka porositur dhe blerë pajisjen nga shoqëria italiane “IC Filling Systems SRL”, nuk ka patur aktivitet tregtimi apo prodhimi pijesh apo aktivitet tregtimi pajisjesh, në mënyrë që ta blinte për nevojat e saj pajisjen nga shoqëria italiane. Referuar ekstraktit historik të shoqërisë “Artcon” sh.p.k, në periudhën kur është porositur dhe blerë pajisja, objekti i aktivitetit ishte: *“Krijimi dhe menaxhimi i impianteve të rritjes, perpunimit, therjes dhe tregtimit të mishit të gjitha kafsheve, mishi i cili tregtohet në tregun vendas e të huaj. Zhvillimi i teknologjive të reja në fushën e rritjes, perpunimit, therjes dhe tregtimit të mishit të gjitha kafsheve, mishi i cili tregtohet në tregun vendas e të huaj. Import-Eksport të këtyre produkteve, si psh. mish, viçi, derri, lope etj. Gjithashtu shoqëria mund të kryejë aktivitet edhe në fushën e prodhimit, Import- Eksport të nenprodukteve të mishit të gjitha llojeve të kafsheve si psh. Sallameve, qofieve, kotoletave gjysem të gatshme e të gatshme. Import-Eksport të produkteve me të cilat ushqehen të gjitha llojet e kafsheve. Import-Eksport të makinerive dhe mjeteve që shërbejnë për impiantet e rritjes, perpunimit, therjes dhe tregtimit të gjitha kafsheve. Import-Eksport të makinerive dhe mjeteve që shërbejnë për prodhimin e nenprodukteve të mishit të gjitha llojeve të kafsheve si psh: sallameve, qofieve, kotoletave, gjysem të gatshme etj. Import-Eksport të makinerive dhe mjeteve që shërbejnë për prodhimin e produkteve me të cilat ushqehen të gjitha llojet e kafsheve. Furnizimin dhe tregtimin në pikat e konsumit dhe tregjet e vendit të gjitha produkteve që përmenden në objektin e veprimtarisë së Shoqërisë. Importimi i desifektanteve ushqimore, vaksinave të ndryshme të shpendeve, kafsheve dhe të gjitha produktet e tjera medicinale të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të saj primar, rritjes së shpendeve dhe kafsheve të tjera. Mbledhja e mbetjeve ushqimore dhe perpunimi i tyre. Prodhimi i ushqimeve për kafshe të ndryshme nga perpunimi i mbetjeve ushqimore dhe tregtimi i tyre me pakice dhe shumice. Punime civile dhe transport”*.

Nga të dhënat e marra në Qendrën Kombëtare të Biznesit, rezulton se me datë 19.03.2013 është regjistruar operatori ekonomik “Edmond Bllako” Person Fizik, me NIPT-L377190010, me objekt aktiviteti: “Prodhim dhe tregtim birre” me adresë: “Rruga Ropi Stillo Gostivishti”, Ersekë. Ky operator me datë 29.09.2022 ka vendosur “pezullimin e aktivitetit pa afat”. Po ashtu, rezulton se operatori ekonomik “Edmond Bllako” Person Fizik, ka pasur si fushë veprimtarie prodhimin dhe tregtimin e birrës, në kohën që shoqëria

“Artcon” sh.p.k. ka porositur dhe blerë pajisjen për mbushjen e shisheve të birrës nga shoqëria italiane “IC Filling Systems SRL”.

Sipas prokurorisë, nga aktet e administruara rezulton se shtetasi Alqi Bllako, ka kërkuar dhe përfituar në mënyrë të parregullt nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, vlerën monetare prej 119,755 Euro, me qëllim favorizimin gjatë procedurës së dhënies së koncesionit, shoqërinë koncesionare “Integrated Energy BV”, në përbërje të së cilës ka qënë aksionere edhe shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services” sh.p.k. Këtë përfitim të parregullt shtetasi Alqi Bllako e ka siguruar në mënyrë të tërthortë nga shtetasi Klodian Zoto nëpërmjet pagesës për pajisje “Makineri për mbushjen, mbylljen, vulosjen apo etiketimin e shisheve, makineri për gazimin e pijeve”, me vlerë 119,755 Euro. Kjo pajisje ka shërbyer për aktivitetin tregtar të shoqërisë së babait të tij, Edmond Bllako, operatorin ekonomik “Edmond Bllako” Person Fizik, e cila ka pasur si fushë veprimtarie prodhimin dhe tregtimin e birrës në qytetin Ersekës. Kjo pajisje është blerë pas kërkesës së bërë nga shtetasi Alqi Bllako, me porosi të shtetasit Klodian Zoto, bërë nëpërmjet shoqërisë së bashkëshortes së tij, Ilza Zoto. “Artemis Farm” sh.p.k (aktualisht me emrin e ri tregtar “Artcon” sh.p.k). Pagesat për këtë pajisje janë bërë nga shoqëria e bashkëshortes së shtetasit Klodian Zoto, e cila e ka blerë këtë pajisje nga shoqëria italiane “IC Filling Systems SRL” me pagesa të bëra në dy këste, në datën 22.11.2016, në vlerën 36,489 Euro, me përshkrimin “Pagesë 30% fatura, data 07.11.2016” dhe në datën 11.07.2017, në vlerën 83,266 Euro, me përshkrimin “Payment Invoice 2017-205”.

Në lidhje me faktin penal të mësipërm, rezulton se shtetasi Alqi Bllako, me veprimet e kundraligjshme të tij të kryera para dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës koncesionare, për shkak të funksionit të tij me cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, me qëllim marrjen e përfitimeve të parregullta për vete, dyshohet se ka konsumuar elementët e veprës penale të “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 të Kodit Penal.

Në lidhje me faktin penal të mësipërm, për subjektet që kanë konsumuar elementët e veprës penale të “Korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal, nisur nga koha e kryerjes së veprës penale, ushtrimi i ndjekjes penale është parashikuar për këtë vepër penale, bazuar në nenin 66, gërma “ç” të K.Pr.Penale.

Po ashtu, sipas prokurorisë, rezulton se shtetasi Alqi Bllako, nën cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, i ka propozuar shtetasit Vladimir Bezhani që të vazhdonte me ndihmesën e tij si Këshilltar i Jashtëm i Ministrit të Mjedisit dhe të ndihmonte me konsulencë juridike gjatë kohës që kishte lindur idea e projektit të zhvillimit të procedurës së koncesionit në lidhje me trajtimin e mbetjeve në qytetin e Tiranës, përpara se të bëhej propozimi i pakërkuar në Ministrinë e Mjedisit nga shoqëritë “Energy Recuperator S.P.A”, “Paul Ēurth Italia S.P.A”, “Integrated Technology Services” sh.p.k. Për shërbimin e tij, si Këshilltar i Jashtëm i Ministrit të Mjedisit, shtetasi Alqi Bllako ka rënë dakord me shtetasin Klodian Zoto, që ta paguante shtetasin Vladimir Bezhani tek shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, i cili ka marrë përfitimin e tij në sajë të pagës së dhënë nga shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, që përkon me momentin e daljes së tij në pension nga data 01.12.2014 deri në muajin shtator të vitit 2022, shtetasi Vladimir Bezhani ka marrë përfitimin e parregullt në sajë të vlerës së pagës së tij mujore 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë, në total në shumën prej 7,520,000 (shtatë milion e pesëqind e njëzet mijë) lekë. Shtetasi Vladimir Bezhani rezulton se gjatë kohës që ka shërbyer si Këshilltar i Jashtëm i Ministrit të Mjedisit në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit, ai ka shërbyer për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm nga Ministria e Mjedisit në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit, të

cilin ia ka vendosur në dispozicion shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm dhe për t'u shpallur fitues i kësaj procedure koncesioni.

Sipas procesverbalit për kqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi C@TS, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të datës 30.11.2023, rezulton se shtetasi Vladimir Bezhani ka qenë i deklaruar si i punësuar në shoqërinë "Integrated Technology Services" sh.p.k, si Këshilltar i shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, nga muaji Janar i vitit 2016 deri në muajin shtator të vitit 2022. Gjatë kësaj periudhe kohore, ky shtetas ka përfituar në mënyrë të parregullt, në saj të vlerës së pagës së tij mujore 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë, vlerën monetare prej 6,480.000 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Ndërsa rezulton se faktikisht shtetasi Vladimir Bezhani e ka marrë pagën tek kjo shoqëri që nga muaji Dhjetor i vitit 2014. Në total ky shtetas ka marrë përfitime të parregullta në vlerën prej 7,520,000 (shtatë milion e pesëqind e njëzet mijë) lekë.

Për faktin penal të mësipërm, rezulton se shtetasi Alqi Bllako, nën cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, duke i kërkuar/propozuar shtetasit Klodian Zoto dhënien e përfitimit të parregullt për shtetasin Vladimir Bezhani, duke e punësuar fiktivisht tek shoqëria e shtetasit Klodian Zoto. "Integrated Technology Services" sh.p.k, kjo me qëllim favorizimin gjatë procedurës së dhënies së koncesionit, shoqërinë koncesionare "Integrated Energy BV", në përbërje të së cilës ka qenë aksionere edhe shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, dyshohet për veprën penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione të larta shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. Ndërsa, për faktin penal të mësipërm, rezulton se shtetasi Klodian Zoto, me veprimet e kundraligjshme të tij, dyshohet për veprën penale të "Korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal (në lidhje me përfitimin e parregullt të marrë nga shtetasi Vladimir Bezhani).

Nga aktet e administruara, nga dokumentacioni i sekuestruar pranë shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, rezulton se ndodhet në fotokopje edhe dokumenti, kontratë nënkontraktimi, datë 07.12.2017, lidhur ndërmjet shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k me administrator shtetasin italian Giuseppe Ciaffaglione dhe shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, me administrator shtetasin Klodian Zoto, i cili në kohën e lidhjes së kësaj kontrate ishte dhe *aksioner i shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k*. Sipas kësaj kontrate parashikohet se shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, duhej të kryente për llogari të shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, një sërë punimesh civile, si më poshtë:

- a) Punime civile për mbylljen e venddepozitimeve ekzistues Sharrë, Tiranë;
  - b) Rivitalizimin e zonës së venddepozitimit ekzistues;
  - c) Projektim dhe ndërtim të impiantit të diferencimit të mbetjeve;
  - d) Punime për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme në funksion të mbylljes së menaxhimit të venddepozitimit ekzistues Sharrë, Tiranë, etj.
- Kjo kontratë është lidhur për një vlerë monetare prej 1 549 168 800 (një miliard e pesëqind e dyzet e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, për fazën e parë e cila duhej që të përfundonte brenda 12 muajve pas fillimit të punimeve.

-Nga marrja e provave nëpërmjet letërporosisë dërguar Autoriteteve Italiane të Drejtësisë, nr. 97 prot., datë 22.06.2022, letërporosi e ekzekutuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë, rezulton se për këtë fakt (kontratën e nënkontraktimit) është pyetur shtetasi italian, Giuseppe Ciaffaglione, i cili rezulton të këtë qenë administratori i shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, nga momenti i themelimit të saj, datë 31.08.2017 deri në Mars të vitit 2022. I pyetur për faktin e nënshkrimit të kontratës së lidhur ndërmjet shoqërisë "Integrated Energy

BV SPV" sh.p.k. dhe shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, datë 07.12.2017, ai deklaron se nuk është nënshkruar nga ai kjo kontratë, të cilën po e shikonte për herë të parë. Po ashtu ai deklaron se nuk ka dijeni që shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, të ketë furnizuar apo sjellë ndonjëherë materiale për punime tek kantieri i Inceneratorit të Tiranës.

Në bazë të aktit të ekspertimit grafik të nëshkrimit, nr. 10200, datë 27.10.2023, ka rezultuar se në dokumentin objekt ekspertimi "Kontratë", datë 07.12.2017, mes shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, me administrator shtetasin italian Giuseppe Ciaffaglione dhe shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, me administrator shtetasin Klodian Zoto, nënshkrimi, aty ku gjendet shenja e vulës, nuk duhet të jetë nënshkrimi i shtetasit Giuseppe Ciaffaglione.

Nga aktet e administruara në lidhje me të ardhurat që ka deklaruar në organet tatimore shoqëria **Intergrated Energy BV SPV** sh.p.k, deri në momentin e vendosjes së masë së sigurimit "sekuestro preventive", rezultojnë të dhënat si më poshtë:

Nga librat e shitjes që shoqëria "Intergrated Energy BV SPV" sh.p.k, me nipt L72115013Q, ka deklaruar në organet tatimore rezulton se kjo shoqëri ka kryer shitje ndaj **Bashkisë Tiranë** në vlerën **5,805,669,568 lekë** (pesë miliard e tetëqind e pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, sipas tabelës më poshtë:

Shitës	Blerës	Vlera në lekë
"Intergrated Energy BV SPV" sh.p.k	Bashkia Tiranë	5,805,669,568 lekë

Nga analizimi i librave të shitjes që shoqëria "Intergrated Energy BV SPV" sh.p.k me nipt L72115013Q, ka deklaruar në organet tatimore, rezulton që kjo shoqëri ka kryer shitje ndaj **Bashkisë Kavajë** në vlerën **138,928,832 lekë** (njëqind e tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy lekë) sipas tabelës më poshtë:

Shitës	Blerës	Vlera në lekë
"Intergrated Energy BV SPV" sh.p.k	Bashkia Kavajë	138,928,832 lekë

Nga analizimi i librave të shitjes që shoqëria "Intergrated Energy BV SPV" sh.p.k me nipt L72115013Q, ka deklaruar në organet tatimore, rezulton që kjo shoqëri ka kryer shitje ndaj **Bashkisë Vorë** në vlerën **17,987,369 lekë** (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë lekë) sipas tabelës më poshtë:

Shitës	Blerës	Vlera në lekë
"Intergrated Energy BV SPV" sh.p.k	Bashkia Vorë	17,987,369 lekë

Nga analizimi i librave të blerjes që shoqëria "Intergrated Energy BV SPV" sh.p.k me nipt L72115013Q, ka deklaruar në organet tatimore, rezulton se kjo shoqëri ka kryer blerje nga shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, në vlerën **2,884,905,384** (dy miliard e tetëqind e tetëdhjetë e katër milion e nëntëqind e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lekë, sipas tabelës më poshtë:

Shitës	Blerës	Vlera në lekë
“Integrated Technology Services” sh.p.k	“Integrated Energy BV SPV”	2,884,905,384 lekë

Nga analizimi i llogarive bankare që shoqëria koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, disponon në bankën Credins dhe në bankën Raiffeisen, në monedhën vendase por edhe atë të huaj, rezulton se shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services” sh.p.k, ka përfutur nga shoqëria “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, vlerën monetare prej 3,014,132,088 (tre miliard e katërbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e tetë) lekë, si dhe vlerën prej 6,737,851 (gjashtë milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) Euro.

Në rrethanat e mësipërme, rezulton dukshëm mospërputhje ndërmjet shumës monetare të paguar nga shoqëria koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, në drejtim të shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services” sh.p.k, krahasuar me faturimet e kryera nga shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services” sh.p.k, në drejtim të shoqërisë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k.

Nga të dhënat e marra nga Qendra Kombëtare e Biznesit, rezulton se shoqëria “Integrated Technology Services”, sh.p.k me nipt L02302032C, me pronar shtetasin Klodian Zoto, është regjistruar me datë 02.11.2010, me objekt veprimtarie; *“Ndertime te llojeve te ndryshme. Ndertime impiantesh teknologjike, impiante te prodhimit te energjise se rinovueshme, landfillesh per perpunimin e mbetjeve urbane dhe te rrezikshme, ndertime te impianteve te trajtimit mbetjeve me djegie (incenerator). Ndertim te rrjeteve hidraulike. ujesjellesash, kanalizimesh, elektrike si dhe impiante te ndryshme qe kane lidhje me to. Ndertim impiantesh per pastrimin dhe mbrojtjen ujore dhe lumore. Perpunim, trajtim, menaxhim dhe transport i mbetjeve. Ngritje dhe instalim i rrjeteve me fije pa fije per uje, energji elektrike, kablllovak dhe eireless etj, ngritje e sistemeve te neteork-u per matjen e utiliteteve. Realizimin e laboratoreve, softëareve, mirembajtjen e sistemeve te realizuar prej saj dhe te trete. Ndertim stacionesh dhe nenstacionesh elektrike. Ndertim dhe rikonstruksion i objekteve te rendesise se vecante si dhe objekteve te tjera. Ndertim rrugeshe dhe strukturash te ndryshme. Import, eksport i materialeve, te mallrave qe kane te bejne me objektin e aktivitetit. Transporte te ndryshme. Projektme, sherbime konsulence, studime mjedisore e studime te ndryshme. Import, eksport, shitje, blerje te makinerive te 2 ndryshme. Bonifikim dhe trajtime terrenesh te ndotura. Dhenie me qera dhe nenqera te ambjenteve te tipeve te ndryshme.”*

Sipas prokurorisë, nga aktet e administruara rezulton se shoqëria e shtetasit Klodian Zoto “Integrated Technology Services” sh.p.k, në lidhje me kontratën koncesionare ku rezultojnë se aksionerët “de facto” janë shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, ka përfutur në saj të faturave tatimore të falsifikuara, vlerën monetare 409,428,000 (katërqind e nëntë milion e katërqind e njëzet e tetë mijë) lekë, duke paraqitur dhe deklaruar fatura për punime të kryera si nënkontraktor i shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, me subjekte fiktive, të cilët rezultojnë të regjistruar si operatorë ekonomikë, por që nuk kanë ushtruar asnjëherë ndonjë aktivitet real tregtar. Në rastin konkret shtetasi Klodian Zoto ka deklaruar punime të kryera për llogari të shoqërisë koncesionare në bazë të një kontrate nënkontraktimi të falsifikuar, duke e paraqitur situatën vetëm si një marrëdhënie kontraktuale mes shoqërisë së tij “Integrated Technology Services” sh.p.k dhe shoqërisë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, por që në të vërtetë rezulton se shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri janë aksionerët “de facto” të shoqërisë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k,

që ka fituar kontratën koncesionare nr.6597, datë 31.08.2017 me objekt "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vendepozitimeve ekzistuese, Tiranë".

Në përmbajtje të këtyre faturave, shtetasi Klodian Zoto ka paraqitur si kryerje të punimeve dhe blerje mallash me subjektet "Lumi-06" sh.p.k, "AA-117" sh.p.k, "Al-BerCo&Co" sh.p.k, "EZ & LA" sh.p.k, por që në të vërtetë përmbajnë rrethana të rreme të përshkruara në to , konkretisht për secilën shoqëri, si më poshtë:

**1. NË LIDHJE ME SUBJEKTIN "Lumi-06" sh.p.k, me nipt L62322031I.**

- Rezulton se është regjistruar më datë 22.11.2016, me administratore dhe ortakë të vetme shtetasen Lumturije Murati, me adresë të ushtrimit të aktivitetit, Njësia administrative Nr. 8, Rruga "Ferit Xhajko", pall, nr.63/1, apartamenti 44. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë ka qenë tregti me shumicë dhe pakicë, import-eksport, të artikujve të ndryshme industrial, ushqimor, etj.

- Në kohën e lëshimit të faturave të falsifikuara në emër të shoqërisë "Lumi-06" sh.p.k, ndaj shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, që përkon me periudhën kohore nga data 01.10.2018 deri në datë 26.12.2018, është shënuar si administratore e shoqërisë "Lumi-06" sh.p.k. shtetasja Lumturije Murati.

- Nga verifikimi në sistemin tatimor, rezulton se shtetasja Lumturije Murati është e shënuar në organet tatimore si pjesë e aktivitetit për rreth 12 muaj. Gjatë kësaj periudhe rezulton në emër të shoqërisë "Lumi-06" sh.p.k. janë paraqitur fatura shitje të falsifikuara në drejtim të shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k. në vlerën 109,704,000 lekë. Nga analizimi i librave të shitjes dhe të blerjes të kësaj shoqërie rezulton se shitjet janë përshkruar si të realizuara vetëm në subjekte tregtare që operojnë në fushën e ndërtimit, ndërsa blerjet janë të përshkruara të realizuara vetëm nga subjekte tregtare që operojnë në fushën e tregtisë së artikujve ushqimore.

- Nga analizimi i historikut të punësimit të deklaruar në organin tatimor për shtetasen Lumturije Murati, rezulton se kjo shtetase paraqitet e punësuar sipas tabelës së mëposhtme:

NIPT	SUBJEKTI	NR. PERSONAL	EMËR	MBIEMËR	DATA E PUNËSIMIT	DATA E LARGIMIT
K88125301E	KOLECI 2003	F85505074G	Lumturije	Murati	20/10/2016	08/11/2016
L17517501D	FRANGAJ - INTERNATIONAL	F85505074G	Lumturije	Murati	01/03/2012	19/09/2016
L17517501D	FRANGAJ - INTERNATIONAL	F85505074G	Lumturije	Murati	01/01/2012	29/02/2012
L62322031I	LUMI - 06	F85505074G	Lumturije	Murati	06/04/2018	09/07/2019
L62322031I	LUMI - 06	F85505074G	Lumturije	Murati	25/11/2016	12/12/2017

- Nga analizimi i bilancit të deklaruar në organin tatimor, rezulton se shoqëria "Lumi 06" sh.p.k, nuk ka mjete apo makineri të deklaruara, si dhe volumi i shitjeve të deklaruara në

organin tatimor nga subjekti "Lumi 06" sh.p.k. është jashtë kapaciteteve teknike të shoqërisë.

- Nga analizimi i librave të blerjes rezulton se blerjet janë kryer vetëm nga shoqëri që operojnë në fushën e tregtisë së artikujve ushqimore ndërsa shitjet janë kryer të gjitha në subjekte që operojnë në fushën e ndërtimit.

- Po ashtu, rezulton se subjekti "Lumi 06" sh.p.k, nuk ka kapacitete në burime njerëzore dhe në mjete për të bërë të mundur ushtrimin e këtij aktiviteti tregtar, si dhe nuk mund të faturojë në volumet, në të cilat janë deklaruar faturat e shitjes, duke marrë parasysh se ka të shënuar një numër shumë të vogël punonjësish, si dhe për një periudhë të gjatë kohore ka pasur të shënuar si të punësuar vetëm administratorin e shoqërisë.

- Duke verifikuar listëpagesat dhe historikun e punonjësve rezulton se subjekti "Lumi-06" sh.p.k, ka të deklaruar në listëpagesën e muajit të fundit gjithsej 7 (shtatë) të punësuar, sipas tabelës:

Nr ID	Punonjësi	Pozicioni	Paga
F85505074G	Lumturije Murati	Administrator	40,000
H50917009M	Ilir Lika	Punëtor për sistemim malli	26,000
F61114058E	Astrit Kastrati	Manovrator i prodhimit të armaturave	30,000
F90924070D	Ahmet Ceka	Shofer kamioni	30,000
J11103055N	Migert Kello	Teknik/inxhinieri civile (strukture)	30,000
G60226058R	Nezir Beqiri	Shofer kamioni	30,000
F86020086Ë	Vexhide Malo	Punëtor i shërbimeve të tjera elementare	26,000

- Nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS rezulton se punonjësit e sipërcituar janë të deklaruar në disa shoqëri njëkohësisht si të punësuar, në funksione të ndryshme si punonjës shërbimi, etj. Konkretisht, shtetasi Ilir Lika në të njëjtën periudhë që ka paraqitet i punësuar të shoqëria "Lumi 06" sh.p.k, ka qënë i punësuar edhe si punëtor që sistemon mallin pranë shoqërisë "Dekon Frigo" sh.p.k me adresë: **Bradashesh, Elbasan** për periudhën 03.2017 deri në 09.2019. Shtetasi Astrit Kastrati rezulton i punësuar në disa shoqëri, në periudhën që paraqitet i punësuar tek shoqëria "Lumi 06" sh.p.k, ka qënë i punësuar edhe tek shoqëritë "Gesi 05" sh.p.k dhe "Gesi 05 Group" sh.p.k. Shtetasi Ahmet Ceka, në të njëjtën periudhë që paraqitet i punësuar tek shoqëria "Lumi 06" sh.p.k, ka qënë i punësuar edhe në disa shoqëri të tjera. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se këta shtetas kanë qënë të punësuar realisht në subjekte të tjera dhe nuk kanë punuar asnjëherë tek shoqëria "Lumi 06" sh.p.k.

E pyetur për këtë fakt shtetasja Lumturije Murati ka deklaruar se nuk ka themeluar ndonjë operator ekonomik me emrin "Lumi 06" sh.p.k dhe nuk ka dijeni se kush e ka themeluar dhe regjistruar këtë operator ekonomik, si dhe nuk ka kryer ndonjë aktivitet tregtar në emër të

kësaj shoqërie.

I pyetur për faktin nëse ka dëgjuar ndonjëherë për operatorin ekonomik "LUMI-06" sh.p.k, dhe nëse ka qenë i punësuar, shtetasi **Migert Kello** deklaron se nuk ka dëgjuar ndonjëherë për operatorin ekonomik "LUMI 06" sh.p.k. dhe nuk ka qenë asnjëherë i punësuar pranë këtij operatori ekonomik. Po ashtu, ai deklaron se nuk ka dijeni se kush mund të jetë pronari i kësaj kompanie. I pyetur për faktin se pse në sistemin "C@ts", të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezulton se ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik "LUMI-06" sh.p.k, ai deklaron se është i habitur nga ky fakt që rezulton të jetë shënuar si i punësuar pranë kësaj kompanie, pasi nuk ka punuar asnjëherë dhe nuk ka asnjë lidhje me këtë kompani.

I pyetur për faktin nëse ka dëgjuar ndonjëherë për operatorin ekonomik "LUMI-06" sh.p.k, dhe nëse ka qenë i punësuar, shtetasi **Astrit Kastrati** deklaron se nuk e ka dëgjuar asnjëherë, dhe është hera e parë që po e dëgjon atë. Ai deklaron se nuk ka punuar asnjëherë tek operatori ekonomik "LUMI-06" sh.p.k. Po ashtu ai deklaron se nuk ka dijeni se kush është pronari i operatorit ekonomik "LUMI-06" sh.p.k. I pyetur për faktin se pse në sistemin "C@ts", të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezulton se ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik "LUMI-06" sh.p.k, ai deklaron se është i habitur pasi nuk ka punuar asnjëherë tek kjo kompani dhe nuk ka asnjë lidhje me këtë kompani, madje është hera e parë që po e dëgjon.

E pyetur për faktin nëse ka dëgjuar ndonjëherë për operatorin ekonomik "LUMI-06" sh.p.k, dhe nëse ka qenë e punësuar, shtetasja **Vexhide Malo** deklaron se ajo është pensioniste dhe se nuk është marrë me ndonjë aktivitet, si dhe nuk e ka dëgjuar asnjëherë këtë operator ekonomik. Ajo deklaron se nuk ka punuar asnjëherë tek shoqëria "LUMI-06" sh.p.k., nuk e di se kush mund të jetë pronari i kësaj shoqërie. E pyetur për faktin se pse në sistemin "C@ts", të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezulton se ka qenë e punësuar pranë operatorit ekonomik "LUMI-06" sh.p.k, ajo deklaron se në vitin 2018 për efekt të mbushjes së vjetërsisë së moshës së pensionit bashkëshorti i saj e ka regjistruar tek një shoqëri, së cilës nuk ajo nuk ia di as emrin, por kjo është bërë vetëm për efekt të mbushjes së moshës së pensionit, nuk ka qenë asnjëherë e punësuar realisht, pasi nuk ka shkuar asnjëherë në punë tek kjo shoqëri, por ka qëndruar në shtëpinë e saj pasi në atë kohë ka qenë shtëpiake

## 2. Në lidhje me subjektin tjetër "AA-117" shpk, me nipt L71403005S.

- Rezulton se është regjistruar në datë 03.02.2017, me administrator dhe aksioner shtetasen **Drita Frangaj**, me adresë të ushtrimit të aktivitetit, Njësia administrative Nr.8, Rruga Ferit Xhajko, pall, nr.64/2, apartamenti 42. Me objekt aktiviteti: "Tregti me shumicë dhe pakicë, imp-eks, të artikujve të ndryshme industrial, ushqimor etj".

- Në kohën e lëshimit të faturave të falsifikuara në emër të shoqërisë "AA-117" sh.p.k, ndaj shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, që përkon me periudhën kohore nga data 23.08.2018 deri në datë 14.12.2018, është shënuar si administratore e shoqërisë "AA-117" sh.p.k, shtetasja **Drita Frangaj**. Gjatë kësaj periudhe rezulton se në emër të shoqërisë "AA-117" sh.p.k, janë paraqitur fatura shitje të falsifikuara në drejtim të shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, në vlerën 117,534,000 lekë.

- Nga analizimi i deklarimeve të bëra në organin tatimor nga shoqëria "AA-117" sh.p.k, rezulton se kjo shoqëri nuk ka mjete apo makineri dhe volumi i shitjeve të deklaruara në

organin tatimor nga subjekti "AA-117" sh.p.k, është jashtë kapaciteteve teknike të shoqërisë. Nga analizimi i librave të blerjes rezulton se blerjet janë kryer vetëm nga shoqëri që operojnë në fushën e tregtisë së artikujve ushqimore ndërsa shitjet janë të gjitha të kryera në subjekte që operojnë në fushën e ndërtimit. Nga ana tjetër rezulton se subjekti "AA-117" sh.p.k, nuk ka kapacitete në burime njerëzore dhe në mjete për të bërë të mundur ushtrimin e këtij aktiviteti, si dhe nuk mund të faturojë në volumet në të cilat janë deklaruar faturat e shitjes, duke marrë parasysh se kanë një numër shumë të vogël punonjësish, si dhe për një periudhë të gjatë kohore ka të shënuar si të punësuar sipas listëpagesave vetëm administratorin e shoqërisë.

- Duke verifikuar listëpagesat dhe historikun e punonjësve, rezulton se subjekti "AA-117" sh.p.k, ka të deklaruar në listëpagesën e muajit të fundit gjithsej 7 (shtatë) të punësuar, sipas tabelës si më poshtë:

Nr. ID	Punonjësi	Pozicioni	Paga
H80304182K	Arbër Xhaferaj	Teknik ndërtimi	30.000
H06225069L	Drita Frangaj	Administrator	35,000
J41112017D	Hekuran Shadini	Shofer kamioni	30,000
J00525103S	Erald Hasa	Punëtor grumbullimi	26.000
J10116012B	Mariglen Haka	Punëtor ngarkim-shkarkimi për materiale ndërtimi	26,000
G00406072V	Agim Hasa	Punëtor grumbullimi	26,000
I40218048U	Edlir Hida	Punëtor ngarkim-shkarkimi për materiale ndërtimi	26,000

- Nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS, rezulton se punonjësit e sipërcituar janë të deklaruar në disa shoqëri njëkohësisht si të punësuar, në funksione të ndryshme si punonjës shërbimi, etj. Konkretisht, shtetasi Arbër Xhaferaj i cili rezulton i punësuar si "Teknik ndërtimi" pranë shoqërisë "AA-117" sh.p.k, rezulton njëkohësisht i punësuar edhe në subjektin "S2 Albania" si "Mbikëqyrës i Inxhinierisë Elektronike". Shtetasi Hekuran Shadini, i cili rezulton i punësuar si "shofer kamioni" pranë shoqërisë "AA-117" sh.p.k, (edhe pse kjo shoqëri nuk ka asnjë mjet të deklaruar apo të marrë me qira), ky shtetas rezulton si i punësuar edhe "mekanik" në shoqërinë "GSA". Shtetasi Mariglen Haka i cili rezulton i punësuar pranë shoqërisë "AA-117" sh.p.k, si punëtor ngarkim shkarkimi, rezulton i punësuar me kohë të plotë në shoqërinë "Kurum" Sha në pozicionin "mekanik për kamiona", si dhe rezulton i punësuar në disa shoqëri të tjera, të cilat janë fiktive. Shtetasi Agim Hasa, i cili rezulton i shënuar si i punësuar pranë shoqërisë "AA-117" sh.p.k, si "punëtor grumbullimi", në të njëjtën periudhë kohe rezulton i punësuar me kohë të plotë në shoqërinë "Victoria Invest", si dhe në disa shoqëri të tjera, të cilat janë fiktive. Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se këta shtetas kanë qenë të punësuar realisht në subjekte të tjera dhe nuk kanë punuar asnjëherë tek shoqëria "AA-117" sh.p.k.

I pyetur për faktin nëse ka dëgjuar ndonjëherë për operatorin ekonomik "AA-117" sh.p.k, dhe nëse ka qenë i punësuar, shtetasi Mariglen Haka deklaroi se nuk e ka

dëgjuar asnjëherë këtë shoqëri, madje është hera e parë që po e dëgjon atë. Ai deklaroi se nuk ka punuar asnjëherë tek operatori ekonomik "AA-117" sh.p.k, pasi ai është me profesion mekanik i industrisë së rëndë dhe në vitin 2018 e në vijim ka qenë i punësuar tek kompania "KURUM" sh.a. Po ashtu ai deklaroi se nuk ka dijeni se kush është pronari i operatorit ekonomik "AA-117" sh.p.k. I pyetur për faktin se në sistemin "C@ts", të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezulton se ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik "AA-117" sh.p.k, ai deklaroi se nuk din gjë rezulton që të këtë qenë i shënuar si i punësuar pranë kësaj shoqërie, pasi nuk ka punuar asnjëherë tek kjo shoqëridhe nuk e njeh këtë shoqëri.

### 3. Në lidhje me subjektin tjetër "Al-BerCo&Co" sh.p.k, me nipt L53516002S.

- Rezulton se ky subjekt është regjistruar në datë 16.11.2015, me administrator dhe aksioner shtetasin Santiliano Çifliku, me adresë të ushtrimit të aktivitetit. Lagja Nr.13 Shtatori, Berat. Me objekt aktiviteti: "Tregti me shumicë dhe pakicë, imp-eks, të artikujve të ndryshme industrial, ushqimor etj".

- Gjatë kësaj periudhe rezulton se në emër të shoqërisë "Al-BerCo&Co" sh.p.k, janë paraqitur fatura shitje të falsifikuara në drejtim të shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, në vlerën 110,544,000 lekë. Nga analizimi i librave të shitjes dhe të blerjes të kësaj shoqërie rezulton se shitjet janë përshkruar si të realizuara vetëm në subjekte tregtare që operojnë në fushën e ndërtimit, ndërsa blerjet janë të përshkruara të realizuara vetëm nga subjekte tregtare që operojnë në fushën e tregtisë së artikujve ushqimore.

- Rezulton se në datën 01.11.2016, me vendimin i asamblesë së ortakëve të shoqërisë, ortaku i vetëm shtetasi Santiliano Çifliku ka miratuar shtimin e aktivitetit të shoqërisë më shërbime konsulentë inxhinierie dhe supervizimi, si dhe ka miratuar hapjen e adresave të aktivitetit për mjetet e transportit kamion me targë AA351AO, kamion me targë AA873AM, kamion me targë TR2532I, kamion me targë TR5771H, kamion me targë AA876AM, fadromë të markës Perlin 131-33, fadromë të markës Case 460 CX3.

- Po ashtu rezulton se në datën 31.10.2017, ka ndodhur ndryshimet përsa i përret aksionerit të shoqërisë "Al-BerCo&Co" sh.p.k, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, duke u shënuar si aksioner i vetëm shtetsja Esmeralda Çifliku.

- Nga verifikimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), rezulton se targat e deklaruara sa më sipër, nuk janë mjete kamiona. Konkretisht, mjeti me targë AA351AO, rezulton të jetë rimorkio, i cili është në pronësi të subjektit "Aren 2005" sh.p.k; mjeti me targë AA876AM rezulton të jetë rimorkio, i cili është në pronësi të subjektit "Aren 2005" sh.p.k; mjeti me targë TR 2532I, rezulton të jetë rimorkio, i cili është në pronësi të shtetasit "Flladion Kol Prenga"; ndërsa nuk rezulton të këtë të regjistruar asnjë mjet me targën TR5771H. Mjetet e deklaruara nga subjekti në organin tatimor nuk janë mjete në pronësi reale të subjektit "Al-Ber Co&Co" sh.p.k, por janë deklaruar fiktivisht me qëllimin për të lëshuar fatura fiktive.

- Nga analizimi i deklarimeve të bëra në organin tatimor nga shoqëria "Al-Ber Co&Co" sh.p.k, rezulton se kjo shoqëri nuk ka pasur kapacitete për të realizuar volumin e shitjeve të deklaruara nga subjekti "Al-BerCo&Co" sh.p.k.

- Nga analizimi i librave të blerjes dhe të shtijes rezulton se shitjet janë të gjitha të kryera në subjekte që operojnë në fushën e ndërtimit dhe blerjet janë të gjitha nga subjekte importuese të artikujve ushqimorë.

- Nga ana tjetër rezulton se subjekti "Al-Ber Co&Co" sh.p.k, nuk ka kapacitete në burime njerëzore dhe në mjete për të bërë të mundur ushtrimin e këtij aktiviteti, si dhe nuk mund të faturtojë në volumet, në të cilat janë deklaruar faturat e shitjes, duke marrë parasysh se ka të deklaruar një numër shumë të vogël punonjësish dhe për një periudhë të gjatë kohore ka pasur të punësuar sipas listëpagesave vetëm administratorin e shoqërisë.

- Duke verifikuar listëpagesat dhe historikun e punonjësve rezulton se subjekti ka të deklaruar në listëpagesën e muajit të fundit gjithsej 7 të punësuar sipas tabelës;

NR. ID	Personi	Pozicioni	Punësimi	Paga
G50420103P	Artur Xhambolli	Punëtor krahu në ndërtim rrugësh	I punësuar në dy subjekte	24,000
I11101059L	Isa Lushi	Shofer kamioni	I punësuar në dy subjekte	30,000
F91001079E	Jakup Kapxhiu	Punëtor krahu në ndërtim rrugësh	I punësuar në dy subjekte	24,000
G11022026U	Luan Xhambolli	Punëtor krahu në ndërtim godinash	I punësuar në dy subjekte	24,000
J61204039V	Xhon Lama	Punëtor krahu në ndërtim rrugësh	I punësuar për herë të parë apo rishtazi te subjekti përkatës	24,000
J25414064Q	Esmeralda Çifliku	Drejtor i administratës	I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më shumë se 87 orë në muaj,	30,000
G30715167C	Genci Skifteri	Shofer kamioni	I punësuar në dy subjekte	27,500

- Nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS rezulton se punonjësit e sipërcituar janë të deklaruar në disa shoqëri njëkohësisht si të punësuar, në funksione të ndryshme si punonjës shërbimi etj, sipas tabelës së mësipërme. Vihet re se këta shtetas kanë qënë të punësuar realisht në subjekte të tjera dhe nuk kanë punuar asnjëherë tek shoqëria "Al-BerCo&Co" sh.p.k.

I pyetur për këtë fakt shtetasi Santilliano Çifliku ka deklaruar se ai nuk e ka krijuar apo themeluar shoqërinë "Al-BerCo&Co" sh.p.k.", nuk ka qënë i punësuar tek kjo shoqëri, si dhe nuk ka kryer ndonjë aktivitet tregtar në emër të kësaj shoqërie. Ai mban mend se kartën e tij të identitetit ia ka kërkuar miku i tij i familjes Dashmir Ymeraj, por nuk ka dijeni se ku e ka përdorur këtë dokument identifikimi.

E pyetur për këtë fakt shtetasja **Esmeralda Çifliku** ka deklaruar se nuk ka qenë e punësuar asnjëherë tek shoqëria "Al-BerCo&Co" sh.p.k.", nuk ka dijeni se e kujt është kjo shoqëri, por mban mend se me propozimin e shtetasit Dashmir Ymeraj, ajo ka shkuar tek noteri dhe ka nënshkruar një kontratë, nëpërmjet së cilës është bërë kalimi i pronësisë së një shoqërie të shtetasit Dashmir Ymeraj, nga vëllai i saj, **Santillano Çifliku tek ajo**. Shtetasja Esmeralda Çifliku deklaron se nuk ka dijeni për emrin e kësaj shoqërie, realisht nuk ka qenë e punësuar ndonjëherë tek kjo shoqëri, si dhe nuk ka kryer ndonjë aktivitet tregtar në emër të kësaj shoqërie.

I pyetur për faktin nëse ka dëgjuar ndonjëherë për operatorin ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k." dhe nëse ka qenë i punësuar, shtetasi **Artur Xhambolli** deklaron se nuk e ka dëgjuar asnjëherë këtë shoqëri. Ai deklaron se nuk ka punuar asnjëherë tek operatori ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k.", pasi ai është me profesion hekurkthyes. Po ashtu, ai deklaron se nuk ka dijeni se kush është pronari i operatorit ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k.". I pyetur për faktin se në sistemin "C@ts", të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve rezulton se ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k." ai deklaron se nuk di gjë, ai nuk e njeh këtë shoqëri dhe nuk ka punuar asnjëherë tek kjo shoqëri

I pyetur për faktin nëse ka dëgjuar ndonjëherë për operatorin ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k, dhe nëse ka qenë i punësuar, shtetasi **Genci Skifteri** deklaron se nuk e ka dëgjuar asnjëherë këtë shoqëri, është hera e parë që po e dëgjon këtë emër. Ai deklaron se nuk ka punuar asnjëherë tek operatori ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k.", pasi ai është me profesion shofer kamioni. Po ashtu, ai deklaron se nuk ka fare dijeni se kush është pronari i operatorit ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k." pasi nuk e njeh këtë operator ekonomik. I pyetur për faktin se sistemin "C@ts", të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezulton se ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k." ai deklaron se nuk di gjë, ai nuk ka punuar asnjëherë pranë këtij operatori ekonomik.

I pyetur për faktin nëse ka dëgjuar ndonjëherë për operatorin ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k, dhe nëse ka qenë i punësuar, shtetasi **Isa Lushi** deklaron se nuk e ka dëgjuar asnjëherë këtë operator ekonomik. Ai deklaron se është hera e parë që po e dëgjon dhe se nuk ka punuar asnjëherë tek operatori ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k.", pasi ai është me profesion shofer kamioni. Po ashtu, ai deklaron se nuk ka fare dijeni se kush është pronari i operatorit ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k.". I pyetur për faktin se në sistemin "C@ts", të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezulton se ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik "Al-BerCo&Co" sh.p.k." ai deklaron se nuk din gjë, ai nuk ka punuar asnjëherë tek ky operator ekonomik.

#### 4. Në lidhje me subjektin tjetër "EZ&LA" sh.p.k, me NIPT L87701301Q.

- Rezulton se është regjistruar në datë 22.02.2018, me administrator dhe aksioner shtetasin Emiljano Frroku, me adresë të ushtrimit të aktivitetit, ZallHerr, pranë Forcave Komando. Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie ka qenë Import- Eksport. Zbatimi i punimeve te ndertimit Kat. I. etj.

- Nga analizimi i deklarimeve të bëra në organin tatimor nga shoqëria "EZ&LA" sh.p.k, rezulton se kjo shoqëri nuk ka mjete apo makineri dhe volumi i shitjeve të deklaruara në organin tatimor nga subjekti "EZ&LA" sh.p.k, është jashtë kapaciteteve teknike të shoqërisë. Nga analizimi i librave të shitjes dhe blerjes të shoqërisë "EZ&LA" sh.p.k, rezulton se blerjet janë kryer vetëm nga shoqëri që operojnë në fushën e tregtisë së artikujve

ushqimore, ndërsa shitjet janë të gjitha të kryera në subjekte që operojnë në fushën e ndërtimit.

- Gjatë periudhes kohore nga data 23.08.2018 deri në datë 14.12.2018,rezulton se në emër të shoqërisë "EZ&LA" sh.p.k, janë paraqitur fatura shitje të falsifikuara në drejtim të shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, në vlerën 71,646,000 lekë.

- Nga ana tjetër, rezulton se subjekti "EZ&LA" sh.p.k. nuk ka kapacitete në burime njerëzore dhe në mjete për të bërë të mundur ushtrimin e këtij aktiviteti, si dhe nuk mund të faturojë në volumet në të cilat janë deklaruar faturat e shitjes, duke marrë parasysh se kanë një numër shumë të vogël të punësuarish dhe për një periudhë të gjatë kohore ka pasur të punësuar sipas listëpagesave vetëm administratorin e shoqërisë.

- Duke verifikuar listëpagesat dhe historikun e punonjësve, rezulton se subjekti ka të deklaruar në listëpagesën e muajit të fundit gjithsej 7 (shtatë) të punësuar, të cilët figurojnë të punësuar në subjekte të tjera dhe me funksione të ndryshme, ndërsa vetëm administratori i saj rezulton i punësuar te kjo shoqëri. Konkretisht, sipas tabelës si më poshtë:

Nr. ID	Personi	Pozicioni	Paga
G95228152V	File Hasvataj	Magaznier	26,000
H05226136V	Drita Kalia	Arkëtar magazine	26,000
F70303075K	Zako Stajkiq	Shofer kamioni	26,000
J50712064I	Emiljano Frroku	Drejtor ekzekutiv në tregti	30,000
H90316213K	Lutfi Elezi	Shofer kamioni	26,000
J45904036B	Elida Shpendi	Sekretar	26,000
F50628134U	Pjetër Frroku	Shofer kamioni	26,000

- Nga verifikimi në sistemin tatimor C@TS rezulton se disa nga punonjësit e sipërcituar janë të deklaruar në disa shoqëri njëkohësisht si të punësuar në funksione të ndryshme si punonjës shërbimi etj. Rezulton se këta shtetas kanë qenë të punësuar realisht ne subjekte të tjera dhe nuk kanë punuar asnjëherë për shoqërinë "EZ&LA" sh.p.k.

I pyetur për faktin nëse ka nëse ka qenë i punësuar tek operatori ekonomik "EZ&LA" sh.p.k sh.p.k, shtetasi Pjetër Frroku deklaron se nuk e ka dëgjuar asnjëherë këtë operator ekonomik, nuk e di dhe nuk e njeh këtë operator ekonomik. Ai deklaron se është hera e parë që po e dëgjon dhe se nuk ka punuar asnjëherë tek operatori ekonomik "EZ&LA" sh.p.k. Po ashtu ai deklaron se nuk ka dijeni se kush është pronari i operatorit ekonomik "EZ&LA" sh.p.k, por mban mend se rreth muajit prill të vitit 2018 ka qenë duke shkuar për Tiranë dhe në afërsi të Mamurrasit ka parë një njoftim, në të cilën kishin shkruar që kërkonin roje objekti. Ai deklaron se ka shkuar tek objekti që ishte në rrugën Laç-Mamurras, km 2, ka takuar menaxherin që kishte tek vendi i punës dhe i ka thënë që kishte parë njoftimin që kishin nxjerrë për roje objekti dhe nëse kishin nevojë për roje objekti. Ai deklaron se menaxheri i ka thënë se kishin nevojë për roje objekti tek një pikë inertesh në Laç, Mamurras. Ai deklaron se ka punuar si i siguruar tek kjo punë deri rreth vitit 2019, më shumë ka punuar për efekt pensioni. Ai deklaron se e kanë toleruar për efekt pensioni, në punë ka shkuar vetëm ndonjëherë. Ai deklaron se ka marrë një pagë 20.000 lekë në muaj dhe ndonjë rast të rrallë ka qëndruar tek objekti, pika e inerteve nga ora 19:00 deri në orën 07:00. Ai

deklaron se më shumë kjo punë i është dukur si punë fiktive, pasi shoqëria nuk kishte aktivitet të mirëfilltë.

Sipas prokurorisë, në rrethanat e mësipërme rezulton se shtetasit Klodian Zoto në bashkëpunim me shtetasin Mirel Mërtiri kanë përfituar në sajë të faturave tatimore të falsifikuara, vlerën monetare 409,428.000 (katërqind e nëntë milion e katërqind e njëzet e tetë mijë) lekë, ku shtetasi Klodian Zoto është paraqitur dhe ka deklaruar fatura të falsifikuara për punime të kryera si nënkontraktor i shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. ku rezulton se në kohën e lëshimit të këtyre faturave, aksionerë "de facto" kanë qenë shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri. Nga aktet e administruara rezulton se këto vlera monetare të siguruar në sajë të mashtrimit nëpërmjet paraqitjes së faturave të falsifikuara, janë tërhequr një pjesë e madhe e vlerave monetare në cash dhe janë transferuar në mënyra të ndryshme jashtë vendit nga shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri. Po ashtu, rezulton se shtetasi Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, si akisionerët "de facto" të shoqërisë koncesionare, kanë përgatitur preventiva të falsifikuara duke fryrë treguesit në kostot e ndërtimit, të përfshira dhe në studimin e fizibilitetit të paraqitur nga ana e tyre, për fitimin e kontratës koncesionare nr.6597, datë 31.08.2017 me objekt "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë".

Në rrethanat e mësipërme rezulton se shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, akisionerët "de facto" të shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, dyshohet se kanë kryer veprat penale "Mashtrimi" me pasoja të rënda, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 143/3, 25 i Kodit Penal, "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 287/ gërma "a" dhe "b" të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese "në bashkëpunim", sipas nenet 287 paragrafi 2 i Kodit Penal.

Nga hetimi në lidhje me akisionerët e shoqërisë hollandeze "Geogenix BV" (ish-"Integrated Energy BV"), e cila zotëron si akisioner i vetëm me 100 % të aksioneve në shoqërinë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, kanë rezultuar të dhënat si më poshtë:

Me datë 31.08.2017 është lidhur kontrata e koncesionit me objekt "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë", ndërmjet Ministrisë së Mjedisit të Republikës së Shqipërisë dhe operatorit ekonomik "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k.

Nga verifikimet e kryera në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., është themeluar me datë 30.08.2017 si 'Subjekt për Qëllime të Vecanta (SPV)', dhe është regjistruar me datë 31.08.2017 në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Ky operator ekonomik ka si akisioner të vetëm (100%) shoqërinë hollandeze "Integrated Energy BV", sot me emrin e ri tregtar "Geogenix BV". Objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, është "*Ndërtimi, administrimi, operimi dhe transferimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve në Tiranë dhe prodhimi i energjise për autoritetin kontraktues, duke përfshirë financimin, ndërtimin, vënien në punë, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, shitjen dhe eksportin e energjise elektrike në këto kontrate koncesioni si dhe çdo lloj tjetër aktiviteti tregtar që lidhet dhe ushtrohet sipas kesaj kontrate, gjithashtu dhe çdo aktivitet tjetër që kontribuon në zhvillimin dhe administrimin e projektit*".

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Aktin dhe statutin e themelimit të shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, e ka nënshkruar shtetasi Klodian Zoto, si përfaqësues i shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV", (sot me emrin e ri tregtar "Geogenix BV").

*Administratori i shoqërisë të krijuar në Shqipëri "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, nga shoqëria holandeze "Integrated Energy BV", është caktuar shtetasi italian Giuseppe Ciaffaglione.*

Nga dokumentacioni që është ngarkuar në sistemin elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), tek 'Dokumentat e tenderit', rezultojnë që shoqëria holandeze **"Integrated Energy BV"** është krijuar nga bashkimi i tre shoqërive, konkretisht si më poshtë:

-**"Integrated Technology Services"** sh.p.k, me Nipt - L02302032C, me adresë zyre rruga "Abdi Toptani", godina "Torre Drin", nr. 31/1, Tiranë, me administrator shtetasin **Klodian Agim Zoto**, i datëlindjes 24.04.1976, lindur dhe banues në Tiranë, me nr. personal **H60424155A**;

-**"Energy Recuperator S.P.A"** me numër në regjistrin tregtar Italian **BS-297248**, me kod fiskal **02074150174**, me adresë via Cristoforo Colombo 27, 25013 Novagli, Carpenedolo, me përfaqësues ligjor shtetasin **Ernesto Granelli**, lindur në Carpenedolo, Itali, i datëlindjes 08.12.1944, me kod fiskal **GRNRST44TO8B817C**, me vendbanim në Via Cesare Abba, nr.120, Carpenedolo – Brescia, Itali.

-**"Paul Ęurth Italia S.P.A"**, me numër në regjistrin tregtar Italian **GE418356**, me kod fiskal **0155964998**, me adresë Via di Francia 1, 16149, Genova, me përfaqësues ligjor shtetasin **Thomas Ęalter Hansmman** lindur në Aachen, Gjermani me datë 23.10.1961, me kod fiskal **HNSTMS61R23Z112F**, me vendbanim në Viale Arezzo 5D - 16146 Genova, Itali.

Rezultojnë se me datë 19.08.2016 është hartuar akti i themelimit i shoqërisë **"Integrated Energy B.V"**, me seli në Hollandë, nga noteri hollandez **Gilian Renkema**, i punësuar nga shtetasi **Pieter Gerard van Druten**, noter me seli në Amsterdam. Për këtë akt-themelimi është paraqitur shtetasi **Freek Hilberdink**, lindur në Haarlem, me datë 11.02.1986, i punësuar pranë firmës ligjore **Loyens & Loeff** (22227996) me adresë zyre: **Fred.Roeskestraat 100, 1076 ED Amsterdam, Hollandë**. Shtetasi **Freek Hilberdink** është paraqitur si person i autorizuar me prokurë nga të tre shoqëritë: **"Paul Ęurth Italia S.P.A."** (themeluesi 1) **"Energy Recuperator S.P.A."** (themeluesi 2) dhe **"Integrated Technology Services"** sh.p.k (themeluesi 3). Ky shtetas i pajisur me prokurë, pranë zyrës së noterisë ka kryer aktin e themelimit të shoqërisë **"Integrated Energy B.V."**, me seli në Hollandë. Kapitali themeltar i kësaj kompanie ka qenë 50.000 Euro me vlerë nominale aksioni prej 1 Euro dhe aksionet janë zotëruar përkatësisht nga:

- 22.500 askione ose 45% nga **"Paul Ęurth Italia S.P.A"**; (themeluesi 1)
- 15.000 aksione ose 30% nga **"Energy Recuperator S.P.A."**; (themeluesi 2)
- 12.500 aksione ose 25% nga **"Integrated Technology Services"** sh.p.k (themeluesi 3).

Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve në QKB, datë 03.04.2023, tek regjistri i pronarëve përfutues, përsa i përket shoqërisë **"Integrated Energy BV SPV"** sh.p.k, rezultojnë se me datë 25.06.2021, kanë ndodhur ndryshimet përsa i përket aksionerëve të shoqërisë holandeze **"GeoGenix"** (më herët me emrin tregtar **"Integrated Energy BV"**).

Në këtë deklaram të datës 25.06.2021 të kryer në QKB, konstatohet se ka pasur një ndryshim të aksionerëve të shoqërisë holandeze **"Geogenix BV"** (ish- **Integrated Enmergy BV**) e cila rezultojnë që të jetë pronare me 100% të aksioneve të shoqërisë koncesionare **"Integrated Energy BV SPV"** sh.p.k. Aksionerët e shoqërisë holandeze **"Geogenix BV"** sipas këtij regjistrimi të kryer, janë deklaruar që të jenë:

1. **Giuseppe Ciaffaglione**, i datëlindjes 24.04.1968, me shtetësi italiane, - përfitues i 30% të aksioneve të shoqërisë GeoGenix me Nipt:66671752 (shoqëria mëmë e "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k).
2. **Salvatore Russell**, i datëlindjes 03.1975, me shtetësi italiane, pronari i vetëm i shoqërisë italiane Hydros SRL (numër identifikimi 01380110765)- përfitues i 25 % të aksioneve të shoqërisë GeoGenix me Nipt:66671752.
3. **Alberto Presezzi**, i datëlindjes 07.1969, me shtetësi italiane, pronar i shoqërive aksionere "Bruno Presezzi SPA" me Nipt 07118380158 dhe "Franco Tosi Meccanica SPA" me Nipt 09020510963, - përfitues i 43% të aksioneve të shoqërisë "GeoGenix" me Nipt:66671752.

Nga dokumentacioni që shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, ka dorëzuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për të kryer deklarin e pronarëve përfitues fundor të shoqërisë "Integrated Energy BV SPV", rezulton se nuk është dorëzuar nga shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, në QKB, dokumentacioni shoqërues justifikues për të provuar ndryshimin e aksionerëve përkatës për periudhën kohore në fjalë, sipas përcaktimeve të ligjit nr.112 të vitit 2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar, si dhe VKM nr.1008, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara".

Po ashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit që shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. ka dorëzuar në QKB, për të kryer këtë deklarin të pronarëve përfitues fundorë, rezulton se administratorja e shoqërisë "Integrated Energy BV SPV", shtetasja Arjola Kodra ka dorëzuar kopjen e pasaportës të shtetasve Alberto Presezzi dhe Salvatore Russell, nëpërmjet të cilave këta shtetas janë deklaruar të shënuar si aksionerë me përqindjet përkatëse të përshkruara më sipër, por që në të vërtetë nuk rezulton që të kenë qenë aksioner këta shtetas në momentin e regjistrimit në QKB.

E pyetur për këtë fakt shtetasja Arjola Kodra deklaron se dokumentacionin që është dorëzuar nga ajo në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si administratore e shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k. për të bërë përditësimin e të dhënave të pronarëve përfitues fundorë, këtë dokumentacion ia kanë vënë në dispozicion zyra e konsulencës ligjore e Klodian Zoto. "Zoto Consulting", e cila ia ka kërkuar që ta dorëzojë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ajo deklaron se ka patur porosi nga shtetasi Klodian Zoto që çdo dokumentacion që vinte nga zyra ligjore "Zoto Consulting", ku dhe ai ishte pronar, duhej nënshkruar nga ana e saj, si administratore e shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. Ajo deklaron se thjeshtë ia kanë vënë në dispozicion dhe i kanë thënë që duhej t'i dorëzonte pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, por ajo nuk e di vërtetësinë e tyre, apo sesi ka rënë në dispozicion të tyre zyra "Zoto Consulting" e shtetasit Klodian Zoto. E pyetur në lidhje me rolin që kanë pasur shtetasit Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto në shoqërinë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, ajo deklaron se ajo ka qenë administratore e shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, nga muaji mars i vitit 2019 deri në muajin mars të vitit 2022. Shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri i ka pyetur në lidhje me çdo vendim të saj, si administratore e shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, pasi këto dy shtetas kanë qenë "de facto" pronarët e vërtetë të shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, pra ato që kontrollonin me të vërtetë këtë shoqëri koncesionare. Ajo deklaron se pavarësisht se "de jure" shtetasi Klodian Zoto ishte larguar nga cilësia e aksionerit të shoqërisë holandeze "Integrated Energy BV", në të vërtetë, ai vazhdonte të ishte aksioner i kësaj shoqërie, edhe kjo ishte edhe arsyeja pse duhej t'i raportonte dhe t'i jepte llogari atij dhe shtetasit Mirel Mërtiri.

1. **Giuseppe Ciaffaglione**, i datëlindjes 24.04.1968, me shtetësi italiane. - përfitues i 30% të aksioneve të shoqërisë GeoGenix me Nipt:66671752 (shoqëria mëmë e "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k).
2. **Salvatore Russelli**, i datëlindjes 03.1975, me shtetësi italiane, pronari i vetëm i shoqërisë italiane Hydros SRL (numër identifikimi 01380110765)- përfitues i 25 % të aksioneve të shoqërisë GeoGenix me Nipt:66671752.
3. **Alberto Presezzi**, i datëlindjes 07.1969, me shtetësi italiane. pronar i shoqërive aksionere "Bruno Presezzi SPA" me Nipt 07118380158 dhe "Franco Tosi Meccanica SPA" me Nipt 09020510963. - përfitues i 43% të aksioneve të shoqërisë "GeoGenix" me Nipt:66671752.

Nga dokumentacioni që shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. ka dorëzuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për të kryer deklarin e pronarëve përfitues fundor të shoqërisë "Integrated Energy BV SPV", rezulton se nuk është dorëzuar nga shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. në QKB, dokumentacioni shoqëruar justifikues për të provuar ndryshimin e aksionerëve përkatës për periudhën kohore në fjalë, sipas përcaktimeve të ligjit nr.112 të vitit 2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar, si dhe VKM nr.1008, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njohimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara".

Po ashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit që shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. ka dorëzuar në QKB, për të kryer këtë deklarin të pronarëve përfitues fundorë, rezulton se administratorja e shoqërisë "Integrated Energy BV SPV", shtetasja Arjola Kodra ka dorëzuar kopjen e pasaportës të shtetasve Alberto Presezzi dhe Salvatore Ruselli, nëpërmjet të cilave këta shtetas janë deklaruar të shënuar si aksionerë me përqindjet përkatëse të përshkruara më sipër, por që në të vërtetë nuk rezulton që të kenë qenë aksioner këta shtetas në momentin e regjistrimit në QKB.

E pyetur për këtë fakt shtetasja Arjola Kodra deklaron se dokumentacionin që është dorëzuar nga ajo në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si administratore e shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k. për të bërë përditësimin e të dhënave të pronarëve përfitues fundorë, këtë dokumentacion ia kanë vënë në dispozicion zyra e konsulencës ligjore e Klodian Zoto. "Zoto Consulting", e cila ia ka kërkuar që ta dorëzojë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Ajo deklaron se ka patur porosi nga shtetasi Klodian Zoto që çdo dokumentacion që vinte nga zyra ligjore "Zoto Consulting", ku dhe ai ishte pronar, duhej nënshkruar nga ana e saj, si administratore e shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. Ajo deklaron se thjeshtë ia kanë vënë në dispozicion dhe i kanë thënë që duhej t'i dorëzonte pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, por ajo nuk e di vërtetësinë e tyre, apo sesi ka rënë në disponim të tyre zyra "Zoto Consulting" e shtetasit Klodian Zoto. E pyetur në lidhje me rolin që kanë pasur shtetasit Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto në shoqërinë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, ajo deklaron se ajo ka qenë administratore e shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, nga muaji mars i vitit 2019 deri në muajin mars të vitit 2022. Shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri i ka pyetur në lidhje me çdo vendim të saj, si administratore e shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, pasi këto dy shtetas kanë qenë "de facto" pronarët e vërtetë të shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, pra ato që kontrollonin me të vërtetë këtë shoqëri koncesionare. Ajo deklaron se pavarësisht se "de jure" shtetasi Klodian Zoto ishte larguar nga cilësia e aksionerit të shoqërisë holandeze "Integrated Energy BV", në të vërtetë, ai vazhdonte të ishte aksioner i kësaj shoqërie, edhe kjo ishte edhe arsyeja pse duhej t'i raportonte dhe t'i jepte llogari atij dhe shtetasit Mirel Mërtiri.

I pyetur për faktin e përditësimit të të dhënave në regjistrin e pronarëve përfitues tûndorë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në muajin qershor të vitit 2021, për operatorin ekonomik qenë i punësuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, por nuk i kujtohet ky aplikim i operatorit ekonomik "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k, pasi në atë kohë ka pasur një fluks shumë të madh aplikimesh. I pyetur në lidhje me faktin se pse është miratuar aplikimi i operatorit ekonomik "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k, pasi rezultoi se në këtë aplikim, ky operator nuk ka dorëzuar dokumentacion e kërkuar sipas Ligjit nr.112 të vitit 2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar si dhe VKM-së nr.1088, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjekte të tjera", ai deklaroi se eprorja e tij ka qenë shtetasja Silena Tola, me pozicion Drejtoreshë e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe ajo ka pasur aksesin që të ishte personi i fundit që refuzonte aplikimet. Ai deklaroi se ai ka patur qëndrimin që këtij operatori duhej t'i refuzohej aplikimi dhe t'i kërkohej dokumentacion shtesë provues, por pasi eprorja e tij, shtetasja Silena Tola, i ka thënë që duhej të rishikonte aplikimin pasi ai ishte në rregull. ai ka bërë bërë miratimin e aplikimit të këtij subjekti tregtar.

E pyetur për faktin e përditësimit të të dhënave në regjistrin e pronarëve përfitues fundorë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në muajin Qershor të vitit 2021, për operatorin ekonomik "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k, shtetasja Silena Tola deklaroi se ajo ka qenë në pozicionin e Drejtoreshës së Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe se komunikimi që ka pasur me vartësin e saj, shtetasin Jetmir Llapaj duke i lënë në sistemin elektronik të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, komentin "rishikoje se më duket në rregull", nuk ka qenë urdhër për miratimin e aplikimit dhe se miratimi është kryer nga vartësi i saj, shtetasin Jetmir Llapaj. Ajo ka deklaruar se bazuar në dokumentacionin që ka dorëzuar operatori ekonomik në muajin Qershor të vitit 2021, aplikimi i këtij subjekti raportues duhej që të ishte refuzuar në bazë të ligjit, pasi ka mungesë dokumentacioni, siç janë ekstraktet e kompanive të huaja, që janë pronarë të subjektit raportues.

Sipas prokurorisë, në rrethanat e mësipërme, rezultoi se punonjësit e Qendrës Kombëtare të Biznesit, të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, shtetasit Jetmir Llapaj dhe Silena Tola, kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr.112/2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues", si dhe në kundërshtim me VKM nr.1008, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara". Për faktin penal të mësipërm, shtetasit Jetmir Llapaj dhe Silena Tola, me veprimet dhe mosveprimet e kundraligjshme të tyre, dyshohet se kanë kryer veprën penale " Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

Nga marrja e provave nëpërmjet letërporosisë dërguar Autoriteteve Italiane të Drejtësisë, sipas letërporosisë me nr. 97 prot., datë 22.06.2022, ekzekutuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, rezultoi se janë pyetur për rrethanat të hetimit shtetasit italian Ernesto Granelli, dhe Thomas Hansmann, në cilësinë e përfaqësuesve të shoqërive respektive "Energy Recuperator SPA" dhe "Paul Èurth Italia SPA", shoqëri që kanë shërbyer për themelimin e shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV", si dhe shtetasit Giuseppe Ciaffaglione, Alberto Pressezzi dhe Salvatore Ruselli, të cilët në një moment të mëvonshëm janë shënuar edhe si aksionerë tek shoqëria hollandeze "Geogenix BV" (ish-Integrated Energy BV).

Në deklaratimet e tij shtetasit italian Alberto Pressezzi ka deklaruar se ai është presidenti i shoqërive "Bruno Presezzi SPA" dhe "Franco Tosi Meccanica SPA". Shoqëria "Franco Tosi

I pyetur për faktin e përditësimit të të dhënave në regjistrin e pronarëve përfitues fundorë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në muajin qershor të vitit 2021, për operatorin ekonomik qenë i punësuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, por nuk i kujtohet ky aplikim i fluks shumë të madh aplikimesh. I pyetur në lidhje me faktin se pse është miratuar aplikimi i operatorit ekonomik “Integrated Energy BV S.P.V” sh.p.k, pasi në atë kohë ka pasur një ky operator nuk ka dorëzuar dokumentacion e kërkuar sipas Ligjit nr.112 të vitit 2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, të ndryshuar si dhe VKM-së nr.1088, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjekte të tjera”, ai deklaroi se eprorja e tij ka qenë shtetasja Silena Tola, me pozicion Drejtoreshë e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe ajo ka pasur aksesin që të ishte personi i fundit që refuzonte aplikimet. Ai deklaroi se ai ka patur qëndrimin që këtij operatori duhej t’i refuzohej aplikimi dhe t’i kërkohej dokumentacion shtesë provues, por pasi eprorja e tij, shtetasja Silena Tola, i ka thënë që duhej të rishikonte aplikimin pasi ai ishte në rregull. ai ka bërë bërë miratimin e aplikimit të këtij subjekti tregtar.

E pyetur për faktin e përditësimit të të dhënave në regjistrin e pronarëve përfitues fundorë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në muajin Qershor të vitit 2021, për operatorin ekonomik “Integrated Energy BV S.P.V” sh.p.k, shtetasja **Silena Tola** deklaroi se ajo ka qenë në pozicionin e Drejtoreshës së Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe se komunikimi që ka pasur me vartësin e saj, shtetasin Jetmir Llapaj duke i lënë në sistemin elektronik të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, komentin “rishikoje se më duket në rregull”, nuk ka qenë urdhër për miratimin e aplikimit dhe se miratimi është kryer nga vartësi i saj, shtetasin Jetmir Llapaj. Ajo ka deklaruar se bazuar në dokumentacionin që ka dorëzuar operatori ekonomik në muajin Qershor të vitit 2021, aplikimi i këtij subjekti raportues duhej që të ishte refuzuar në bazë të ligjit, pasi ka mungesë dokumentacioni, siç janë ekstraktet e kompanive të huaja, që janë pronarë të subjektit raportues.

Sipas prokurorisë, në rrethanat e mësipërme, rezultoi se punonjësit e Qendrës Kombëtare të Biznesit, të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, shtetasit Jetmir Llapaj dhe Silena Tola, kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr.112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, si dhe në kundërshtim me VKM nr.1008, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara”. Për faktin penal të mësipërm, shtetasit Jetmir Llapaj dhe Silena Tola, me veprimet dhe mosveprimet e kundraligjshme të tyre, dyshohet se kanë kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

Nga marrja e provave nëpërmjet letërporosisë dërguar Autoriteteve Italiane të Drejtësisë, sipas letërporosisë me nr. 97 prot., datë 22.06.2022, ekzekutuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, rezultoi se janë pyetur për rrethana të hetimit shtetasit italian **Ernesto Granelli**, dhe **Thomas Hansmann**, në cilësinë e përfaqësuesve të shoqërive respektive “Energy Recuperator SPA” dhe “Paul Èurth Italia SPA”, shoqëri që kanë shërbyer për themelimin e shoqërisë hollandeze “Integrated Energy BV”, si dhe shtetasit **Giusseppe Ciaffaglione**, **Alberto Pressezzi** dhe **Salvatore Ruselli**, të cilët në një moment të mëvonshëm janë shënuar edhe si aksionerë tek shoqëria hollandeze “Geogenix BV” (ish-Integrated Energy BV).

Në deklaratimet e tij shtetasin italian **Alberto Pressezzi** ka deklaruar se ai është presidenti i shoqërive “Bruno Pressezzi SPA” dhe “Franco Tosi Meccanica SPA”. Shoqëria “Franco Tosi

Meccanica SPA", rezulton të jetë aksioner "i fjetur" i shoqërisë hollandeze "Geogenix BV" (ish- Integrated Energy BV), bërë nëpërmjet marrëveshjes të bërë mes shoqërisë së tij "Franco Tosi Meccanica SPA", "ICARE Holding S.A" dhe shtetasit Giuseppe SPV" sh.p.k, ka rënë në kontakt dhe është përfshirë në marrëdhënie pune nga shtetasi italian Giuseppe Ciaffaglione, fillimisht nga fundi i vitit 2017 apo fillimi i vitit 2018 për projektin e Inceneratorit të Fierit në lidhje me furnizimin me turbinën për inceneratorin e Fierit. Ai deklaron se më pas, nga mesi i vitit 2018 apo fillimi i vitit 2019, shtetasi Giuseppe Ciaffaglione ka nisur t'i flasë për projektin e Inceneratorit të Tiranës, por që në atë kohë nuk kanë konkretizuar gjë. Pas disa kohës i ka bërë propozimin shtetasit Giuseppe Ciaffaglione, duke i thënë që ishin të gatshëm që të hynin si aksioner në shoqërinë hollandeze "Geogenix BV", e cila zotëronte shoqërinë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, së bashku me një partner që bashkëpunonte shoqëria e shtetasit Alberto Pressezzi, shoqëria zviceriane "ICARE", në pronësi të shtetasit Max Abitbol. Ai deklaron se në prill të vitit 2022, në marrëveshje me shtetasin Giuseppe Ciaffaglione, kanë hyrë si aksionerë të fjetur ("sleeping partner") në shoqërinë hollandeze "Geogenix BV", shoqëria "ICARE" në pronësi të shtetasit Max Abitbol dhe shoqëria "Franco Tosi Mecanica SPA" në pronësi të shtetasit Alberto Pressezzi, duke i lënë kuotën e aksioneve prej 20% aksionerit tjetër, shtetasit Giuseppe Ciaffaglione. Gjithashtu deklaron se edhe shoqëria "Hydros SRL" ka zotëruar 1 aksion. Ai deklaron se përfshirja e tij dhe partnerit tjetër të tij "ICARE", si aksioner në shoqërinë hollandeze "Geogenix BV", ishte me kusht, pasi shoqëria "Franco Tosi Mecanica SPA" dhe "ICARE" duhej që të gjenin financimin prej 100 milion Euro që duhej për t'u ndërtuar Inceneratori i Tiranës. Pasi të sigurohej financimi nga këto dy shoqëri, atëherë ato do të aktivizoheshin si aksionerë të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV" në Hollandë dhe do të merrnin kontrollin e plotë të menaxhimit dhe financiar të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV". Ai deklaron se nuk ka dijeni se çfarë ndodh me menaxhimin dhe kontrollin financiar të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV", pasi ai dhe shoqëria zviceriane "ICARE", me të cilin bashkëpunon, nuk kanë arritur akoma që të sigurojnë financimin për ndërtimin e Inceneratorit të Tiranës. Po ashtu ai deklaron se nuk përfituar asnjë të ardhur apo përfitim tjetër nga shoqëria hollandeze "Geogenix BV". I pyetur në lidhje me ndryshimin e Drejtorëve Menaxhues të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV" të bëra me datë 23.11.2022, ai deklaron se pavarësisht se ai së bashku me shoqërinë zviceriane "ICARE" kanë mazhorancën e kuatave të aksioneve të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV", ato nuk kanë marrë ndonjë vendim për ndryshimin e Drejtorëve Menaxhues të kësaj shoqërie dhe nuk kanë dijeni se si është bërë ky ndryshim. Gjithashtu, ai deklaron se nga koha që rezultoi si aksioner i fjetur, nuk ka dijeni për ndonjë mbledhje të Asamblesë së shoqërisë hollandeze Geogenix BV". Ai deklaron se nuk ka dijeni se ku shkojnë të ardhurat që grumbullohen shoqëria koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, e cila zotërohet nga shoqëria hollandeze "Geogenix". Po ashtu, ai deklaron se nuk i njeh aksionerët e mëparshëm, shtetasit Ernesto Granelli, Thomas Hansmann, si dhe nuk e njeh as aksionerin e regjistruar në vitin 2021, shtetasin Salvatore Ruselli. Ai deklaron se njeh shtetasin Klodian Zoto dhe Mirel Mertiri, të cilët ia ka prezantuar shtetasi italian Giuseppe Ciaffaglione. Shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri i ka takuar shumë herë gjatë vitit 2022, me të cilët kanë folur për çështje pune, konkretisht për Inceneratorin e Tiranës. Në këto takime ka qenë edhe shtetasi Giuseppe Ciaffaglione. Ai deklaron se për Inceneratorin e Tiranës ka diskutuar me shtetasin Mirel Mërtiri që para hyrjes si aksioner të tij tek shoqëria hollandeze "Geogenix BV". I pyetur për faktin nëse e njeh shtetasin Herman Daniel Vermeulen, administratori i shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, që nga data 15 mars 2022, ai deklaron se nuk e njeh dhe nuk ka dijeni se kush e ka emëruar si administrator të kësaj shoqërie. Ai deklaron se shtetasi Mirel Mërtiri kishte një peshë të madhe në shoqërinë

“Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, pasi ai merrej me anën teknike, bisedonte me të gjithë rimbuzuesit, etj. Po ashtu ai deklaroi se të gjitha kuotat që ai ka blerë për të hyrë si aksioner tek shoqëria hollandeze “Geogenix BV”, i ka blerë nga shtetasi Giuseppe Ciaffaglione, kundrejt një shumë simbolike. I pyetur në lidhje me të dhënat e pasaportës së tij që kanë shërbyer për regjistrimin në QKB të pronarëve fundor përfitues të shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, në vitin 2021, ai ka deklaruar se nuk ka autorizuar asnjë person për të kryer ndonjë veprim me pasaportën e tij në Shqipëri. Gjithashtu, shtetasi Alberto Pressezzi, ka dorëzuar dokumentacionin që ai dispononte, dokumentin e titulluar “Marrëveshje e aksionerëve”, datë 6 prill 2022, sipas së cilës janë shënuar si aksionerë të shoqërisë hollandeze “Geogenix BV”: shoqëria “Franco Tosi Meccanica SPA” me pronarë shtetasin Alberto Pressezzi me 20,001 kuota, shoqëria “Icare Holding SPA” me pronarë shtetasin Max Abitbol me 20,000 kuota, shtetasi Giuseppe Ciaffaglione me 9,999 kuota, shoqëria “Stichting Easte to Integrated Energy” me 1 kuotë pa të drejtë vote, si dhe shoqëria “Hydros SRL” me 1 kuotë pa të drejtë vote.

Sipas deklarimit të shtetasit italian **Salvatore Ruselli**, ai ka deklaruar se është pronari i shoqërisë italiane “Hydros SRL” dhe se me shoqërinë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. ka rënë në kontakt dhe është përfshirë në marrëdhënie pune, nga shtetasit italian Giuseppe Ciaffaglione dhe Fausto De Mare. Ai deklaroi se kontakti i parë është bërë në vitin 2016 në Tiranë me shtetasin Giuseppe Ciaffaglione, ku në këtë takim ka qenë edhe një shtetas me emrin Mirel. Ai deklaroi se në vitin 2020 shtetasi Giuseppe Ciaffaglione i ka kërkuar një ofertë për impiantin e kullimit në landfillin e Tiranës, ku dhe ka nënshkruar një kontratë me shoqërinë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, me administratoren e shoqërisë koncesionare, shtetasen Arjola Kodra. Ai deklaroi se vlera e kësaj kontrate ishte rreth 3.6 milion Euro dhe ka marrë një parapagim prej 550.000 Euro, por nuk është finalizuar, pasi pritej përfundimi i punimeve civile nga shoqëria koncesionare para së të procedohet më tej. Ai deklaroi se nuk ka dijeni nëse kanë përfunduar punimet civile dhe se është në pritje që të marrë njoftimin nga shoqëria koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, kur të përfundojnë punimet civile, që të vazhdohet me finalizimin e kontratës që ka nënshkruar me shoqërinë koncesionare. Ai deklaroi se nuk ka dijeni se kush e zotëron shoqërinë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. Po ashtu, ai deklaroi se aksionerët e shoqërisë hollandeze “Geogenix BV” janë “Franco Tosi Meccanica SPA”, “Icare Holding”, shtetasi Giuseppe Ciaffaglione, “Stichting Easte to Integrated Energy”, si dhe ai veç me 1 kuotë pa të drejtë vote. I pyetur në lidhje me kohën kur është bërë aksioner i shoqërisë hollandeze “Geogenix BV” ai deklaroi se nuk e mban mend, si dhe nuk e mban mend nga kush e ka marrë këtë kuotë aksioni të shoqërisë hollandeze “Geogenix BV”, por mban mend se i ka dhënë një prokurë noterit të tij në Itali, i cili ia ka dorëzuar një studioje noteriale hollandeze “Civillience BV”, për blerjen e kuotës së 1 aksioni. Ai deklaroi se me datë 22.10.2020 ka marrë një kërkesë formale nga përfaqësuesja e shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, shtetësja Denisa Tollkuçi, e cila i ka propozuar që të hyjë si aksioner tek shoqëria hollandeze “Geogenix BV”. Ai deklaroi se interesi i tij në lidhje me marrjen e kuotës tek shoqëria hollandeze “Geogenix BV” është në mënyrë që të ruante raportin me grupin e kompanive pasi ishte kontraktor tek një pjesë e veprës që do të realizohej në Tiranë. Ai deklaroi se nuk i di interesat e shoqërive të tjera aksionere tek shoqëria hollandeze “Geogenix BV” për sa i përket projektit të Tiranës. I pyetur në lidhje me ndryshimet që janë pasqyruar tek regjistri i QKB në Shqipëri për sa i përket pronarëve përfitues, ku rezultoi të jetë shënuar shtetasi Salvatore Ruselli me datë 25.06.2021 si aksioner tek shoqëria hollandeze “Geogenix BV”, në kuotën prej 25% të aksioneve, ai deklaroi se nuk ka dijeni dhe nuk është informuar për këtë gjë. I pyetur për faktin nëse e njeh shtetasin **Herman Daniel Vermeulen**, administratori i shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, që

nga data 15 mars 2022, ai deklaroi se nuk e njeh këtë shtetas. I pyetur në lidhje me të dhënat e pasaportës së tij që kanë shërbyer për regjistrimin në QKB të pronarëve fundor përfitues të shoqërisë “**Integrated Energy BV SPV**” sh.p.k, në vitin 2021, ai ka deklaruar se nuk ka autorizuar asnjë person për të kryer ndonjë veprim me pasaportën e tij në Shqipëri.

Sipas deklaramit të shtetasit **Ernesto Granelli** ai ka deklaruar se ka themeluar shoqërinë “**Energy Recuperator SPA**”. shoqëri e cila ka shërbyer për themelimin e shoqërisë hollandeze “**Integrated Energy BV**”. Më pas, rreth fundit të vitit 2016 apo fillimit të vitit 2017 ka shitur shoqërinë e tij “**Energy Recuperator SPA**” tek shoqëria tjetër italiane “**Paul Èurth Italia SPA**”. Aidedklaron se për të themeluar shoqërinë hollandeze “**Integrated Energy BV**”, ai ka rënë në kontakt me një shoqëri shqiptare, por që nuk ia mban mend emrin dhe kishte mësuar se në Shqipëri ishin të interesuar për të ndërtuar inceneratorë duke filluar në Elbasan dhe pastaj duke e përhapur në të gjithë Shqipërinë. Ai deklaroi se mban mend që kanë shkuar në Itali, shtetasit Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, me qëllimin për të parë impiantet ekzistuese. I pyetur për faktin nëse shoqëria e tij “**Energy Recupertaor SPA**” ka zotëruar aksione tek shoqëria hollandeze “**Integrated Energy BV**”, ai deklaroi se shoqëria e tij “**Energy Recuperator SPA**” nuk ka pasur aksione tek shoqëria hollandeze “**Integrated Energy BV**”, por shoqëria e tij ka pasur 15 % aksione tek një shoqëri hollandeze, që nuk ia mban mend emrin. I pyetur për faktin nëse ka dijeni se dokumentat që i përkasin shoqërisë së tij “**Energy Recuperator SPA**” janë përdorur për të fituar koncesionin për Inceneratorin e Tiranës, ai deklaroi se dokumentacioni i dorëzuar nga shoqëria e tij “**Energy Recuperator SPA**” ka qenë për t’u përdorur më herët në kohë dhe konkretisht për Inceneratorin e Elbasanit, ai nuk ka dijeni se ky dokumentacion do përdorej për kritere teknike edhe tek Inceneratori i Tiranës. Po ashtu, ai deklaroi se këto dokumente të shoqërisë së tij “**Energy Recuperator SPA**” iua ka dorëzuar shtetasve me emrin Mirel dhe Zoto. Ai deklaroi se pavarësisht se ai e kishte shitur shoqërinë e tij “**Energy Recuperator SPA**” tek shoqëria tjetër italiane “**Paul Èurth Italia SPA**”, ai kishte të drejtën e nënshkrimit, pasi kishte mbetur kryetar i shoqërisë “**Energy Recuperator SPA**”. Gjithashtu deklaroi se ai nuk ka dijeni se shoqëria e tij “**Energy Recuperator SPA**” te këtë fituar tenderin në lidhje me inceneratorin e Tiranës. Ai deklaroi se nuk ka dijeni se shoqëria e tij “**Energy Recuperator SPA**”, te këtë qenë aksioner me 30 % të aksioneve tek shoqëria hollandeze “**Integrated Energy BV**”, pasi në këtë kohë ka qenë duke dakordësuar shitjen e shoqërisë së tij “**Energy Recuperator SPA**” tek shoqëria italiane “**Paul Èurth Italia SPA**” dhe nuk ia kanë bërë me dije këtë situatë. Ai deklaroi se në vitin 2018 shoqëritë shqiptare i kanë kërkuar shoqërive “**Energy Recupertaor SPA**” dhe “**Paul Èurth Italia SPA**” të dalin nga të qënurit aksioner të shoqërisë hollandeze “**Integrated Energy BV**”. Në këtë mënyrë ka mbetur aksioner i vetëm shoqëria shqiptare. I pyetur për faktin nëse e njeh shtetasin Freek Hilberdink, person i autorizuar me prokurë edhe nga shoqëria “**Energy Recuperator SPA**”, për të kryer aktin e themelimit të shoqërisë hollandeze “**Integrated Energy BV**”, ai deklaroi se nuk e njeh këtë shtetas. I pyetur për faktin nëse i njeh shtetasit Arnaud Jean – François Guillaume van der Èerd, Theo Spijkerman, Hans Èerner Èallage, të cilët kanë pasur pozicione drejtuese, menaxhuese tek shoqëria hollandeze “**Integrated Energy BV**”, ai deklaroi se nuk njeh asnjë nga shtetasit e mësipërm. Ndërsa në lidhje me shtetasin Giuseppe Ciaffaglione, ai ka deklaruar se e ka patur të punësuar më herët tek shoqëria e tij “**Energy Recuperator SPA**”.

Sipas deklaramit të shtetasit **Thomas Hansmann**, ai ka deklaruar se nga viti 2016 është administratori i shoqërisë “**Paul Èurth Italia SPA**”, shoqëri e cila ka shërbyer për themelimin e shoqërisë hollandeze “**Integrated Energy BV**”. Po ashtu ai deklaroi se shoqëria “**Paul Èurth Italia SPA**”, rreth vitit 2016 apo 2017 ka vendosur të blejë shoqërinë tjetër italiane “**Energy Recuperator SPA**”, e cila kishte pasur më herët një projekt tjetër po në Shqipëri për mbetjet, ndërsa tani kishte dalë mundësia për një incenerator, atë të Tiranës. I pyetur për

faktin e themelimit të shoqërisë hollandeze “Integrated Energy BV” ai deklaroi se pronari i mëpsrshëm i shoqërisë italiane “Energy Recuperator SPA”, shtetasi Ernesto Granelli, e ka prezantuar atë me shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri që ishin përfaqësues të shoqërisë “Integrated Energy BV”. Më pas kanë marrë pjesë dhe kanë fituar një tender si një grupim shoqërisë, konkretisht “Paul Ēurth Italia SPA” “Energy Recuperator SPA” dhe një shoqëri tjetër shqiptare që nuk i kujtohet emri. I pyetur në lidhje me faktin se kush kanë qenë veprimet konkrete të shoqërisë “Paul Ēurth Italia SPA” për të ushtuar aktivitetin e saj si aksioner tek shoqëria hollandeze “Integrated Energy BV”, ai deklaroi se shoqëria hollandeze “Integrated Energy BV” kishte tre aksionerë dhe se kjo shoqëri kishte krijuar një degë në Shqipëri, shoqërinë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. Ai deklaroi se Inceneratori i Tiranës nuk është ndërtuar asnjëherë pasi kishin dalë probleme me lejen e ndërtimit nga autoritetet shqiptare, si dhe kishte probleme për sigurimin e financimit dhe pas një apo dy vitesh shoqëria e tij ka vendosur të dalin nga të qenurit aksionerë duke ia shitur të gjitha kuotat e aksioneve aksionerit tjetër shqiptar themelues tek shoqëria hollandeze “Integrated Energy BV”. Ai deklaroi se shuma monetare e shitjes së aksioneve të shoqërive që ai ka përfaqësuar tek shoqëria hollandeze “Integrated Energy BV” ka qenë në një vlerë mjaft të vogël, si dhe nuk ka marrë ndonjë përfitim monetar në formën e dividendit apo gjë tjetër. Ai deklaroi se e njëj shtetasin Klodian Zoto, i cili ka përfaqësuar gjithmonë shoqërinë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, në bordin e shoqërisë hollandeze “Integrated Energy BV”. I pyetur për faktin nëse i njëj shtetasit Arnaud Jean – François Guillaume van der Ēerd, Theo Spijkerman, Hans Ēerner Ēallage, shtetas të cilët kanë pasur pozicione drejtuese, menaxhuese tek shoqëria hollandeze “Integrated Energy BV”, ai deklaroi se nuk një asnjë nga shtetasit e mësipërm. Ndërsa në lidhje me shtetasin Giuseppe Ciaffaglione, ai deklaroi se e njëj këtë shtetas, pasi ky person kishte menaxhuar impiantin e Elbasanit. Për këtë fakt shtetasi Thomas Hansman ka paraqitur dokumentin “Shitje, blerje dhe transferim aksionesh Integrated Energy B.V”, bërë nga përfaqësuesi i tij me prokurë tek noteria në Amsterdam, Hollandë, me datë 28.12.2017 ku përshkruhet shitjet e aksioneve nga “Paul Ēurth Italia S.P.A” tek shoqëria “Integrated Technology Services” sh.p.k. Si dhe ka paraqitur dokumentin tjetër “Shitje, blerje dhe transferim aksionesh Integrated Energy BV”, bërë nga përfaqësuesi i tij me prokurë tek noteria në Amsterdam, Hollandë, me datë 12.01.2018, ku përshkruhet shitjet e aksioneve nga Energy Recuperator SPA tek shoqëria “Integrated Technology Services” sh.p.k.

Sipas deklaramit të shtetasit italian **Giuseppe Ciaffaglione**, ai ka deklaruar se ka qenë i punësuar deri në vitin 2017 tek shoqëria italiane “Energy Recuperator SPA”, për ndërtimin e Inceneratorit të Elbasanit. Më pas, në Gusht të vitit 2017 i ka mbaruar kontrata me shoqërinë italiane “Energy Recuperator SPA” dhe ka lidhur kontratë me shoqërinë shqiptare të shtetasit Klodian Zoto. Ai ka deklaruar se me shoqërinë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, ka rënë në kontakt dhe është përfshirë në marrëdhënie pune nga shtetasin Klodian Zoto, i cili kishte shoqërinë e tij “ITS”. Po ashtu ai deklaroi se të gjitha detyrimet për pagesat për qiratë, strehimin dhe nevojat e tij, ia ka mbuluar shtetasi Klodian Zoto, nëpërmjet kompanive të tij “ITS” dhe “Zoto Consulting”. Ai deklaroi se gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri, ai kryesisht është frekuentuar me teknikë të ngarkuar për realizimin e impiantit, por në të paktën dy raste, punonjëse të studios “Zoto Consulting” e kanë shoqëruar atë në zyrat e Ministrisë së Mjedisit, si dhe në një zyrë të Bashkisë Tiranë për të nënshkruar dokumenta, të cilat ishin përgatitur nga studioja e shtetasit Klodian Zoto. Ai deklaroi se pavarësisht se ka figuruar si administrator tek Inceneratori i Tiranës, angazhimi i tij kryesor, fizik dhe material, ka qenë tek Inceneratori i Fierit. Gjatë punës së tij ai është ndihmuar nga punonjës të kompanisë “ITS” dhe “Zoto Consulting”. Ai deklaroi se gjatë punës së tij si administrator i shoqërisë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k,

ka vënë re dokumentacione që mbanin nënshkrimin e tij, por që në të vërtetë nuk ishin nënshkruar nga ai, për këto konstatime ka pyetur shtetasin Klodian Zoto, i cili i ka thënë që nuk ka arsye pse të shqetësohet. Ai deklaroi se pagën e tij, si dhe për emërimin si administrator i shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, ia ka komunikuar vetë shtetasi Klodian Zoto. I pyetur në lidhje me faktin se kush ishin aksionerët e shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV", e cila zotëronte me 100% të aksioneve të shoqërisë shqiptare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, ai deklaroi se aksionerët e shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV" ishin shoqëritë: "Paul Ëurth SPA" me përfaqësues një shtetas Hansmann, shoqëria "Energy Recuperator" e shtetasit Ernesto Granelli dhe shoqëria "Integrated Technology Services" sh.p.k. e shtetasit Klodian Zoto. Shtetasi Giuseppe Ciaffaglione deklaroi se aksioneri "Paul Ëurth", i cili më herët kishte blerë shoqërinë aksionere tjetër, "Energy Recuperator", ka hequr dorë më vonë nga aksionet e tij tek shoqëria hollandeze "Integrated Energy BV" dhe në vend të tij kanë hyrë: shoqëria italiane "Franco Tosi SPA" me 40% të aksioneve, shoqëria "ICARE" me 40% të aksioneve, vetë shtetasi Giuseppe Ciaffaglione ka marrë 18 % të aksioneve, shoqëria "Hydros SRL" ka marrë 1% të aksioneve dhe shoqëria "Ëest Energy" ka marrë 1% të aksioneve. Ai deklaroi se nuk ka paguar asnjë shumë monetare për përfitimin e këtyrë 18% të aksioneve. Por i janë dhënë për shkak të kapaciteteve teknike që ai zotëronte dhe i nevojitej për projektin. Po ashtu, ai deklaroi se edhe shoqëritë e tjera aksionere, për raportet me institucionet shqiptare, referoheshin tek studioja e shtetasit Klodian Zotos dhe se nuk ka dijeni se si merreshin vendimet tek shoqëria hollandeze "Integrated Energy BV". Shtetasi Giuseppe Ciaffaglione deklaroi se përsa i përket anës ekonomike të shoqërisë koncesionare, pavarësisht se ai ishte administratori i saj, me anën ekonomike janë marrë punonjëse të lidhura me shtetasin Klodian Zoto, të cilat i jepnin formularë të paplotësuar, kupona për të kryer transfertat në bankë etj, dhe që ai i nënshkruante pa ditur as shumën e transfertave dhe as përfituesit e këtyre transfertave. Ai deklaroi se shtetasi Mirel Mërtiri është personi që i ka prezantuar shtetasin Klodian Zoto. I pyetur për faktin nëse i njeh shtetasit Arnaud Jean – François Guillaume van der Ëerd, Theo Spijkerman, Hans Ëerner Ëallage, Georgi Leonidovich Birman, David Hugh Hampson, Martijn Folkert Hendrik Harpe, Alissa Jangildina, Simone Dormio, Herman Daniel Vermeulen, shtetas të cilët kanë pasur pozicione drejtuese, menaxhuese tek shoqëria hollandeze "Integrated Energy BV", ku rezultoi që shtetasi Giuseppe Ciaffaglione ka qënë një ndër tre aksionerët, ai deklaroi se nuk njeh asnjë nga shtetasit e mësipërm. I pyetur në lidhje me faktin se çfarë roli kishte shtetasi Mirel Mërtiri tek Inceneratori i Tiranës, ai deklaroi se Mirel Mërtiri kryente aktivitetin e koordinimit dhe verifikimit për llogari të shoqërisë "ITS", po ashtu deklaroi se Mirel Mërtiri ka qënë prezent në mbledhjet që janë kryer për llogari të projektit të Inceneratorit të Tiranës dhe se ishte i interesuar mbi ecurinë e punimeve dhe kur i parashtronte problematikat, ai aktivizohej dhe i gjente zgjidhjet. I pyetur në lidhje me faktin e nënshkrimit apo jo nga ana e tij të kontratës së nënkontraktimit për punimet civile me shoqërinë e shtetasit Klodian Zoto "Integrated Technology Services" sh.p.k., ai deklaroi se kontrata e lidhur ndërmjet shoqërisë koncesionare dhe shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, me pronar shtetasin Klodian Zoto e lidhur për kryerjen e punimeve civile, datë 07.12.2017, nuk është nënshkruar nga ai dhe po e shikonte për herë të parë këtë kontratë. Po ashtu ai deklaroi se nuk ka dijeni se shoqëria "ITS" e shtetasit Klodian Zoto të ketë furnizuar apo sjellë ndonjëherë materiale për punime tek kantieri i Inceneratorit të Tiranës. Gjithashtu shtetasi Giuseppe Ciaffaglione deklaroi se 18% të aksioneve të shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV", ai i ka përfituar nga shtetasi Klodian Zoto, si dhe deklaroi se gjatë gjithë kësaj kohe nuk ka marrë asnjë përfitim monetar nga të qenurit aksioner i shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV". Ai deklaroi se nuk mban mend të

ketë nënshkruar ndonjë dokument apo të ketë ndonjë dokument për kalimin e kuotës prej 18 % të aksioneve nga shtetasi Klodian Zoto.

Nga verifikimet e kryera në QKB, tek regjistri i pronarëve përfitues, përsa i përket shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, rezulton se me datë 03.04.2023, kanë ndodhur ndryshimet përsa i përket aksionerëve të shoqërisë hollandeze "GeoGenix BV" (më herët me emrin tregtar "Integrated Energy BV"). Në këtë deklaram të datës 03.04.2023 vihet re se ka pasur një ndryshim të aksionerëve të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV" (ish-Integrated Enmergy BV) e cila rezulton që të jetë pronare me 100% të aksioneve të shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. Aksionerët e shoqërisë hollandeze sipas këtij regjistrimi janë deklaruar që të jenë:

1. **Alberto Prezezzi**, i datëlindjes 07.1969, me shtetësi italiane, pronar i shoqërive aksionere "Bruno Prezezzi SPA" me Nipt 07118380158 dhe "Franco Tosi Meccanica SPA" me Nipt 09020510963, - përfitues i 40% të akioneve të shoqërisë "GeoGenix" me Nipt:66671752.
2. **Max Abitbol**, i datëlindjes 19.05.1950, me shtetësi franceze, me adresë banimi: Chemin Des Bochattets 25, 1296, Coppet, Zvicër;  
**Marcelle Dominique Obadia ep. Abitbol**, e datëlindjes 19.05.1950, me shtetësi franceze, me adresë banimi: Chemin Des Bochattets 25, 1296, Coppet, Zvicër, - aksionerë të shoqërive zviceriane " ICARE Energy SA" dhe "ICARE Holding SA", - përfitues të 40% të akioneve të shoqërisë "GeoGenix" me Nipt:66671752.

Nga provat e marra nëpërmjet letërporosisë dërguar Autoriteteve Hollandeze të Drejtësisë, nr. 95 prot., datë 21.06.2022, është administruar dokumentacioni në lidhje me themelimin e shoqërisë hollandeze "GeoGenix B.V", me emrin tregtar të mëparshëm ("Integrated Energy B.V."), sipas këtij dokumentacioni rezultojnë të dhëna për aksionerët themelues të shoqërisë hollandeze "GeoGenix B.V", shoqëritë "Paul Ëurth Italia SPA", "Energy Recuperator SPA" dhe "Integrated Technology Services" sh.p.k, por nuk ka të administruar ndonjë dokumentacion tjetër në lidhje me ndonjë ndryshim aksionerësh të shoqërisë hollandeze "GeoGenix B.V".

I pyetur për këtë fakt shtetasi **Herman Daniel Vermeulen**, administrator aktual i shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, ai ka deklaruar se është emëruar në këtë detyrë me datë 15.03.2022, detyrë të cilën vazhdon ta kryejë. Ai deklaron se është caktuar si administrator me vendimin e Bordit të shoqërisë "GeoGenix B.V", me anëtarë të Bordit Michael Druijts dhe Marc Lappat. Ai deklaron se aksionerët aktual të shoqërisë hollandeze "GeoGenix B.V", janë "Franco Tosi Meccanica SPA" dhe "ICARE Holding SA" dhe shtetasi Giuseppe Ciaffaglione. Ai deklaron se nuk i njeh dhe as nuk kontaktuar ndonjëherë me aksionerët e kësaj shoqërie, shtetasit **Alberto Prezezzi** dhe **Max Abitbol**, ai mban kontakte vetëm me shtetasit Michael Druijts dhe Marc Lappat. Shtetasi Herman Daniel Vermeulen ka dorëzuar dokumentacionin në lidhje me ndryshimet e aksionerëve të bërë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me datë 03.04.2023, ku janë deklaruar dhe regjistruar pronarët përfitues fundor, por që këto të dhëna në lidhje me aksionerët aktual të shoqërisë hollandeze nuk mbështeten nga dokumentacion ligjor shoqërues për të provuar shitjen apo blerjen e aksioneve ndërmjet aksionerëve në kohë të ndryshme.

Nga të dhënat e nxjerra nga kompjuteri i sekuestruar shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik nr.93, datë 21.04.2022, është konstatuar një dokument në formatin "ëord", i pavulosur dhe i pa nënshkruar "marrëveshje e datës 29.07.2016, ndërmjet shoqërive "Integrated Technology Services" sh.p.k, dhe shoqërive italiane "Energy Recuperator SPA" dhe "Paul Ëurth Italia SPA", ku në përmbajtje të saj përshkruhet se

shoqëritë italiane "Energy Recuperator SPA" dhe "Paul Eurth Italia SPA" ishin të detyruara që t'i shisnin aksionet që ato zotëronin tek shoqëria hollandeze "Integrated Energy BV", tek shoqëria shqiptare e shtetasit Klodian Zoto "Integrated Technology Services" sh.p.k, në momentin që do t'i kërkohej nga kjo shoqëri. Rezulton se kjo marrëveshje i përket kohës para se të kryhej regjistrimi i shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV" në Hollandë. Në këto rrethana rezulton se shoqëritë italiane janë përfshirë si aksionerë të shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV", vetëm për të plotësuar kriteret teknike, por "de facto" si përfituese reale e koncesionit ka qenë shoqëria e shtetasit Klodian Zoto "Integrated Technology Services" sh.p.k.

Nga aktet e administruar rezulton se shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri janë "de facto" pronarët e shoqërisë hollandeze "Geogenix BV" (me emrin e mëparshëm "Integrated Energy BV"), të cilët kanë përdorur persona dhe shoqëri të tjera për ta fshehur gjurmët, kjo pasi evidentohet se shtetasi Klodian Zoto, administrator dhe pronar i shoqërisë "Integrated Technology Services" sh.p.k, në bashkëpunim me shtetasin Mirel Mërtiri, kanë udhëzuar dhe kanë marrë vendimet në lidhje me shoqërinë hollandeze "Geogenix BV" (me emrin e mëparshëm "Integrated Energy BV"), që përkon që nga momenti i themelimit të kësaj shoqërie e në vijimësi. Këto vendime dhe udhëzime shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri i kanë transmetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet vartëses së tij, Denisa Tollkuçi, tek Drejtorët Menaxhues të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV", siç rezulton të jetë dokumentuar ky fakt nga komunikimet me email të shtetasve Klodian Zoto, Mirel Mërtiri, Denisa Tollkuçi dhe Drejtorët Menaxhues të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV".

Konkretisht, shtetasja Denisa Tollkuçi gjatë komunikime që ka pasur me përfaqësues të shoqërisë "Almares Management BV", shoqëri e kontraktuar si Drejtor Menaxhues i shoqërisë hollandeze "Geogenix BV", ka njoftuar shtetasin Klodian Zoto, si dhe në disa raste shtetasin Mirel Mërtiri, e cila ju ka kërkuar sugjerime dhe aprovime këtyre shtetasve. Këto komunikime mes tyre janë dokumentuar nga këqyrja e aktit të ekspertimit kompjuterik nr. 65 datë 03.03.2022, të sekuestruar shtetasit Klodian Zoto, ku rezultojnë të dhënat si më poshtë:

-Emaile të nisura nga adresa e postës elektronike të përfaqësuesve të shoqërisë "Residence Corporate Services" (që janë njëherësh edhe përfaqësues të shoqërisë "Almares Management BV") në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasve Denisa Tollkuçi dhe Klodian Zoto, **ku ju kërkon shtetasve Denisa Tollkuçi dhe Klodian Zoto likuidimin e pagesave në lidhje me shërbimin që shoqëria "Residence Corporate Services" ka ofruar dhe faturuar shoqërinë hollandeze "Integrated Energy BV".**

-Email i datës 03.10.2019, i nisur nga adresa e postës elektronike "alissa.jangildina@residencecs.com" në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasës Denisa Tollkuçi, ku i kërkohet shtetasve Klodian Zoto dhe Denisa Tollkuçi pagesa e faturave të datës 04.07.2019, 01.07.2019, 17.10.2019, të lëshuara nga shoqëritë "STPtaxlaëyers" dhe "Residence Corporate Services" në drejtim të shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV".

-Email i datës 22.09.2021, i dërguar nga adresa e postës elektronike shtetasit Marc Lappat, "ml@dynamisgroup.nl" në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasës Denisa Tollkuçi, nëpërmjet të cilit kërkon pagesat e disa faturave që i janë faturuar shoqërisë hollandeze "Geogenix BV" nga shoqëritë "Amsterdam Desk Company" dhe "AMS Corporate BV", të cilat mbajnë datat 05.08.2021, 24.08.2021 dhe 22.09.2021.

-Email i datës 30.09.2021, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetasës Denisa Tollkuçi në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Marc Lappat, nëpërmjet të cilit urdhëron shtetasin Marc Lappat mbi pagesat që duhet të kryhen nga llogaria bankare e

shoqërisë "Geogenix BV" për pagesat e disa faturave që i janë faturuar shoqërisë holandeze "Geogenix BV" nga shoqëritë "Amsterdam Desk Company" dhe "AMS Corporate BV".

-Email i datës 30.09.2021, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetases Denisa Tollkuçi në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasve Julia Muça (Demneri) dhe Merila Luga, nëpërmjet të cilit ka sqaruar këto shtetase që email-in po ia nis vetëm me qëllim që ato t'i administrojnë këto dokumente, pasi ka vendosur që faturat që i janë faturuar shoqërisë holandeze "Geogenix BV" nga shoqëritë "Amsterdam Desk Company" dhe "AMS Corporate BV", do të paguhen nga shoqëria "Geogenix BV" me fondet që tashmë janë transferuar.

-Emaile të nisura nga adresa e postës elektronike e shtetases Denisa Tollkuçi në drejtim të adresës së postës elektronike të përfaqësuesve të shoqërisë "Almares Management BV", nëpërmjet të cilëve kërkon nga shoqëria "Almares Management BV" që të nënshkruajnë dokumentacion dhe prokura, të cilat i japin të drejtë shtetasit Mirel Mërtiri që të veprojë në emër të shoqërisë holandeze "Integrated Energy BV", për të hapur llogari bankare në Zvicër, dhe për të kryer transaksione nga kjo llogari. Dokumentacionet dhe prokura e kërkuar nga shtetasja Denisa Tollkuçi rezultojnë që të jenë nënshkruar nga shoqëria "Almares Management BV".

Nga përmbajtja e komunikimeve të mësipërme, rezulton se në fillim nuk ishte vendosur personi që do të kishte kontrollin e llogarive bankare që do të hapeshin në bankën në Zvicër, por referuar email-eve të datës 10.01.2019, rezulton se shtetasja Denisa Tollkuçi pyet shtetasit Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, që këta të fundit të vendosin se cili do të jetë personi që do të nënshkruajë dokumentacionin për hapjen e llogarisë bankare. Shtetasi Mirel Mërtiri, nëpërmjet email-it, jep mendimin që personi që do të nënshkruajë për hapjen e llogarisë, të jetë shtetasi Giuseppe Ciaffaglione, si dhe kërkon mendimin edhe të shtetasit Klodian Zoto.

Pasi ka marrë email-in nga shtetasi Mirel Mërtiri, shtetasja Denisa Tollkuçi ju dërgon email shtetasve Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, ku shkruan "*Per ne nuk perben problem se kane qene gjithë kohes shume bashkepunues dhe te hapur per cdo vendim qe eshte marre*". Pas këtij emaili, shtetasja Denisa Tollkuçi u dërgon një email tjetër shtetasve Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, ku në këtë email ka bashkëlidhur përgjigjen që do t'i drejtohet shoqërisë "Almares Management BV" dhe kërkon nga shtetasit Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, nëse kanë sugjerime mbi përgjigjen që ajo ka përgatitur. Përgjigjja e përgatitur nga shtetasja Denisa Tollkuçi, konsiston në përcaktimin e shtetasit Mirel Mërtiri si personin që do të hap llogarinë bankare në Zvicër, gjithashtu refuzon kërkesën e shoqërisë "Almares Management BV", e cila kishte kërkuar që në prokurë të përfshihej edhe shoqëria "Almares Management BV" për të pasur kontroll në llogaritë bankare.

-Emaile të shkëmbyera midis shtetases Denisa Tollkuçi dhe përfaqësuesve të shoqërisë "Almares Management BV", në lidhje me dhënien e prokurave shtetasit Mirel Mërtiri për të hapur një shoqëri në Bullgari në emër të shoqërisë holandeze "Integrated Energy BV", si edhe për të hapur llogari bankare në Bullgari në emër të shoqërisë "Integrated Energy BV" dhe për të kryer transaksione nga kjo llogari;

-Email i datës 20.11.2018, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetases Denisa Tollkuçi në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Klodian Zoto, nëpërmjet të cilit shtetasja Denisa Tollkuçi i dërgon shtetasit Klodian Zoto komunikimet që shtetasja Denisa Tollkuçi ka pasur me shtetasin Chris Oei (përfaqësues i shoqërisë Residence Corporate Services). Nga procesverbali i këqyrjes rezulton që kjo shoqëri kontrollon

shoqërin "Almares Management BV"), ku ky i fundit i kërkon që të verifikojë pasqyrat financiare të vitit 2017 të shoqërisë holandeze "Integrated Energy BV", dhe nëse është dakord i kërkon që ato si edhe një prokuror të nënshkruhen nga shtetasi Giuseppe Ciaffaglione.

-Më pas, me email-in e datës 26.11.2018, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetases Denisa Tollkuçi në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Klodian Zoto, nëpërmjet të cilit shtetasja Denisa Tollkuçi bashkëlidh përgjigjen që ka marrë nga shtetasi Michael Druijts mbi disa dokumente që i ka kërkuar këtij shtetasi për llogarinë bankare, si edhe ka bashkëlidhur një dokument të emërtuar "Financial Statements 2017 IE.pdf" (Në këtë dokument janë pasqyrat financiare të shoqërisë "Integrated Energy BV" të vitit 2017, të njëjta me ato të email-itë të mëparshëm të datës 20.11.2018, të dërguar nga shtetasi Chris Oei, por tashmë këto pasqyra financiare janë firmosur nga shtetasi Giuseppe Ciaffaglione).

-Email i datës 13.08.2018, i dërguar nga adresa e postës elektronike të shtetases Denisa Tollkuçi në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Klodian Zoto, ku dërgohet përgjigjja e shtetasit Michael Druijts mbi kërkesën për të hapur llogari bankare të shoqërisë holandeze "Integrated Energy BV". Shtetasi Michael Druijts kërkon që të ketë kontakt direkt me personin që po asiston për hapjen e llogarisë bankare, pasi dokumentet që kërkon shtetasja Denisa Tollkuçi nuk jepen për shoqëritë holandeze. Në lidhje me hapjen e llogarive bankare ka edhe shkëmbime të tjera email-esh, ndërmjet shtetases Densa Tollkuci dhe përfaqësuesve të shoqërisë "Almares Management BV", dhe më pas shtetasja Denisa Tollkuçi informon shtetasin Klodian Zoto.

-Email i datës 08.06.2018, nga adresa e postës elektronike "mirelmertiri@gmail.com" dërgohet në drejtim të adresës së postës elektronike "fabrizio.strobino@paulëurth.com", nëpërmjet të cilit shtetasi Mirel Mërtiri i përgjigjet emailit të mëparshëm të shtetasit Fabrizio Strobino, duke i kërkuar një takim me stafin e shoqërisë italiane "Paul Ëurth" për të avancuar me projektin e Inceneratorit të Tiranës. Në datën 02.11.2018 rezulton që është zhvilluar një takim në Duseldorf (Gjermani), ku shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri kanë qenë përfaqësuesit e vetëm të shoqërisë holandeze "Integrated Energy BV" dhe shoqërisë shqiptare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k:

-Email i datës datës 07.09.2018, i nisur nga adresa e postës elektronike e shtetasit Mirel Mërtiri në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Klodian Zoto. Shtetasi Mirel Mërtiri në këtë email shkruan "*Klod miremengjes ,Ne attachment me posht do te gjesh te gjithë debitorët qe ne kemi si group ..Do te veresh qe ka patur edhe shume prioritete te tjera per tu paguar te cilet jane lene komplet ne hije ... Te lutem nuk dua qe te me nderhysh me ne listen e pagesave si veprova kete here me gocat..E kemi bere qindra here kete bised the perseri me ate stilin tend te vacante vazhdon te dalesh atje ku do. Vella here tjetër nese ke prioritete mi thuaj dhe ske me pune me listen .Perse jam rrugeve sdo te thote qe skan perparësi ne ecurin e puneve apo mbarevajtjen . Une sjam aty por smund te lejoj qe financa ( e perpunuar nga ty )te me hedhi hi syve me miratimin tend .Kjo te lutem sdua te ndodhe me ..Bashk i kemi ndare detyrat , mund te diskutojme per cdo gje por jo te perpunojme njeri tjetrin se une se bej kurre. TE LUTEM MOS me ve me ne nje siklet te tille ...Financa eshte Zyre me vete dhe duhet te jete transparente si per ty edhe per mua ..... Mos me ve ne siklet te LUTEM ... "*

Bashkëlidhur këtij email-i gjendet një dokument në formatin "Excel", i emërtuar "Analitike furnitore.xlsx", ku në secilën faqe të excelit ndodhen disa tabela që në kokën e tyre kanë të shënuara "Nr", "Furnitori", "Balanca pa paguar ne all", "Balanca pa paguar ne euro" dhe

“Pershkrimi”. Secila nga tabelat ka të shënuar veçmas: “Albtek”, “IEBV”, “ITËASTE”, “ITS”, “Artemis”, “CGC”, “Miklo”, “SE” dhe “Zoto cons”. Tabelat janë të plotësuar me emra të shoqërive tregtare të ndryshme, si edhe me vlerat monetare përmbajtja e email-it konkludohet se tabelat e bashkëlidhura në email nga shtetasi Mirel Mërtiri, përmbajnë të dhëna në lidhje me furnitorët e shoqërive “Albtek” sh.p.k, “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, “Integrated Technology East Treatment Fier” sh.p.k, “Integrated Technology Services” sh.p.k, “Artemis Farm” sh.p.k, “CGC” sh.p.k, “Miklo Konstruktion” sh.p.k, “Consulting SE Partners” sh.p.k dhe “Zoto Consulting” sh.p.k, si dhe dalin në pah mosmarrëveshjet në lidhje me interesat e shtetasve Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto në këtë kontratë koncesioni.

-Shtetasi Klodian Zoto, në datën 07.09.2018, i përgjigjet shtetasit Mirel Mërtiri, duke i shkruar “*Mirmengjes Te me falesh. Singerisht te siguroj qe sdo te ndodhe me nderhyrja per sa thua ti. Besoj qe nuk do kemi me neboje ta bejme kete diskutim dhe nuk do perpunoj me rjeri. Dhe njehere te kerkoj falje Dite te mbare&nbsp;*”.

Shtetasi Mirel Mërtiri, po në datën 07.09.2018, në vazhdim të këtij email-i, i shkruan shtetasit Klodian Zoto “*Faleminderit Zemra*”.

-Email i datës 24.03.2019, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetasit Klodian Zoto në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasës Sevi Zani. Në këtë email është dërguar komunikimi që ka pasur shtetasja Denisa Tollkuçi me shtetasin Fabrizio Strobino, përfaqësuesi i shoqërisë “Paul Eurth”, ku shtetasja Denisa Tollkuçi, ndër të tjera është përgjigjur “*As at this moment the shareholder of the company is Mr. Giuseppe Ciaffaglione, who holds 100 % of the shares. You already know the reasons of the transactions/ Ndërsa në këtë moment aksioner i kompanisë është Z. Giuseppe Ciaffaglione, i cili zotëron 100% të aksioneve. Tashmë i dini arsyet e transaksioneve*”.

-Email i datës 13.07.2019, nga adresa e postës elektronike “mirelmertiri@gmail.com” dërgohet në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Klodian Zoto, nëpërmjet të cilit shtetasi Mirel Mërtiri diskuton me shtetasin Klodian Zoto mbi fitimin që duhet të deklarojnë për shoqërinë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k.

-Email i datës 06.10.2021, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetasit Marc Lappat në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasës Denisa Tollkuçi, ku për dijeni ka qenë edhe shtetasi Klodian Zoto. Në këtë email gjenden disa komunikime, që fillojnë në datën 28.07.2021, midis shtetasës Denisa Tollkuçi dhe shtetasit Marc Lappat, mbi kërkesën e shtetasës Denisa Tollkuçi për të marrë pasqyrat financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020 të shoqërisë “Geogenix BV”, të certifikuar nga Dhoma Hollandeze e Tregtisë. Shtetasja Denisa Tollkuçi, së bashku me shtetasin Marc Lappat diskutojnë në lidhje me nënshkrimin e pasqyrave financiare të vitit 2020, pasi kanë ndryshuar Drejtorët Menaxhues të shoqërisë hollandeze “Geogenix BV” dhe nuk kanë nënshkruar këto pasqyrura financiare. Shtetasja Denisa Tollkuçi, së bashku me shtetasin Marc Lappat diskutojnë në lidhje me zgjidhjen e kësaj situate.

-Në datën 16.08.2021, nëpërmjet emailit, shtetasi Marc Lappat informon shtetasen Denisa Tollkuçi që pasqyrat financiare të vitit 2020 nuk janë plotësuar dhe sqaron se mund të marrin një version online të ekstraktit, i cili përmban informacionin e kërkuar nga shtetasja Denisa Tollkuçi, por që ky version nuk mund të marrë vulë apostile. Po në datën 16.08.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi, nëpërmjet email-it udhëzon shtetasin Marc Lappat që t’ia nis atë ekstrakt.

-Në datën 17.08.2021 shtetasi Marc Lappat i shkruan shtetases Denisa Tollkuçi, ku i thotë që bashkëlidhur do të gjejsh dokumentet.

-Në datën 18.08.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi pasi e falenderon për ekstraktin e nisur, i kërkon shtetasit Marc Lappat që pasqyrat financiare të vitit 2020 të nënshkruhen nga Drejtori Menaxhues B dhe më pas shtetasja Denisa Tollkuçi t'ia dërgojë Drejtorit Menaxhues A.

-Në datën 23.08.2021, shtetasi Marc Lappat informon shtetasen Denisa Tollkuçi që do t'i kërkojë shtetasit Martijn Harpe që të nënshkruaj pasqyrat financiare të vitit 2020, pasi diskutimet me drejtorët e mëparshëm të shoqërisë nuk janë duke dhënë rezultat. Po, në datën 23.08.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi i shkruan shtetasit Marc Lappat, që edhe ajo mendon të njëjtën gjë.

-Në datën 01.10.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi i kërkon shtetasit Marc Lappat që t'i nisë pasqyrat financiare të vitit 2020 të nënshkruara nga shtetasi Martijn Harpe, në mënyrë që ajo t'ia dërgojë shtetasit David Hampson, i cili është Drejtori Menaxhues A i shoqërisë hollandeze "Geogenix BV".

-Në datën 06.10.2021, shtetasi Marc Lappat i shkruan shtetases Denisa Tollkuçi, ku i thotë që bashkëlidhur do të gjej paqyrat financiare të nënshkruar.

-Email i datës 12.10.2021, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetasit Marc Lappat në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetases Denisa Tollkuçi, ku për dijeni ka qenë edhe shtetasi Klodian Zoto. Në këtë email gjenden disa komunikime të mëhershme, që fillojnë në datën 26.05.2021, midis shtetases Denisa Tollkuçi dhe shtetasit Marc Lappat, mbi kërkesën e shtetases Denisa Tollkuçi për t' i dhënë shoqërisë "Boldrocchi srl" dy aksione pa të drejtë vote të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV".

-Në email-in e datës 26.05.2021, shtetasja Denisa Tollkuci i shkruan shtetasit Marc Lappat "Siç jua kam shpjeguar tashmë, ne kemi synimin të emetojmë edhe dy aksione të tjera pa të drejtë vote. Bashkëngjitur do të gjeni dokumentet e Boldrocchi...". Pasi shtetasit Marc Lappat dhe Denisa Tollkuci kanë shkëmbyer disa email-e në lidhje me disa dokumente të shoqërisë "Boldrocchi srl", në datën 09.06.2021, shtetasi Marc Lappat i dërgon shtetases Denisa Tollkuci email ku e informon që bashkëlidhur do të gjejë dokumentet për lëshimin e dy aksioneve pa të drejtë vote për shoqërinë "Boldrocchi srl". Gjithashtu, në këtë email ky shtetas informon që noteri kërkoj që të kishte një sqarim të shkurtër të çmimit 1 Euro për çdo aksion, dhe një shpjegim se përse shoqëria "Boldrocchi srl" po i merr këto aksione. Për t'iu përgjigjur noterit ai mendon që t'i thotë se pjesëmarrja e "Boldrocchi srl" është për t'i treguar publikut dhe palëve të tjera, si bankat, që janë partner me disa shoqëri me emër të mirë, por kërkon miratim për këtë përgjigje. Gjithashtu, ai informon se janë disa fatura të papaguara të noterit, dhe ky i fundit do të ekzekutojë transaksionin vetëm nëse likujdohen të gjitha faturat, prandaj i kërkon shtetases Denisa Tollkuçi që të merret me këtë gjë.

-Me email-in e datës 10.06.2021, shtetasja Denisa Tollkuci i përgjigjet shtetasit Marc Lappat, duke i thënë se ajo do të likujdojë faturat dhe do t'ia dërgojë pagesat e tyre, si edhe i kërkon informacion mbi arsyen e përfshirjes së shoqërive që nuk kanë aksione me të drejtë vote në rezolutën e aksionerëve. Gjithashtu, e pyet nëse "PoA" (prokura) që ka nisur për shoqërinë "Boldrocchi srl" është saktë, si edhe e informon mbi arsyen e përfshirjes së shoqërisë "Boldrocchi srl", ku shpjegon se shoqëritë që do të zotërojnë aksione pa të drejtë vote do të jenë shoqëri me emër të mirë, dhe në të ardhmen do të prodhojnë pjesët kryesore të inceneratorit.

-Në datën 23.06.2021, shtetasi Marc Lappat i dërgon email shtetases Denisa Tollkuçi, ku i thotë që për pjesën e prokurës e ka rikujtuar noterin. Ndërsa për rezolutën e aksionerëve, sqaron se noteri ka thënë që aksionerët pa të drejtë vote janë përmendur në rezolutë sepse edhe pse nuk lejohen të votojnë, këta aksionerë kanë ende të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e aksionerëve dhe si të tillë edhe të nënshkruajnë rezolutën. Po në datën 23.06.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi i dërgon email shtetasit Marc Lappat, dhe i kërkon informacion si mund të gjejnë një zgjidhje, pasi herë pas herë do të duhet të përgatisin rezoluta të aksionerëve për bankat dhe çështje të tjera, dhe nënshkrimi i këtyre rezolutave nga aksionerët pa të drejtë vote do t'u shkaktojë shumë vonesa dhe kosto. Shtetasi Marc Lappat i është përgjigjur shtetases Denisa Tollkuçi me email-in e datës 23.06.2023, ku i thotë që do të pyes noterin se si mund të zgjidhet.

-Në datën 08.07.2021, shtetasi Marc Lappat i dërgon email shtetases Denisa Tollkuçi, ku e informon se noteri i ka thënë që aksionerët pa të drejtë vote gjithmonë kanë të drejtë të jenë pjesëmarrës në mbledhjet e aksionerëve.

-Në datën 15.07.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi i dërgon shtetasit Marc Lappat email, ku i thotë që dokumentet që ka përgatitur noteri duhet të përditësohen, pasi në ato dokumente gjendet emri i "Drejtorit të vjetër", si edhe të shihet nëse është e regjistruar adresa e re e shoqërisë. Gjithashtu, i kërkon që të rregullojë nënshkrimin e Drejtorit B përpara se ai të shkojë me pushime. Në email-in e datës 15.07.2021, shtetasi Marc Lappat i shkruan shtetases Denisa Tollkuçi se Drejtori i ri duhet si fillim të shkojë te noteri dhe nuk është i sigurt nëse mund ta bëjë këtë përpara se të shkojë me pushime. Ndërsa në lidhje me adresën sqaron se adresa nuk është regjistruar, pasi nuk është paguar fatura.

-Në email-in e datës 18.08.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi i shkruan shtetasit Marc Lappat *"I dashur Marc, Ju lutemi, ne kemi nevojë urgjente për informacion nëse adresa e re e kompanisë është e regjistruar. Gjithashtu, a mund të kemi draft dokumentet e përditësuara (modifikimi i adresës dhe emri i drejtorit B), që të vazhdojmë me nënshkrimet e nevojshme dhe të finalizojmë emetimin e aksioneve. Kompania Boldrocchi s.r.l po pyet pse kjo procedurë ende nuk është finalizuar. Përshëndetje të përzemërta, Denisa"*.

- Në email-in e datës 19.08.2021, shtetasi Marc Lappat i shkruan shtetases Denisa Tollkuçi se adresa nuk ka ndryshuar pasi shtetasi Martijn Harper i ka plotësuar formularët gabim, për këtë arsye shtetasi Martijn Harper do t'i nënshkruajë përsëri formularët, dhe pas kësaj, do të organizojë nënshkrimin e dokumenteve për emetimin e aksioneve.

-Me email-in e datës 01.10.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi i shkruan shtetasit Marc Lappat *"I dashur Marc, Ju lutemi na duhet informacion nëse adresa e re e kompanisë është regjistruar në regjistrin e biznesit. Gjithashtu, a mund të kemi draft dokumentet e përditësuara (modifikimi i adresës dhe emri i drejtorit B), që të vazhdojmë me nënshkrimet e nevojshme dhe të finalizojmë emetimin e aksioneve. Ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk e kuptoj pse nuk më dërgohen draft dokumentet e modifikuara. Përshëndetje të përzemërta, Denisa"*.

-Shtetasi Marc Lappat i dërgon email në datën 12.10.2021 shtetases Denisa Tollkuçi, ku i shkruan *"Denisa, Noteri më në fund identifikoi Martijn si drejtor. Në parim, ne tani mund të vazhdojmë me emetimin e aksioneve, por ju së pari dëshironi të organizoni një drejtor të ri apo do të z. Hampson është ende në dispozicion për të nënshkruar? Përshëndetje të përzemërta, Marc"*.

-Në email-in e datës 12.10.2021, është dërguar email nga adresa e postës elektronike e shtetases Denisa Tollkuci në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Marc

Lappat, ku për dijeni ka qenë edhe shtetasi Klodian Zoto. Shtetasja Denisa Tollkuçi informon shtetasin Marc Lappat që marrëveshja për Drejtorin e ri është shumë urgjente. Në email-in e datës 12.10.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi, ndër të tjera, pyet shtetasin Marc Lappat nëse është e mundur që të vendosin si Drejtor A të shoqërisë "Geogenix BV" shtetasen Arjola Kodra.

-Po në datën 12.10.2021, në email-in e dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetasit Marc Lappat në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasës Denisa Tollkuçi, ku për dijeni ka qenë edhe shtetasi Klodian Zoto, shtetasi Marc Lappat informon që ka diskutuar me një person për të marrë pozicionin e Drejtorit A të shoqërisë "Geogenix BV", dhe nëse ky person pranon, atëherë regjistrimi i tij si Drejtor A do të përfundojë shumë më shpejt sesa regjistrimi i një personi që nuk jeton në Amsterdam.

-Shtetasi Marc Lappat dërgon përsëri një email në datën 12.10.2021, në drejtim të shtetasës Denisa Tollkuçi, dhe për dijeni shtetasit Klodian Zoto, ku shkruan "*Denisa, Klodian, Bëra të pamundurën për të rregulluar një Drejtor të ri A, dhe ai sapo konfirmoi përmes Michael i cili është kontakti i tij i drejtpërdrejtë. Kërkesat e tij janë të njëjta si për kontratën e Martijn: 1500 euro në muaj (pa TVSH) dhe 6 muaj pagesë paraprake. Ai jeton në Amsterdam dhe sapo mora të dhënat e tij duke më lejuar të përgatis të gjitha dokumentet. Javën e ardhshme ai nuk është në dispozicion për të nënshkruar kështu që unë jam duke u përpjekur të rregulloj nënshkrimet dhe letrat e tij këtë javë. Nuk do të ishte mirë ta anuloni këtë tani papritmas, por sigurisht varet nga ju. Ju lutem më tregoni se si dëshironi të vazhdoni. Përsëritje të përzemërta, Marc*". Këtij email-i i është përgjigjur shtetasi Klodian Zoto, ku me email-in e datës 12.10.2021, i shkruan shtetasit Marc Lappat "*në këtë moment është e pamundur pagesa e 6 muajve përpara deri sa të zgjidhet situata me z.hampson Maksimumi që mund të bëjmë është 2 ose 3 muaj*".

-Me email-in e datës 12.10.2021, shtetasi Marc Lappat i shkruan shtetasit Klodian Zoto "*OK do t'i them, por nëse ai pranon, a je në rregull të vazhdash me të dhe a mund të përgatis dokumentet dhe të nënshkruaj dhe regjistroj gjithçka? Më duhet një konfirmim që të di se çfarë mund t'i them.*" Shtetasi Klodian Zoto i është përgjigjur email-it të mësipërm duke thënë "po". Pas kësaj shtetasi Marc Lappat me email-in e datës 12.10.2021, informon shtetasin Klodian Zoto, që personi pranoi me tre muaj pagesë paraprake.

-Në email-in e datës 13.10.2021, shtetasi Marc Lappat i shkruan shtetasit Klodian Zoto dhe për dijeni shtetasës Denisa Tollkuçi "*Përsëritje Klodian dhe Denisa, Të bashkëngjitura janë dokumentet për dorëheqjen e z. Hampson dhe emërimin e z. Dormio si drejtor A. Nëse jeni dakord, a mundeni të nënshkruani këtë nga z. Ciaffaglione dhe të më dërgoni kopje të skanimit? Ju lutemi mos shkruani datat. Faleminderit, Marc*". Pas këtij komunikimi, me email-in e datës 18.10.2021, shtetasja Denisa Tollkuçi i shkruan shtetasit Marc Lappat, që bashkëngjitur do të gjejë dokumentet e nënshkruara. Për dijeni në këtë email ka qenë edhe shtetasi Klodian Zoto.

-Email i datës 06.10.2021, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetasit Marc Lappat në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasve Denisa Tollkuçi dhe Klodian Zoto. Në këtë email shtetasi Marc Lappat ju ka kërkuar shtetasve Denisa Tollkuçi dhe Klodian Zoto që të hapnin dy adresa emaili të shoqërisë "Geogenix BV", një për vetë shtetasin Marc Lappat, dhe një për shtetasin Martijn Harpe, i cili ka detyrën e Drejtorit Menaxhues të shoqërisë hollandeze "Geogenix BV". Pas këtij emaili, në datën 19.10.2021, nga adresa e postës elektronike e shtetasës Denisa Tollkuçi është dërguar në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Marc Lappat, ku për dijeni ka qenë edhe shtetasi Klodian Zoto,

kredencialet e adresave të hapura. Adresat e hapura janë “m.harpe@iebv.nl” (për shtetasin Martijn Harpe) dhe “m.lappat@iebv.nl” (për shtetasin Marc Lappat).

-Email i datës 14.12.2021, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetases Denisa Tollkuçi në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Marc Lappat, ku për dijeni është shtetasi Klodian Zoto. Në këtë email shtetasja Denisa Tollkuçi shkruan “*I dashur Marc, Shpresoj se ju jeni mirë! Ne duam të regjistrojmë një punonjës të ri në GeoGenix. Ju lutem mund të na informoni për procedurën? Përshëndetje të përzemërta, Denisa*”

-Email i datës 29.12.2017, i dërguar nga adresa e postës elektronike e shtetasit Marc Lappat, në drejtim të adresës së postës elektronike të shtetasit Klodian Zoto. Në këtë email shtetasi Marc Lappat ka bërë një përmbledhje të diskutimit që ka pasur me shtetasin Klodian Zoto, ku shkruan “*Nga diskutimi ynë kuptova se Energy Recuperator Spa i shiti aksionet e tij në Integrated Energy BV firmës suaj Integrated Technology Services shpk. Paul Eurth Italia Spa parashikon të transferojë aksionet e saj tek Integrated Technology Services dhe i aksion te një fondacion i ri holandez që do të krijohet, i cili do ta mbajë këtë aksion vetëm me qëllimin që të shmangë përmendjen e Integrated Technology Services shpk në regjistrin publik si aksioner i vetëm. Kjo do të ekzekutohet sapo ne, Residence CS të përfundojmë me sukses procedurën e pranimit të klientit tonë. Tarifat për shërbimet tona ndaj një fondacioni të tillë, zakonisht nuk do të kalojnë 5.000 euro në vit. Pasi kjo të jetë zbatuar, ne mund të diskutojmë dëshirën tuaj për të organizuar një hapësirë të dedikuar për zyrë dhe një avokat që do të punojë disa orë në ditë ose javë. Ju lutem më njoftoni në rast se kam keqkuptuar dhe ju lutem nënshkruani të dyja marrëveshjet nëse jeni të kënaqur me përmbajtjen.*”

-Bashkëlidhur email-it të mësipërm janë dy dokumente të pa nënshkruar. Dokumenti i parë është një marrëveshje midis shtetasit Klodian Zoto dhe shoqërive “Residence Corporate Services BV” (e përfaqësuar nga shtetasit Marc Lappat dhe Alissa Jangildina) dhe “Almares Management BV” (e përfaqësuar nga shtetasit Marc Lappat dhe Alissa Jangildina) dhe dokumenti i dytë është një marrëveshje midis shoqërive “Integrated Technology Services” sh.p.k, (e përfaqësuar nga shtetasi Klodian Zoto), “Integrated Energy BV” (e përfaqësuar nga shtetasit Marc Lappat dhe Alissa Jangildina), “Residence Corporate Services BV” (e përfaqësuar nga shtetasit Marc Lappat dhe Alissa Jangildina) dhe “Almares Management BV” (e përfaqësuar nga shtetasit Marc Lappat dhe Alissa Jangildina). Në këto marrëveshje del dukshëm fakti që:

-Shoqëria “Almares Management BV” do të vendos në dispozicion të shoqërisë hollandeze “Integrated Energy BV” drejtorin menaxhues, i cili do të përzgjidhet dhe shkarkohet si drejtor menaxhues me vendim të shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services sh.p.k”;

-Shoqëritë “Almares Management BV” dhe “Residence Corporate Services BV” do t'i kryejnë vendimmarrjet e tyre në shoqërinë hollandeze “Integrated Energy BV” në konsultim me shoqërinë e shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services sh.p.k.”;

-Shoqëritë “Integrated Technology Services” dhe “Integrated Energy BV” do të jenë debitorë solidar në lidhje me pagesat për shërbimet dhe rimbursimet e kostove që do të kryejnë shoqëritë “Almares Management BV” dhe “Residence Corporate Services BV”.

Sipas prokurorisë, nga aktet e administruara ka rezultuar se shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri kanë në zotërim indirekt edhe shoqërinë “F.M.O” sh.p.k, me administrator shtetasin Fatos Bunoca. Rezulton se shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri zotërojnë në mënyrë indirekte pasurinë e paluajtshme me nr. 5/ 1183- N1/2, Zona Kadastrale 8513, Volumi 81; Faqe 242; me sipërfaqe 611 m<sup>2</sup>, me adresë: “Durrës, L. 17 Rr. P. Hanxhari”. Për të humbur gjurmët nga pronësia e vërtetë e tyre, kjo pasuri është blerë në emër të shtetasit Fatos

Bunoca, sipas aktit noterial "Kontratë shitje me rezervë e pasurisë së paluajtshme" nr. 26 rep., nr. 17 kol., datë 13.01.2017, në shumën 1,100,000 (një milion e njëqind mijë) Euro, por që në fakt likuidimi i kësaj kontrate në drejtim të shitësit është bërë nga shtetasi Klodian Zoto.

Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së të dhënave nga faqja eeb e Qendrës Kombëtare të Biznesit, i datës 06.04.2023, rezulton se shoqëria "F.M.O" sh.p.k, me Nipt L02324003H, është themeluar në datën 22.11.2010, me adresë "Tirane, Njësia Bashkiake Nr.11, Rruga Halil Aga, Nr.5, Laprakë", me kapital prej 100,000 lekë, me ortak e administrator shtetasin Klodian Zoto, i cili ka qëndruar si ortak dhe administrator i vetëm i kësaj shoqërie deri më datën 01.07.2013. Më pas, nëpërmjet kontratës së shitjes nr. 10312 rep., nr.1540 kol., datë 01.07.2013, shtetasi Klodian Zoto i ka shitur 100% të kuotave të shoqërisë tek shtetasi Arenc Myrtezani për vlerën prej 100,000 lekë. Shtetasi Arenc Myrtezani ka qenë ortak i vetëm dhe administrator i kësaj shoqërie deri më datë 15.06.2015, kur është kryer shitja 100% e kuotave të aksioneve nga shtetasi Arenc Myrtezani në drejtim të shtetasit Fatos Bunoca për vlerën prej 100.000 lekë.

Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së të dhënave nga sistemi tatimor C@TS, rezulton që shtetasi Fatos Bunoca është regjistruar për herë të parë si i punësuar në datën 24.06.2015, pranë shoqërisë "F.M.O" sh.p.k, i deklaruar si Drejtor i Përgjithshëm Ndërmarrje. Pas kësaj date, shtetasi Fatos Bunoca rezulton të jetë punësuar si më poshtë:

- Në shoqërinë "Fusha" sh.p.k, për periudhën 15.08.2015-02.12.2015, i deklaruar si punëtor krahu guri;
- Në shoqërinë "ALKO-IMPEX General Construcion" sh.p.k, për periudhën 03.02.2016-19.09.2019 dhe për periudhën 20.12.2019-30.06.2021, i deklaruar si punëtor krahu;
- Në shoqërinë "Shaga" sh.p.k për periudhën 21.09.2019-23.09.2019, i deklaruar si punëtor ngarkim-shkarkimi;
- Në shoqërinë "ALKO IMPEX CONSTRUCTION" sh.p.k, për periudhën 02.07.2021 dhe vazhdon aktualisht, i deklaruar si punëtor krahu;
- Në shoqërinë "MIKLO KONSTRUKSION" sh.p.k, i deklaruar si Drejtor i Përgjithshëm Ndërmarrje. Shoqëria "MIKLO KONSTRUKSION" sh.p.k është themeluar nga shtetasi Loran Dusha (lidhje e shtetasit Klodian Zoto) në datën në datën 07.05.2014, dhe më pas në datën 15.06.2016 shtetasi Loran Dusha ia ka shitur këtë shoqëri shtetasit Fatos Bunoca.

Nga të dhënat e administruara tek kompjuteri i sekuestruar shtetasit Klodian Zoto, sipas aktit të ekspertimit teknik kompjuterik nr.93, datë 21.04.2022, ka rezultuar si më poshtë:

- Kontributet e punonjësve tek shoqëria "F.M.O" i ka llogaritur dhe i ka deklaruar shtetasja Julia Demneri (Julia Muça), dhe për këto ajo nuk njofton shtetasin Fatos Bunoca (administratori dhe pronari i deklaruar në QKB), por njofton shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri.
- Në lidhje me detyrimet e shoqërisë "F.M.O" dhe akt marrëveshjen me autoritetet tatimore për detyrimet tatimore që duhen shlyer, shtetasja Julia Demneri informon shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, shtetasi Mirel Mërtiri jep urdhrin mbi momentet kur duhet të kryhen pagesat.
- Shtetasi Klodian Zoto kryen komunikime dhe dërgon dokumente të shoqërisë "F.M.O" sh.p.k, te përfaqësues të shoqërisë Ujësjellës Kanalazime Korçë, në lidhje me pagesat që do të përfitojë shoqëria "F.M.O" sh.p.k.

- Shtetasja Denisa Tollkuçi, nëpërmjet adresës së postës elektronike i nis shtetasit Klodian Zoto vendimin e asamblesë së shoqërisë “F.M.O” sh.p.k, shkresa të shoqërisë “F.M.O” sh.p.k, dhe më pas shtetasi Klodian Zoto ia nis këtë vendim dhe shkresat noteres Majlinda Lama.
- Noterja Majlinda Lama i dërgon shtetasit Klodian Zoto draft kontratën që do të lidhet midis shoqërisë “F.M.O” sh.p.k, dhe shoqërisë “Ëind - co” sh.p.k, (shoqëri e bashkëshortes së ish Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, shtetases Brunilda Koka) dhe më pas, shtetasi Klodian Zoto bën disa ndryshime në këtë draft kontratë dhe ia dërgon noteres Majlinda Lama.
- Noterja Majlinda Lama kryen komunikime me shtetasin Klodian Zoto në lidhje me pagesat që shoqëria “F.M.O” sh.p.k, ka bërë për blerjen e pasurisë së paluajtshme nga shoqëria “Ëind - co” sh.p.k.
- Gjenden komunikimet midis shtetasve Erton Kaleshi dhe Jolita Hoxhollit në lidhje me transferimin e aktivitetit nga shoqëritë “Integrated Technology Services” sh.p.k, dhe “Miklo Konstruksion” sh.p.k, tek shoqëria “F.M.O” sh.p.k. Në këto komunikime gjenden emaillet e shtetasve Erton Kaleshit, Jolita Hoxhollit, Florian Pustina, Rudi Metaj (3 të fundit përfaqësues të zyrës juridike “Tashko Pustina”), si edhe shtetasve Klodian Zoto, Mirel Mërtiri dhe Helada Papa.
- Komunikimet në adresat elektronike të shtetasve Brunilda Koka, Klodian Zoto dhe Fatos Bunoca në adresat respektive si më poshtë: “brunakoka@yahoo.it”, “klodianszoto@yahoo.com” dhe “f.bunoca@fmo.al” mbi pagesat e kryera nga shoqëria “F.M.O” sh.p.k në drejtim të shoqërisë “Ëind - co” sh.p.k.

Gjatë hetimit, tek zyra e noteres Majlinda Lama është sekuestruar akti noterial, “Kontratë shitje me rezervë e pasurisë së paluajtshme” nr. 26 rep., nr. 17 kol., datë 13.01.2017, me palë shitëse shoqëria “Ëind - co” sh.p.k, e përfaqësuar nga shtetasja Brunilda Koka dhe me palë blerëse shoqëria “F.M.O” sh.p.k, e përfaqësuar nga shtetasi Fatos Bunoca. Objekti i kësaj kontrate është shitja e pasurisë nr. 5/ 1183- N1 në qytetin e Durrësit me këto të dhëna: Zona Kadastrale 8513; Adresa e pasurisë “Durrës, L. 17 Rr. P. Hanxhari”; Volumi 75; Faqe 33; Indeks Harte DR-H I-6.7; sipërfaqja totale 2223,3 m<sup>2</sup>, lloji i pasurisë “njësi”. Vlera e kontratës është 4,000,000 (katër milion) Euro. Si pjesë e kontratës është parashikuar se nëse shoqëria “F.M.O” sh.p.k, nuk paguan çmimin total, me skadimin e afatit maksimal 15.05.2017, atëherë shoqëria “F.M.O” sh.p.k, do të fitojë pronësinë për aq sipërfaqe sa i korrespondon vleftës së paguar dei më skadimin e afatit 15.05.2017. Kriteri është 1,800 Euro/m<sup>2</sup> (njëmijë e tetëqind euro për metër katror).

Bashkëlidhur këtij akti noterial (nr. 26 rep., nr. 17 kol., datë 13.01.2017), ndër të tjera, gjendej edhe shkresa e shoqërisë “F.M.O” sh.p.k, datë 20.02.2017, me lëndë “Kerkese per transferim pagesash”; si edhe komunikimi midis adresës së noteres Majlinda Lama, me adresë emaili “majlindalama@yahoo.com” dhe shtetasit Klodian Zoto, me adresë emaili “klodianszoto@yahoo.com”, me të cilin noterja Majlinda Lama ka njoftuar shtetasin Klodian Zoto që e ka marrë shkresën dhe e vinte në dijeni se nga llogaria e saj si notere janë kryer transfertat në llogarinë e shoqërisë “Ëind - co” sh.p.k, për shumat 10,000 Euro, 182,000 Euro dhe 149,000 Euro. Gjithasthu, noterja Majlinda Lama i kërkonte shtetasit Klodian Zoto që pagesat e tjera të kryheshin direkt në llogarinë e shitësit “Ëind - co” sh.p.k, dhe vetëm kësti i fundit me vlerë prej 1,000,000 Euro do të kryhej nëpërmjet llogarisë së noteres.

Nga të dhënat e administruara tek kompjuteri i sekuestruar shtetasit Klodian Zoto, rezulton se ndodhen tek ky kompjuter si shkresa e shoqërisë “F.M.O” sh.p.k, datë 20.02.2017, me lëndë “Kerkese per transferim pagesash”, ashtu edhe komunikimi nëpërmjet emailit midis

noteres Majlinda Lama dhe shtetasit Klodian Zoto, dokumentuar kjo me procesverbalin e këqyrjes dhe marrjes së të dhënave, datë 31.05.2023.

Gjatë hetimit, në zyrën e notere Majlinda Lama është sekuestruar akti noterial nr. 533 rep., nr. 204 kol., datë 21.06.2018 "Deklaratë noteriale", nëpërmjet të cilës shoqëria "Ëind - Co" sh.p.k e përfaqësuar nga shtetasja Brunilda Koka, deklaroi se: *"Me kontratën e shitjes me rezervë nr. 26/17 datë 13.01.2017, shoqëria "Ëind - co" sh.p.k pala shitëse, ka kontraktuar me palën blerëse "F.M.O" sh.p.k për shitjen e pasurisë nr. 5/1183-N1 ZK 8513, njësi me sipërfaqe 2223.3 m<sup>2</sup> për çmimin 4,000,000 (katër milion) Euro. Pala blerëse ka paguar për pjesën e vlerës vetëm 1,100,000 (një milino e njëqind mijë) Euro, për këtë arsye bazuar në pikën 6 të kontratës nr. 26 rep., nr. 17 kol., datë 13.01.2017, shoqëria "Ëind-CO" ka lëshuar këtë deklaratë noteriale ku ka përcaktuar sipërfaqen takuese koresponduese të kësaj prone të shitur, lloji i pasurisë "njësi", me sipërfaqe prej prej 611 m<sup>2</sup>, e cila kalon në favor të palës blerëse shoqëria "F.M.O" sh.p.k".*

Nga aktet e administruara rezulton se, nga llogaritë bankare të shoqërisë "F.M.O" sh.p.k, janë transferuar nga shoqëria "F.M.O" sh.p.k në drejtim të llogarisë bankare të noteres Majlinda Lama shumat prej 341,000 (treqind e dyzet e një mijë) Euro, dhe 1.532,520 (një milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e njëzet) lekë. Gjithashtu janë transferuar nga shoqëria "F.M.O" sh.p.k në drejtim të llogarisë bankare të shoqërisë "Ëind Co" sh.p.k shuma prej 750,000 (shtatëqind e pesdhjetë mijë) Euro. Këto transfertat kanë ndodhur nëpërmjet transaksioneve të mëposhtme:

Nga llogaria e shoqërisë "F.M.O" sh.p.k me nr. 515740909CLPRCLALLAL në Bankën Kombëtare Tregtare: Në datën 10.02.2017 shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k ka transferuar te shoqëria "F.M.O" sh.p.k vlerën prej 15,000,000 lekë. Shoqëria "F.M.O" sh.p.k, po në datën 10.02.2017, e ka transferuar këtë shumë në llogarinë e saj bankare me nr. 515740909CLPRCFEURVU në monedhën euro, ku shuma është ekuivalnetuar në vlerën 110,456 Euro; Nga llogaria e shoqërisë "F.M.O" sh.p.k me nr. 515740909CLPRCFEURVU, në Bankën Kombëtare Tregtare:

- Në datën 10.02.2017 shtetasja Merila Luga ka depozituar "cash" vlerën 72,000 Euro në llogarinë bankare të shoqërisë "F.M.O", gjithashtu në datën 10.02.2017 shoqëria "F.M.O" ka transferuar nga llogaria e saj në monedhën lekë drejtë llogarisë së saj në monedhën euro, shumën prej 110,456 Euro (të cilat ishin transferuar nga shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k në drejtim të shoqërisë "F.M.O" sh.p.k). Po në datën 10.02.2017, shoqëria "F.M.O" ka transferuar shumën **182,000 Euro** në llogarinë bankare të notere Majlinda Lama.
- Në datën 14.02.2017 shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k ka transferuar te shoqëria "F.M.O" shumën 149,500 Euro. Po në datën 14.02.2017, shoqëria "F.M.O" transferon në llogarinë bankare të notere Majlinda Lama shumën prej **149,000 Euro**.
- Në datën 27.04.2017 shoqëria "Integrated Technology Services" sh.p.k ka transferuar te shoqëria "F.M.O" sh.p.k shumën 200,500 Euro. Po në datën 27.04.2017 shoqëria "F.M.O" sh.p.k ka transferuar shumën prej **200,000 Euro** te shoqëria "Ëind - co" sh.p.k;

Nga llogaria e shoqërisë "F.M.O" sh.p.k me nr. 00000880846 në bankën Credinis:

- Në datën 17.01.2017 shtetasja Merila Luga depoziton në llogarinë bankare të shoqërisë "F.M.O" sh.p.k vlerën prej 902,000 lekë, po në këtë datë shoqëria "F.M.O" sh.p.k transferon vlerën **900,000 lekë** në llogarinë bankare të notere Majlinda Lama;

- Në datë 30.01.2017 shtetasja Ueda Hajrullaj depoziton në llogarinë bankare të shoqërisë “F.M.O” sh.p.k vlerën prej 628,000 lekë, po në këtë datë shoqëria “F.M.O” sh.p.k transferon vlerën prej 623,520 lekë në llogarinë bankare të notere Majlinda Lama;
- Në datën 15.03.2017 shoqëria “Integrated Technology Ëaste Treatment Fier” sh.p.k transferon në llogarinë bankare të shoqërisë “F.M.O” sh.p.k shumën prej 74,650,000 lekë, po në këtë datë shoqëria “F.M.O” sh.p.k transferon shumën prej 74,615,256 lekë në llogarinë e saj me nr. 00000880847 (llogari në monedhën Euro);

Nga llogaria e shoqërisë “F.M.O” sh.p.k me nr. 00000880847, në bankën Credinis:

- Në datë 13.01.2017 shtetasja Ueda Hajrullaj depoziton në llogarinë bankare të shoqërisë “F.M.O” sh.p.k, shumën prej 10,200 Euro, po në këtë datë shoqëria “F.M.O” transferon shumën prej 10,000 Euro në llogarinë bankare të notere Majlinda Lama;
- Në datën 15.03.2017 shoqëria “F.M.O” sh.p.k transferon shumën e transferuar nga shoqëria “Integrated Technology Ëaste Treatment Fier” sh.p.k prej 74,615,256 lekë në llogarinë nga llogaria e saj në monedhën lekë në llogarinë e saj në monedhën euro, shuma e ekuivalentuar është 550,260 Euro, po në datën 15.03.2017 shoqëria “F.M.O” ka transferuar shumën 550,000 Euro në llogarinë e shoqërisë “Ëind - co” sh.p.k.

Me procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e dokumentave, datë 12.05.2023, rezulton se pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës është marrë një kopje e njëzuar me origjinalin e praktikës së regjistrimit e pasurisë Nr.5/1183-N1/2, zk nr.8513, vol.81, fq.242, me sipërfaqe prej 611 m<sup>2</sup>, me pronar shoqërinë “F.M.O” sh.p.k. Nga analizimi i kësaj praktike rezulton se shoqëria “Ëind-Co” sh.p.k, ka bërë aplikimin me datë 31.08.2020 pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, për lëshimin e kopjes së kartelës së pasurisë duke u bërë ndryshimet në kartelën e pasurisë të pronës, duke kaluar pronësia nga shoqëria “Ëind-Co” sh.p.k, tek shoqëria “F.M.O” sh.p.k.

**Në rrethanat e mësipërme, sipas prokurorisë, rezulton se pronarët “de facto” të shoqërisë “F.M.O” sh.p.k, janë shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, të cilët rezultojnë të jenë edhe pronarët e pasurisë së paluajtshme të blerë në shumën 1, 100, 000 Euro, por që për të humbur gjurmët kanë përdorur shtetasin Fatos Bunoca, për të kryer aktin e blerjes së saj.**

**Rrethana të tilla u provuan nga provat e analizuara më sipër, si vijon: Kallëzimi nr. 255/2020; Urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr.255; Kallëzimi nr. 53/2021; Urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr.53; Vendim për bashkimin e procedimit penal nr.255 dhe nr.53; Kallëzimi nr.45/2022; Urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr.45; Vendim për bashkimin e procedimit penal nr.255 dhe nr.45; Kallëzimi nr.49/2022; Urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr.49; Vendim për bashkimin e procedimit penal nr.255 dhe nr.49; Kallëzimi nr.50/2022; Urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr.50; Vendim për bashkimin e procedimit penal nr.255 dhe nr.50; Kallëzimi nr.54/2022; Urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr.54; Vendim për bashkimin e procedimit penal nr.255 dhe nr.54; Kallëzimi nr.143/2022; Urdhër për regjistrimin e procedimit penal nr.143; Vendim për bashkimin e procedimit penal nr.255 dhe nr.143; Procesverbal i datës 08.05.2023 “Për këqyrjen dhe marrjen e dokumentave”, pranë Bashkisë Tiranë; Procesverbal i datës 31.05.2023 “Për këqyrjen e pjesshme dhe marrjen e të dhënave të hard diskut të jashtëm, të përfutuar nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik (i pjesshëm) nr.93, datë 21.04.2022”;**

Procesverbal i datës 19.07.2023 "Për këqyrjen e pjesshme dhe marrjen e të dhënave të hard diskut të jashtëm, të përfitur nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik (i pjesshëm) nr.65, datë 03.03.2022"; Procesverbal i datës 19.11.2023 "Për këqyrjen e pjesshme dhe marrjen e të dhënave të hard diskut të jashtëm, të përfitur nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik (i pjesshëm) nr.65, datë 03.03.2022"; Procesverbal i datës 01.12.2023 "Për këqyrjen e pjesshme dhe marrjen e të dhënave të hard diskut të jashtëm, të përfitur nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik (i pjesshëm) nr.65, datë 03.03.2022"; Shkresa nr. 6257 prot., datë 03.05.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa kthim përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e protokolluar me nr. 6257/1 prot., datë 12.05.2023 në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa nr. 7189 prot., datë 22.05.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa kthim përgjigje me nr. 3316/1 prot., datë 31.05.2023 e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Procesverbal i datës 01.02.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e dokumentave", pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Shkresa nr. 602 prot., datë 13.01.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa kthim përgjigje me nr. 466/1 prot., datë 23.01.2023 e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; Shkresa nr. 7770 prot., datë 31.05.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa kthim përgjigje me nr. 3535/1 prot., datë 06.06.2023 e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Shkresa nr. 7590 prot., datë 31.05.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa nr. 2611 prot., datë 20.02.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa nr. 2612 prot., datë 20.02.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa nr. 2613 prot., datë 20.02.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa nr. 2614 prot., datë 20.02.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa kthim përgjigje me nr. 747/1 prot., datë 17.03.2023 e Bashkisë Kavajë; Shkresa kthim përgjigje me nr. 1913/1 prot., datë 01.03.2023 e Bashkisë Kamëz; Shkresa kthim përgjigje me nr. 1026/1 prot., datë 01.03.2023 e Bashkisë Vorë; Shkresa kthim përgjigje me nr. 704/1 prot., datë 03.03.2023 e Bashkisë Rrogozhinë; Shkresa nr. 15616 prot., datë 16.11.2023 e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Shkresa kthim përgjigje me nr. 1017/1 prot., datë 21.11.2023 e Kontrollit të Lartë të Shtetit; Procesverbal i datës 24.04.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi elektronik i APP-së"; Procesverbal i datës 25.05.2023, "Për këqyrjen dhe marrjen e deklaratave doganore të shoqërisë Artcon" sh.p.k; Procesverbal i datës 18.06.2023, "Për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga faqja web e Qendrës Kombëtare të Biznesit"; Procesverbal i datës 22.07.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi tatimor C@TS"; Procesverbal i datës 26.04.2023 "Për këqyrjen e librave të shitjes të shoqërisë "Artcon" sh.p.k; Procesverbal i datës 30.11.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi tatimor C@TS"; Procesverbal i datës 30.11.2023, "Për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga faqja web e Qendrës Kombëtare të Biznesit"; Akt ekspertimi grafik i nënshkrimit nr. 10200, datë 27.10.2023 nga Intituti i Policisë Shkencore; Aktet e marra në ekzekutim të letërporosisë dërguar Autoriteteve Italiane të Drejtësisë nr. 97 prot., datë 22.06.2022; Aktet e marra në ekzekutim të letërporosisë dërguar Autoriteteve Hollandeze të Drejtësisë nr. 95 prot., datë 21.06.2022; Procesverbal i datës 25.07.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi tatimor C@TS"; Procesverbal i datës 24.07.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi tatimor C@TS"; Procesverbal i datës 06.06.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi tatimor C@TS"; Procesverbal i datës 03.04.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga Qendra Kombëtare e Biznesit"; Procesverbal i datës 06.04.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e dokumentave nga Qendra Kombëtare e Biznesit"; Procesverbal i datës 17.06.2023 "Për

këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi tatimor C@TS"; Procesverbal i datës 28.02.2023 "Për sekuestrimin e provës materiale"; Procesverbal i datës 03.04.2023 "Për sekuestrimin e provës materiale"; Procesverbal i datës 24.03.2023 "Për sekuestrimin e provës materiale"; Procesverbal i datës 12.05.2023 "Për këqyrjen dhe marrjen e dokumentave nga Agjencia Shtetërore e Kadastres"; Deklarimet e shtetasve Vladimir Bezhani, Ledjana Bojaxhi (Karalliu), Alba Thoma, Valbona Ballgjini, Bledar Karoli, Etleva Kondi, Pëllumb Abeshi, Sidita Temali, Namik Simixhiu, Taulant Tusha; Lumturije Murati, Migert Kello, Astrit Kastrati, Vexhide Malo, Mariglen Haka, Santiliano Çifliku, Esmeralda Çifliku, Artur Xhambolli, Genci Skifteri, Isa Lushi, Pjetër Frroku, Herman Daniel Vermeulen, Arjola Kodra, Jetmir Llapaj, Silena Tola; Akte të tjera të procedimit nr.255 të vitit 2020.

### **Pretendimet e prokurorit**

Mbi rrethanat e parashtruara më sipër, në kërkesën drejtuar gjykatës prokurori ka parashtruar se ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229, 230, 237, 238, të K.Pr.Penale, siç janë: Ekziston dyshimi i arsyeshëm dhe i bazuar në prova në ngarkim të shtetasve nën hetim Lefter Koka, Alqi Billako, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Etleva Kondi, Alba Thoma, Bledar Karoli, Valbona Ballgjini, Sidita Temali, Taulant Tusha, Namik Simixhiu se kanë kryer veprat penale që i atribuohen.

Nuk ka shkaqe padënueshmërie ndaj personave nën hetim ose të shuarjes së veprës penale. Personat në hetim janë të përgjegjshëm para ligjit për veprat penale për të cilat dyshohen. Në rastin konkret, sipas prokurorisë, ekziston rreziku i ikjes së personave nën hetim, kjo nisur nga fakti që tashmë personat nën hetim kanë ardhur në dijeni të faktit për të cilën ato hetohen, si dhe nisur nga sanksioni i lartë i veprave penale, për të cilët dyshohen, mund të largohen për t'i shpëtuar dënimit të mundshëm.

Në kërkesën dhe llojin e masës së sigurimit nga ana e prokurorisë kërkohet që të merret parasysh edhe mundësia e ndërhyrjes së personave nën hetim të mësipërm për të mundësuar pengimin e hetimeve dhe vështirësinë e marrjes së provave, kjo pasi nga ana e organit procedues po kryhen veprime hetimore në vijimësi, siç është edhe pyetja e personave që kanë dijeni për veprën penale dhe personat nën hetim mund të ndikojnë në lidhje me rrethanat e hetimit, tek këta persona drejtpërdrejt ose nëpërmjet personave bashkëpunëtor të tyre.

Në kërkesën dhe llojin e masës së sigurimit që kërkohet të caktohet mbahet parasysh proporcionaliteti dhe përshtatshmëria e nevojave të sigurimit, në raport edhe me veprat penale për të cilët dyshohen personat e mësipërm. Duke vlerësuar rëndësinë e faktit, sanksioni që parashikojnë veprat penale, duke vlerësuar edhe shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret, duke patuar parasysh rrezikshmërinë shoqërore për secilën nga këto vepra penale.

Nisur nga përshtatshmëria e masës së sigurimit me nevojat e sigurimit, duke marrë parasysh sanksionin që parashikohet për këto vepra penale, rrezikshmërinë e personave nën hetim, faktin se ndaj disa prej personave nën hetim është ushtruar ndjekja penale, të cilët janë të akuzuar tashmë për veprimtari të kundraligjshme të kryer për shkak të detyrës, rrethana e përsëritjes, për raste të tjera të ndodhura më parë në rastin e Inceneratorit të Elbasanit dhe të Fierit, konkretisht për personat nën hetim Lefter Koka, Alqi Billako, Pëllumb Abeshi, Etleva Kondi, Erjon Murataj, Klodian Zoto, Mirel Mërtiri, nisur nga pasoja e ardhura nga vepra penale, dëmit të madh të shkaktuar interesave të ligjshme të shtetit si shkak i veprimeve të kundraligjshme të të gjithë personave nën hetim, nisur nga fakti se personi nën hetim Sidita

Temali ka bashkëpunuar me organin procedues deri në këtë fazë të hetimeve paraprake, nga ana e prokurorisë vlerësohet se masa më e përshtatshme për personat nën hetim **Lefter Koka, Alqi Bilako, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Klodian Zoto, Mirel Mërtiri, Etleva Kondi, Bledar Karoli, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, Jetmir Llapaj**, është ajo e “arrestit në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Ndërsa, nisur nga rrethanat e veçanta familjare, moshën e fëmijëve, si dhe rrethana të tjera lehtësuese, për personat nën hetim **Valbona Ballgjini, Alba Thoma, Sidita Temali, Silena Tola**, nga ana e prokurorisë vlerësohet se masa më e përshtatshme është ajo e “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

### Vlerësimi i Gjykatës

Nga analiza në tërësi e të gjitha provave të marra në përputhje me ligjin procedural penal, deri në këtë fazë të hetimeve, ka dyshime se personat nën hetim, **Lefter Koka, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, Bledar Karoli, Etleva Kondi, Jetmir Llapaj, Valbona Ballgjini, Alba Thoma, Sidita Koplaku, Silena Tola**, në bashkëpunim me njëri tjetrin (në formën e bashkëpunimit të thjeshtë), kanë konsumuar elementët e veprës penale të “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 245 e 25 të Kodit Penal; i hetuari **Alqi Bilako**, ka konsumuar elementët e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, dy herë, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal; i hetuari **Klodian Zoto**, ka konsumuar elementet e veprave penale “*Mashtrimi*” me pasoja të rënda, në bashkëpunim, “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 143/3, 25, 245 të Kodit Penal, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287, gërmat “a” dhe “b” të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal, ndërsa shtetasi nën hetim **Mirel Mërtiri**, ka konsumuar elementet e veprave penale “*Mashtrimi*” me pasoja të rënda, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 143/3, 25 i Kodit Penal, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287, gërmat “a” dhe “b” të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal.

**Neni 245 i Kodit Penal**, parashikon veprën penale të **Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë** “*Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.*”.

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për garantuar veprimtarinë e rregullt të organeve shtetërore, e pandikuar ajo nga veprimet e kundërligjshme të personave të ndryshëm.

Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet në formë të ndryshme që nga premtimi deri tek dhënia drejtpërdrejtë ose tërthorazi i çfarëdo përfitimi të parregullt funksionarit të lartë shtetëror apo të zgjedhurit vendor.

Nga ana subjektive kjo vepër penale kryhet me dashje direkte dhe qëllimi është kryerja ose moskryerja e një veprimi që lidhet me detyrën e funksionarit të lartë shtetëror apo të zgjedhurit vendor.

Subjekt është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

**Neni 248 i Kodit Penal**, parashikon veprën penale të **Shpërdorimi i detyrës** "Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet."

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për garantuar veprimtarinë e rregullt të organeve shtetërore, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, shtetit apo personave të tjerë juridikë.

Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet me veprime aktive të kundërligjshme ose mosveprime që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës.

Nga ana subjektive kjo vepër penale kryhet me dashje direkte dhe qëllimi është përfitimi material apo shoqëror të parregullt për vete ose, passjell dëmtimin e interesave të ligjshëm të shtetasve, shtetit apo personave të tjerë juridikë, duke kryer apo moskryer veprime apo mosveprime të kundërligjshme që përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës.

Subjekt është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, i ngarkuar me funksione publike, i cili përdor këto cilësi të posaçme funksionale, duke vepruar në mënyrë të kundraligjshme, në mospërbushje të rregullt të detyrës.

Për të pasur përgjegjësi penale sipas nenit 248 të Kodi Penal nuk është kusht që pasojat e ardhura nga veprimet ose mosveprimet në kundërshtim me ligjin të personit që ushtron funksione publike të jenë vetëm pasoja materiale. Kjo dispozitë parashikon dy lloje pasojash: a) përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për vetë personin që ushtron funksione publike ose për persona të tjerë, dhe b) dëmtimin e interesave të ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë.

Lloji i dytë i pasojave, dëmtimi i interesave të ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, mund të jetë dëm material ose jo material. Përveç kërkesës që interesat e dëmtuara duhet të jenë të ligjshme, dispozita penale nuk ka caktuar ndonjë kriter lidhur me llojin apo me rëndësinë e tyre. Prandaj vlerësimi i pasojës së ardhur në këtë drejtim është çështje që zgjidhet rast pas rasti nga vetë gjykata. Në vlerësimin e kësaj gjykate, çdo lloj interesi i ligjshëm i shtetit, i shtetasve dhe i personave juridikë, të cilit i shkaktohet dëm nga veprimet/ mosveprimet e kryera me dashje, në kundërshtim me ligjin, nga personi që ushtron detyrën, është pasojë e veprës penale sipas nenit 248 të Kodit Penal.

**Neni 260 i Kodit Penal**, parashikon veprën penale të **Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë** "Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimit i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet".

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për garantuar veprimtarinë e rregullt të organeve shtetërore, e pandikuar ajo nga veprimet e kundërligjshme të personave të ndryshëm.

Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet në forma të ndryshme që nga premtimi deri tek marrja drejtpërdrejtë ose tërthorazi i çfarëdo përfitimi të parregullt nga ana e funksionarit të lartë shtetëror apo të zgjedhurit vendor.

Nga ana subjektive kjo vepër penale kryhet me dashje direkte dhe qëllimi është përfitimi material apo shoqëror të parregullt për vete ose, për persona të tjerë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionarit të lartë shtetëror apo të zgjedhurit vendor.

Subjekt është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

**Neni 287 i Kodit Penal**, parashikon veprën penale të **Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale** "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim...".

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për garantuar interesat shtetërore nga format e ndryshme të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet me veprime aktive apo mosveprime, të cilat cilësohen specifikisht në përmbajtje të dispozitës më sipër.

Nga ana subjektive kjo vepër penale kryhet me dashje direkte dhe qëllimi është pastrimi i të ardhurave financiare apo produkteve kriminale të cilat vijnë si rezultat i ushtrimit të një veprimtarie kriminale të mëparshme.

Subjekt është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

**Neni 143 i Kodit Penal**, parashikon veprën penale të **Mashtrimit** "Përvetësimi i pasurisë private ose publike nëpërmjet paraqitjes së fakteve të rreme ose duke fshehur fakte të vërteta, gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit, për vete ose persona të tjerë, përbën veprën penale të mashtrimit dhe dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

**Kur vepra ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet".**

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar të drejtën e pronësisë private apo publike, të personit juridik apo shtetëror si dhe të drejtat pasurore, paprekshmërinë e tyre nga mashtrimi, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet në forma të ndryshme për fitimin e pasurisë dhe të drejtave pasurore, me anë të gënjeshtërs dhe shpërdorimit të besimit.

Nga ana subjektive kjo vepër penale kryhet me dashje direkte dhe qëllimi është shtwnia në dorë e pasurisë së personit fizik, personit juridik apo shtetëror, me qëllim për të nxjerrë përfitime materiale për vete apo për persona të tjerë.

Subjekt është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Në rastin konkret, prokurori i ka kërkuar Gjykatës të caktohet masa e sigurimit personal shtrengues për shtetasit nën hetim më sipër. Kodi i Procedurës Penale ka normuar hapësirën e vlerësimit diskrecional të gjykatës, lidhur me caktimin e masës së sigurimit. Për këtë qëllim Kodi i Procedurës Penale, ka parashikuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta si dhe kriteret nga të cilat gjykata udhëhiqet për caktimin e masës së sigurimit.

Neni 228 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masës së sigurimit. Kushtet e parapara nga neni 228 i K.Pr.Penale duhet plotësohen njëkohësisht, në mënyrë kumulative.

Kështu, neni 228 i K.Pr.Penale parashikon se “1. Askush nuk mund t’u nënshirohet masave të sigurimit personal në qoftëse në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. 2. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale. 3. Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen e provës; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”.

Gjykata vlerëson se, nga hetimet e kryera dhe provat e përfuara, plotësohet kushti i parë universal i masave të sigurimit, të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Nga analiza e provave më sipër, në interpretim dhe kuptim të drejtë të shprehjes “*dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova*” duhet të kuptohet dhe dallohet gjykimi mbi dyshimin e arsyeshëm bazuar në prova për caktimin e masës së sigurimit nga gjykimi i provës për efekt të formimit të bindjes mbi të vërtetën, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, në dhënien e vendimit të pushimit, pajfjesisë apo dënimit të së pandehurit. *Dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit se ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij.*

Analiza në tërësi e të gjitha provave të marra në përputhje me ligjin procedural penal, vlerësohet nga gjykata për të krijuar dyshimin e arsyeshëm në përputhje me këto prova të cilat provojnë: Përfshirjen e personave nën hetim në kryerjen e veprave penale që i atribuohen. Të vlerësuara në tërësinë e tyre provat e analizuara më sipër, provojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova, se duket e mundshme përgjegjësia e personave nën hetim në lidhje me dyshimin e kryerjes së veprave penale më sipër. Në nivelin e provave të grumbulluara deri në këtë fazë hetimi, rezulton ekzistenca e një bashkëpunimi të thjeshtë ndërmjet personave nën hetim, për kryerjen e veprave penale të sipërcituara, për sa do të analizohet në vijim:

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi bazën e kallëzimit të bërë nga ana e Partisë Demokratike të Shqipërisë me datë 22.10.2020 ka regjistruar procedimin penal nr.255 për veprat penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, “*Shpërdorimi i detyrës*”, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale*”, të parashikuara nga nenet 258, 248 dhe 287 të Kodit Penal, procedim penal ky i bashkuar me procedimet penale nr.53 të vitit 2021, nr.45 të vitit 2022, nr.49 të vitit 2022, nr.50 të vitit 2022, nr.54 të vitit 2022, nr.143 të vitit 2022, me objekt hetimi për të njëjtin fakt penal.

2. Nga tërësia e akteve dhe provave të administruara në kuadër të procedimit penal më sipër, rezulton se hetimi është kryer referuar procedurës së lidhjes së kontratës së koncesionit me objekt *“Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vendepozitimeve ekzistuese, Tiranë”*, me datë 31.08.2017, ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë *“Integrated Energy BV S.P.V”* sh.p.k.

2.1. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 22239 prot. datë 23.12.2015, ka njoftuar Ministrinë e Mjedisit se Bashkia Tiranë së bashku me Koorporatën Ndërkombëtare Financiare /International Financial Corporation (IFC), kanë përfunduar studimin për përmirësimin e shërbimit dhe trajtimin të mbetjeve në qytetin e Tiranës dhe për mundësinë e përfshirjes së sektorit privat nëpërmjet Partneritetit Publik Privat. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj shkrese Bashkia Tiranë ka informuar se opsioni i zgjerimit të Landfillit të Sharrës është vlerësuar dhe nga ekspertët e Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar/Japan International Cooperation Agency (JICA), në kuadër të Masterplanit të Menaxhimit të Mbetjeve për qytetin e Tiranës, si dhe i ka kërkuar Ministrisë së Mjedisit mbështetje për këtë nismë.

2.2. Me shkresën kthim-përgjigje të Ministrisë së Mjedisit, nr. 1469 prot., datë 03.03.2016, konfirmohet se midis stafëve teknike të dy institucioneve është arritur në përfundimin që kjo procedurë të vazhdohet nga Ministria e Mjedisit duke propozuar ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës.

3. Në kuadër të kryerjes së veprimeve hetimore, ndër të tjera, në datë 14.12.2021 është kryer edhe sekuestrimi i një kompjuteri në banesën e të hetuarit Klodian Zoto, administrator dhe aksioner i shoqërisë *“Integrated Technology Services”* sh.p.k. Mbi paisjen e mësipërme është kryer ekspertim teknik dhe akti i ekspertimit teknik kompjuterik nr.93, datë 21.04.2022, paraqet të dhëna me rëndësi për hetimin, e konkretisht nga këqyrja e adresës së e-mailit të të hetuarit Klodian Zoto rezulton se ai ka pasur korrespondencë elektronike, fillimisht me shtetasin Vladimir Bezhani, ish-Këshilltar i jashtëm të Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka dhe në vijim me persona të tjerë nën hetim, lidhur me gjithë procedurën e kontratës së koncesionit *« Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vendepozitimeve ekzistuese, Tiranë »*, të cilat trajtohen hollësisht në rubrikën e rrethanave të faktit të këtij vendimi.

4. Nga të dhënat e përfthuara më sipër, gjykata vlerëson se Ministria e Mjedisit, së bashku me Bashkinë Tiranë, kanë pasur në plan të zhvillojnë një procedurë koncesioni në lidhje me trajtimin e mbetjeve në qytetin e Tiranës, që në datën 23.12.2015, përpara se të bëhej propozimi i pakërkuar në Ministrinë e Mjedisit nga shoqëritë *“Energy Recuperator S.P.A”*, *“Paul Eurth Italia S.P.A”*, *“Integrated Technology Services”* sh.p.k, si dhe për këtë nismë të këtyre dy institucioneve shtetërore, shtetasi Vladimir Bezhani (ish-Këshilltar i jashtëm i Ministrit të Mjedisit, Lefter Koka dhe njëkohësisht punonjës i shoqërisë *“Integrated Technology Services”* sh.p.k, në atë kohë), ka vënë në dijeni shtetasin Klodian Zoto, i cili gjatë periudhës në fjalë ka qenë administratori dhe pronari i shoqërisë *“Integrated Technology Services”* sh.p.k, (një ndër tre shoqëritë që ka bërë propozimin e pakërkuar më pas). Dokumenti i siguruar nga shtetasi Klodian Zoto nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit *“Master Planin per Menaxhimin e Mbetjeve te Ngurta Urbane te Tiranës”*, ka patur të dhëna që do të shërbenin për ndërtimin e studimit të fizibilitetit, të paraqitur më vonë nga shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, për të pritur më pas propozimin e pakërkuar nga shoqëria e shtetasit Klodian Zoto.

**Propozimi i pakërkuar drejtuar Ministrisë së Mjedisit**

5. Me shkresën nr.16/044, datë 23.06.2016, shoqëritë “Energy Recuperator S.P.A”, “Paul Ēurth Italia S.P.A” “Integrated Technology Services” sh.p.k, kanë dërguar shkresën pranë Ministrisë së Mjedisit, me lëndë “Letër Interesi”, si propozim i pakërkuar, hartuar nga shtetasi Vladimir Bezhani, sipas deklarimeve të këtij të fundit, me kërkesë të të hetuarit Klodian Zoto. Nga të dhënat rezultojnë se në këtë periudhë, studimi i fizibilitetit nga shoqëritë e mësipërme nuk ishte përfunduar akoma. Nga dokumentacioni i marrë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, sipas procesverbalit të këqyrje dhe marrjes, datë 01.02.2023, rezultojnë se kjo shkresë nuk ndodhet e administruar pranë Autoritetit Kontraktor, në Ministrinë e Mjedisit apo në Ministrinë së Infrastrukturës dhe Energjitikës, por që përmbajtja e kësaj shkrese është e administruar tek dokumentet e kompjuterit të sekuestruar, të shtetasit Klodian Zoto.

5.1. Në rrethanat e mësipërme, shkresa “Letër Interesi”, datë 23.06.2016, e shoqërive “Energy Recuperator S.P.A”, “Paul Ēurth Italia S.P.A” Integrated Technology Services” sh.p.k, nuk mund të konsiderohet si “propozim i pakërkuar”, në zbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, “Propozimet e pakërkua”, dhe nenet 10 dhe 11 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar. “Rregullat e përgjithshme për paraqitjen e propozimeve të pakërkua”, “Propozimi i pakërkuar në formë të zhvilluar”. Shkresa e nisur nga shoqëritë me lëndë “Letër Interesi”, nuk duhet të ishte konsideruar si “propozim i pakërkuar”, provuar kjo edhe nëpërmjet kthimit të përgjigjes nga ana e Ministrisë së Mjedisit, nëpërmjet së cilës kërkohen dokumente të tjera për propozimin e pakërkuar. Në zbatim të nenit 3 pika 5 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013, “Identifikimi i projekteve të mundshme të koncesionit/PPP”, nëse do të ishim përpara rastit të dorëzimit të një propozimi të pakërkuar pranë një Autoriteti Kontraktor, atëherë Autoriteti Kontraktor do të duhet të ngrinte një komision, ku në bazë të raportit përmbledhës të këtij të fundit, Autoriteti Kontraktor do të mund t’i kërkonte dokumentacion shtesë shoqërisë propozuese.

Konkretisht : Ligji nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, në nenin 25 të tij me titull, “Propozimet e pakërkua”, parashikon se :

*“1. Autoriteti kontraktues autorizohet të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkua, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin procedurat e përzgjedhjes kanë nisur apo janë shpallur.*

*2. Nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, pas vlerësimit paraprak, autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë veprimet për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat.*

*6. Propozuesit i jepet një bonus për rezultatin teknik dhe/ose financiar të arritur gjatë procedurës konkurruese deri në një maksimum 10 % të pikëve totale të garës.*

*7. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjen dhe trajtimin e propozimeve të pakërkua”.*

VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, e ndryshuar, në Nenin 3 me titull “Identifikimi i projekteve të mundshme të koncesionit/PPP”, pika 5 e tij, parashikon se:

*“...5. Autoriteti kontraktues, bazuar në raportin përmbledhës të hartuar nga komisioni i koncesionit/PPP, me vendim përcakton: shtyrjen ose refuzimin e plotë të zbatimit të projektit. Bazat për ndërprerjen mund të përbëhen nga provat thelbësore të mungesës së mundshme të fizibilitetit të projektit/alternativave që janë analizuar. Prova të tilla krijohen*

*në bazë të krahasimeve paraprake të përfitimeve dhe kostove të përdoruesve. të informacionit për mungesën e fizibilitetit/përshtatshmërisë financiare apo të konkluzionit se objekti në përgjithësi nuk është i nevojshëm; vazhdimin e procedurave me përgatitjen e studimit të fizibilitetit; kthimin për plotësim të propozimit të pakërkuar, për shkak se nuk është paraqitur sipas formave të kërkuara në nenin 10 të këtyre rregullave. Në këtë rast, propozuesi ka afat 30 ditë nga data e kthimit të propozimit për ta plotësuar atë."*

Neni 10 i VKM-së së mësipërme, me titull "Rregullat e përgjithshme për paraqitjen e propozimeve të pakërkua", parashikon se: "1. Çdo operator ekonomik ose grup operatorësh ekonomikë, referuar më poshtë si propozuesi, mund të paraqesë një propozim të pakërkuar për zbatimin e një projekti koncesionar/PPP dhe autoriteti kontraktues i analizon propozimet e tilla, me kusht që: a) propozimi të lidhet me një projekt në njërin prej sektorëve që parashikohen në nenin 4 të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat; b) propozimi nuk lidhet me një projekt, për të cilin tashmë ka filluar ose është shpallur procedura për dhënien e tij. 2. Propozimi i pakërkuar i dorëzohet vetëm autoritetit kontraktues. të cilit ligji i jep autoritetin të ndërmarrë procedurën e dhënies së asaj kontrate të koncesionit/PPP-së. 3. Propozimi i pakërkuar mund të detajohet, në mënyrë që të trajtojë projektin në secilën prej formave të mëposhtme: ...b) formë të zhvilluar me analiza teknike, ekonomike dhe financiare, sipas nenit 11 të këtyre rregullave; c) një studim fizibiliteti i zhvilluar plotësisht, duke përfshirë arsyetimin e vendimit për dhënien me koncesion/PPP."

Neni 11 i VKM-së së mësipërme, me titull "Propozimi i pakërkuar në formë të zhvilluar", parashikon se "Propozimi i pakërkuar, i paraqitur në këtë formë, përmban: a) përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore, kontekstin e zhvillimit dhe, nëse është e përshatshme, një panoramë të tregut; b) parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave; c) përshkrim të përgjithshëm të projektit; ç) përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti; d) bashkërendimin me politikat e investimeve të përgjithshme, sektoriale apo rajonale; dh) analizat teknike, sipas nenit 5 të këtyre rregullave; e) ndikimet mjedisore dhe sociale, sipas nenit 6, të këtyre rregullave; ë) analizat ekonomike dhe financiare, sipas nenit 7 të këtyre rregullave".

**Procedura e krijimit të komisionit të dhënies së koncesionit me objekt "Për dhënien me koncesion/ppp, ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese, Tiranë"**

6.Me shkresën nr. 5474 prot., datë 24.08.2016, Ministria e Mjedisit ju është drejtuar Bashkisë Tiranë, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Agjencisë së Trajtitit të Koncesioneve (ATRAKO), për caktimin e anëtarëve të komisionit të dhënies së koncesionit me objektin "Për dhënien me koncesion/ppp, ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese, Tiranë".

Gjykata gjen me vend të theksojë se në kohën kur Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit ka kërkuar caktimin e anëtarëve të Komisionit të dhënies së koncesionit, nuk ka patur ende një projekt konkret të dorëzuar nga shoqëritë "Energy Recuperator S.P.A", "Paul Eurth Italia S.P.A" Integrated Technology Services". Në lidhje me veprimet e Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit, për caktimin e anëtarëve të komisionit të koncesionit/PPP, rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e nenit 3 pika 3, të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar.

Neni 3 pika 3, të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar, parashikon se: Për

*shqyrtimin dhe dhënien e koncesionit/PPP, referuar nenit 18 të Ligjit, autoriteti kontraktues ngre komisionin e koncesionit/PPP, duke kërkuar caktimin e të paktën dy anëtarëve nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve. Kërkesa për caktimin e anëtarëve shoqërohet me një informacion të detajuar për projektin.*

6.1. Me datë 31.08.2016 shoqëria holandeze “Integrated Energy B.V”, e formuar nga bashkimi i tre shoqërive “Energy Recuperator S.P.A”, “Paul Ēurth Italia S.P.A”, “Integrated Technology Services” sh.p.k, i ka dërguar shkresë Ministrisë së Mjedisit dhe për dijeni Bashkisë Tiranë, ku vetëm liston dokumentet e kërkuara nga Ministria e Mjedisit me shkresën e datës 28.06.2016, pa dokumentacion shoqërues të kësaj shkrese.

6.2. Si anëtarë të Komisionit të mësipërm, nga Bashkia Tiranë, janë caktuar si anëtarë shtetasit Taulant Tusha, me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Publike dhe Namik Simixhiu, me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pastrimit të Mbetjeve Urbane; Nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), janë caktuar si anëtar specialistët shtetasit Erjon Murataj dhe Sidita Temali; Nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, nr.5349/1 prot., datë 01.09.2016, janë caktuar si anëtarë shtetasja Etleva Kondi, me Detyrë Drejtore e Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit.

6.3. Nga të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik i kompjuterit të sekuestruar të hetuarit Klodian Zoto, rezulton se nga shoqëria holandeze “Integrated Energy BV” nuk është nisur në rrugë zyrtare dokumentacioni i kërkuar nga Ministria e Mjedisit sipas shkresës së datës 28.06.2016. Ky dokumentacion është nisur nga shtetasi Klodian Zoto nëpërmjet adresave të email-it privat tek shtetaset Valbona Ballgjini dhe Alba Thoma. Rezulton se në datën kur është dërguar email-i, datë 02.09.2016, shtetasja Valbona Ballgjini ende nuk ishte emëruar nga Autoriteti Kontraktor në Komisionin e dhënies së koncesionit, të dhëna këto që njoftojnë se shtetasi Klodian Zoto ka qenë në dijeni të përbërjes së komisionit të dhënies së koncesionit, ende pa u shpallur zyrtarisht komisioni nga Autoriteti Kontraktor.

6.4. Me urdhrin nr.169, datë 05.09.2016, të Ministri i Mjedisit, Lefter Koka, është ngritur komisioni për dhënien me koncesion/ppp, me objekt: “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistuese, Tiranë”, përbërë nga shtatë persona, me kryetare shtetasen Valbona Ballgjini dhe anëtar shtetasit Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Sidita Temali, Etleva Kondi, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, të cilëve u janë ngarkuar detyrat përkatëse, në përmbajtje të urdhërit të mësipërm.

6.5. Gjykata eidenton se, nga të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik i kompjuterit të sekuestruar të hetuarit Klodian Zoto, rezulton se shtetaset Etleva Kondi dhe Valbona Ballgjini kanë patur komunikime me anë të korrespondencës elektronike me shtetasin Klodian Zoto, pronari i shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, të cilit i është dhënë konsulencë juridike për hapat e ndjekjes së procedurës së dhënies së koncesionit.

**Ndjekja e procedurave nga Komisioni i dhënies së koncesionit**

7. Komisioni i dhënies së koncesionit ka zhvilluar në vijim mbledhjet respektive, duke ndjekur të gjitha hapat proceduriale, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore, ku në përfundim, më datë 04.11.2016, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin nr.5, ku në këtë takim ka vendosur se studimi ekonomik i paraqitur nga shoqëria, i plotësonte elementet ligjorë që kërkon një studim ekonomik dhe social. Në këtë takim, komisioni ka vendosur që t’i propozojë Ministrisë së Mjedisit hartimin dhe fillimin e procedurave për dhënien e bonusit prej 8% të pikëve shoqërisë propozuese

“Integrated Energy B.V”. Komisioni do të vazhdonte punën për përfundimin e studimit të fizibilitetit dhe hartimin e draft-kontratës deri në akordimin e bonusit shoqërisë prej 8 pikësh, nga Këshilli i Ministrave.

7.1. Me shkresën kthim-përgjigje, nr. 3535/1 prot., datë 06.06.2023, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, është administruar një kopje e njësuar me origjinalin të të gjithë dokumentacionit të hartuar për dhënien e procedurës koncesionare. Nga dokumentacioni i dërguar nga Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, konstatohet se **nuk është mbajtur raporti përmbledhës i propozimit që duhet të bënte Komisioni i Dhënies së Koncesionit, për dhënien e bonusit prej 8 pikësh, shoqërisë propozuese “Integrated Energy BV”.**

Në bazë të VKM nr. 575, datë 10.7.2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, neni 3 me titull “Identifikimi i projekteve të mundshme të koncesionit/PPP”, pika 4 dhe 5 përcaktohet: “...4. Komisioni i koncesionit/PPP përgatit një raport përmbledhës i cili përqendrohet veçanërisht në aspekte të domosdoshmërisë e të përshtatshmërisë së idesë së projektit dhe merr parasysh një gamë të gjerë të alternativave të realizimit. Ai duhet të përmbajë të paktën: a) përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore apo të hapësirave të zhvillimit, kontekstin e përmirësimit dhe, nëse është e përshtatshme, një pasqyrë të tregut; b) parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave; c) përshkrimin e përgjithshëm të projektit; ç) legjislacionin që rregullon objektin e fushës së investimit; d) në rastin e një projekti që përfshin kryerjen e një funksioni institucional, natyrën e funksionit institucional në fjalë dhe masën në të cilën ky funksion institucional, si ligjërish, ashtu edhe nga natyra e tij, mund të kryhet nga një palë private; dh) në rastin e një projekti që përfshin përdorimin e pronës shtetërore, një përshkrim të pronës shtetërore në fjalë, përdorimet, nëse ka, subjekt i të cilave është aktualisht një pronë e tillë shtetërore, dhe një përshkrim të llojeve të përdorimit, në të cilat mund të përfshihet ligjërish një subjekt privat; e) përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti; ë) bashkërendimin me politikat e përgjithshme të investimeve sektoriale apo rajonale; f) skenarët teknikë dhe ekonomikë, me anë të të cilëve mund të arrihen objektivat e projektit; g) vlerësimet paraprake të kostos së projektit dhe të qëndrueshmërisë financiare; gj) analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike bazuar në informacionet në dispozicion; h) alternativat e alokimit të riskut financiar, teknike dhe operacionale ndërmjet palës publike dhe subjektit privat; i) konkluzionet e rekomandimet e zbatimit të mundshëm dhe rregullimet operacionale për projektin/projektet e mundshme, duke përfshirë modelet e zbatueshme/të përshtatshme të partneritetit publik privat; j) propozimin për dhënien e pikëve bonus në bazë të rezultateve teknike dhe financiare për propozimet e pakërkua.5. Autoriteti kontraktues, bazuar në raportin përmbledhës të hartuar nga komisioni i koncesionit/PPP, me vendim përcakton: shtyrjen ose refuzimin e plotë të zbatimit të projektit. Bazat për ndërprerjen mund të përbëhen nga provat thelbësore të mungesës së mundshme të fizibilitetit të projektit/alternativave që janë analizuar. Prova të tilla krijohen në bazë të krahasimeve paraprake të përfitimeve dhe kostove të përdoruesve, të informacionit për mungesën e fizibilitetit/përshtatshmërisë financiare apo të konkluzionit se objekti në përgjithësi nuk është i nevojshëm; vazhdimin e procedurave me përgatitjen e studimit të fizibilitetit; kthimin për plotësim të propozimit të pakërkuar, për shkak se nuk është paraqitur sipas formave të kërkuara në nenin 10 të këtyre rregullave. Në këtë rast, propozuesi ka afat 30 ditë nga data e kthimit të propozimit për ta plotësuar atë”.

**Neni 12 me titull “Raporti përmbledhës i propozimit të pakërkuar”, parashikon se:**  
“1. Komisioni i koncesionit/PPP harton raportin përmbledhës në të cilin verifikon plotësimin e kushteve të parashikuara në nenin 10 dhe se dokumentacioni i paraqitur është

i plotë e në përputhje me nenin 11 të këtyre rregullave. Në raport përcaktohet nëse: a) objektivat e projektit janë të përcaktuar qartë dhe të arritshëm; b) objektivat e projektit i shërbejnë interesit publik dhe përshtaten brenda prioriteteve strategjike të autoritetit kontraktues; c) nuk ka pengesa ligjore ose kufizime për zbatimin e projektit dhe/ose për të hyrë në një kontratë koncesioni/PPP; ç) projekti mund të zbatohet siç është planifikuar, duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa rreziqe të paarsyeshme teknike; d) projekti duket të ketë qëndrueshmëri ekonomike; dh) projekti duket të jetë në gjendje të tërheqë garantuesit/mbështetësit financiarë, duke siguruar kthimin e arsyeshëm financiar; e) niveli i propozuar i alokimit të riskut nga subjektet e sektorit publik dhe privat është racional dhe i arsyeshëm; ë) mbështetja e duhur financiare mund të përshtatet brenda buxhetit të kufizuar dhe detyrimeve të tjera fiskale;

2. Gjatë periudhës së përgatitjes së raportit përmbledhës, autoriteti kontraktues mund të kërkojë informacione shtesë nga propozuesi.

3. Bazuar në raportin përmbledhës, autoriteti kontraktues vendos:

të kthejë për plotësim propozimin e pakërkuar, për shkak se nuk është paraqitur sipas formave të kërkuara në nenin 10 të këtyre rregullave. Në këtë rast, propozuesi ka afat 30 ditë nga data e kthimit të propozimit për të plotësuar atë. të pranojë propozimin dhe të vazhdojë hartimin e studimit të fizibilitetit; të refuzojë propozimin dhe të heqë dorë nga zbatimi i projektit. Bazat për ndërprerjen mund të përbëhen nga provat thelbësore të mungesës së mundshme të fizibilitetit të projektit/alternativave që janë analizuar. Prova të tilla krijohen në bazë të krahasimeve paraprake të përfitimeve dhe kostove të përdoruesve, të informacionit për mungesën e fizibilitetit/përshtatshmërisë financiare apo të konkluzionit se objekti në përgjithësi nuk është i nevojshëm. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura autoriteti kontraktues i komunikon me shkrim propozuesit vendimin e marrë.”

**Neni 15 me titull “Dhënia e bonusit”, pika 1 parashikon se se:**

“1. Në rast pranimi të një propozimi të pakërkuar, propozuesit i jepet një bonus për rezultatin tekniko-financiar të arritur gjatë procedurës konkurruese deri në një maksimum prej 10% të pikëve totale të garës.”

7.2. Nga të dhënat e përftuara më sipër, gjykata vlerëson se anëtarët e Komisionit të dhënies së koncesionit, të cilët kanë propozuar dhënien e bonusit, nuk kanë hartuar një raport përmbledhës, si dhe nga ana e zyrtarëve të Autoritetit Kontraktor, Ministri i Mjedisit, shtetasi Lefter Koka, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, shtetasi Alqi Billako dhe Drejtoresha Juridike e Ministrisë së Mjedisit, shtetasja Alba Thoma, të cilët kanë përgatitur dhe dërguar projektvendimin për dhënien e bonusit në Këshillin e Ministrave, janë kryer veprime në kundërshtim me ligjin nr.125/2103 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, neni 25 si dhe në kundërshtim me VKM nr. 575, datë 10.07.2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, e ndryshuar, pasi referuar këtyre parashikimeve ligjore dhe nënligjore, bonusi jepet nëse është pranuar propozimi i pa kërkuar, dhe propozimi i pa kërkuar pranohet në bazë të raportit përmbledhës që përgatit komisioni i dhënies së koncesionit. Pra, rezulton se komisioni i dhënies së koncesionit, ende nuk kishte sqaruar kostot e projektit, në datën 04.11.2016, kur është bërë propozimi për dhënien e bonusit, pasi në datë 23.11.2016 ka vendosur që t’i kërkojë informacion shtesë shoqërisë propozuese. Gjithashtu, Komisioni, ende nuk kishte sqaruar statusin juridik të tokës, ku do të ndërtohej objekti, në kohën kur është bërë propozimi për dhënien e bonusit.

7.3. Po kështu, nga të dhënat e përftuara nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik i kompjuterit të sekuestruar të hetuarit Klodian Zoto, rezulton shtetasja Alba Thoma, me

funkcionin e Drejtoreshës së Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Mjedisit bashkërendonte punën me shtetasin Klodian Zoto, përsa i përket kthimit të përgjigjeve të Ministrisë së Mjedisit në lidhje me kërkesat për plotësimin e kërkesave të duhura në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit.

7.4. Nga korrespondenca midis Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Financave, rezulton se Ministria e Mjedisit është informuar nga Bashkia Tiranë përpara se të depozitohet propozimi i pakërkuar nga shoqëria, që Bashkia Tiranë së bashku me IFC-në kanë identifikuar një projekt me interes në lidhje me përmirësimin e shërbimit dhe trajtimin të mbetjeve në qytetin e Tiranës dhe për mundësinë e përfshirjes së sektorit privat nëpërmjet Partneritetit Publik Privat. Gjithashtu, nuk rezulton se Ministria e Mjedisit të ketë kryer ndonjë studim tregu mbi koston e kontraktimit të një shoqërie për të kryer identifikimin e projektit, dhe aq më tepër që vlera të shkonte rreth 3,000,000 Euro.

### Studimi i fizibilitetit

8. Në vijim të procedurave Komisioni i dhënies së koncesionit ka hartuar studimin e fizibilitetit, i cili është ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit ku është pasqyruar mënyra e llogaritjes së tarifës prej 29 Euro/ton, që duhet të paguajnë Njësitë e Qeverisjes Vendore për depozitim dhe mbetjeve në vlerën, por pasqyrimi i mënyrës së llogaritjes së tarifës mungon në studimin e fizibilitetit, që i është bashkëlidhur kontratës së lidhur midis Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit, dhe shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV".

8.1. Nga të dhënat e pasqyruara në studimin e fizibilitetit që është hartuar nga Komisioni i dhënies së koncesionit, i cili sqaron mënyrën e llogaritjes së tarifës, vërehen pasaktësi, si dhe kostot dhe të ardhurat e llogaritura nuk pasqyrojnë realitetin, të konstatuara si më poshtë:

- Vlera e mjeteve të transportit në momentin që është përdorur për të llogaritur koston e ndërtimit është shënuar në vlerën prej 750,000 Euro, ndërsa kur është llogaritur tarifa, vlera e mjeteve të transportit është vendosur 3,750,000 Euro. Kjo ka mbivlerësuar koston e ndërtimit në vlerën prej 3,000,000 Euro dhe ky mbivlerësim ka ndikuar në rritjen e tarifës që është përcaktuar për t'u paguar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

- Studimi i fizibilitetit i hartuar nga Komisioni i dhënies së koncesionit ka vendosur koston për ndërtimin e objekteve, të cilat nuk i sqaron sesi i ka vlerësuar, pra nuk shpjegon në mënyrë të detajuar zërat e punimeve që do të kryhen, sasisë e punimeve për çdo zë, matjet e kryera për të përcaktuar sasisë e punimeve për secilin zë, si edhe çmimet e përdorura për çdo zë të punimeve, pajisjet, komponentët përbërës të pajisjeve me çmimet përkatëse, si edhe ku janë marrë referencat e çmimeve për çdo komponentë.

8.2. Rezulton se në kontratën koncesionare, të datës 31.08.2017, lidhur midis shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV S.P.V" sh.p.k, dhe Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit, i është dhënë e drejta shoqërisë koncesionare që të kërkojë ndërtimin e veprave plotësuese, të cilat nuk janë pjesë e projektit aktual, por që në pikën 10.5.2 të kontratës është përcaktuar se vlera e investimit në varësi të optimizimit të projektit, koncesionari mund të përfshijë brenda të njëjtës vlerë investimi edhe koston në lidhje me veprat plotësuese. Pra, është shtuar vlera e objekteve të përcaktuara në projekt, për sa kohë këto vlera do t'i lejojnë mundësinë shoqërisë koncesionare që përveç ndërtimit të objekteve të përcaktuara në projekt, të ndërtohen edhe objekte të tjera (vepra plotësuese).

**8.2.1. Komisioni nuk ka argumentuar sesi i ka gjetur vlerat referuese për të përcaktuar kostot e operimit dhe mirëmbajtjes për funksionimin e impiantit (kostot e operimit të landfillit). Gjithashtu, rezulton se janë dhënë vlerësime në lidhje me shpenzimet për operimin dhe mirëmbajtjen për funksionimin e impiantit, ndërsa në tabelën e të dhënave të përgjithshme të landfillit, janë shtuar zëra të tjerë të kostove, duke ndikuar në rritjen e tarifës që është përcaktuar për t'u paguar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.**

**Këto kosto janë vlerësuar si më poshtë:**

**-Shpenzimet e pagave për rreth 27 të punësuar në vlerën 408,000 Euro në vitin e dytë, dhe rritje graduale deri në vitin e shtatë me 130 të punësuar me kosto totale 846,000 Euro. Për këtë zë kostoje është kontradiktor fakti që për 27 punonjës është vlerësuar që shpërblimi duhet të jetë në masën 408,000 euro, ndërsa kur numri i punonjësve rritet me 4.81 herë shpërblimi rritet me 2.07 herë. Gjithashtu, gjatë vitit të dytë të punës, bazuar në grafikun e punimeve dhe në studimin e fizibilitetit, do të jetë mbyllur landfilli ekzistues, do të jetë ndërtuar landfilli i ri, do të jetë ndërtuar impianti i riciklimit dhe stabilizimit, do të jetë ndërtuar linja e parë e termovalorizatorit, pra pothuajse që të gjitha aktivitetet që do të kryhen gjatë 30 viteve të koncesionit do të fillojnë që gjatë vitit të dytë, pra fuqia punëtore që i duhet koncesionarit gjatë vitit të dytë nuk do të duhet të ndryshonte shumë me fuqinë punëtore që do t'i duhej koncesionarit gjatë vitit të shtatë e në vazhdim, kjo sepse ndërtimi i linjave të mbetura të termovalorizatorëve nuk do të kërkojë 103 punonjës shtesë, pasi mbetet që do të dërgohen në këto linja e kanë përfunduar procesin e selektimit dhe vetëm do të transportohen me kamion në pikën e grumbullit të termovalorizatorëve dhe nga aty nëpërmjet një vinçi do të furnizohet furra e termovalorizatorëve;**

**-Shpenzime për materiale të konsumit, të cilat përbëhen nga substancat kimike që përdoren në impiant dhe materiale ndihmëse, me kosto 360,000 Euro për secilën linjë të termovalorizatorëve. Komisioni nuk ka shpjeguar konkretisht se çfarë janë këto materiale, sasia e tyre që duhet të përdoren për çdo ton mbetje që të digjet në termovalorizator, si edhe çmimi për sasi i këtyre materialeve;**

**-Kosto mirëmbajtje impiantesh (termovalorizatorësh) në vlerën 320,000 euro në vit për impiant. Komisioni nuk shpjegon se cili nga komponentët e impiantit do të ndërtohet, shpeshësinë e ndërrimit të tyre, si edhe mënyrën sesi ka konkluduar që vlera e këtyre është 320,000 Euro;**

**-Kosto e operimit të venddepozitimeve në vlerën 12.5 euro për ton. Komisioni nuk ka shpjeguar se çfarë përfshihet në këtë zë kostoje. Përfshirja e këtij zëri duket sikur dublon kostot, pasi kosto e operimit të landfillit përbëhen nga kosto e punonjësve, kosto e mirëmbajtjes impiantesh (termovalorizatorësh), kosto mirëmbajtje dhe operimi mjeteve kosto këto të llogaritur në mënyrë të veçantë;**

**-Kosto e mirëmbajtjes dhe operimit të flotës operative në vlerën 900,000 Euro në vitin e parë dhe 1,300,000 Euro në kapacitet të plotë. Komisioni nuk ka treguar komponentët e mjeteve që kanë nevojë për mirëmbajtje dhe kostot përkatëse të tyre (kontradiktor është fakti që vlera e mjeteve të transportit është 750,000 Euro), gjithashtu nuk ka treguar se çfarë përfshihet në kostot e operimit të flotës dhe mënyrën sesi e ka vlerësuar këtë kosto.**

**-Komisioni i dhënies së koncesionit kur ka llogaritur tarifën për depozitimin e mbetjeve, përveç kostove të operimit të mësipërme, ka shtuar vlera shpenzimesh, për të cilat nuk është**

shprehur më herët në studimin e fizibilitetit (këto në tabelën e llogaritjes së tarifës janë në rubrikën e kostove të operimit të landfillit, por në faqet 93-94 të studimit të fizibilitetit ku janë listuar kostot e operimit të landfillit, këto shpenzime nuk janë përshifër). Shpenzimet që janë shtuar në momentin e llogaritjes së tarifës janë në vlerën 61.179,232 Euro dhe janë të përbëra nga shpenzimet për konsulencë në vlerën 2.115,000 Euro, shpenzime telekomunikacioni, në vlerën 507,600 Euro dhe shpenzime të tjera administrative, në vlerën 58.556.632 Euro.

**-Përfitimi i shoqërisë për ton mbetje të depozituar** është shënuar në vlerën 2.9 Euro/ton, e përlllogaritur kjo vlerë për sasinë e parashikuar për 30 vite, prej 8.364,340 ton mbetje, që sipas këtyre të dhënave do të konsistonte në vlerën  $2.9 * 8,364,340 = 24,256,586$  Euro. Këto të dhëna bien ndesh me të dhënat ku në të njëjtën tabelë përfitimi i shoqërisë koncesionare është shënuar 120,948,356 Euro.

**8.2.3. Për këtë fakt, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer Raport Auditimin e përputhshmërisë tek 'Drejtoria e Koncesioneve-Ministria e Financave dhe Ekonomisë', në vitin 2019, përcjellë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me shkresën nr.1017/1 prot. datë 21.11.2023, në të cilin janë konstatuar shkeljet respektive.**

**8.2.4. Sipas argumentimit të bërë në studimin e fizibilitetit konstatohet se:**

**-Shpenzimet e pagave** për rreth 27 të punësuar në vitin e dytë të funksionimit në një kosto prej 408 mijë euro dhe rritja gradualisht në përputhje me rritjen e numrit të të punësuarve dhe të ndërtimit të centraleve të reja që rezultojnë nga viti i shtatë tutje me 130 të punësuar efektive dhe kosto totale prej 846 mijë euro.

**-Shpenzimet e materialeve të konsumit** të cilat përbëhen nga substancat kimike që përdoren në impiant dhe materiale ndihmëse. Këto kanë një kosto prej 360 mijë euro në vit, kur një linjë e vetme do të jetë në veprim, 714 mijë euro kur dy linja do të jenë në veprim, 1.068 mijë euro gjatë periudhës kur tre linja do të jenë në veprim dhe 1.4 milionë euro gjatë operacionit të katër linjave.

**-Shpenzimet e mirëmbajtjes së impianteve** janë parashikuar të jenë rreth 320 mijë euro në vit, kur një linjë e vetme do të jetë në veprim, 640 mijë euro kur dy linja do të jenë në veprim, 960 mijë euro kur tre linja do të jenë në veprim dhe 1.3 milion euro gjatë funksionimit të katër linjave.

**-Kostot e operimit të venddepozitimeve** vlerësohen në 12.5 euro për ton dhe të përmbledhura në 993 mijë euro në vitin e parë në rritje deri në 3.65 milionë, në vitin e shtatë e në vazhdim, kur ky projekt është me kapacitet të plotë.

**-Kostot e mirëmbajtjes dhe operimit të flotës operative** (të vincave, kamjonve, kompaktatorve, ngarkuesve, ekskavatorëve, boteve etj) do të ketë një kosto vjetore prej 0.9 milionë euro në vitin e parë dhe 1.3 milion euro në kapacitet të plotë, duke përfshirë përdorimin e tyre.

**8.2.5. Nga auditimi konstatohet se nuk ka argumentim në studimin e fizibilitetit në lidhje me kostot e konsulencës (2,115,000 euro), telekomunikacionit (507,600 euro) dhe mbi të gjitha të shpenzimeve të tjera administrative, të cilat janë paraqitur në vlerën (58,556,632 euro). Përfshirja e kostove administrative në masën 20% të vlerës totale të**

kostove të operimit të paargumentuara dhe të pambështetura paraqet dyshime në lidhje me fluksin dalës të projektuar për to me ndikim të drejtpërdrejtë në vërtetësinë e llogaritjeve të kryera për përcaktimin e tarifës së ofrimit të shërbimit. Mbi bazën e fluksit të investimeve të kërkuara, fluksit të shpenzimeve operative të kërkuara dhe flukseve të tjera hyrëse është kryer analiza për përcaktimin e tarifës për njësi të ofrimit të shërbimit që përfshin ky projekt.

8.2.6. Nga auditimi konstatohet se treguesit e përdorur për përcaktimin e kostos për njësi janë llogaritur duke mos marrë parasysh vlerën në kohë të parasë, duke qenë se fluksat dalëse nga investimet dhe fluksat dalëse nga operimi i përkasin në vlera të ndryshme viteve të ndryshme. Nga ana tjetër, edhe për fluksat hyrëse në lidhje me shitjen e energjisë si pasojë e energjisë së prodhuar nga impianti apo nga shitja e skrapit, nuk ka një projektion në lidhje me realizueshmërinë e tyre në çdo vit. Nxjerrja e tarifës për njësi të shërbimit mbi bazën e këtyre supozimeve të munguara vendos në dyshim nevojën reale për mbështetjen e projektit në atë vlerë të projektuar nga njësitë e vetqeverisjes vendore. Përtej problemeve metodologjike me impakt direkt në tarifën e ofrimit të shërbimit, pasaktësi konstatohen edhe në llogaritjen e kostos për njësi dhe përfitimit për njësi të shoqërisë. Këto vlera janë transformuar dhe nuk i përgjigjen llogaritjeve matematikore, ku përfitimi i shoqërisë nga projekti llogaritet në masën 2.9 euro/njësi, ndërkohë që realisht ai rezulton në shumën 14.46 euro/njësi.

8.2.7. Nga të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik i kompjuterit të sekuestruar të hetuarit Klodian Zoto, rezulton se shoqëria propozuese holandeze "Integrated Energy BV" si fillim ka pasur një plan biznesi, ku të ardhurat që do të gjeneronte shoqëria nga shitja e energjisë do të ishin 22.81 Euro/ton, dhe të ardhurat që do të përfitonte nga shitja e skrapit do të ishin 13,77 Euro/ton. Në ndryshim nga këto vlera, komisioni në studimin e fizibilitetit që ka përgatitur, ka vlerësuar se të ardhurat që do të realizohen nga shitja e energjisë janë 15.97 Euro/ton, dhe të ardhurat që do të realizohen nga shitja e skrapit janë në vlerën 9.37 Euro/ton. Nga të dhënat e marra nga email-i, rezulton se pasi shtetasi Erton Kaleshi ka bërë përlllogaritjet, ka konstatuar se nëse shoqëria do të fiksonte tarifën në vlerën 29 Euro/ton, atëherë e ardhura që do të përfitonte do të ishte e 14.46 Euro/ton, dhe ka sugjeruar që të ulin çmimin e shitjes së energjisë dhe skrapit në mënyrë që të ulej në mënyrë fiktive përfitimi i shoqërisë. Këto sugjerime ia ka nisur shtetasve Klodian Zoto, Mirel Mërtiri dhe Sevi Zani. Më pas shtetasi Erton Kaleshi ka bërë përlllogaritje të reja dhe ia ka nisur përsëri shtetasve Klodian Zoto, Mirel Mërtiri dhe Sevi Zani. Shtetasi Klodian Zoto më pas këto përlllogaritje të reja ia ka nisur shtetasve Alba Thoma, nëpërmjet së cilës këto të dhëna janë dërguar tek Komisioni i dhënies së koncesionit, i cili i ka përfshirë në studimin e fizibilitetit pa kryer verifikime. Ulja në mënyrë fiktive e vlerave të të ardhurave të pritura, për t'u gjeneruar nga shitja e energjisë dhe e skrapit, ka ndikim negativ në buxhetin e shtetit, pasi nëse fitimi i shoqërisë do të ishte në nivelin prej 2.9 Euro/ton (aq sa është në studimin e fizibilitetit) dhe të ardhurat e pritura nga shitja e energjisë dhe e skrapit nuk do të ndryshonin në mënyrë fiktive, atëherë vlera e tarifës do të duhej të ishte 17.81 Euro/ton ( $51.13 + 2.9 - 22.81 - 13.77 = 17.81$ ).

8.2.8. Gjykata, nga të dhënat e përfuara mësipër, vlerëson se Komisioni i dhënies së koncesionit i ka marrë kostot nga studimi i fizibilitetit të shoqërisë propozuese "Integrated Energy BV" pa kryer asnjë verifikim në lidhje me vërtetësinë e tyre, si dhe rezultojnë të dhëna se vlerat e vendosura kanë rritur fiktivisht tarifën e depozitimit të

mbetjeve nga Njësitë e Qeverisjeve Vendore. Anëtarët e komisionit të dhënies koncesionit kanë vepruar në kundërshtim me VKM nr. 575, datë 10.07.2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar, e cila në nenin 13, pika 3, me titull "Detajimi i studimit të fizibilitetit" të VKM nr. 575, datë 10.07.2013. përcakton se: "1. Para marrjes së vendimit për investime, komisioni i koncesionit/PPP13 harton një studim fizibiliteti, në përputhje me këto rregulla; 2. Komisioni i koncesionit/PPP mund të përdorë të gjitha ose një pjesë të informacionit të propozimit të pakërkuar për të hartuar studimin e fizibilitetit; 3. Pavarësisht se sa i detajuar është propozimi, autoriteti kontraktues verifikon me kujdes të gjitha hipotezat, supozimet, zgjidhjet, treguesit, analizat dhe rezultatet, në mënyrë që të përcaktojë nëse informacioni është i saktë, i zbatueshëm dhe i përshtatshëm për kontekstin e analizës."

8.2.9. Në studimin e fizibilitetit të përgatitur nga Komisioni i dhënies së koncesionit, nuk janë marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat reale që do të përfitonte shoqëria koncesionare. Këto të ardhura, të cilat nuk janë përfshirë, ndikojnë negativisht në buxhetin e shtetit, pasi nëse do të ishin llogaritur, atëherë vlera e tarifës që do të duhej të paguanin Njësitë e Qeverisjes Vendore do të ishte më e ulët. Pra, Komisioni i dhënies së Koncesionit ka vepruar në kundërshtim me nenin 19 të ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", "Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat", si dhe në kundërshtim me nenet 7 dhe 13 të VKM-së nr.575/2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat" i ndryshuar. Llogaritja e tarifës është nxjerrë nga Komisioni si rezultat i diferencës së shumës së kostove të llogaritura, fitimit të synuar të shoqërisë koncesionare me të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë edhe të ardhurave të realizuara nga shitja e skrapit. Diferenca është pjesëtuar me sasinë e mbetjeve të parashikuara që do të depozitohen për periudhën 30 vjeçare nga Njësitë e Qeverisjeve Vendore. Nga kjo analizë komisioni ka konkluduar që tarifa është në vlerën prej 29.05 Euro/ton. Nga aktet e administruara rezulton se vlera e tarifës është përcaktuar përpara se të ndërtohej plan buxheti. Pra vlera prej 29 Euro/ton është e synuar nga shoqëria koncesionare, dhe kostot e vendosura në studimin e fizibiliteti nga shoqëria koncesionare, nuk janë reale, por janë përshtatur për të arritur në këtë vlerë. Komisioni i dhënies së koncesionit nga ana e tij ka përfshirë të dhëna të kostos në studimin e fizibilitetit, vërtetësinë e të cilave nuk e ka verifikuar, si edhe vlerat që ka marrë për llogaritjen e tarifës, kanë dukshëm mospërputhje.

8.2.10. Komisioni i dhënies së koncesionit ka anashkaluar përfshirjen e të ardhurave që do të përfitojë shoqëria koncesionare nga palët e treta për depozitimin e mbetjeve inerte, duke i shkaktuar dëm të drejtpërdrejtë buxhetit të shtetit. Nga pëllogaritjet e kryera për periudhën nga krijimi i shoqërisë koncesionare deri në datën 28.02.2021, rezulton se shoqëria koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k ka realizuar të ardhura nga shitjet në vlerën 6,063,327,392 lekë, ku kjo vlerë përbëhet nga shitjet që i ka faturuar Bashkisë Tiranë në vlerën 3,667,778,422 lekë, dhe shitjet që i ka faturuar palëve të treta, në vlerën 2,395,548,970 lekë. Nëse do të ishin përllogaritur të ardhurat që shoqëria koncesionare do të përfitonte nga palët e treta, si zë të ardhurash në studimin e fizibilitetit, atëherë do të ishte ulur pjesa e mbulimit që do të kryhej nga shteti. Nga aktet e administruar rezulton se në studimin e fizibilitetit, Komisioni i dhënies së koncesionit ka patur mundësitë që të parashikonte si zë të ardhurash, të ardhurat që do të përfitonte shoqëria koncesionare nga depozitimi i mbetjeve inerte nga personat e tretë, pasi në studimin e fizibilitetit është parashikuar që koncesionari do të ndërtojë landfill për mbetjet inerte (LOT G dhe LOT H), si dhe Komisioni e ka përfshirë si bazë ligjore VKM nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", e

cila synon të disiplinojë procesin e grumbullimit, transportit, dorëzimit dhe trajtimit të mbetjeve inerte në fushën e ndërtimit, duke përcaktuar rregullat dhe kërkesat konkrete për subjektet që operojnë në këtë fushë.

Në ligjin nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", në nenin 19, me titull "Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat", pika 2 dhe 3, përcaktohet se:"...2. Studimi i fizibilitetit përmban, në mënyrë të veçantë: a) përmbledhjen operacionale dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit; b) analizat teknike, financiare, ekonomike dhe ligjore; c) studimet mjedisore dhe implikimet në natyrë; ç) anekset shoqëruese, shtesat e kërkuara, konkluzionet dhe rekomandimet; 3. Në studimin e fizibilitetit merren parasysh në veçanti interesi publik, ndikimi në mjedis dhe mbrojtja e mjedisit, qëndrueshmëria, përshtatshmëria financiare e projektit, treguesit e vlerës së parasë, harmonizimi i projektit me objektivat kombëtarë dhe sektorialë strategjikë, risqet direkte dhe indirekte financiare dhe ndikimet në buxhetin qendror dhe në atë të qeverisjes vendore, mbështetja e nevojshme financiare, realizueshmëria teknike dhe tregtare, si dhe interesi i tregut dhe aftësia për të tërhequr operatorët e interesuar ekonomikë dhe mbështetësit financiarë."

Në bazë të VKM nr. 575/2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion,partneritet publik privat", të ndryshuar, në nenin 4, me titull "Studimi i fizibilitetit", pika 1, përcaktohet se:"1. Autoriteti kontraktues harton studimin e fizibilitetit përpara se të ndërmerret angazhim për realizimin e projektit. Studimi i fizibilitetit siguron shqyrtimin dhe vlerësimin e aspekteve teknike, ekonomike dhe tregtare të një projekti të propozuar, të cilat do të jenë baza për vendimin e investimit."

Në neni 7 të saj, me titull "Analiza ekonomike dhe financiare", pika 2 dhe 7, përcaktohet se:"...2. Studimi i fizibilitetit shpreh një vlerësim të investimit në total, kostot operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe çdo të ardhur që pritet të krijohet, në të gjithë kohëzgjatjen e projektit...7. Të ardhurat e projektit përfitohen nga: a) përdoruesit fundorë që paguajnë për shërbimin apo për një pjesë të tij; dhe/ose b) përdorimi i aseteve të institucionit."

8.2.11.Me datë 12.04.2017, Komisioni i dhënies së koncesionit ka mbajtur procesverbalin e mbledhjes nr .8, në të cilën është diskutuar mbi procesin e marrjes së dakortësisë së Bashkisë Tiranë për vazhdimin e procedurave të projektit në fjalë, referuar studimit të fizibilitetit, si dhe miratimin përkatës nga Ministria e Financave. Në këtë mbledhje është finalizuar studimi i fizibilitetit, i cili është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Po ashtu, në këtë mbledhje është diskutuar në lidhje me hartimin e Dokumentave Standarte të Koncesionit. Komisioni ka lënë si mbledhje të radhës, parimisht datën 14.04.2017, si dhe deri atëherë, do të procedonte me përfundimin e punës për hartimin e Dokumenteve Standarte të Koncesionit me miratimin përkatës.

**Dokumentacioni i procedurës "Dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistues Tiranë"**

9.Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së të dhënave nga sistemi i prokurimit elektronik, datë 24.04.2023, rezulton se dokumentet e procedurës me emërtimin "Dhënia me koncesion e ndërtimit të landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzistues Tiranë", ku përfshihen edhe Dokumentet Standarte të procedurës përzgjedhëse konkurruese "Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe reabilitim i vend depozitimeve ekzistuese Tiranë", janë ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik në datën 19.04.2017 nga përdoruesi "valbona ballgjini". Gjithashtu, rezulton se në këto dokumente kanë lënë gjurmë kompjuterat që mbajnë emrin "Denisa Tollkuci" dhe "bledar.karoli". Në këto rrethana rezulton se Dokumentet Standarte të procedurës së koncesionit janë

hartuar nga punonjësit e shtetasit Klodian Zoto, i cili jua ka dërguar më pas punonjësve të Ministrisë së Mjedisit, shtetasve Alba Thoma dhe Bledar Karoli. Në këtë kohë këto dy shtetas kanë shërbyer si “urë lidhëse” ndërmjet Komisionit të dhënies së koncesionit, Autoritetit Kontraktor, Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto. Më pas shtetasi Bledar Karoli këto dokumente i ka nisur në drejtim të përfaqësuesve të shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, pjesëmarrëse në këtë procedurë koncesioni si aksioner i shoqërisë holandeze “Integrated Energy BV”. Pasi janë bërë komentet nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, mbi Dokumentet Standarte të procedurës, është bërë ngarkimi i dokumenteve në sistemin e prokurimit elektronik nga shtetasja Valbona Ballgjini, Kryetare e Komisionit të dhënies së koncesionit, njëkohësisht me detyrë Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Mjedisit.

9.1. Nga aktet e administruara rezulton se në kohën që janë ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Dokumentet Standarte të Koncesionit, nuk rezultojnë të jenë hartuar dhe miratuar nga anëtarët e komisionit, pasi rezulton se nga ana e komisionit nuk është mbajtur mbledhje për hartimin e Dokumentave Standarte të Koncesionit, si dhe nuk është mbajtur procesverbal për hartimin e Dokumenteve Standarte të Koncesionit, por rezulton se procesverbali i mbledhjes së radhës ka qenë për hapjen e ofertave.

9.2. Gjykata, në rrethanat e mësipërme, vlerëson se anëtarët e Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasit Valbona Ballgjini, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Sidita Temali, Etleva Kondi, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, kanë vepruar në kundërshtim me pikën 5/a të nenit 18 të Ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, si edhe pikës 2 të nenit 24 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion,partneritet publik privat”, i ndryshuar.

Në pikën 5/a të nenit 18 të ligjit nr. 125/2013, i ndryshuar, përcaktohet se: “...5. Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat kryen detyrat e mëposhtme: a) Harton studimin e fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik privat, përcakton procedurën e zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe harton dokumentacionin e tenderit”.

Në pikën 2 të nenit 24 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013, e ndryshuar, përcaktohet se: “...2. Komisioni i koncesionit/PPP harton dokumentet e tenderit në përputhje me setin e dokumenteve standarde të procedurës së koncesionit/PPP dhe dispozitave përkatëse të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat.”

9.3. Ndërsa shtetasit Alba Thoma dhe Bledar Karoli, njëkohësisht pjesë e Sekretariatit Teknik, sipas Urdhrit të Ministrit të Mjedisit, rezultojnë se gjatë fazës së ndjekjes së procedurës së dhënies së koncesionit, kanë mbajtur lidhje me përfaqësues të shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, shtetasit Klodian Zoto dhe Denisa Tollkuci, duke ju siguruar informacionin e duhur këtyre shtetasve, si dhe duke marrë sugjerime nga ato në lidhje me specifikimet teknike dhe Setin e Dokumenteve Standarte të Koncesionit, kanë shërbyer si persona ndërlidhës mes anëtarëve të Komisionit të dhënies së koncesionit dhe shtetasve Klodian Zoto dhe Denisa Tollkuci, në lidhje me përcaktimin e Dokumenteve Standarte të Tenderit nga ana e Komisionit.

9.4. Po kështu nga të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik i kompjuterit të sekuestruar të hetuarit Klodian Zoto, rezulton se këto dokumente kanë të bëjnë me formën juridike që do të kishte shoqëria fituese e koncesionit, dhe për këtë shtetasi nën hetim Klodian Zoto ka marrë konsulencë juridike nga anëtarja e

Komisionit të dhënies së Koncesionit, shtetasja Etleva Kondi dhe nga studioja ligjore e shtetasit Floran Pustina, të cilët e këshillojnë që fituesi i koncesionit të mos paraqitet si “Bashkim operatorësh”, pasi mund të sillte probleme ligjore në të ardhmen.

#### Shpallja e shoqërisë fituese

10.Me shkresën me nr.6488 prot, datë 24.08.2017, Ministria e Mjedisit ka dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), “Formularin e njoftimit të fituesit”.

11.Me shkresën nr.25 prot., datë 25.08.2017, shoqëria propozuese “Integrated Energy BV” ka dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Dokumentacionin Standart të procedurës koncesionare për Inceneratorin e Tiranës, shkresë kjo, e protokolluar në Ministrinë e Mjedisit me datë 28.08.2017.

12.Pas kryerjes së procedurave vijuese ligjore, në datë 31.8.2017 është lidhur kontrata ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë propozuese “Integrated Energy B.V”, me nr 6597 prot, si dhe është bërë formulari i sigurimit të kontratës tek shoqëritë e sigurimit nga shoqëria koncesionare.

13.Në funksion të hetimeve, nga ana e organit procedues janë pyetur si deklarues, shtetasit Valbona Ballgjini, Etleva Kondi, Pëllumb Abeshi, Sidita Temali, Namik Simixhiu dhe Taulant Tusha (anëtarë të komisionit) në lidhje me mënyrën se si i ishte vendosur në dispozicion dokumentacioni që ka dorëzuar shoqëria propozuese “Integrated Energy BV”, si propozim i pakërkuar në Ministrinë e Mjedisit dhe lidhur me hartimin e studimit të fizibilitetit që ka bërë Komisioni dhe se si janë nxjerrë të dhënat që ai përmban dhe nga krahasimi i të të dhënave që njoftojnë këta deklarues, në raport me aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit paraprak, rezulton se: Në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit me objekt: “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i vend depozitimeve ekzituese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike”, shoqëria propozuese “Integrated Energy BV”, në përbërje të së cilës është aksionere edhe shoqëria e shtetasit Klodian Zoto “Integrated Technology Services” sh.p.k, ka qenë e paracaktuar që të shpallej fituese e procedurës koncesionare, pasi kjo shoqëri ka qenë në dijeni të rrethanave konkurruese para se të shpallej procedura. Funkionarët e Ministrisë së Mjedisit, shtetasi Lefter Koka, ish Ministri i Mjedisit, shtetasi Alqi Bllako, Sekretari i Përgjithshëm, shtetasja Alba Thoma, Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike, shtetasi Bledar Karoli, Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, si dhe nga anëtarët e Komisionit të dhënies së koncesionit, shtetasit Valbona Ballgjini, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Sidita Temali, Etleva Kondi, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, e kanë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm që duhej të dorëzonte në Ministrinë e Mjedisit para dhe gjatë procedurës koncesionare, me qëllim shpalljen fituese të kësaj shoqërie.

13.1.Për sa më sipër u trajtua, gjykata vlerëson se shtetasit nën hetim Lefter Koka, Alba Thoma, Bledar Karoli, Valbona Ballgjini, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Sidita Temali, Etleva Kondi, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, me veprimet dhe mosveprimet e kundraligjshme të kryera para dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës koncesionare, dyshohet se kanë kryer veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 të Kodit Penal.

14. Lidhur me të hetuarin Alqi Bllako, nga të dhënat e përftuara nga akti i ekspertimit teknik kompjuterik i kompjuterit të sekuestruar të hetuarit Klodian Zoto, e konkretisht korrespondencës elektronike nepërmjet e-mailit të këtij shtetasi, dyshohet se i hetuari Alqi Bllako, ka kërkuar dhe përftuar në mënyrë të parregullt nga shtetasit Klodian Zoto

dhe Mirel Mërtiri, vlerën monetare prej 119,755 Euro, me qëllim favorizimin gjatë procedurës së dhënies së koncesionit, shoqërinë koncesionare “Integrated Energy BV”, në përbërje të së cilës ka qënë aksionere edhe shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services” sh.p.k. Këtë përfitim të parregullt shtetasi Alqi Bllako e ka siguruar në mënyrë të tërthortë nga shtetasi Klodian Zoto nëpërmjet pagesës për pajisje “Makineri për mbushjen, mbylljen, vulosjen apo etiketimin e shisheve, makineri për gazimin e pijeve”, me vlerë 119,755 Euro. Kjo pajisje ka shërbyer për aktivitetin tregtar të shoqërisë së babait të tij, Edmond Bllako, operatorin ekonomik “Edmond Bllako” Person Fizik, e cila ka pasur si fushë veprimtarie prodhimin dhe tregtimin e birrës në qytetin Ersekës. Kjo pajisje është blerë pas kërkesës së bërë nga shtetasi Alqi Bllako, me porosi të shtetasit Klodian Zoto, bërë nëpërmjet shoqërisë së bashkëshortes së tij, Ilda Zoto, “Artemis Farm” sh.p.k (aktualisht me emrin e ri tregtar “Artcon” sh.p.k). Pagesat për këtë pajisje janë bërë nga shoqëria e bashkëshortes së shtetasit Klodian Zoto, e cila e ka blerë këtë pajisje nga shoqëria italiane “IC Filling Systems SRL” me pagesa të bëra në dy këste, në datën 22.11.2016, në vlerën 36,489 Euro, me përshkrimin “Pagesë 30% fatura, data 07.11.2016” dhe në datën 11.07.2017, në vlerën 83,266 Euro, me përshkrimin “Payment Invoice 2017-205”.

14.1. Për sa më sipër u trajtua, shtetasi nën hetim Alqi Bllako, me veprimet e kundraligjshme të tij të kryera para dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës koncesionare, për shkak të funksionit të tij me cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, me qëllim marrjen e përfitimeve të parregullta për vete, dysohet se ka konsumuar elementët e veprës penale të “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 të Kodit Penal.

Në lidhje me faktin penal të mësipërm, sipas vlerësimit të bërë nga prokurori, për subjektet që kanë konsumuar elementët e veprës penale të “Korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal, nisur nga koha e kryerjes së veprës penale, ushtrimi i ndjekjes penale është parashkruar për këtë veprë penale, bazuar në nenin 66, gërma “ç” të K.Pr.Penale.

Gjykata vlerëson se lidhur me akuzën që i atribuohet të hetuarit Alqi Bllako, për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, nga analiza në tërësi e faktit penal, dhe duke vënë theksin në funksionin që ka pasur ky shtetas gjatë periudhës në të cilën prokuroria pretendon se është kryer vepra penale për të cilën shtetasi Alqi Bllako po hetohet, pikërisht funksioni i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, gjykata vlerëson se ky fakt penal ka nevojë për një rishikim të kualifikimit ligjor të veprës penale nga ana e organit të akuzës, për këto arsye:

Si vepra penale e korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, ashtu edhe ajo e korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, parashikuar nga neni 259 i K.Penal, janë vepra penale që kanë të njëjtin objekt: marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve shtetërore dhe po kështu, elementet e anës objektive i kanë të njëjtë, nëpërmjet kërimit apo marrjes drejtpërdrejt apo tërthorazi të çfarëdo përfitimi të parregullt për vetë apo për persona të tjerë apo pranimit të një oferte apo premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, për të kryer një veprim apo mosveprim që lidhet me detyrën apo funksionin. Veprat penale të mësipërme ndyshojnë sa i takon subjektit që i kryen ato. Në të dyja rastet subjekti është i posaçëm dhe për të bërë diferencimin midis

këtyre dy veprave penale dhe kualifikimin e duhur ligjor, duhet që së pari të përcaktohet qartë detyra/funksioni i shtetasit nën hetim Alqi Billako gjatë kohës në të cilën është zhvilluar fakti penal, dhe në cilën prej kategorive ajo gjen vend, atë të personave që ushtrojnë funksione publike apo atë të funksionarëve të lartë shtetërorë.

Ndonëse nuk ka një përkufizim të "funksionarit të lartë shtetëror" apo "funksionarit publik", që do të na jepte një parashikim eksplisit të listës së funksioneve të përfshira në gjithësecilën prej këtyre kategorive, mund të themi se në kategorinë e parë, atë të funksionarëve të lartë shtetërorë, përfshihen funksionarët të cilët ushtrojnë detyra/funksione të larta legjislativ apo ekzekutive në nivel qëndror dhe vendor: deputët, të zgjedhurit vendorë, Ministrat, stafet politike të tyre (këshilltarë dhe drejtues kabinetit), drejtuesit e institucioneve qëndrore të emëruar nga Kuvendi apo Këshilli i Ministrave.

Për sa më sipër, i referohemi Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku nëpërmjet terminologjisë së përdorur, bëhet diferencimi midis funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, të cilët janë funksionarë të lartë shtetërorë dhe funksionarëve të lartë të administratës shtetërore, të cilët ushtrojnë funksione publike. Neni 131 i Kushtetutës parashikon se "Gjykata Kushtetuese vendos për: ....e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre", ndërsa neni 69 i saj parashikon se "Nuk mund të kandidojnë e as të zgjidhen deputetë. pa hequr dorë nga detyra: ....e) Presidenti i Republikës dhe funksionarët e lartë të administratës shtetërore të parashikuar nga ligji...".

Ndërkohë, nëse i referohemi Ligjit Nr.9584, datë 17.7.2006, i ndryshuar "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", konstatojmë se në nenin 2 të tij, parashikohen shprehimisht se cilat janë institucionet kushtetuese dhe institucionet e tjera të krijuara me ligj, e konkretisht "Institucione kushtetuese dhe institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj janë: Institucioni i Presidentit, Kuvendi, Avokati i Popullit, Gjykata Kushtetuese, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Autoriteti i Konkurrencës, Enti Rregullator i Telekomunikacionit, Enti Rregullator i Energjisë, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Këshilli i Lartë i Drejtësisë Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit. Ndërkohë neni 2 i këtij ligji jep përfufizimin e funksionarëve të lartë, si më poshtë: "2. "Funksionarë të lartë" janë titullarët e institucioneve që bëjnë pjesë në fushën e veprimit të këtij ligji, të cilët mund të jenë funksionarë politikë ose të tjerë të emëruar, anëtarët e organeve drejtuese të tipit kolegjal të institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, si dhe funksione të përmendura shprehimisht në ligjet përkatëse". Ky ligj ka bërë diferencimin midis pagave dhe shpërblimeve të funksionarëve të lartë, të parashikuara në kreun 2 të tij dhe pagave dhe shpërblimeve të nënpunësve civil/nëpunësve të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, nga niveli sekretar i përgjithshëm deri në specialist, të parashikuara në kreun 4 të tij.

Gjithashtu, gjykata i referohet edhe parashikimeve ligjore të Ligjit "Për nënpunësin civil", i ndryshuar, i cili ka klasifikuar pozicionet në shërbimin civil, në nenin 19 të tij, sipas së cilit "... 2. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori: a) të lartë drejtues; b) të mesëm drejtues; c) të ulët drejtues; ç) ekzekutiv. 3. Secila nga kategoritë, sipas pikës 2 të këtij neni, ndahet në klasa. 4. Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese janë këto pozicione: a)

sekretar i përgjithshëm; b) drejtor departamenti; c) drejtor drejtorie të përgjithshme; ç) pozicionet e barasvlershme me tre të parat...

Po kështu, në nenin 2 të tij ligji përcakton fushën e veprimit të tij, e konkretisht **“Ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim “nëpunës civil”), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, me përjashtim të: a) të zgjedhurve; b) ministrit dhe zëvendësministrit; 2 c) funksionarët e emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës ose Këshilli i Ministrave; ç) gjyqtarit dhe prokurorit; d) shfuqizuar; dh) ushtarakut të Forcave të Armatosura; e) personelit të Shërbimit Informativ Shtetëror; ë) personelit të njërive publike direkte të shërbimit; f) anëtarit dhe kryetarit të organeve kolegjiale drejtuese të komiteteve apo institucioneve në varësi të Kryeministrit apo një ministri; gj) punonjësit administrativ; gj) funksionarit të kabinetit; h) punonjëseve që realizojnë atributet e agjentit/oficerit të Policisë Gjyqësore dhe ata që sipas ligjit lejohet të mbajnë armë; i) civilët në strukturat e Forcave të Armatosura; j) punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare; k) punonjësit e bordeve të kullimit; l) avokatët pranë Avokatit të Shtetit”.** Në këtë mënyrë, ligji i mësipërm ka diferencuar nëpunësit civile, të cilët ushtrojnë funksione publike, si pranë institucioneve të administratës shtetërore, atyre të pavarura apo njërive të qeverisjes vendore, me funksionarët e tjerë, të zgjedhur apo të emëruar, siç listohen më sipër. **Në deduksion logjik, gjykata vlerëson se ky fakt bën diferencimin midis funksionarit publik dhe funksionarit të lartë shtetëror.** Qartazi, funksioni i sekretarit të përgjithshëm pranë një Ministrie, sic edhe konkretisht e ka mbajtur i hetuari Alqi Bllako në rastin konkret, përfshihet në kategorinë e lartë drejtuese të nëpunësve civilë dhe jo të funksionarëve të lartë shtetërorë.

Për arsyet e mësipërme, gjykata sjell në vëmendje të prokurorisë, rishikimin e kualifikimit ligjor të veprës penale për të cilën është duke u hetuar shtetasi nën hetim Alqi Bllako, nga neni 260 në nenin 259 të Kodit Penal, duke u reflektuar ky ndryshim edhe sa i përket subjektit aktiv, shtetasit nën hetim Klodian Zoto, duke u rishikuar kualifikimi ligjor i veprës penale për të cilën është duke u hetuar ky shtetas, nga vepra penale **“Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”**, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal, në veprën penale **“Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”**, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal.

**14.2.** Po ashtu, nga ana e prokurorit, vlerësohet se ka dyshime të arsyeshme se shtetasi Alqi Bllako, nën cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, i ka propozuar shtetasit Vladimir Bezhani që të vazhdonte me ndihmesën e tij si Këshilltar i Jashtëm i Ministrit të Mjedisit dhe të ndihmonte me konsulencë juridike gjatë kohës që kishte lindur idea e projektit të zhvillimit të procedurës së koncesionit në lidhje me trajtimin e mbetjeve në qytetin e Tiranës, përpara se të bëhej propozimi i pakërkuar në Ministrinë e Mjedisit nga shoqëritë **“Energy Recuperator S.P.A”**, **“Paul Eurth Italia S.P.A”**, **“Integrated Technology Services” sh.p.k.** Për shërbimin e tij, si Këshilltar i Jashtëm i Ministrit të Mjedisit, shtetasi Alqi Bllako ka rënë dakord me shtetasin Klodian Zoto, që ta paguante shtetasin Vladimir Bezhani tek shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, i cili ka marrë përfitimin e tij në sajë të pagës së dhënë nga shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, që përkon me momentin e daljes së tij në pension nga data 01.12.2014 deri në muajin shtator të vitit 2022, shtetasi Vladimir Bezhani ka marrë përfitimin e parregullt në sajë të vlerës së pagës së tij mujore 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë, në total në shumën prej 7,520,000 (shtatë milion e pesëqind e njëzet mijë) lekë. Shtetasi Vladimir Bezhani rezulton se gjatë kohës që ka shërbyer si Këshilltar i Jashtëm i Ministrit të Mjedisit në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit, ai ka shërbyer për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm nga Ministria e Mjedisit në lidhje me procedurën e

dhënies së koncesionit, të cilin ia ka vendosur në dispozicion shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm dhe për t'u shpallur fitues i kësaj procedure koncesioni.

Sipas procesverbalit për kqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi C@TS, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të datës 30.11.2023, rezulton se shtetasi Vladimir Bezhani ka qenë i deklaruar si i punësuar në shoqërinë "Integrated Technology Services" sh.p.k, si Këshilltar i shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, nga muaji Janar i vitit 2016 deri në muajin shtator të vitit 2022. Gjatë kësaj periudhe kohore, ky shtetas ka përfituar në mënyrë të parregullt, në saj të vlerës së pagës së tij mujore 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë, vlerën monetare prej 6,480,000 (gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë. Ndërsa rezulton se faktikisht shtetasi Vladimir Bezhani e ka marrë pagën tek kjo shoqëri që nga muaji Dhjetor i vitit 2014. Në total ky shtetas ka marrë përfitime të parregullta në vlerën prej 7,520.000 (shtatë milion e pesëqind e njëzet mijë) lekë.

Për faktin penal të mësipërm, nga prokuroria vlerësohet se shtetasi Alqi Bllako, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, duke i kërkuar/propozuar shtetasit Klodian Zoto dhënien e përfitimit të parregullt për shtetasin Vladimir Bezhani, duke e punësuar fiktivisht tek shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, kjo me qëllim favorizimin gjatë procedurës së dhënies së koncesionit, shoqërinë koncesionare "Integrated Energy BV", në përbërje të së cilës ka qënë aksionere edhe shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, dyshohet për veprën penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione të larta shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. Ndërsa, për faktin penal të mësipërm, rezulton se shtetasi Klodian Zoto, me veprimet e kundraligjshme të tij, dyshohet për veprën penale të "Korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal (në lidhje me përfitimin e parregullt të marrë nga shtetasi Vladimir Bezhani).

Lidhur me faktin e mësipërm që i atribuohet nga ana e prokurorisë të hetuarit Alqi Bllako, Gjykata çmon të trajtojë paraprakisht nëse gjyqtari i hetimit paraprak është i detyruar t'i përmbahet cilësimit juridik të faktit të bërë nga prokuroria në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit apo mund të bëjë një vlerësim të pavarur të faktit të sjellë përpara gjykatës mbështetur në prova. Kështu, në nenin 229 pika 2 të K.Pr.Penale nën titullin "**Kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal**", parashikohet shprehimisht: "**2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete.**", ndërsa në nenin 260 pika 2 të këtij Kodi parashikohet shprehimisht se: "**2. Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë**". Gjykata vlerëson se me termin ligjor të mësipërm "**rëndësia e faktit**" parashikuar nga nenet 229 dhe 260 i K.Pr.Penale nuk nënkuptohet cilësimi juridik që i bëhet faktit nga prokuroria, por nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt<sup>1</sup> që i korrespondon një vepre penale të parashikuar nga Kodi Penal dhe që i nënshtrohet një vlerësimi të pavarur nga gjykata kur shqyrton kërkesën për caktimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit. Gjyqtari i hetimit paraprak është i pavarur në vlerësimin e faktit dhe mund të bëjë një cilësim juridik të ndryshëm të faktit penal nga ai i prokurorisë për të vlerësuar rëndësinë e faktit penal dhe të dënimit që mund të caktohet ndaj të dyshuarit në përfundim të gjykimit. Këtë vlerësim, gjykata e bën në mënyrë të pavarur pavarësisht faktit nëse prokurori ka bërë ndryshimin e cilësimit juridik sipas nenit 287 i K.Pr.Penale, pasi gjykata nuk është e detyruar të mbajë parasysh qëndrimin e prokurorisë lidhur me cilësimin juridik të

<sup>1</sup>Shiko Vendimet Nr. 8, datë 08.05.2005 dhe Nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

faktit. Përkundrazi, gjykata pas administrimit të provave mund të konkludojë se jemi përpara një cilësimi juridik të gabuar të prokurorisë që në fazën e hetimit paraprak. Përcaktimi i saktë i normës që parashikon veprën penale, ka një rëndësi themelore, sepse është një parakusht për respektimin e parimit të ligjshmërisë. Për rrjedhojë vlerësimi i drejtë i faktit penal nga gjykatë është detyrim i saj që rrjedh nga parimi i ligjshmërisë.

Në respektim të parimit të ligjshmërisë, ndryshe nga sa ka arsyetuar prokurori, se shumata e përfuara nga ana e shtetasit Vladimir Bezhani, të dhëna në formën e pagës, janë përfitime të parregullta, pasi punësimi i tij tek shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k ka qenë fiktiv dhe me qëllim favorizimin gjatë procedurës së dhënies së koncesionit, të shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV", gjykata çmon se nga aktet dhe provat e grumbulluara deri në këtë fazë të hetimit, për sa rezultojnë rrethanat e faktit lidhur me këtë moment, nuk krijohen dyshime bazuar në to, për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione të larta shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, për sa do të argumentohet më poshtë:

Në kuadër të kryerjes së veprimeve hetimore është pyetur me cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, shtetasi Vladimir Bezhani, i cili midis tjerave ka deklaruar se deri në date 07.11.2014 ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Mjedisit, me pozicionin "Përgjegjës Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve". Në këtë date ka dalë në pension dhe ka punuar në sektorin privat, konkretisht, si specialist në shoqërinë "Integrated Technology Services" sh.p.k, me pronar shtetasin Klodian Zoto, me pagë fikse neto, 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë. Pranë kësaj shoqërie ka punuar deri nga fundi i vitit 2021. Për shkak të formimit të tij, duke qenë se ishte e nevojshme konsulenca për Ministrinë e Mjedisit, ish-Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, shtetasi Alqi Billako, i ka sugjeruar që të ishte Këshilltar i jashtëm i Ministrit të Mjedisit të kohës, Lefter Koka, por duke qenë se nuk do të paguhej nga Ministria e Mjedisit, shtetasi Alqi Billako i ka thënë që për të marrë pagën, do ta punësonte atë tek shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k, ku dhe është punësuar. Nga viti 2014 deri në vitin 2021, ai ka deklaruar se ka punuar tek shoqëria e mësipërme, por nuk ka patur kontratë punë, ndërsa më vonë, pasi kishte përfunduar procedura e dhënies së Inceneratorit, ai ka lidhur kontratë formale pune me shoqërinë e shtetasit Klodian Zoto, "Integrated Technology Services" sh.p.k.

Referuar deklarimeve të shtetasit Vladimir Bezhani, por edhe provave të administruara deri në këtë fazë të hetimit, rezulton se ky shtetas, deri në date 07.11.2014 ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Mjedisit, me pozicionin "Përgjegjës Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve". Në vijim, rezulton se ky shtetas ka qenë i deklaruar si i punësuar në shoqërinë "Integrated Technology Services" sh.p.k, si Këshilltar i kësaj shoqërie, nga muaji Janar i vitit 2016 deri në muajin shtator të vitit 2022 (Sipas procesverbalit për kqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi C@TS), por sipas deklarimeve të këtij shtetas, menjëherë pas daljes në pension, më datë 07.11.2014, ai ka filluar punë në shoqërinë e mësipërme. Saktësimi dhe sqarimi i këtij fakti paraqitet me vlerë në drejtim të përcaktimit të shumës totale, e cila pretendohet se është përfutur në mënyrë të parregullt nga ana e shtetasit Vladimir Bezhani, por nuk paraqet rëndësi në kuadër të konkludimit mbi ekzistencën ose jo të dyshimit të arsyeshëm, nëse në procedurën e punësimit të mësipërme, vërrehen apo jo elemente të anës objektive të veprës penale të korrupsionit aktiv/pasiv.

Në të kundërt sa pretendon prokuroria, se shtetasi Vladimir Bezhani ka marrë përfitime të parregullta në vlerën prej 7,520,000 (shtatë milion e pesëqind e njëzet mijë) lekë, gjykata

vlerëson se në rastin konkret, ndodhemi përpara një marrëdhënie juridike të rregullt të punësimit, për sa kohë shtetasi i mësipërm ka ushtruar defacto detyrën e tij si këshilltar pranë subjektit privat “Integrated Technology Services” sh.p.k, fakt ky i konfirmuar edhe nga procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e të dhënave nga sistemi C@TS, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku shtetasi Vladimir Bezhani figuron i deklaruar si i punësuar pranë subjektit të mësipërm. Pikërisht për këtë fakt, gjykata vlerëson se vlera e përlogaritur nga e prokurorisë prej 7,520,000 (shtatë milion e pesëqind e njëzet mijë) lekë, e cilësuar si një përfitim i parregullt për shtetasin në fjalë, nuk është e tillë, por e marrë në sajë të punës së ushtruar prej tij, në formën e pagës, në vlerën monetare të dakortësuar midis palëve.

Ndërhyrja e shtetasit Alqi Bllako, për të punësuar shtetasin Vladimir Bezhani pranë Integrated Technology Services” sh.p.k, nuk vlerësohet se përmbush elementet e anës objektive të veprës penale të “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, për sa kohë shumta e përfituar nga ana e shtetasit Vladimir Bezhani nuk konsiderohet si përfitim i padrejtë, aq më tepër i kërkuar të jepet në këmbim të kryerjes apo moskryerjes së ndonjë veprimi që lidhet me funksionin e tij, që deri në këtë moment, nuk rezulton i dokumentuar, në mënyrë që të krijojë dyshimin e arsyeshëm.

15.Në funksion të hetimeve, nga dokumentacioni i sekuestruar pranë shoqërisë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, rezulton se ndodhet në fotokopje edhe dokumenti, kontratë nënkontraktimi, datë 07.12.2017, lidhur ndërmjet shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k me administrator shtetasin italian Giuseppe Ciaffaglione dhe shoqërisë “Integrated Technology Services” sh.p.k, me administrator shtetasin Klodian Zoto, i cili në kohën e lidhjes së kësaj kontrate ishte dhe *aksioner i shoqërisë koncesionare* “

15.1.Nga analizimi i të dhënave që rezultojnë nga librat e shitjes (referohu tabelave respektive në pjesën e rrethanave të faktit) të shoqërisë “Intergrated Energy BV SPV” sh.p.k; analizimi i llogarive bankare që shoqëria koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, disponon në bankën Credins dhe në bankën Raiffeisen, rezultojnë dukshëm mospërputhje ndërmjet shumës monetare të paguar nga shoqëria koncesionare “Intergrated Energy BV SPV” sh.p.k, në drejtim të shoqërisë së shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services” sh.p.k, krahasuar me faturimet e kryera nga shoqëria e shtetasit Klodian Zoto, “Integrated Technology Services” sh.p.k, në drejtim të shoqërisë koncesionare “Intergrated Energy BV SPV” sh.p.k.

15.2.Nga aktet e administruara rezulton se shoqëria e shtetasit Klodian Zoto “Integrated Technology Services” sh.p.k, në lidhje me kontratën koncesionare ku rezultojnë se aksionerët “de facto” janë shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, ka përfituar në sajë të faturave tatimore të falsifikuara, vlerën monetare 409,428,000 (katërqind e nëntë milion e katërqind e njëzet e tetë mijë) lekë, duke paraqitur dhe deklaruar fatura për punime të kryera si nënkontraktor i shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, me subjekte fiktive, të cilët rezultojnë të regjistruar si operatorë ekonomikë, por që nuk kanë ushtruar asnjëherë ndonjë aktivitet real tregtar. Në rastin konkret shtetasi Klodian Zoto ka deklaruar punime të kryera për llogari të shoqërisë koncesionare në bazë të një kontrate nënkontraktimi të falsifikuar, duke e paraqitur situatën vetëm si një marrëdhënie kontraktuale mes shoqërisë së tij “Integrated Technology Services” sh.p.k dhe shoqërisë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, por që në të vërtetë rezulton se shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri janë aksionerët “de facto” të shoqërisë koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k, që ka fituar kontratën koncesionare nr.6597, datë 31.08.2017 me

objekt "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë". Në përmbajtje të këtyre faturave, shtetasi Klodian Zoto ka paraqitur si kryerje të punimeve dhe blerje mallash me subjektet "Lumi-06" sh.p.k, "AA-117" sh.p.k, "Al-BerCo&Co" sh.p.k, "EZ & LA" sh.p.k. por që në të vërtetë përmbajnë rrethana të rreme të përshkruara në to.

15.2.1. Vlerat monetare të mësipërme rezultojnë se janë siguruar në sajë të mashtrimit nëpërmjet paraqitjes së faturave të falsifikuara, ku janë tërhequr një pjesë e madhe e vlerave monetare në cash dhe janë transferuar në mënyra të ndryshme jashtë vendit nga shtetasi Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri. Po ashtu, rezultojnë se shtetasi Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto, si aksionerët "de facto" të shoqërisë koncesionare, kanë përgatitur preventiva të falsifikuara duke fryrë treguesit në kostot e ndërtimit, të përfshira dhe në studimin e fizibilitetit të paraqitur nga ana e tyre, për fitimin e kontratës koncesionare nr.6597, datë 31.08.2017 me objekt "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë".

15.3. Për sa më sipër u trajtua, gjykata vlerëson se shtetasit nën hetim Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, aksionerët "de facto" të shoqërisë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, dyshohet se kanë kryer veprat penale "Mashtrimi" me pasoja të rënda, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 143/3, 25 i Kodit Penal, "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 287/ gërma "a" dhe "b" të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese "në bashkëpunim", sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal.

**Veprimet e kryera në Qendrën Kombëtare të Biznesit lidhur me shoqërinë "Integrated Energy BV SPV"**

16. Nga hetimi në lidhje me aksionerët e shoqërisë hollandeze "Geogenix BV" (ish-"Integrated Energy BV"), e cila zotëron si aksioner i vetëm me 100 % të aksioneve në shoqërinë koncesionare "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k. kanë rezultuar të dhënat si më poshtë:

16.1. Me datë 31.08.2017 është lidhur kontrata e koncesionit me objekt "Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë", ndërmjet Ministrisë së Mjedisit të Republikës së Shqipërisë dhe operatorit ekonomik "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k.

16.2. Nga verifikimet e kryera në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezultojnë se shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., është themeluar me datë 30.08.2017 si 'Subjekt për Qëllime të Veçanta (SPV)', dhe është regjistruar me datë 31.08.2017 në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Ky operator ekonomik ka si aksioner të vetëm (100%) shoqërinë hollandeze "Integrated Energy BV", sot me emrin e ri tregtar "Geogenix BV".

16.3. Nga dokumentacioni i administruar rezultojnë se Aktin dhe statutin e themelimit të shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, e ka nënshkruar shtetasi Klodian Zoto, si përfaqësues i shoqërisë hollandeze "Integrated Energy BV", (sot me emrin e ri tregtar "Geogenix BV"). Administratori i shoqërisë të krijuar në Shqipëri "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, nga shoqëria hollandeze "Integrated Energy BV", është caktuar shtetasi italian Giuseppe Ciaffaglione.

16.4. Pas këqyrjes së dokumentacionit që rezulton nga Qendra Kombëtare e Biznesit lidhur me këtë shoqëri, lidhur me historikun e aksionerëve respektivë, vlerat në përqindje të aksioneve të tyre etj, rezulton se nga dokumentacioni që shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, ka dorëzuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për të kryer deklarimin e pronarëve përfitues fundor të shoqërisë "Integrated Energy BV SPV", rezulton se nuk është dorëzuar nga shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, në QKB, dokumentacioni shoqërues justifikues për të provuar ndryshimin e aksionerëve përkatës për periudhën kohore në fjalë, sipas përcaktimeve të ligjit nr.112 të vitit 2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar, si dhe VKM nr.1008, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara".

16.5. Po ashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit që shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, ka dorëzuar në QKB, për të kryer këtë deklarim të pronarëve përfitues fundorë, rezulton se administratorja e shoqërisë "Integrated Energy BV SPV", shtetasja Arjola Kodra ka dorëzuar kopjen e pasaportës të shtetasve **Alberto Pressezzi** dhe **Salvatore Ruselli**, nëpërmjet të cilave këta shtetas janë deklaruar të shënuar si aksionerë me përqindjet përkatëse, por që në të vërtetë nuk rezulton që të kenë qenë aksioner këta shtetas në momentin e regjistrimit në QKB.

16.6. Për këtë fakt janë pyetur shtetasit **Arjola Kodra, Jetmir Llapaj dhe Silena Tola**, ku shtetasi Jetmir Llapaj në thelb ka deklaruar se eprorja e tij ka qenë shtetasja Silena Tola, me pozicion Drejtoreshë e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe ajo ka pasur aksesin që të ishte personi i fundit që refuzonte aplikimet. Ai vetë ka patur qëndrimin që operatorit "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k, duhej t'i refuzohej aplikimi dhe t'i kërkohej dokumentacion shtesë provues, por pasi eprorja e tij, shtetasja Silena Tola, i ka thënë që duhej të rishikonte aplikimin pasi ai ishte në rregull, ai ka bërë bërë miratimin e aplikimit të këtij subjekti tregtar. Ndërsa shtetasja nën hetim Silena Tola në thelb ka deklaruar se komunikimi që ka pasur me vartësin e saj, shtetasin Jetmir Llapaj duke i lënë në sistemin elektronik të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, komentin "*rishikoje se më duket në rregull*", nuk ka qenë urdhër për miratimin e aplikimit dhe se miratimi është kryer nga vartësi i saj, shtetasi Jetmir Llapaj. Ajo ka deklaruar se bazuar në dokumentacionin që ka dorëzuar operatori ekonomik në muajin Qershor të vitit 2021, aplikimi i këtij subjekti raportues duhej që të ishte refuzuar në bazë të ligjit, pasi ka mungesë dokumentacioni, siç janë ekstraktet e kompanive të huaja, që janë pronarë të subjektit raportues.

16.7. Për sa më sipër u trajtua, gjykata vlerëson se shtetasit nën hetim **Jetmir Llapaj dhe Silena Tola**, punonjës të Qendrës Kombëtare të Biznesit, të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr.112/2020 "Për regjistrin e pronarëve përfitues", si dhe në kundërshtim me VKM nr.1008, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara".

16.7.1. Ligji nr.112/2020 "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues", në nenin 3 të tij, me titull "*Përkufizime*", pika 10, parashikon se: *...10. "Të dhëna" janë faktet, aktet dhe informacionet që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, të cilët identifikojnë pronarët përfitues të subjekteve raportuese.*"

Neni 4 "Administrimi i Regjistrit të Pronarëve Përfitues", pika 2 dhe 7 parashikojnë se: *...2. Qendra Kombëtare e Biznesit është përgjegjëse: a) të regjistrojë, të administrojë, të përpunojë dhe të ruajë në regjistër të dhënat e deklaruara nga subjektet*

*raportuese....7.Rregullat për procedurën e regjistrimit të të dhënave në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, mënyrën e transferimit të të dhënave nga Regjistri Tregtar dhe Regjistri i Organizatave Jofitimprurëse si dhe funksionimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Neni 6 “Mënyra e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues”, pika 8, parashikon se 8.Rregullat për mënyrën dhe arsyet e refuzimit për regjistrimin e të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**16.7.2.VKM nr.1008, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e mënyrës dhe të procedurave të regjistrimit e publikimit të të dhënave për pronarët përfitues, si dhe të njoftimit nga autoritetet shtetërore kompetente e nga subjektet e detyruara”, në Kreun III, me titull Dokumentacioni dhe forma e kërkuar, parashikon se:**

*1. Subjektet raportuese kanë detyrimin të ruajnë e të mbajnë të dhëna dhe dokumente shoqëruese të duhura, të sakta e të përditësuara, në hazë të të cilave përcaktohen pronarët përfitues të subjektit dhe lloji i kontrollit të pronarëve të tyre përfitues. Personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues në aplikimin elektronik për regjistrimin e pronarit përfitues bashkëlidh si dokumentacion shoqërues, në format elektronik, aktet, si më poshtë vijon:*

*a) Në rastin e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues:*

*i. dokumentacionin që vërteton numrin unik të identifikimit dhe emrin e subjektit raportues, si dhe datën e regjistrimit të subjektit në regjistrin përkatës;*

*ii. dokumentacionin që vërteton të dhënat e identifikimit të pronarit përfitues, sipas pikës 3.2.1. të nenit 4. të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues;*

*iii. dokumentacionin e autoritetit kompetent regjistruar, që vërteton se pronari përfitues i regjistruar është zotërues i 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit, të të drejtave të votimit ose të interesave të pronësisë, nëse nuk përmban datën e përcaktimit si pronar përfitues, duhet të depozitohet një dokument tjetër që përmban këtë të dhënë; ose*

*iv. dokumentacionin tjetër që zotëron subjekti raportues që përmban informacionin e nevojshëm për identifikimin dhe regjistrimin e pronarit, përfitues të tij, sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.*

**16.8.Për faktin penal të mësipërm, shtetasit Jetmir Llapaj dhe Silena Tola, me veprimet dhe mosveprimet e kundraligjshme të tyre, dyshohet se kanë kryer veprën penale “ Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal, pasi në kundërshtim nga sa normojnë dispozitat më sipër, kanë regjistruar si pronarë përfitues fundorë, shtetasit Alberto Pressezzi dhe Salvatore Ruselli, të shënuar si aksionerë me përqindjet përkatëse në shoqërinë “Integrated Energy BV SPV”, sh.p.k por që në të vërtetë nuk rezulton që të kenë qenë aksioner këta shtetas në momentin e regjistrimit në QKB.**

**Shoqëria “F.M.O” sh.p.k**

**17. Nga aktet dhe provat e administruara gjatë fazës së hetimit, ka rezultuar se shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri kanë në zotërim indirekt edhe shoqërinë “F.M.O” sh.p.k, me administrator shtetasin Fatos Bunoca. Rezulton se shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri zotërojnë në mënyrë indirekte pasurinë e paluajtshme me nr. 5/ 1183- N1/2, Zona Kadastrale 8513, Volumi 81; Faqe 242; me sipërfaqe 611 m<sup>2</sup>, me adresë: “Durrës, L. 17 Rr. P. Hanxhari”. Për të humbur gjurmët nga pronësia e vërtetë e tyre, kjo pasuri është blerë në emër të shtetasit Fatos Bunoca, sipas aktit noterial “Kontratë shitje me rezervë e pasurisë së paluajtshme” nr. 26 rep., nr. 17 kol.,**

datë 13.01.2017, në shumën 1,100,000 (një milion e njëqind mijë) Euro, por që në fakt likuidimi i kësaj kontrate në drejtim të shitësit është bërë nga shtetasi Klodian Zoto.

17.1. Në kuadër të hetimit, është sekuestruar akti noterial, "Kontratë shitje me rezervë e pasurisë së paluajtshme" nr. 26 rep., nr. 17 kol., datë 13.01.2017, me palë shitëse shoqëria "Ëind - co" sh.p.k, e përfaqësuar nga shtetasja Brunilda Koka dhe me palë blerëse shoqëria "F.M.O" sh.p.k, e përfaqësuar nga shtetasi Fatos Bunoca. Objekti i kësaj kontrate është shitja e pasurisë nr. 5/ 1183- N1 në qytetin e Durrësit me këto të dhëna: Zona Kadastrale 8513; Adresa e pasurisë "Durrës, L. 17 Rr. P. Hanxhari"; Volumi 75; Faqe 33; Indeks Harte DR-H I-6.7; sipërfaqja totale 2223,3 m<sup>2</sup>, lloji i pasurisë "njësi". Vlera e kontratës është 4,000,000 (katër milion) Euro. Si pjesë e kontratës është parashikuar se nëse shoqëria "F.M.O" sh.p.k, nuk paguan çmimin total, me skadimin e afatit maksimal 15.05.2017, atëherë shoqëria "F.M.O" sh.p.k, do të fitojë pronësinë për aq sipërfaqe sa i korrespondon vlefës së paguar dei më skadimin e afatit 15.05.2017. Kriteri është 1,800 Euro/m<sup>2</sup> (njëmijë e tetëqind euro për metër katror).

17.2. Në rrethanat e mësipërme, rezulton se pronarët "de facto" të shoqërisë "F.M.O" sh.p.k, janë shtetasit Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, të cilët rezultojnë të jenë edhe pronarët e pasurisë së paluajtshme të blerë në shumën 1, 100, 000 Euro, por që për fshehur origjinën e vërtetë të pronës kanë përdorur shtetasin Fatos Bunoca, për të kryer aktin e blerjes së saj.

Në nivelin e provave të grumbulluara deri në këto momente nga ana e organit të akuzës, ekziston dyshimi i arsyeshëm se i hetuari Lefter Koka, me cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Ministria e Mjedisit, të hetuarit Valbona Ballgjini, Pëllumb Abeshi, Erjon Murataj, Sidita Temali, Etleva Kondi, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të dhënies së koncesionit, e hetuara Alba Thoma, në cilësinë e Drejtoreshës së Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Mjedisit, i hetuari Bledar Karoli, në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve në Ministrinë e Mjedisit, e hetuara Silena Tola, në cilësinë e Drejtoreshës së Regjistratit të Pronarëve Përfitues pranë QKB-së si dhe i hetuari Jetmir Llapaj, punonjës pranë QKB-së, kanë konsumuar elementet e shpërdorimit të detyrës, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal, ndërsa i hetuari Alqi Bilako, me cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, dyshohet se ka kryer veprën penale "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", dy herë, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal; i hetuari Klodian Zoto, dyshohet se ka kryer veprat penale "Mashtrimi" me pasoja të rënda, në bashkëpunim, "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", të parashikuara përkatësisht nga nenet 143/3, 25, 245 të Kodit Penal, "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287, gërmat "a" dhe "b" të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese "në bashkëpunim", sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal dhe i hetuari Mirel Mërtiri, dyshohet se ka kryer veprat penale "Mashtrimi" me pasoja të rënda, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 143/3, 25 i Kodit Penal, "Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287, gërmat "a" dhe "b" të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese "në bashkëpunim", sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal.

Gjykata, për sa më sipër vlerëson se në rastin konkret, plotësohet, kushti themelor i përgjithshëm për caktimin e masave të sigurimit personal, të parashikuar në nenin 228 pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: "Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i buzuar në prova". Në arritjen e këtij konkluzioni gjykata mban parasysh edhe arsyetimin e

Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues Nr.7 datë 14.10.2011, sipas të cilit: *„...dysshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit a të gjykuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij...”*.

Lidhur me kërkesën e prokurorisë për caktimin si masë sigurimi atë të “arrestit në burg” ndaj personave nën hetim **Lefter Koka, Alqi Billako, Erjon Murataj, Taulant Tusha, Namik Simixhiu, Bledar Karoli, Jetmir Llapaj, Klodian Zoto, Mirel Mërtiri**, të parashikuar nga neni 232, pika “dh” dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata çmon se ajo duhet të pranohet, pasi ekzistojnë kushtet dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit personal, si dhe kriteret e veçanta të caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”.

Gjatë gjykimit të kërkesës nga gjykata nuk u konstatua ekzistenca e ndonjë rrethane padënueshmërie apo shuarje e veprës penale. Personat nën hetim ndaj të cilëve kërkohet të caktohet masa e sigurimit personal “Arrest në burg” janë madhorë, tërësisht të përgjegjshëm dhe nga faktet që provat prezantojnë nuk paraqitet asnjë shkak padënueshmërie apo të shuarjes së veprës penale. Kështu, edhe elementi i dytë i kushtit të dytë të përgjithshëm plotësohet (neni 228/2 i K.Pr.Penale) sipas të cilit: *“Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale”*.

Pika 3 e nenit 228 të K.Pr.Penale, vendos kushte të cilat nuk janë domosdoshmërisht kumulative për t’u plotësuar, megjithatë edhe mund të ekzistojnë njëherazi, por mjafton ekzistenca e njëres prej tyre që të nxjerrë në konkluzion gjykatën se jemi para një rasti të ligjshëm për të caktuar një masë sigurimi personal. Konkretisht, neni i mësipërm në pikën 3 të tij parashikon se: *“...3. Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”*.

**Së pari**, plotësohet kushti i parë i veçantë i parashikuar nga shkronja “a”, pika 3, të nenit 228 të K.Pr.Penale, pasi ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës në funksion të hetimit të kësaj çështjeje. Për faktin e ndodhur po zhvillohen hetime në drejtim të sqarimit të plotë të rrethanave të faktit dhe për shkak të funksioneve që kanë ushtruar më parë shtetasit nën hetim në kohën e kryerjes së veprës penale, këta shtetas, për shkak të marrdhënieve të krijuara si rezultat i ushtrimit të funksioneve të mësipërme dhe influencave që mund të kenë tek persona të tjerë, ekziston mundësia që të ndërhyjnë dhe të ndikojnë në prishjen apo asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e tyre, çfarë do të ndikonte në një hetim të mangët për sqarimin e plotë të faktit penal objekt gjykimi.

**Së dyti**, plotësohet kushti i dytë i veçantë i parashikuar nga shkronja “b”, pika 3, të nenit 228 të K.Pr.Penale, pasi gjykata vlerëson se në rastin konkret, duke analizuar rrethanat e faktit, duke patur parasysh rrezikshmërinë e veprave penale, për kryerjen e të cilave dyshohen shtetasit nën hetim, sanksionet e parashikuara në dispozitat përkatëse si dhe

pasojat që kanë ardhur nga ushtrimi i aktivitetit kriminal, i cili rezultoi se ka zgjatur në kohë nga muaji gusht i vitit 2017 deri aktualisht, ekziston rreziku që të hetuarit të largohen.

**Gjithashtu, gjykata mban parasysh kriteret për caktimin e masave të sigurimit të parashikuara nga neni 229<sup>2</sup> të Kodit të Procedurës Penale, përshtatshmërinë e tyre lidhur me shkallën e nevojave të sigurimit që duhet marrë në rastin konkret, rëndësinë e faktit, sanksionin e parashikuar në dispozitat përkatëse si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.**

Kështu, duke patur parasysh rrezikshmërinë e veprave penale, e cila vlerësohet e lartë jo vetëm për shkak të marrëdhënieve juridike që çënon dhe sanksionit të parashikuar në dispozitat përkatëse por, edhe për shkak të përhapjes që kanë marrë kohët e fundit, veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv, shpërdorimit të detyrës, pastrimit të produkteve të veprës penale dhe mashtrimit, duke marrë parasysh faktin e kryerjes së tyre në formën e bashkëpunimit, kushtet e mungesës së rrethanave lehtësuese deri në këtë fazë të hetimit, gjykata, çmon se çdo masë tjetër do të jetë e papërshtatëshme dhe këtu, i referohet paragrafit të parë të nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, *“Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatëshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit”*. Në përputhje me analizën e bërë më sipër, arrijmë në përfundimin se veprat penale për të cilat dyshohohet shtetasit më sipër, paraqesin shkallë të lartë rrezikshmërie shoqërore. Gjykata në mbështetje të neneve 229 e 230 të Kodit të Procedurës Penale çmon se masa e sigurimit “arrest në burg”, që parashikohet nga neni 238 i K.Pr.Penale është në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit dhe në raport të drejtë me faktin e kundërligjshëm për të cilin dyshohet dhe çmohet të jetë masa më e përshtatshme, duke e parë atë edhe në raport me rëndësinë e faktit, pasojën e ardhur dhe me sanksionet që parashikojnë dispozitat penale konkrete.

Ndërsa për të hetuarat **Valbona Ballgjini, Alba Thoma, Sidita Koplaku, Silena Tola**, dyshuar për kryerjen e veprës penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal, gjykata duke patur parasysh rrezikshmërinë e veprave penale, sanksionin me burgim deri në 7 vjet, shkallën e nevojave të sigurimit, raportin e drejtë mes rëndësisë së faktit të ndodhur dhe sanksioneve që parashikohen për veprat penale, moshën e të hetuarave si dhe rrethanat familjare të tyre, çmon se duhet të caktojë masat e sigurimit të kërkuara nga prokurori, e konkretisht atë të *“arrest në shtëpi”* parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale.

Ndryshe nga sa ka kërkuar prokurori lidhur me të hetuarit **Etleva Kondi dhe Pëllumb Abeshi**, për caktimin ndaj tyre të masës së sigurimit personal “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, gjykata çmon se ndaj tyre duhet të caktohet masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale. Gjykata ka parasysh moshën e të hetuarit Pëllumb Abeshi (65 vjeç) si dhe gjendjen familjare të të hetuarës Etleva Kondi, e cila referuar certifikatës familjare të saj, është kryefamiljare dhe ka në ngarkim një fëmijë të mitur (12 vjeç), kjo lidhur edhe me zbatimin e parimit të rëndësishëm të së drejtës penale për interesin më të lartë të fëmijës. Në rastin konkret rezultoi se kujdestarja e vetme e fëmijës së mitur është nëna e saj dhe vendosja e masës së sigurimit “arrest në burg” për të hetuarën Etleva Kondi, do të çënonte njëkohësisht interesin më të lartë të fëmijës, për të

<sup>1</sup>Kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal

1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhet marrë në rastin konkret.

2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprat penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.

3. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror, social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Gjykata duhet të vlerësojë me përparësi interesin më të lartë të të miturit, duke mbajtur parasysh dhe aftësinë e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të tij si dhe vazhdimësinë e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore. Në këto kushte, duke qenë se e hetuara Etleva Kondi është prindi i vetëm kujdestar për fëmijën e mitur, në zbatim të parimit të mësipërm, gjykata çmon se ndaj saj duhet të caktohet masa e sigurimit "Arrest në shtëpi", parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

Për sa më lart, Gjykata ka vlerësuar në mënyrë ezauruese kushtet e kriteret për caktimin e masave të sigurimit, si dhe përse gjejnë ato zbatim në çështjen konkrete (*Sarban kunder Moldavise*, 2005).

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazë të neneve 112/2, 228, 229, 230, 232, pika 1 gërmat "d" dhe "dh", 237, 238, 244, 245, 249 dhe 466 të Kodit të Procedurës Penale:

## V E N D O S I

I.Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

1. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në burg", e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Lefter Koka**, i biri i Haki-ut dhe i Lumturie-s, i datëlindjes 04.08.1964, lindur dhe banues në Durrës, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i dyshuar: për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.
2. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në burg", e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Alqi Bllako**, i biri i Edmond-it dhe i Kostanca-s, i datëlindjes 10.05.1987, lindur në Ersekë banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i dyshuar: "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*". dy herë, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal.
3. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në burg", e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Erjon Murataj**, i biri i Selman-it dhe i Ervehe-së, i datëlindjes 02.08.1982, lindur në Sarandë, banues në Tiranë me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i dyshuar: për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.
4. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në burg", e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Taulant Tusha**, i biri i Ndue-s dhe i Drita-s, i datëlindjes 24.06.1977, lindur në Laç, banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i dyshuar: për kryerjen e veprës

penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

5. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “**arrest në burg**”, e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Namik Simixhiu**, i biri i Ajet-it dhe i Nezver, i datëlindjes 02.12.1957, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i **dyshuar**: për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.
6. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “**arrest në burg**”, e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Bledar Karoli**, i biri i Romeos dhe i Ferjale-s, i datëlindjes 31.12.1978, lindur në Elbasan, banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i **dyshuar**: për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.
7. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “**arrest në burg**”, e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Jetmir Llapaj**, i biri i Edmond-it dhe i Anila-s, i datëlindjes 01.12.1994, lindur në Fier, banues në Tiranë, me gjendje civile beqar. me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i **dyshuar**: për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.
8. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “**arrest në burg**”, e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Klodian Zoto**, i biri i Agim-it dhe i Valentina-s, i datëlindjes 24.04.1976, lindur dhe banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i **dyshuar**: për kryerjen e veprave penale “*Mashtrimi*” me pasoja të rënda, në bashkëpunim, “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë*”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 143/3, 25, 245 të Kodit Penal, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287, gërmat “a” dhe “b” të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal.
9. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “**arrest në burg**”, e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Mirel Mërtiri**, i biri i Trifon-it dhe i Andoniqi-t, i datëlindjes 08.08.1978, lindur në Fier, banues në Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i **dyshuar**: për kryerjen e veprave penale “*Mashtrimi*” me pasoja të rënda, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 143/3, 25 i Kodit Penal, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287, gërmat “a” dhe “b” të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “në bashkëpunim”, sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal.
10. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “**arrest në shtëpi**”, e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasit nën hetim **Pëllumb Abeshi**, i biri i Hamdi-ut dhe i Fatime-s, i datëlindjes 06.05.1958, lindur në Elbasan, banues në Tiranë, me gjendje civile i martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i **dyshuar**: për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

- 10.1. Urdhërohet shtetasi nën hetim **Pëllumb Abeshi**, të mos largohet nga banesa e tij e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga "Beqir Rusi", ndërtesa 25, hyrja 9, ap.5, njësia administrative 4.
11. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në shtëpi", e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj shtetases nën hetim **Etleva Kondi**, e bija e Goxho-s dhe e Vitori-së, e datëlindjes 29.03.1972, lindur në Vlorë, banues në Tiranë, me gjendje civile beqare, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, e **dyshuar**: për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.
- 11.1. Urdhërohet shtetasja nën hetim **Etleva Kondi**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: Bulevardi "Zhan D'Ark", ndërtesa 53, hyrja 1, njësia administrative nr.2.
12. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në shtëpi", e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetases nën hetim **Valbona Ballgjini**, e bija e Shyqyri-ut dhe i Diana-s, e datëlindjes 07.07.1985, lindur në Durrës, banues në Tiranë, me gjendje civile e martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, e **dyshuar**: për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.
- 12.1. Urdhërohet shtetasja nën hetim **Valbona Ballgjini**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga "Alqi Boshnjaku", ndërtesa 38, hyrja 6, ap.36, njësia administrative nr.10.
13. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në shtëpi", e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetases nën hetim **Alba Thoma**, e bija e Viktor dhe e Irena, e datëlindjes 06.09.1982, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me gjendje civile e martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, e **dyshuar**: për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.
- 13.1. Urdhërohet shtetasja nën hetim **Alba Thoma**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga "Robert Shvarc", ndërtesa 75, hyrja 7, ap.21, njësia administrative nr.5.
14. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues "arrest në shtëpi", e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetases nën hetim **Sidita Kopliku**, e bija e Avenir dhe e Avidane, e datëlindjes 23.10.1988, lindur në Shkodër, banues në Tiranë, me gjendje civile e martuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, e **dyshuar**: për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.
- 14.1. Urdhërohet shtetasja nën hetim **Sidita Kopliku**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga "Prokop Myzeqari", ndërtesa 31, hyrja 1, ap.1, njësia administrative nr.9.

15. Caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues “arrest në shtëpi”, e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, ndaj shtetasës nën hetim **Silena Tola**, e bija e Vangjo dhe e Nexhmije, e datëlindjes 02.08.1989, lindur në Poliçan, banues në Tiranë, me gjendje civile beqare, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, e dyshuar: për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248, 25 i Kodit Penal.

15.1. Urdhërohet **shtetasja nën hetim Silena Tola**, të mos largohet nga banesa e saj e ndodhur në Tiranë, në adresën: rruga “Ptero Nini Luarasi”, ndërtesa 80, hyrja 8, ap.1, njësia administrative nr.2.

II. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të ekzekutojë vendimin e gjykatës, nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

III. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5 ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 07.12.2023

SEKRETARE

BORA TOTOLAKU



GJYQTARE

IRENA GJOKA

